



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute

DORACAKU I GJYQTARËVE PËR PROCEDURËN PENALE

Botuar nga:

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK) dhe Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it në Kosovë

Autorë:

Bashkim Hyseni, Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj
Afrim Shala, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan

Kontribuues:

Në emër të IGjK-së:

Besim Morina, Koordinator i Programit

Valon Jupa, Udhëheqës i Programit për Trajnime të Vazhdueshme

Të drejtat e autorit © 2015 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK) dhe Programit për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it nuk pranojnë çfarëdo detyrimi sa i përket përmbajtjes së këtij doracaku dhe nuk janë përgjegjës për temat e trajtuara, korrektësinë, tërësinë ose cilësinë e informatave të paraqitura. Prandaj, kërkesat në lidhje me dëmin e shkaktuar për shkak të përdorimit të çfarëdo informate të dhënë, duke përfshirë çfarëdo informate e cila nuk është e plotë ose e saktë do të hedhen poshtë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGjK).

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme ose e saktë, përmbajtja ose vlefshmëria e pjesëve tjera mbetet e pandikuar nga ky fakt.

Botimi i këtij doracaku është mundësuar nga Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it në Kosovë.

Përmbajtja

AKRONIMET	8
Parathënie	10
Fjala e Autorëve.....	12
I.KOMPETENCA E GJYKATAVE	14
1.1 Shqyrtime të Përgjithshme.....	17
1.2 Kompetenca Funktionale	18
1.3 Kompetenca Territoriale	20
1.4 Bashkimi i Procedurës	21
1.5 Veçimi i Procedurës	21
1.6 Kalimi i Kompetencës Territoriale	22
1.7 Pasojat e Mungesës së Kompetencës	23
1.8 Përjashtimi	23
1.9 Lista Kontrolluese	27
II. HETIMET DHE FILLIMI I PROCEDURËS PENALE	30
2.1. Hetimet dhe Fillimi i Procedurës Penale	34
2.2 Masat e Fshehta dhe Teknike të Vëzhgimit dhe Hetimit.....	36
2.3 Kontrolli dhe Konfiskimi	41
2.4 Ekspertimi në Procedurën Penale	47
2.5 Mundësia Hetuese e Veçantë.....	50
2.6 Mbrojtja e të Dëmtuarve dhe Dëshmitarëve	53
2.7 Heqja e Lirisë dhe Masat për Sigurimin e Pranisë së të Pandehurit në Procedurën Penale.....	60
III. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT	66
3. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit.....	68
3.1 Shqyrtime të përgjithshme	68
3.2 Thirrja	68
3.34 Urdhërarrestit	69
3.4 Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin	70
3.5 Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar	71
3.6 Paraqitja në stacionin policor.....	72
3.7 Dorëzania	73
3.8 Arresti shtëpiak	75
3.9 Diversioni.....	76
3.10 Paraburgimi.....	77
IV. SHQYRTIMET DHE PROCEDURAT PAS NGRITJES SË AKTAKUZËS	92
4.1 Shqyrtimet dhe procedurat pas ngritjes së aktakuzës	95
4.2. Kundërshtimi i provave.....	106
4.3 Kërkesa për hudhjen e aktakuzës.....	107
4.4 Hudhja e aktakuzës	109
4.5 Shqyrtimi i dytë.....	112

V. SHQYRTIMI GJYQËSOR	116
5.1 Shqyrtimi gjyqësor.....	119
5.2 Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor.....	136
VI. AKTGJYKIMI.....	148
6. Aktgjykimi	151
6.1 Çka është aktgjykimi?	151
6.2 Cilat janë aktet akuzuese?	151
6.3 Marrja e aktgjykimit	152
6.4 Identiteti subjektiv dhe objektiv në mes të aktgjykimit dhe aktakuzës	157
6.5 Në cilat prova mund të bazohet aktgjykimi?	159
6.6 Llojet e aktgjykimit.....	162
6.7 Shpallja e aktgjykimit (neni 366 i KPP)	178
6.8 Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit (neni 367 i KPP)	180
6.9 Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit (neni 369 i KPP)	180
6.10 Forma dhe përmbajtja e aktgjykimit (neni 370 i KPP)	182
6.11 Përmirësimi i gabimeve të imëta dhe teknike të aktgjykimit (neni 371 i KPP)	186
6.12 Ekzekutimi i sanksioneve penale pas shpalljes së aktgjykimit (neni 372 i KPP)	
.....	187
6.13 Urdhërarresti për ekzekutimin e sanksionit penal.....	188
VII. PROCEDURAT E VEÇANTA.....	190
7 Procedurat e veçanta	192
7.1 Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimit	192
7.2 Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore	195
7.3 Procedura për revokimin e dënimeve alternative.....	200
VIII. PËRMBLEDHJE E DISA VENDIMEVE GJYQËSORE, PROCESVERBALEVE DHE SHKRESAVE TJERA.....	206
8. Përmbledhje e disa vendimeve gjyqësore, procesverbaleve dhe shkresave tjera	208
8.1 Formulari numër 1. Procesverbali seancës dëgjimore mbi paraburgimin	208
8.2 Formulari numër 2. Aktvendim për caktimin e paraburgimit.....	212
8.3 Formulari numër 3. Aktvendim për lirim nga paraburgimi	215
8.4 Formulari numër 4. Aktvendim për heqjen e masës së paraburgimit	218
8.5 Formulari numër 5. Aktvendim për vazhdimin e masës së paraqitjes në stacionin policor	221
8.6 Formulari numër 6. Procesverbal i shqyrtimit fillestar.....	223
8.7 Formuari numër 7. Aktvendim për hudhjen e aktakuzës.....	226
Biografia e Autorëve.....	229
LITERATURA:	231

AKRONIMET

GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil

INTERPOLI – Organizata Ndërkombëtare e Policisë

IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

KPP - Kodi i Procedurës Penale

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut

RK – Republika e Kosovës

PARATHËNIE

Të nderuar lexues,

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka mision përkrahjen e zhvillimit të gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet me të larta ndërkombëtare, si dhe në funksion të zbatimit të programeve të trajnimit për gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

Ky doracak i hartuar me mbështetjen e ofruar nga Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it, është një nga mjetet praktike përmes të cilit gjyqtarëve, ju mundësohet për të qenë më produktiv, t'i sfidojnë vështirësitë praktike dhe t'i inspirojë në arritjen e zgjidhjeve të drejta, i cili nuk ka për qëllim të jetë një komentuar në procedurën penale apo ligjet tjera substanciale të Kosovës.

Që nga momenti kur vendosëm të përgatisim një doracak të tillë kishim në mendje idenë e ofrimit të një mundësie më tepër për t'iu shërbyer gjyqtarëve në gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë më efikase, dhe lehtësuese në procesin e menaxhimit të rasteve.

Gjetja e zgjidhjes së duhur është procesi më i vështirë në bërjen e drejtësisë, ndërsa zgjidhja e shpejtë është motivimi më adekuat në krijimin e besimit në drejtësi.

Doracaku u hartua nga grupi punues i themeluar nga IGJK në përbërje të gjyqtarëve me përvojë në gjyqësorin e Kosovës, ku secili nga ta ka bërë një punë substanciale duke i dhënë energji këtij projekti, të ndihmuar edhe nga stafi i IGJK. Me këtë rast atyre u shprehim mirënjohje dhe falënderime të sinqerta. Gjithashtu shprehim mirënjohje respekt të lartë për ndihmën e stafit të IGJK-së në këtë proces.

Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, ka për qëllim të ofrojë udhëzime praktike ndaj situatave me të cilat ndeshen gjyqtarët gjatë punës së tyre. Doracaku përfshin procedurat që kërkohen nga Kodi i Procedurës Penale. Gjyqtarët e rinj në veçanti do të përfitojnë nga ky publikim, por edhe gjyqtarët me përvojë mund të gjejnë se ky ju shërben si përkujtues i dobishëm se si të merren me gjërat rutinë, duke propozuar çështje më komplekse ose pikënisje të dobishme kur të ndeshen me situata për herë të parë.

Ky është botimi i parë i Doracakut të Gjyqtarëve për Procedurën Penale, i cili si i tillë, përfaqëson një pikë referimi për proceset penale. Pa dyshim këto procedura dhe praktika do të zhvillohen me kalimin e kohës. Veprimet praktike të sugjeruara këtu parashohin vetëm rekomandimet e grupit punues. Informacionet që jepen konsiderohen më të qarta dhe më me vlerë, por nuk kanë për qëllim të shërbejnë si autoritet ligjor.

Ne jemi të nderuar që ju keni zgjedhur të lexoni dhe përdorni këtë doracak i cili synon të ju ndihmojë në gjetjen e përgjigjeve në shumë nga pyetjet dhe situatat sfiduese në praktikën tuaj, duke besuar se ky doracak do të ndihmojë që profesionalizmi, shkathtësitë dhe aftësitë tuaja të jenë të standardeve më të larta.

Ju dëshirojmë suksese në punën tuaj!

Lavdim Krasniqi, Drejtor i IGJK

FJALA E AUTORËVE

Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale ka për qëllim të ofrojë një doracak praktik ndaj situatave me të cilat ndeshen gjyqtarët gjatë punës së tyre. Doracaku përfshin procedurat që kërkohen nga Kodi i Procedurës Penale. Qëllimi është të jepen udhëzime të detajuara lidhur me këto çështje dhe çështje të tjera që ngritën në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. Gjyqtarët me më pak përvojë në veçanti do të përfitojnë nga ky publikim, por edhe gjyqtarëve me përvojë mund të ju shërbejë ky doracak, si përkujtues i dobishëm se si të merren me gjërat rutinë, duke propozuar çështje më komplekse ose pikënisje dobishme të kur të ndeshen me situata për herë të parë. Ky është botimi i parë i doracakut për gjyqtarë të çështjeve penale. Si i tillë, përfaqëson një pikë referimi për proceset penale. Pa dyshim se këto procedura dhe praktika do të zhvillohen me kalimin e kohës. Është me rëndësi të theksohet që materiali bazë i këtij doracaku është Kodi i Procedurës Penale. Informacionet dhe udhëzimet që jepen në këtë doracak janë vetëm rekomandime të cilat do të mund të jenë adekuate për situata të caktuara, por nuk kanë për qëllim të shërbejnë si autoritet ligjor.

Autorët

KAPITULLI I

KOMPETENCA E GJYKATAVE

KAPITULLI I

1.KOMPETENCA E GJYKATAVE	14
1.1 Shqyrtime të Përgjithshme.....	17
1.1.1 Caktimi i Lëndëve brenda Gjykatave	17
1.2 Kompetenca Funksionale	18
1.2.1 Gjyqtari i Procedurës Paraprake	18
1.2.2 Gjyqtari i vetëm gjykues, Kryetari i trupit gjykues dhe Trupi gjykues	19
1.3 Kompetenca Territoriale	20
1.3.1 Caktimi i Kompetencës Territoriale	20
1.3.2 Kriteret Dytësore të Kompetencës	20
1.3.3 Kompetenca territoriale e urdhëruar nga Gjykata Supreme	21
1.4 Bashkimi i Procedurës	21
1.4.1 Kompetenca territoriale lidhur me bashkimin e procedurës	21
1.5. Veçimi i Procedurës	21
1.5.1 Shqyrtime të përgjithshme	21
1.6 Kalimi i Kompetencës Territoriale	22
1.6.1 Kompetenca e deleguar dhe konflikti i kompetencës	22
1.7 Pasojat e Mungesës së Kompetencës	23
1.7.1 Kompetenca e nënkuptuar e gjykatave	23
1.8 Përjashtimi	23
1.8.1 Shqyrtime të përgjithshme	23
1.8.2 Procedura për përjashtim	25
1.8.3 Kërkesa për përjashtim	25
1.8.4 Vendimet mbi kërkesat për përjashtim	26
1.8.5 Ndërprerja e ushtrimit të veprimeve pas kërkesës për përjashtim të gjyqtarit	27

1.9 Lista Kontrolluese	27
a) Sipas fuqisë së ligjit	27
b) Përjashtimi sipas kërkesës së palëve	28
c) Vendimet të cilat i ndërmerr gjykata pas paraqitjes së kërkesës për përjashtim.....	28
d) Veprimet të cilat i ndërmerr gjyqtari pas paraqitjes së kërkesës për përjashtim.....	28

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Njëra prej çështjeve fillestare që gjyqtarët duhet të vlerësojnë është çështja e kompetencës lëndore dhe territoriale të gjykatës. Kompetencat e Gjykatës Themelore në procedurë penale përcaktohen me ligj të posaçëm dhe atë në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat.¹ Kontrollimi i kompetencës është një çështje fundamentale në procedurën penale, ngase mos kontrollimi i duhur dhe veprimi jashtë kompetencës, sjell pas vetes edhe shkelje thelbësore të procedurës penale në kuptim të nenit 384 të Kodit të Procedurës Penale² rrjedhimisht edhe anulimi i vendimit të marrë për atë çështje.

Kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e gjykatës e përcaktuar me ligj e një kategorie gjykatash që në procedurë penale të ndërmarrin veprime procedurale konkrete dhe të gjykojnë për disa vepra penale varësisht nga natyra dhe rëndësia tyre. Kompetenca lëndore përcaktohet në bazë të llojit dhe rëndësisë së veprës penale. Bazë për përcaktimin e kësaj kompetence është vepra penale, përkatësisht çështja penale e cila është objekt i gjykimit (*ratione materiae*). Si kriter themelor për përcaktimin e kësaj kompetence merret lloji dhe lartësia e dënimeve e paraparë për veprën penale të tillë.³ Gjykata ka për detyrë të kujdeset “*ex officio*” për kompetencën lëndore gjatë tërë rrjedhës së procedurës dhe një obligim i tillë rrjedh edhe nga dispozita e nenit 6 paragrafit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore,⁴ “*sipas së cilës çdo kush ka të drejtë që të dëgjohet para një gjykatë të themeluar në bazë të ligjit*”. Për rëndësinë që ka ky detyrim, tregon edhe fakti se vetëm gjykata kompetente mund të shqiptoj sanksionin penal. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatën në esencë e karakterizon funksioni i saj gjyqësor, respektivisht ajo që nxjerrë vendime mbi bazën e kompetencës në bazë të parimit të sundimit të ligjit dhe në procedurën e përcaktuar me ligj.⁵

1.1. Caktimi i lëndëve brenda gjykatave

Procedura penale zhvillohet dhe çështja e gjykohet në shkallë të parë në Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin e Krimeve të Rënda apo ndonjë Divizion apo Departament të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit për Gjykatat që ka juridiksion mbi veprat penale.

¹ Ligji për Gjykatat, nr.03/L-193, i datës 22 korrik 2010.

² Neni 240 paragrafi 1 i Kodi i Procedurës Penale, nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013 (Në tekstin e mëtejme KPP). Në nenin 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të KPP, është parashikuar se aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes

³ Ejup Sahiti dhe Rexhep Murati, E drejta e Procedurës Penale” (Prishtinë, 2013) fq. 139

⁴ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore u hartua në Këshillin e Evropës. Ajo u hap për nënshkrim në Romë më 4 nëntor të vitit 1950 dhe hyri në fuqi në shtator të vitit 1953.

⁵ Aktgjykimi i GJEDNJ-së H. kundër Belgjikës, i datës 30 nëntor 1987, Seria A nr.127., faqe 34.

Kur një fëmijë është i pandehur në një rast penal, ai rast do të ndahet nga çdo rast tjetër dhe do të shqyrtohet vetëm nga Departamenti për të Mitur në kuadër të Gjykatës Themelore, sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur,⁶ apo ligjit pasues.⁷

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në të gjitha procedurat penale që nuk janë brenda juridiksionit të Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Miturit ose ndonjë Divizionit apo Departamentit të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit për Gjykatat që ka juridiksion mbi veprat penale.⁸

Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në çfarëdo procedure penale për veprat penale të dënueshme deri në 10 vite burgim, si dhe kur prokurori i shtetit pretendon apo ka ngritur akuzë për një ose më shumë vepra të mundshme penale sipas nenit 15 të Ligjit për Gjykatat në përgjithësi, dhe veçanërisht ato vepra penale të cekura në nenin 22 të KPP.

1.2 Kompetenca funksionale

Kompetenca funksionale përcakton kompetencën brenda gjykatës, respektivisht ndarjen e detyrave. Secili nga autoritetet gjyqësore do të ketë për detyrë të merret me çështjen e caktuar në kuptimin fragmentar, që nënkupton se për përfundimin e një çështje të caktuar në gjykatë mund të nevojitet veprimi i disa autoriteteve gjyqësore siç janë : gjyqtari i procedurës paraprake, kolegji shqyrtues, trupi gjykues, prandaj përmes kompetencës funksionale përcaktohet qartë se cili nga këto autoritete do të veprojnë varësisht prej momentumit procedural në të cilën gjendet çështja e caktuar penale.

Gjykata kompetencën e saj funksionale e ushtron përmes:

- gjyqtarit të procedurës paraprake;
- kolegjit shqyrtues;
- gjyqtarit të vetëm gjykues;
- kryetari i trupit gjykues;
- trupit gjykues dhe
- kryetarit të gjykatës.

1.2.1 Gjyqtari i procedurës paraprake

Roli i gjyqtarit të procedurës paraprake është i fokusuar në fazën e hershme të procedurës penale, prandaj Gjykata Themelore do të mbikëqyrë hetimet penale duke caktuar një

⁶ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nr.03/L-193, i datës 08.07.2010 (Në tekstin e mëtejshëm KDM).

⁷Neni 21 paragrafi 2 i KPP.

⁸Neni 21 paragrafi 3 i KPP.

gjiqtar profesional nga departamenti i duhur për të shërbyer si gjiqtar i procedurës paraprake.

Gjiqtari i procedurës paraprake mbikëqyr procedurën penale gjatë fazës së hetimit. Me paraqitjen e aktakuzës, gjiqtari i procedurës paraprake nuk ka më kompetencë mbi të pandehurin.

Gjiqtari i procedurës paraprake është kompetent për të pranuar kërkesat nga:

- prokurori i shtetit;
- i pandehuri;
- mbrojtësi;
- mbrojtësi i viktimave;
- i dëmtuari
- dhe të nxjerr vendime dhe urdhra bazuar mbi këto kërkesa, në pajtim me dispozitat e KPP.

Gjiqtari i procedurës paraprake është kompetent për të përcaktuar në mënyrë të pavarur nëse shqiptimi apo vazhdimi i privimit të lirisë së të pandehurit është proceduralisht apo kushtetutshmërisht i lejuar. Gjiqtari i procedurës paraprake ka për detyrë që të urdhërojë lirimin e të pandehurit, nëse heqja e lirisë të së cilit nuk është proceduralisht apo kushtetutshmërisht e lejuar.⁹

Kundër urdhrave të gjiqtarit të procedurës paraprake lejohen kundërshtime për të cilat vendos kolegji shqyrtuesi i të njëjtit departament. Ndërsa, vendimet e gjiqtarit të procedurës paraprake mund të atakohen në Gjykatën e Apelit.¹⁰

1.2.2 Gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe trupi gjykues

Me dorëzimin e aktakuzës nga prokurori i shtetit në gjykatën themelore caktohet një gjiqtar i vetëm ose një kolegji gjyqtarësh me kryetarin e tij nga departamenti përkatës. Në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, rasti vendoset nga gjiqtari profesional i cili shërben si gjiqtar i vetëm gjykues, kurse në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore, aktgjykimi merret nga tre (3) gjyqtarë profesional, njëri nga të cilët kryeson trupin gjykues.¹¹

Pas ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit në Gjykatën Themelore, gjiqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues:

⁹Neni 23 i KPP.

¹⁰ Neni 24 i KPP.

¹¹Neni 25 i KPP.

- mban shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë;
- merr vendim mbi kërkesat për hedhje të aktakuzës;
- merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë;
- merr vendim mbi kërkesën për caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit.¹²

1.3 Kompetenca territoriale

1.3.1 Caktimi i kompetencës territoriale

Sipas nenit 29 paragrafi 1 të KPP, kompetenca territoriale në parim i jepet Gjykatës Themelore, brenda territorit të së cilës është kryer ose është tentuar vepra penale ose brenda territorit ku është shkaktuar pasoja.

Kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, kompetente është ajo gjykatë e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje në kërkesën e prokurorit të autorizuar, por nëse procedura nuk është filluar, atëherë kompetente është gjykata në të cilën së pari është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës. Në rast se me ligj themelohet ndonjë departament i gjykatës themelore që ka kompetencë për hetimin dhe gjykimin e veprave të caktuara penale, departamenti i tillë do të ketë kompetencë mbi të gjitha procedurat penale për veprat e tilla penale.

1.3.2 Kriteret dytësore të kompetencës

- a) Në qoftë se nuk dihet territori i përshkruar në paragrafin 1 të nenit 29 të KPP, ose kur ky vend nuk është në territorin e Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.
- b) Në qoftë se gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e ka filluar procedurën, gjykata mbetet kompetente edhe nëse është mësuar vendi i kryerjes së veprës penale.
- c) Në qoftë se nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale, as vendbanimi apo vendqëndrimi i të pandehurit ose nëse të dyja janë jashtë territorit të Kosovës, kompetente është Gjykata në territorin e së cilës arrestohet i pandehuri ose në territorin e së cilës i pandehuri vetë u dorëzohet organeve.

¹²Neni 26 i KPP.

1.3.3 Kompetenca territoriale e urdhëruar nga Gjykata Supreme

Në qoftë se nuk mund të vërtetohet se cila gjykatë ka kompetence territoriale, Gjykata Supreme e Kosovës cakton njëri nga gjykatat me kompetencë lëndore në të cilën do të zbatohet procedura.

1.4 Bashkimi i procedurës

1.4.1 Kompetenca territoriale lidhur me bashkimin e procedurës

Në nenin 35 të KPP, janë parashikuar disa rregulla me anë të cilave janë rregulluar disa çështje që kanë të bëjnë me bashkimin e procedurës penale.

- a) Kur personi i njëjtë akuzohet me shumë vepra penale të peshës së njëjtë, kompetente është gjykata në të cilën së pari është ngritur aktakuza, ndërsa, kur nuk është paraqitur aktakuzë, kompetente është gjykata, të cilës së pari i është dorëzuar aktvendimi i vulosur i hetimeve.
- b) Kur i dëmtuari njëkohësisht ka kryer vepër penale ndaj të pandehurit, gjithashtu zhvillohet procedurë e përbashkët.
- c) Në parim të bashkëpandehurit i nënshtrohen kompetencës së gjykatës, e cila ka kompetencë për njërin pre tyre dhe në të cilën së pari është ngritur aktakuza.
- d) Në parim gjykata e cila është kompetente për kryerësin e veprës penale është kompetente edhe për bashkëkryerësit dhe ndihmësit, pas kryerjes së veprës penale dhe për personat të cilët nuk kanë njoftuar për përgatitjen e veprës, kryerjen e saj ose kryerësin.
- e) Kur disa persona fajësohen për disa vepra penale, gjykata mund të vendos të zbatojë procedure të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, me kusht që veprat të jenë të ndërlidhura dhe provat të jenë të përbashkëta.
- f) Gjykata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, po që se, para të njëjtës gjykatë zbatohen procedura të ndara, kundër të njëjtit person, për disa vepra ose kundër disa personave, për vepër penale të njëjtë.
- g) Për bashkim të procedurës, vendos gjykata, e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së bashkuar, në bazë të propozimit të prokurorit të shtetit ose sipas detyrës zyrtare. Kundër aktvendimit me të cilin caktohet bashkimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për bashkim, nuk lejohet ankesë.

1.5 Veçimi i procedurës

1.5.1 Shqyrtime të përgjithshme

Gjykata e cila sipas KPP është kompetente, për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendos veçimin e

procedurave të zbatuara për disa vepra penale ose kundër disa të pandehurve dhe procedon ndaras ose çështjet e ndara ia dërgon një gjykate tjetër kompetente.¹³

Gjykata mund të vendos që deri në përfundimin e procedurës të veçojë procedurën për ndonjë vepër penale ose për ndonjërin nga të pandehurit. Për marrjen e aktvendimit të tillë është e nevojshme të ekzistojnë arsyet e efikasitetit. Shkaqet apo arsyet mbi bazën e së cilës gjykata mund të vendosë që të veçojë procedurën mund të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Mirëpo, si arsye për veçimin e procedurës penale, e cila merret shpeshherë për bazë në praktikën tonë gjyqësore, është situata kur p.sh. është ngritur aktakuzë ndaj disa të pandehurve, ndërsa njëri prej të pandehurve është në arrati dhe nuk mund që të sigurohet prezenca e tij në seanca gjyqësore, kurse në anën tjetër ekziston rreziku i kalimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale. Në këtë situatë, gjykata mund të vendosë që të veçojë procedurën penale ndaj të pandehurit i cili është në arrati. Gjithashtu, si arsye që më së shpeshti mund të paraqiten janë edhe rrethanat si: sëmundje e rëndë ose lëndimi i rëndë i ndonjërit nga të pandehurit, e cila tregon se i njëjti për një kohë të gjatë nuk do të mund të paraqitet në procedurë. Pastaj, arsye e efikasitetit mund të jenë se në shqyrtimin gjyqësor për një vepër të rëndë penale janë prezantuar të gjitha provat dhe për të njëjtën mund të merret aktgjykimi, ndërsa për veprën tjetër janë të nevojshme ekspertiza apo të ngjashme.

Kur të plotësohen kushtet, gjykata mund të marrë aktvendim mbi veçimin e procedurës sipas propozimit të palëve ose mbrojtësit, por këtë mund ta bëjë edhe pa propozimin e tyre. Nëse veçimi i procedurës është bërë sipas detyrës zyrtare gjykata para marrjes së aktvendimit duhet të dëgjojë palët dhe mbrojtësin. Kundër aktvendimit me të cilën është përcaktuar veçimi i procedurës ose është refuzuar propozimi për veçimin e procedurës nuk lejohet ankesë e veçantë.¹⁴

1.6 Kalimi i kompetencës territoriale

1.6.1 Kompetenca e deleguar dhe konflikti i kompetencës

Gjykata themelore është e detyruar që të shqyrtojë kompetencën territoriale të saj dhe nëse konstaton se i mungon kompetenca, shpall veten jo kompetente dhe pasi që aktvendimi të merr formën e prerë i dorëzon rastin gjykatës e cila ka kompetencë territoriale. Në qoftë se gjykata themelore kompetente për shkaqe juridike ose faktike është penguar të zbatojë procedurën pas dëgjimit të palëve, kryetari i gjykatës themelore mund të kalojë procedurën tek një degë tjetër brenda gjykatës themelore kompetente.

¹³ Neni 36 paragrafi 1 i KPP.

¹⁴ Neni 36 paragrafi 3 i KPP.

Nëse kalimi i lartcekur nuk është i mundshëm, kryetari i gjykatës themelore kompetente duhet të konsultohet me një tjetër gjykatë themelore që ka kompetencë lëndore dhe të pajtohen për transferimin e procedurës. Në qoftë se dy gjykatat themelore nuk pajtohen për transferimin e procedurës brenda dhjetë (10) ditëve, cilado prej tyre e njofton menjëherë për këtë Gjykatën e Apelit, e cila do të caktojë njëren nga gjykatat për të zbatuar procedurën.

Para marrjes së aktvendimit mbi konfliktin e kompetencës lëndore, gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit i cili është kompetent për të vepruar para asaj gjykate, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave dhe të pandehurit apo mbrojtësit të tij. Kundër aktvendimit nga ky nen nuk lejohet ankesë.¹⁵

1.7 Pasojat e mungesës së kompetencës

1.7.1 Kompetenca e nënkuptuar e gjykatave

Sipas nenit 38 paragrafi 1 i KPP, gjykata jo kompetente detyrohet të ndërmarrë ato veprime procedurale për të cilat ekziston rrezik nga vonesa. Pasi aktakuza të merr formë të prerë, gjykata nuk mund të shpall veten jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mungesës së kompetencës territoriale. Për shembull: nëse një qytetar me vendbanim në Prishtinë ka kryer veprën penale në territorin e Komunës së Ferizajt dhe prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila është bërë e formës së prerë dhe ka kaluar në shqyrtimin gjyqësor, kjo Gjykatë nuk mund më të deklarohet jo kompetente përkundër faktit se vepra penale e cila është objekt shqyrtimi është kryer në territorin që bie jashtë juridiksionit të saj territorial.

1.8 Përjashtimi

1.8.1 Shqyrtime të përgjithshme

Gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur duke u bazuar në vlerësimin e drejtë të fakteve në pajtueshmëri me kuptimin e ndërgjegjshëm të ligjit pa ndonjë kërcënim ose ndërhyrje direkte apo indirekte nga kushdo qoftë.¹⁶

KPP si baza për përjashtimin e gjyqtarit nga funksioni gjyqësor përcakton rastet, kur: gjyqtari është dëmtuar me vepër penale; është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në

¹⁵Neni 37 i KPP.

¹⁶ Parimet e Bangalorit mbi sjelljen e gjyqtarëve, neni 1.1, Commentary on The Bangalore Principles of Judicial Conduct, United Nations Office on Drugs and Crime, September, 2007.

shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar; nëse është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit; nëse në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, përfaqësues ligjor apo përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.¹⁷

Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues.¹⁸

Ekziston edhe i ashtuquajtimi përjashtimi fakultativ dhe gjyqtari mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor nëse në rastin konkret prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme.¹⁹

Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 31 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës²⁰ dhe neni 6 i KEDNJ-së.²¹ Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve.

¹⁷ Neni 39 paragrafi 1 i KPP. Në nenin 6 të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit është parashikuar se “Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanshmërinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.

¹⁸ Neni 39 paragrafi 2 i KPP.

¹⁹ Në nenin 39 paragrafi 3 të KPP është parashikuar se “Gjyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme”.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, “E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm”, Neni 31 paragrafi 2 “përcakton çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

²¹ Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, E drejta për një proces të rregullt : Neni 6.1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuzë penale në ngarkim të tij....”.

Gjykata duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. Respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë vënë në dyshim paanshmërinë e tij /saj.²²

Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor.²³ Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur.²⁴ Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të justifikuar që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, kënvështimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm.²⁵

1.8.2 Procedura për përjashtim

Gjyqtari posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim, e ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton Kryetarin e Gjykatës, i cili sipas procedurave apo rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij. Në rastin e përjashtimit të kryetarit të gjykatës, ai kërkon drejtpërdrejt nga Kryetari i Gjykatës së Apelit që të caktojë zëvendësimin.

Në qoftë se gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij nga neni 39, paragrafi 3 i KPP, ai për këtë e njofton kryetarin e gjykatës. Derisa të merret vendim për përjashtim, gjyqtari mund të ndërmer vetëm ato veprime të cilat janë domosdo të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes.

1.8.3. Kërkesa për përjashtim

Gjyqtari duhet të kujdeset “ex officio” se nëse ekziston ndonjë rrethanë për përjashtimin e tij, dhe nëse konsideron se ekziston, atëherë e njofton kryetarin e gjykatës për këtë fakt.

²² Shih rastin Sigurdson kundër Islandës , vendim i GJEDNJ-së kërkesa nr. 39731/98, Aktgjykimi i 10 prillit 2003

²³ Shih vendimin nr.11, datë 05.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë

²⁴ Shih vendimet nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese)

²⁵ Shih vendimin vendim nr. 25 datë 11.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë

Përveç kësaj, edhe palët kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit nga vendosja e lëndës konkrete. Palë në këtë kuptim konsiderohen prokurori i shtetit, i pandehuri dhe i dëmtuari.²⁶ Pala mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit sapo të ketë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përjashtim, dhe këtë mund ta bëjë më së largu deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në rast të përjashtimit për arsyet e parapara në nenin 39, paragrafi 3 i KPP, përjashtimin e kërkon para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa, kur është pyetje kërkesa që të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme, pala mund ta bëjë këtë në procedurë gjatë ushtrimit të mjetit juridik.

Pala mund të kërkojë përjashtimin vetëm të gjyqtarit që e trajton çështjen dhe jo edhe të gjyqtarëve tjerë të cilët nuk janë të përfshirë në trajtimin e çështjes apo të kërkojë përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të një gjykate.

Pala detyrohet që në kërkesë të shënojë rrethanat me të cilat e mbështet pretendimin për ekzistimin e bazës ligjore për përjashtim. Shkaqet e paraqitura në kërkesën e mëparshme për përjashtim e cila është refuzuar nuk mund të paraqiten përsëri në kërkesë.

1.8.4. Vendimet mbi kërkesat për përjashtim

Kërkesat për përjashtim sipas nenit 41 të KPP vendosen nga gjyqtarët në vijim:

- Kryetari i Gjykatës Themelore vendos mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore.
- Kryetari i Gjykatës së Apelit vendos mbi kërkesën për përjashtimin vetëm të Kryetarit të Gjykatës Themelore ose mbi kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë.
- Kryetari i Gjykatës së Apelit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.
- Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendos mbi kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit; kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë ose kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
- Kolegji i kryesuar nga Zëvendës kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendos mbi kërkesën për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ose mbi kërkesën për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjyqtarëve tjerë të së njëjtës gjykatë.

Para marrjes së aktvendimit për përjashtim dëgjohet gjyqtari apo Kryetari i Gjykatës, e sipas nevojës zhvillohen edhe hetime të tjera. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet

²⁶ Neni 19 paragrafi 1.15 i KPP.

kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë. Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme, e kur një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.

Në qoftë se kërkesa për përjashtim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 41, paragrafët 4. dhe 5 të KPP ose kërkesa për përjashtim nga neni 39, paragrafi 3 i KPP është parashtruar pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkesa hedhet në tërësi ose pjesërisht. Kundër aktvendimit me të cilin hedhet kërkesa nuk lejohet ankesë. Aktvendimin me të cilin hedhet kërkesa e merr kryetari i gjykatës, kurse në shqyrtim gjyqësor atë e merr trupi gjykues. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, mund të marrë pjesë në marrjen e aktvendimit nga trupi gjykues.

1.8.5. Ndërprerja e ushtrimit të veprimeve pas kërkesës për përjashtim të gjyqtarit

Efekti paraqitjes së kërkesës përjashtim konsiston në atë se gjyqtari me rastin e vënies në dijeni se është bërë kërkesë për përjashtimin e tij, ai detyrohet që menjëherë të ndërpresë çdo veprim në atë çështje, e kur kemi përjashtim nga neni 39, paragrafi 3 i KPP, ai deri në marrjen e aktvendimit mbi kërkesën, mund të kryejë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rrezik nga vonesa.

1.9. Lista kontrolluese

a) Sipas fuqisë së ligjit

- Gjyqtari menjëherë verifikon pasi është ngarkuar me lëndë nëse ekzistojnë arsye ligjore për përjashtim nga neni 39 paragrafi 1 dhe 2 të KPP, si dhe nëse të njëjtat ekzistojnë, atëherë është detyruar ta njoftoj Kryetarin e Gjykatës (përjashtimi obligator).
- Gjyqtari verifikon nëse në lëndën konkrete ekziston ndonjë rrethanë që do ngritin dyshimin mbi paanësinë e tij (siç janë: njohja personale me të dyshuarin/ akuzuarin, shoqëri nga shkolla, apo nga aktivitete e ndryshme si p.sh. nga klubet sportive, shoqëritë kulturo artistike, gjinia e gjakut përtej vijës së katërt, fqinjësia, apo ndonjë rrethanë tjetër që mund të ndikoj në paanshmërinë, gjithashtu është i detyruar që ta njoftoj Kryetarin e Gjykatës (përjashtimi fakultativ).

b) Përjashtimi sipas kërkesës së palëve

- Palët mund të paraqesin kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, e nëse pala është vënë në dijeni për ekzistimin e arsyes për

përrjashtim më vonë, atëherë kërkesa parashtrohet menjëherë pas njohurisë mbi këtë rrethanë.

- Kërkesa e cila e vënë në pyetje paanshmërinë e gjyqtarit mund të paraqitet vetëm para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.
- Kërkesa paraqitet ndaj gjyqtarit të caktuar në të cilën theksohen faktet dhe provat për ekzistimin e arsyeve ligjore për përrjashtim e gjyqtarit.

c) Vendimet të cilat i ndërmerr gjykata pas paraqitjes së kërkesës për përrjashtim

- Kërkesa aprovohet si e bazuar dhe gjyqtari përrjashtohet nga vendosja ose
- Kërkesa refuzohet si e pabazuar dhe përrjashtimi nuk lejohet.

Ndërsa nëse:

- Kërkesa për përrjashtim është bërë pa e përcaktuar identitetin e gjyqtarit;
- Kërkesa për përrjashtim fakultativ është paraqitur pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor;
- Kërkesa është bërë pa i shënuar rrethanat me të cilat mbështet pretendimi për ekzistimin e bazës për përrjashtim, atëherë kërkesat e tilla të mësipërme hedhen si të palejuara. Aktvendimin e tillë e merr kryetari i gjykatës, kurse në shqyrtimin gjyqësor e merr trupi gjykues.

Para marrjes së vendimit merret deklarata e gjyqtarit të cilit i kërkohet përrjashtimi. Kundër aktvendimit me të cilën lejohet përrjashtimi nuk lejohet ankesë, ndërsa ndaj aktvendimit me të cilën nuk lejohet përrjashtimi mund të paraqitet ankesë e posaçme, por nëse aktvendimi është marr pas ngritjes së aktakuzës atëherë mund të atakohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.

Për përrjashtimin e procesmbajtësit, përrkthyesve, stafit tjetër profesional dhe ekspertëve vendos trupi gjykues ose gjyqtari i vetëm gjykues.

d) Veprimet të cilat i ndërmerr gjyqtari pas paraqitjes së kërkesës për përrjashtim

Gjyqtari ndërpret punën në lëndë pas paraqitjes së kërkesës për përrjashtimin e tij deri në marrjen e vendimit sipas kërkesës dhe i njëjti i ndërmerr vetëm ato veprime të cilat rrezikohen nga vonesa.

KAPITULLI II
HETIMET DHE FILLIMI I
PROCEDURËS PENALE

KAPITULLI II

2. HETIMET DHE FILLIMI I HETIMIT NË PROCEDUREN PENALE	34
2.1. Shqyrtime të përgjithshme.....	34
2.1.1 Fillimi i hetimit.....	34
2.1.2. Parimet e përgjithshme të fazës së hetimit.....	34
2.1.3. Aktvendimi për fillimin e fazës së hetimit.....	35
2.2 Masat e Fshehta dhe Teknike të Vëzhgimit dhe Hetimit.....	26
a) Kërkesat e përbashkëta për masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit.....	36
b) Kërkesa shtesë për masat e urdhëruara me vendim gjykate dhe për hetimet e urdhëruara nga prokurori ne rastet e hetimeve të fshehta.....	37
c) Veprat penale për të cilat mund të lëshohen urdhrat sipas nenit 88 të KPP.....	37
d) Urdhërimi i masave në rastet urgjente.....	37
e) Nevoja për konfirmim me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake.....	38
f) Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.....	38
g) Zbatimi i urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.....	39
h) Pezullimi, zgjatja, ndryshimi dhe pushimi i urdhrave.....	40
i) Pranueshmëria e provave të siguruar me anë të urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.....	40
2.3 Kontrolli dhe Konfiskimi	41
2.3.1 Kontrolli dhe sekuestrimi i përkohshëm	41
a). Cilat janë pritshmëritë nga zbatimi i urdhërkontrollit.....	41
b). Kontrolli i shtëpisë ose lokaleve me urdhër gojor të gjyqtari	42

c). Kur mund të urdhërohet kontrolli i një shtëpie apo të lokaleve të tjera dhe të pasurisë së një personi që nuk dyshohet për vepër penale	42
d). Kontrolli personal.....	42
e). Përmbajtja e urdhër kontrollit	43
f). Kur duhet të ekzekutohet urdhër kontrolli?	43
g). Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës.....	43
h). Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit.....	44
i). Kontrolli personal.....	45
j). Sekuestrimi i përkohshëm.....	45
k). Veprimi me sendet e sekuestruara	46
l). Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht.....	46
m). Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht.....	47
n). Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht.....	47
2.4. Ekspertimi në Procedurën Penale	47
2.4.1. Shqyrtime të përgjithshme	47
2.4.2 Kualifikimet e ekspertit.....	48
a). Çka nuk mund të shpreh eksperti në mendimin e tij.....	49
2.4.3. Caktimi i ekspertimit.....	49
a). Kundërshtimet ndaj përzgjedhjes së ekspertit.....	49
b). Angazhimi i ekspertit nga i pandehuri.....	49
c). Kundërthëniet në mes të ekspertëve.....	50
d). Ekspertimet e urdhëruara nga gjykata.....	50
2.5. Mundësia Hetuese e Veçantë	50
2.5.1 Shqyrtime të përgjithshme	50
2.5.2. Këqyrja dhe rikonstruksioni.....	51
2.6 Mbrojtja e të Dëmtuarve dhe Dëshmitarëve.....	53

2.6.1. Shqyrtime të përgjithshme.....	53
2.6.2 Subjektet e autorizuar për paraqitjen e kërkesës për masa mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet	55
2.6.3 Kushtet që duhet të plotësohen për urdhrat mbrojtës	56
2.6.4 Urdhri për anonimitet nga publiku.....	57
a). Gjyqtari mund të nxjerrë urdhër për anonimitet kur vlerëson.....	57
b). Procedura për urdhrin për anonimitet.....	57
c). Urdhri për anonimitet prej të pandehurit.....	57
d). Gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër të tillë për anonimitet vetëm kur ai çmon se.....	58
e). Forma e urdhrin për anonimitet	58
f). Ndalimi i pyetjeve që mund ta zbulojnë identitetin.....	59
g). Mbrojtja e dëshmitarëve	59
h) Masat tjera mbrojtëse në rastet e dhunës në familje	59
2.7 Heqja e Lirisë dhe Masat për Sigurimin e Pranisë së të Pandehurit në Procedurën Penale.....	60
2.7.1 Parimet e përgjithshme.....	60
2.7.2 Barrën e provave (onus probandi) tek prokurori i shtetit, në shkallën që e mbi peshojnë prezumimin në favor të lirisë.....	61
2.7.3 Parimi i proporcionalitetit.....	61
2.7.4 Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor.....	61
2.7.5 Urdhri i gjykatës për të arrestuar personin.....	62
a). Ka urdhërarrest që duket të jetë i vlefshëm, të pranuar përmes INTERPOL-it apo rrugëve tjera diplomatike	62
b) Arrestimi gjatë fazës së hetimi:	63
2.7.6 Sjellja e personave të arrestuar para gjyqtarit të procedurës paraprake	64

2. HETIMI DHE FILLIMI I PROCEDURES PENALE

2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Hetimet vështruar tradicionalisht në legjislacionin e procedurës penale në Kosovë kanë qenë kompetencë e gjykatës. Me reformat të cilat janë zbatuar në këtë sferë, posaçërisht me aprovimin e kodeve të procedurës penale në vitin 2004 dhe në vitin 2012, kanë përqafuar me tepër elemente të sistemit akuzator. Rrjedhimisht, edhe hetimet si njëra nga fazat e fillestare të procedurës penale, kanë kaluar që të jenë kompetencë dhe përgjegjësi e prokurorit të shtetit dhe roli i gjykatës në këtë aspekt ka evoluar në një rol më pak aktiv. Me KPP roli i gjyqtarit është një garantues i të drejtave, mbikëqyrës dhe gjykues i drejtë i ligjit dhe i fakteve. Fillimi i procedurës penale mund të bëhet përmes kalimit nëpër fazën e hetimit formal apo përmes ngritjes së drejtpërdrejtë të aktakuzës nëse prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën dhe nëse vepra penale është e dënues deri në tre vjet.

Standardi për të filluar një hetim kundër një personi për kryerjen veprës penale është ekzistimi i dyshimit të arsyeshëm.²⁷ Nëse prokurori i shtetit ka informacione të mjaftueshme të cilat ndërtojnë nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe që mund ti siguroj sipas detyrës zyrtare apo se është informuar nga policia apo ndonjë agjenci tjetër mund të fillojë një hetim penal.

2.1.1 Fillimi i hetimit

Prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodh në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Hetimi paraprak fillohet me vendim të prokurorit të shtetit nga neni 104 të KPP.

2.1.2. Parimet e përgjithshme të fazës së hetimit

Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit çmon jo vetëm rrethanat dhe provat fajësuese por edhe ato shfajësuese dhe siguron marrjen e provave të cilat mund të mos jenë të mundshme në shqyrtim gjyqësor. Qëllimi i hetimit është që të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo të pushohet procedura si dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jetë e pamundshme apo e vështirë që të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor. Çdo person për të cilin prokurori i shtetit ka dyshim të arsyeshëm se ka kryer veprë penale duhet të ceket si i pandehur në

²⁷Neni 19 paragrafi 1.8 i KPP. Dyshim i arsyeshëm - nënkupton njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë mund të kryejë ose mund të ketë kryer veprën penale. Se çfarë mund të konsiderohet si "e arsyeshme" do të varet nga të gjitha rrethanat.

aktvendimin për fillimin e hetimit. Çdo i pandehur i cekur në vendim gëzon të gjitha të drejtat që i takojnë të pandehurit me KPP.²⁸

Gjyqtarët duhet të kenë në mendjet e tyre se një hetim i rregullt dhe i duhur duhet t'i ndjek këto parime dhe kanë për detyrë që të vlerësojnë nëse hetimet janë duke u zhvilluar brenda këtyre rregullave.

2.1.3. Aktvendimi për fillimin e fazës së hetimit

Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake. Rezultatet e veprimeve fillestare të policisë dhe mbledhjes së provave janë pjesë e lëndës hetimore.²⁹

Gjatë zhvillimit të hetimeve ndërmerren veprime hetimore të cilat disa prej tyre janë kompetencë e gjyqtarit të procedurës paraprake si p.sh.: urdhërkontrolli, urdhri për kontroll personal, urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, urdhrat për lëshimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe të hetimit, ekspertizat të cilat janë nën autoritetin e gjykatës, por edhe veprime të tjera, siç është: lëshimi i urdhërarrestit për të arrestuar të pandehurin, mundësia e veçantë hetuese (në rastet kur ekziston rreziku se dëshmitë nuk do të jenë të disponueshme në shqyrtimin gjyqësor), këqyrja e vendit të ngjarjes kur kemi të bëjmë me kryes të panjohur, lëshimi i urdhrave ndalues për konfiskimin e pasurisë. Të gjitha këto situata janë ato që tregojnë edhe më tutje rolin e gjyqtarit të procedurës paraprake si një rol të domosdoshëm, të rëndësishëm për zhvillimin jo vetëm efikas të procedurës penale, por edhe të baraspeshuar, të drejtë dhe duke i respektuar standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut të cilat janë të etabluara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që bazohet në instrumentet relevante të drejtave të njeriut e veçanërisht në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Prandaj disa veprimeve hetimore mund të ndërmerren vetëm me angazhimin e gjykatës në formën e caktuar funksionale të saj. “Ratio Legis” mbetja nën juridiksionin e gjykatës e këtyre veprimeve mbështetet në faktin, ngase këtu kemi të bëjmë me disa veprime procedurale të dhunshme, realizimi i të cilave paraqet në një mënyrë devijim nga disa të drejta të garantuara në nivel kushtetues, prandaj vendimin në procedurën e përcaktuar me ligj mund ta merr vetëm gjykata.

²⁸Neni 103 i KPP.

²⁹Neni 104 i KPP.

2.2 Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Sipas nenit 87 paragrafi 1 të KPP, masa të fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe hetimit do të thotë secila nga këto masa të mëposhtme:

- vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video;
- monitorim i fshehtë i bisedave;
- kontrollim i dërgesave postare;
- përgjimi i telekomunikimeve dhe duhet të përdoret Lexuesi – IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil;
- përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik;
- dërgim i kontrolluar i dërgesave postare;
- shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
- blerje e simuluar e ndonjë sendi;
- stimulim i veprës së korrupsionit;
- hetim i fshehtë;
- regjistrim i thirrjeve telefonike dhe
- zbulim i të dhënave financiare.

a) Kërkesat e përbashkëta për masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit

Kërkesat e përbashkëta për të gjitha masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit janë kërkesa të cilat konsiderohen si “*conditio sine qua non*” që duhet të plotësohen dhe të vijnë në shprehje tek të gjitha masat, dhe nëse nuk plotësohet ndonjëri nga këto kushte të njëjtat nuk mund të urdhërohen:

- ekzistimi dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale të dënueshme me 5 (pesë) ose më shumë vjet burgim ose ndonjëri nga veprat penale të listuara në nenin 90 paragrafi 1.2 të KPP.
- masa e fshehtë ka gjasa që do të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Dyshimi i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme. Pra ky duhet të jetë më tepër se dyshimi i arsyeshëm.

Dyshimi i bazuar nuk mund të bazohet thjesht në informatat e pa verifikuara ose të pavërtetuara me prova ose “fjalë të dëgjua se janë thënë nga dikush”, dhe as nuk mund të bazohet në “burime inteligjence”. Megjithatë, mund të pranohet fjala e një informatori

konfidencial që ka provuar në të kaluarën se është i besueshëm, dhe ku mbështetja me prova mund të jetë e mjaftueshme.

b) Kërkesa shtesë për masat e urdhëruara me vendim gjykate dhe për hetimet e urdhëruara nga prokurori në rastet e hetimeve të fshehta:

Masat e fshehta hetimore duhet kuptuar se janë të natyrës subsidiare dhe nuk supozohet se janë përpjekja e parë për të siguruar provat e një hetimi, rrjedhimisht të njëjtat nuk janë masa të rregullta hetimore dhe nuk duhet konceptuar si të tilla. Masat e fshehta duhet të përdoren kur masat e tjera të rregullta hetimore, si p.sh. vëzhgimet e shqyrtimet nga ana e policisë dhe urdhër kontrollit, nuk janë në gjendje të zbulojnë provat. Masat e fshehta presupozojnë se janë ndërmarrë hapa tjerë hetimor ose të paktën janë bërë përpjekje por pa sukses.

Shembulli i përshkruar për natyrën subsidiare të këtyre masave është: nëse policia do të përgjoj për të përcaktuar se ku ndodhet i dyshuari, në fillim duhet të përdorë veprimet e rregullta hetimore, si p.sh. vajtja dhe ardhja në banesën e të dyshuarit dhe vendin e punës, t'i tregoj dëshmitarit fotot në formën e një foto paradë, sidomos kur policia ka dyshime për një person konkret dhe nëse të njëjtat janë të pasuksesshme atëherë mund të shqyrtohet mundësia e përdorimit të masave të fshehta, siç mund të jenë përgjimi i telekomunikimeve, etj.

c) Veprat penale për të cilat mund të lëshohen urdhrat sipas nenit 88 të KPP

Urdhri për masat e fshehta, sipas nenit 90 paragrafi 1 të KPP, mund të përdoret vetëm për hetimin e së paku një nga këto vepra të dyshuara penale:

- 1.1. veprat penale të dënueshme me 5 (pesë) ose më shumë vjet burgim; ose
- 1.2. një apo më shumë nga veprat penale, të cilat janë të parashikuara në nenin 90 paragrafi 1 nën-paragrafët 2 dhe 3 të KPP.

d) Urdhërimi i masave në rastet urgjente

Në situata urgjente, prokurori mund të urdhëroj ndonjëherë nga masat e fshehta nëse pritja për të lëshuar urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake do të:

- rrezikonte sigurinë e hetimeve, ose;
- sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre.
- nëse procedura penale është duke u zhvilluar për veprat penale në kapitullin XXIV, kapitullin XXXIV të KPRK, ose rasteve të shpëlarjes së parasë.

e) Nevoja për konfirmim me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake

Urdhri i përkohshëm i lëshuar nga prokurori në rastet urgjente pushon të ketë efekt nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda 3 (tri) ditëve nga lëshimi i tij. Me rastin e vërtetimit të urdhrit të përkohshëm të prokurorit të shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, do të bëjë vlerësim me shkrim të ligjshmërisë së tij.³⁰

f) Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Në nenin 91 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë secilën nga masat e mëposhtme:

- fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike;
- monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike;
- hetim të fshehtë;
- regjistrimi i bisedave telefonike;
- fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende private;
- monitorim të fshehtë të bisedave në vende private;
- kontrollim të dërgesave postare;
- përgjim të telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike;
- përgjim të komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik;
- dërgim i kontrolluar të dërgesave postare;
- shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
- blerje të simuluar të ndonjë sendi;
- simulim të një vepre të korrupsionit; ose
- zbulim i të dhënave financiare.

Urdhri për ndonjërin nga masat e lartcekura nuk duhet ta kalojë periudhën prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri. Ky urdhër duhet të bëhet me shkrim dhe përmban:

- emrin dhe adresën e personit ose të personave që i nënshtrohen urdhrit, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes;
- emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;
- në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale, sipas nenit 19 nën-paragrafi 1. 11. të KPP;
- masa dhe koha e saktë e fillimit dhe përfundimit të saj nëse zbatohet dhe

³⁰ Neni 91 paragrafi 1 i KPP.

- personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.³¹

g) Zbatimi i urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Periudha kohore brenda së cilës duhet të filloj zbatimi i urdhrit është pesëmbëdhjetë ditë nga dita e lëshimit³² dhe gjithashtu zbatimin e urdhrit duhet ta karakterizoj restriktiviteti, përkatësisht që të minimizohet përgjimi i komunikimeve të cilat në të kundërtën nuk i nënshtrohen përgjimit, prandaj veprimet duhen t'i përmbahen parimit të proporcionalitetit, të jenë vetëm ato që janë të domosdoshme për tu aplikuar.

h) Pezullimi, zgjatja, ndryshimi dhe pushimi i urdhrave

Gjatë zbatimit të masave në praktikë mund të paraqiten situata kur ndonjë kusht që ka ekzistuar për lëshimin e masave pushon të vlejë, në rastet e tilla nëse ndonjë prej kushteve për urdhërimin e masave pushon të vlejë, policia duhet të njoftoj prokurorin dhe gjyqtarin. Gjykata do të përcaktoj nëse urdhri mund të vazhdoj të mbetet në fuqi apo të ndërpritet.

Zgjatja e urdhrit - gjyqtari kompetent nuk mund të lëshojë urdhër tjetër me shkrim për zgjatjen e urdhrit për masat e fshehta, përveç nëse parakushtet për urdhërimin e masës, siç është paraparë në nenin 88 të KPP, vazhdojnë të vlejë dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e disa të dhënave apo të gjitha të dhënave të kërkuara sipas urdhrit të mëparshëm.³³

- Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave, kontroll të dërgesave postare, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, hetim të fshehtë, regjistrim të thirrjeve telefonike ose zbulim të dhënave financiare mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë, i cili urdhër mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrit.
- Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende private apo përgjimi i telekomunikimeve mund të zgjatet deri në gjashtëdhjetë (60) ditë, por mund të ripërtërihet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera.
- Urdhri për blerje të simuluar të sendit ose për simulim të veprës së korrupsionit autorizohet vetëm për një blerje të sendit ose për një vepër të simuluar të

³¹Neni 92 paragrafi 2 i KPP.

³²Neni 93 paragrafi 1 i KPP.

³³Neni 94 paragrafi 1 i KPP.

korrupsionit. Zyrtari i autorizuar gjyqësor mund të lëshojë urdhër tjetër për personin e njëjtë kur parakushtet për urdhërimin e masës, siç parashihet në nenin 88 të KPP, vazhdojnë të zbatohen dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e ndonjë ose të gjitha të dhënave të kërkuara me urdhrin e mëparshëm.³⁴

Ndryshimi i urdhrave - gjatë zbatimit të urdhrave, kushtet për zbatimin e tyre mund të ndryshojnë, si rezultat i saj, paraqitet nevoja që urdhri të ndryshoj, të përshtatet dhe të reflektoj sipas këtyre ndryshimeve.

Pushimi i urdhrin - gjyqtari në çdo kohë mund të pushojë urdhrin, kur çmon se parakushtet për urdhërimin e masës, siç është paraparë në nenin 88 të KPP pushojnë të vlejnjë, nëse parakushtet nuk janë të zbatueshme.

i) Pranueshmëria e provave të siguruara me anë të urdhrin për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Nëse të dhënat nuk janë mbledhur në përputhje me KPP, atëherë provat e siguruara përmes këtyre urdhrave janë të papranueshme.

Prova e cila është marrë nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, simulimi i blerjes së ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit ose hetimi i fshehtë lejohen vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar në nenin 88, paragrafi 3 të KPP, rrjedhimisht nuk mund të përdoret për procedurat penale që kanë të bëjnë me veprat e tjera penale.³⁵

Urdhri dhe zbatimi i paligjshëm mund të nënkuptojnë nëse parakushtet dhe kërkesat e ligjit nuk janë respektuar ose plotësuar, atëherë çdo lloj prove do jetë e papranueshme si p.sh: urdhri ishte i paligjshëm – sepse kërkesa e prokurorit nuk përmbante fakte që mbështesnin dyshimin e bazuar apo urdhri nuk konstatonte në mënyrë specifike dyshimin e bazuar, ose kur koha e masave të fshehta nuk është potencuar, ose kur urdhri lejon vetëm një blerje të simuluar, por policia bën dy blerje. Megjithatë, shkelja e ndonjë raportimi të thjeshtë nga ana e policisë nuk duhet të bëjë provën të papranueshme, ngase nuk ka të bëjë me kërkesat substanciale për urdhërimin e ndonjë urdhri për masat e fshehta hetimore.

Gjyqtarët kanë rol aktiv sa i përket vlerësimit të pranueshmërisë së provave të mbledhura nga urdhrat për masat e fshehta dhe në çdo kohë para se aktgjykimi të marrë formën e prerë, gjyqtari sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të

³⁴Neni 94 paragrafët 2, 3 dhe 4 të KPP.

³⁵Neni 97 paragrafi 2 i KPP.

mbledhura nga neni 88 i KPP, për shkelje të drejtave kushtetuese të të pandehurit, nëse ka indikacione se materialet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme.³⁶

2.3 Kontrolli dhe konfiskimi

2.3.1 Kontrolli dhe sekuestrimi i përkohshëm

Urdhërkontrolli si veprim hetimor dhe me qëllim të sigurimit të pandehurit dhe provave të tjera të rëndësishme në procedurën penale mund të ndërmerret vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se një person ka kryer veprën penale dhe me të cilën ka shkak të bazuar se do të rezultojë me arrestimin e kryesit të veprës penale, bashkëpunëtorëve të tij, ose do të gjenden gjurmë të veprës penale dhe sekuestrimin e provave që janë të rëndësishme në procedurën penale.

Urdhërkontrolli mund të urdhërohet vetëm nëse:

- ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer veprën penale;
- ekziston shkak i bazuar se gjatë kontrollimit do të rezultojë me arrestimin e këtij personi;
- gjenden gjurmët e veprës penale;
- sigurohen prova të rëndësishme procedure penale.

Se kur ekziston dyshimi i bazuar, është çështje faktike, dhe përcaktohet në bazë të rrethanave konkrete në secilin rast. Për këtë arsye, ky kusht duhet të bazohet në rrethana objektive, pasi që është i lidhur me kryerjen e veprës penale dhe i ndërtuar në faktet konkrete, të cilat duhet të shënohen në kërkesë, si dhe të arsyetohen qartë në urdhrin për urdhër-kontroll, pra nuk mund të ndërmerret urdhërkontrolli për të vërtetuar, pastaj dyshimin e bazuar për kryerjen e veprës penale, por ky dyshim i një kualiteti të tillë duhet të ekzistojë paraprakisht, ngase në të kundërtën objekt kontrolli mund të ishte çdo vend, hapësirë ose person.

a) Cilat janë pritshmëritë nga zbatimi i urdhërkontrollit?

- Pritshmëritë nga zbatimi i urdhërkontrollit janë si në vijim: se do të arrestohet kryesi veprës penale;
- do të gjenden gjurmët;
- të sigurohen prova që janë të rëndësishme në procedurën penale.

³⁶ Neni 97 paragrafi 4 i KPP.

I pandehuri në mënyrë vullnetare mund të jap pëlqimin e tij me shkrim për kontrollin e pronës nga ky kapitull. Sendet e gjetura gjatë kontrollit mund të sekuestrohen përkohësisht dhe janë provë e pranueshme në shqyrtim gjyqësor dhe në procedurë tjetër. Sendet e gjetura gjatë kontrollit për të cilin i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin nuk mund të sekuestrohen përkohësisht dhe janë provë e papranueshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe me KPP.³⁷

b) Kontrolli i shtëpisë ose lokaleve me urdhër gojor të gjyqtarit

Policia mund të filloj kontrollin në bazë të lejes gojore të gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:

- urdhri me shkrim nuk mund të merret me kohë dhe ekziston rreziku real për vonesë që mund të rezultojë në humbjen e provave ose rrezik ndaj jetës ose ndaj shëndetit të personave.

Kur policia ndërmerri kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, ajo duhet ti dërgoj raport me shkrim lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake brenda 12 orëve pas kontrollit.³⁸

c) Kur mund të urdhërohet kontrolli i një shtëpie apo të lokaleve të tjera dhe të pasurisë së një personi që nuk dyshohet për veprë penale

Gjatë zhvillimit të procedurës hetimore me qëllim të mbledhjes së provave apo nevojës për arrestimin e të kryesit të veprës penale paraqitet nevoja për të kontrolluar - personin, respektivisht pasurinë e tij i cili nuk është i dyshuar për kryerjen e veprës penale, duhet të plotësohen kushtet si në vijim:

- kur ka gjasa reale se kontrolli do të rezultojë me arrestimin e të pandehurit, ose;
- është e nevojshme të ruhen provat e veprës penale apo të konfiskohen sendet përkatëse të cilat nuk mund të ruhen apo të sigurohen pa zbatimin e kontrollit, dhe
- kur ka gjasa reale se provat ose sendet e tilla ndodhen në lokalet apo në pasurinë që i nënshtrohet kontrollit.³⁹

d) Kontrolli personal

Përveç hapësirave, banesave, lokaleve ekziston mundësia ligjore e kontrollimit personal të personit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin personal të një personi të caktuar kur në rastet kur :

- ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ;

³⁷Neni 105 paragrafi 1 dhe 2 të KPP.

³⁸Neni 111 paragrafi 6 të KPP.

³⁹Neni 105 paragrafi 4 të KPP.

- ose në konfiskimin e provave të një veprë penale.⁴⁰

Urdhërkontrolli lëshohet me shkrim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë.⁴¹

e) Përmbajtja e urdhërkontrollit

Urdhërkontrolli duhet të përmbajë si më poshtë:

- identifikimin e vendit apo personit kundër të cilit lëshohet urdhri (vendi duhet të identifikohet saktë, adresa, shënimet e tjera si fotografitë, të dhënat kadastrale të cilat sigurojnë të dhëna të sakta për objektin i cili do të kontrollohet);
- përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri (vepra penale si emërtimin ligjor, faktet dhe rrethanat të cilat konstituojnë këtë veprë);
- shpjegimin e arsyeve për shkak të bazuar në pajtim me këtë nen (shpjegohen arsyet për ekzistimin e shkakut të bazuar);⁴²
- përshkrimin e sendeve të kërkuara me kontroll. Kjo duhet të bëhet në mënyrë sa më specifike në mënyrë që zyrtarë policor të mos kenë diskrecion të pakufizuar për të kontrolluar gjithë lokalet dhe të shohin gjithçka nga dokumentet etj;
- përshkrimin e veçantë të detajuar të personit, të lokaleve apo të pasurisë ku zbatohet kontrolli. Lokalet dhe prona, është mirë të kenë shënime për përcaktimin e pozicionit të vendndodhjes me satelit, nëse e ka policia këtë pajisje, ose të paktën të përcaktoni pronën në hartë, ose foto e pronës si dhe një përshkrim sipas karakteristikave të veçanta (p.sh., derë e kaltër etj.).

f) Kur duhet të ekzekutohet urdhërkontrolli?

Urdhërkontrolli i lëshuar nga një gjyqtar i procedurës paraprake duhet të ekzekutohet brenda 48 orëve nga lëshimi i urdhrit, gjyqtari duhet të shënoj orën kur e nënshkruan urdhrin.

g) Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës

Parimisht kontrolli duhet të bëhet përmes urdhrit të gjyqtarit i cili lëshon urdhër me shkrim, megjithatë ekzistojnë situata të jashtëzakonshme dhe pritja për të lëshuar urdhrin do të humbte efektin e duhur, ku nevojitet të veprohet me urgjencë. Rrjedhimisht në situatat e tilla zyrtarët policor mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe

⁴⁰ Neni 105 paragrafi 5 të KPP.

⁴¹ Neni 105 paragrafi 6 të KPP.

⁴² Neni 19.paragrafi 1.10 i KPP. Shkak i bazuar - njohuri për informacionin që do të bind një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale. Shkaku i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme.

kryejnë kontroll me qëllim të kufizuar pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, nëse ekziston ndonjëra prej rrethanave të mëposhtme:

- personi përkatës me dije dhe me vullnet jep pëlqimin për kontroll.
- personi thërret për ndihmë.
- kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes.
- arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejt dhe serioz për njerëzit dhe pronën, si dhe
- personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.⁴³

Kjo është një situatë ku lejohet hyrja në pronë me qëllim që të kryhet kontroll i kufizuar pa urdhër, që nënkupton se policia nuk tagër që të kryej kontroll të përgjithshëm, por një kontroll i tillë është bërë vetëm për ti adresuar situatat specifike të jashtëzakonshme të përmendura si më lartë.

h) Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit

Provave të mbledhura gjatë kontrollit mund të ju kontestohet pranueshmëria e tyre për shkak mënyrës se si janë marrë dhe pretendimeve se nuk janë respektuar kriteret ligjore të gjatë sigurimit të tyre. Gjyqtarët si garantues të drejtave dhe njëkohësisht sipas detyrës “*ex officio*“, kujdesen që provat gjatë procedurës penale janë duke u mbledhur në pajtueshmëri me dispozitat e KPP dhe nuk janë duke u marrë në kundërshtim me dispozitat të cilat do ta kenë efektin që të njëjtat të mos mund të përdoren si prova valide për shkak të papranueshmërisë së tyre. Për të evituar këtë, gjyqtarët udhëzohen që gjithmonë të kontrollojnë listën si më poshtë nëse:

- provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës, janë të pa pranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retroaktiv gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe KPP;
- kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit kompetent në kundërshtim me dispozitat e KPP;
- urdhri i gjyqtarit kompetent është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë me KPP;
- përmbajtja e urdhrin të gjyqtarit kompetent është në kundërshtim me kushtet e parapara me KPP;
- kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit kompetent;

⁴³ Neni 110 paragrafi 1 i KPP.

- personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit;
- kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 108 të KPP (kufizimet në kontroll).⁴⁴

i) Kontrolli personal

Përveç hapësirave, banesave dhe lokaleve, ekziston mundësia ligjore e kontrollimit personal të personit. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin personal të një personi të caktuar në rastet kur :

- ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose
- në konfiskimin e provave të një veprë penale.⁴⁵

Urdhërkontrolli në rrethana normale lëshohet me shkrim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë.

Përmbajtja e urdhrit.

Urdhri duhet të përmbaj si vijon:

- identifikimin e personit kundër të cilit lëshohet urdhri;
- përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri ;
- shpjegimin e arsyeve për dyshim dhe gjasave reale;
- përshkrimin e sendeve të kërkuara gjatë kontrollit;
- përshkrimin e personit që kontrollohet ;
- ndonjë informacion tjetër të nevojshëm për zbatimin e kontrollit.

Me rastin zbatimit të kontrollit personal, policia duhet të përpiloj procesverbalin e për personin e kontrolluar. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga personi që kontrollohet, nga avokatët, dëshmitarët ose ndonjë person prania e të cilit është e nevojshme gjatë kontrollit, të përmbajë përshkrimin e sendeve dhe dokumenteve të sekuestruara.

j) Sekuestrimi i përkohshëm

Parimisht me rastin e kryerjes së kontrollit vetëm sendet dhe dokumentet e lidhura me qëllimin e atij kontrolli mund të sekuestrohen e të cilat përshijnë:

- sendet të cilat sipas kodit penal duhet të konfiskohen;
- sendet të cilat mund të shërbejnë si provë në procedurën penale;

⁴⁴ Neni 111 i KPP.

⁴⁵ Neni 105 paragrafi 5 i KPP.

- sendet që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale merren dhe sekuestrohen përkohësisht.

Megjithatë nëse sendet e gjetura të cilat nuk ndërlidhen me veprën penale që justifikon kontrollin, por që flasin për ekzistimin e një vepre tjetër penale, policia duhet ti sekuestroj dhe ta njoftoj prokurorin e shtetit.

Kërkesat e prokurorëve për sekuestrim duhet të jenë të specifikuar, të përmbajnë përshkrime të mjaftueshme të sendeve të cilave kërkohet sekuestrimi, dhe arsyet se pse të njëjtat duhet të sekuestrohen dhe se mund të sherbejnë si prova të veprës, mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose ato përbëjnë dobi pasurore.⁴⁶

k) Veprimi me sendet e sekuestruara

Sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontejnerët përkatës apo në qeset transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave. Armët, automjetet, aeroplanët ose sendet tjera të mëdha të cilat janë sekuestruar përkohësisht, fotografohen dhe mbahen në zonat e sigurta përkatëse dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.⁴⁷

l) Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht

Është me rëndësi që të kuptohet qartë se cilat sende nuk mund të sekuestrohen përkohësisht, sipas dispozitave ligjore të KPP.

Sipas nenit 113 paragrafi 1 të KPP, sendet e shënuara më poshtë nuk mund të sekuestrohen përkohësisht:

- komunikimet me shkrim ndërmjet të pandehurit dhe personave të cilët sipas KPP nuk mund të dëshmojnë nga neni 126 të KPP⁴⁸ ose personat që janë të liruar nga detyrimi për të dhe kanë refuzuar të dëshmojnë në bazë nenit 127 të KPP;
- shënimet personale të mbajtura me privilegj të personave të përshkruar më lartë lidhur me informacionin e fshehtë që u është besuar atyre nga i pandehuri dhe

⁴⁶ Neni 112 par. 3 të KPP-së

⁴⁷ Neni 112 par. 4 dhe 5 të KPP-së

⁴⁸ Në nenin 126 të KPP, janë parashikuar dëshmitarët e privilegjuar. Si dëshmitar të tillë të cilët nuk mund të merret në pyetje janë:

- 1.1. personi i cili me deklarinimin e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;
- 1.2. mbrojtësi, për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetë i pandehuri dhe
- 1.3. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët.

- sende të tjera, të mbrojtura me të drejtat e personave të përshkruar më lartë (nga nenet 126 dhe 127 të KPP).

Këto kufizime nuk zbatohen kur personat e privilegjuar dhe ata të liruar nga obligimi për të dëshmuar dyshohen për nxitje apo bashkëpunim, për pengimin e drejtësisë, për pranimin e mallrave të vjedhura, kur sendet janë marrë me vepër penale, janë përdorur ose janë paraparë të përdoren për kryerjen e veprës penale apo janë rezultat i veprës penale.⁴⁹

m) Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht

Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron sekuestrimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit:

- përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përhershëm;
- nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale dhe
- sendet të cilat sipas ligji mund të konfiskohen.⁵⁰

n) Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht

Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre. Ndërsa, në situatat kur pezullimi i procedurës penale bëhet për shkak të arratisjes së të pandehurit ose paaftësisë së tij mendore apo kur ka gjasa të arsyeshme që hetimi i pezulluar të rifillojë, prokurori i shtetit mund të kërkojë afat shtesë për sekuestrimin dhe gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të lejojë afat shtesë për kthimin e sendeve të sekuestruara.⁵¹

2.4 Ekspertimi në procedurën penale

2.4.1. Shqyrtime të përgjithshme

Gjatë zhvillimit të procedurës penale paraqiten çështje të rëndësishme për sqarimin e të cilave duhet dhënë mendimi profesional nga ekspertët e ndryshëm dhe kjo në praktikë pothuajse është një çështje rutinore në shumë raste. KPP parasheh mundësinë që eksperti të angazhohet nga prokurori i shtetit dhe vetëm në disa raste të caktuara kjo bëhet nga

⁴⁹Neni 113 paragrafi 2 i KPP.

⁵⁰Neni 115 paragrafi 2 i KPP.

⁵¹Neni 116 i KPP.

gjyqtari. Ekzistojnë situatat në të cilat paraqitet nevoja për mendim profesional të ekspertit të fushës së caktuar dhe që përgjigjja në këto duhet të ketë relevancën e caktuar si vijon:

- që mendimi i ekspertit është i nevojshëm të përcaktohet fajësia, gjegjësisht pafajësia e të pandehurit,
- shkalla e dëmit të shkaktuar me vepër penale,
- përgjigjja në pyetjen mund të jepet vetëm nga ekspertiza e specializuar ose teknike.⁵²

Rrjedhimisht fakti që duhet sqarohet duhet të jetë i rëndësishëm dhe që mund të sqarohet fajësinë, respektivisht pafajësinë e të pandehurit, ose të përcaktoj shkallën e dëmit që është shkaktuar me veprën penale. Prandaj, me rastin e urdhrin për kryerjen e ekspertizës së caktuar duhet të merren në konsideratë këto aspekte të cilat flasin për rëndësinë e ekspertimit në çështjen e caktuar penale.

Përgjigjja në pyetjen për nga natyra është e tillë dhe të cilën mund ta japin vetëm ekspertët e specializuar dhe jo një përgjigje e cila mund të jepet me njohurit e zakonshme jetësore joprofesionale.

Eksperti gjatë ekspertizës duhet të përdorë praktikatat të cilat janë të pranuar përgjithësisht në fushën e tij dhe që kanë bazë shkencore ose teknike, të analizoj provat e siguruar në mënyrë të ligjshme, të hartoj raport në të cilën përmbledhen metodat e përdorura të analizës dhe përfundimet.⁵³

2.4.2 Kualifikimet e ekspertit

Eksperti duhet të posedoj përvojën ose trajnimin e specializuar që është relevant dhe aktual.⁵⁴

Qasja e kësaj dispozite është më empirike dhe si duket nuk potencon kualifikimet. Kjo pjesë përmban këshilla/shpjegime të shkëlqyera, arsimore dhe formale në mënyrë shprehimore, por i referohet edhe përvojës ose trajnimit të specializuar që është relevant dhe aktual, pra mund të ekzistojnë profesionist të caktuar të cilët kanë përvojë të konsiderueshme ose trajnime të specializuara dhe që posedojnë nivel të njohurive që mund të japin mendime profesionale mjaft cilësore në kuadër të fushave të tyre të specializuara, dhe që mund të angazhohen në dhënien e mendimeve të tilla.

⁵²Neni 136 paragrafi 1 i KPP.

⁵³Neni 136 par. 1.1.5 të KPP-së

⁵⁴Neni 136 par.1.1.3 të KPP –së .

a) Çka nuk mund të shpreh eksperti në mendimin e tij

Eksperti nuk mund të shpreh mendimin e tij lidhur me fajësinë dhe pafajësinë e të pandehurit, pasi që kjo është një çështje e pastër juridike dhe që ju takon vetëm autoriteteve gjyqësore.

Në praktikë vlerësimi për ekspertizat shpesh është apriori, pa një analizë kritike dhe trajtohet pothuajse si një “regina probationem – mbretëreshe e provave”.

Sa i përket mendimit të ekspertëve është me rëndësi që të merret parasysh si vijon :

- mendimi i ekspertit është vetëm njëra nga provat në procedurën penale;
- vërtetësia, besueshmëria dhe saktësia e saj duhet të vlerësohet sipas bindjes së lirë, pas një analize të gjithanshme dhe në lidhshmëri me provat e tjera;
- nuk kanë ndonjë mbizotërim në raport me provat e tjera.

2.4.3 Caktimi i ekspertit

Ekspertin e cakton prokurori i shtetit me vendim, në të cilën i paraqet :

- pyetje specifike që janë të rëndësishme për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit ose shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
- përcakton emrin e ekspertit dhe paraqet bazën për ekspertimin specializuar të ekspertit, përfshirë edhe shkollimin e tij, përvojën dhe shërbimin e mëparshëm si ekspert i gjykatës;
- siguron ekspertit qasje në provat e duhura për ekspertimin specializuar ose teknik.⁵⁵

a) Kundërshtimet ndaj përzgjedhjes së ekspertit

Përzgjedhjen e ekspertit mund ta kundërshtojë:

- I pandehuri,
- Mbrojtësi,
- Mbrojtësi i viktimave

Bazuar në kualifikimet e ekspertit apo konfliktin potencial të interesit duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake, i cili merr aktvendim mbi përzgjedhjen e ekspertëve brenda 10 ditëve prej momentit të caktimit të ekspertit.

b) Angazhimi i ekspertit nga i pandehuri

KPP i jep mundësi të pandehurit që në funksion të mbrojtjes efektive dhe parimit të respektimit të barazisë së armëve të drejtën për të angazhuar ekspert. I pandehuri mund të

⁵⁵Neni 137 paragrafi 1 i KPP.

kërkoj nga prokurori i shtetit që të paraqes kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij. Nëse prokurori refuzon, i pandehuri mund të kundërshtoj këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake.⁵⁶

I pandehuri mund të merr dhe të paguaj vetë për ekspertizë. Eksperti duhet të veproj në pajtim me nenin 138 të KPP dhe prokurori i shtetit duhet të pranoj kopjen e raportit dhe të ekspertit të mbrojtjes brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga përfundimi i saj. Nga kjo dispozitë është e paqartë nëse i pandehuri duhet të këtë leje për ta angazhuar ekspertin e tij, ose nëse ekzistojnë rrethanat që do të ia jepnin të drejtën për të angazhuar ekspertin me shpenzime të shtetit dhe se si i pandehuri do ta fillonte kërkesën.

c) Kundërthëniet në mes të ekspertëve

Në praktikë ekzistojnë situata në të cilën konstatimet ekspertëve:

- ndryshojnë thellësisht;
- janë të paqarta;
- jo të plota ose
- në kontradikte me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara.

Në raste se këto nuk mund të evitohen me marrjen e serishme në pyetje të eksperteve mund të kërkohet mendimi i eksperteve tjerë. Siç është e nënkuptueshme përpjekja e parë është nëse mund të evitohen me marrjen serishme në pyetje të ekspertëve dhe nëse nuk mundet, atëherë mund të kërkohet mendimi i ekspertëve të tjerë.

d) Ekspertimet e urdhëruara nga gjykata

Ekspertimet të cilat i urdhëron gjykata, janë:

- analizat molekulare;
- ekzaminimet psikiatrike;
- ekzaminimet që ndërlidhen me ndërhyrje trupore, siç janë marrja e mostrave të gjakut gjatë ekzaminimit fizik, mund të bëhen vetëm me urdhër të gjykatës ose me pëlqimin e vullnetshëm të personit në fjalë.

2.5 Mundësia hetuese e veçantë

2.5.1 Shqyrtime të përgjithshme

Në situatat në të cilat ekziston vetëm një mundësi për marrjen e një prove të rëndësishme ose ekziston rreziku i konsiderueshëm se dëshmia ose ekspertiza nuk mund të sigurohet

⁵⁶ Neni 141 paragrafi 1 i KPP.

në shqyrtimin gjyqësor dhe me qëllim të ruajtjes, prokurori i shtetit, viktimave, mbrojtësi i viktimave, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të kërkojnë nga gjyqtari procedurës paraprake që të marrë dëshmitë e lartcekura. Është çështje faktike se kur ekzistojnë ndonjëra nga rrethanat e lartcekura dhe kjo në praktikë mund të vlerësohet në varësi të rrethanave konkrete të çështjes së caktuar. Si p.sh.: rrethanat e posaçme të cilat haptazi tregojnë se veprimet e tilla nuk do të mund të përsëriten në shqyrtimin gjyqësor do të ekzistojnë nëse duhet të dëgjohet dëshmitari për të cilin për shkak të gjendjes shëndetësore ose moshës së shtyrë, ekziston mundësia se nuk do ta mbijetojë deri në shqyrtimin gjyqësor ose nuk do të jetë i aftë për të dhënë dëshmi, etj. Rrethanat të cilat tregojnë se nxjerrja e provës së caktuar në shqyrtimin gjyqësor do të jetë e pamundur, gjegjësisht dukshëm e vështirësuar, është kur bëhet fjalë për dëshmitar i cili jeton në botën e jashtme dhe në ndonjë shtet në të cilin janë gjasat e vogla që të dëgjohet përmes video konferencave, gjithashtu janë gjasat e vogla që i njëjti t'i përgjigjet thirrjeve dhe të jetë prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjyqtari i procedurës paraprake miraton kërkesën vetëm nëse procedura penale zbatohet për hetimin e veprave penale nga neni 90 i KPP.⁵⁷ Në raste të tilla, gjyqtari i procedurës paraprake cakton dy gjyqtarë të tjerë në panelin për mundësinë hetuese të veçantë. Ndërsa, pas ngritjes së aktakuzës, së paku njëri nga gjyqtarët që ka marrë pjesë në panel, caktohet si kryetar i trupit gjykues ose anëtar i trupit gjykues.

Në rastet e mundësisë hetuese të veçantë, gjyqtari i procedurës paraprake merr masat e nevojshme për të siguruar:

- efikasitetin dhe tërësinë e procedurës, si dhe
- të drejtat e të pandehurit.

Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë të pranishëm, në seancë dëgjimore, ndërsa viktimave dhe mbrojtësi i viktimave njoftohen për seancën dëgjimore.

2.5.2 Këqyrja dhe rikonstruksioni

Këqyrja si burim i provës ndërmerret kur për vërtetimin ose sqarimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurë nevojitet vrojtimi i drejtpërdrejtë. Qëllimi i këqyrjes është që në mënyrë të drejtpërdrejtë të vërtetohen saktë dhe sa më objektivisht rrethanat materiale të cilat kanë të bëjnë me veprën penale. Këqyrjen e vendit të ngjarjes mund ta urdhërojë prokurori i shtetit, kurse rikonstruksionin prokurori i shtetit ose gjykata për të shqyrtuar provat e mbledhura, ose për të qartësuar faktet e rëndësishme.

⁵⁷ Neni 149 paragrafi 2 i KPP.

Këqyrjen dhe rikonstruksionin e vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia dhe për t'u konsideruar valid këqyrja ose rikonstruksioni i kryer nga policia dhe prokurori duhet, që i dyshuari, i pandehuri dhe mbrojtësi të njoftohen për ushtrimin e veprimit.

Në praktikë ka raste kur kryesi i veprës penale ose mbrojtësi mund të jenë të panjohur ose të njohur për prokurorinë. Nëse i dyshuari, i pandehuri apo mbrojtësi janë të panjohur për prokurorin e shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake merr pjesë dhe vëzhgon këqyrjen dhe rikonstruksioni.⁵⁸

Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose te situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura.⁵⁹ Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkret, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar.

Në nenin 150 paragrafi 6 të KPP, është parashikuar se gjatë rikonstruksionit të vendit të ngjarjes duhet pasur kujdes:

- të mos shkelet ligji dhe rendi;
- të mos fyhet morali publik;
- të mos vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve.

Kërkesat e mësipërme kanë karakter imperativ të cilat obligojnë autoritetet kompetente që me rastin e ndërmarrjes së veprimeve të rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, duhet pasur kujdes që të mos cenohen dispozitat ligjore dhe rendi publik. Gjithashtu të mos bëhen veprime me të cilat do të fyhet morali publik, si dhe që me veprimet që ndërmerren për rikonstruksionin e vendit të ngjarjes të mos krijohen situata të cilat do të mund të krijojnë rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve .

Për kryerjen në mënyrë efektive dhe të suksesshme të këqyrjes apo rikonstruksionit të vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistë të mjekësisë ligjore, trafikut dhe lëmvive tjera që mund të angazhohen për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet dhe incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera.

Të dhënat e marra sipas neneve 70-77 të KPP⁶⁰ në një raport që është përshtatshëmrisht në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 138 të KPP mund të jenë të pranueshme bazuar në shqyrtimin e gjyqtarit të procedurës paraprake i cili mund të urdhëroj këqyrje dhe

⁵⁸Neni 150 paragrafi 4 i KPP.

⁵⁹Neni 150 paragrafi 5 i KPP.

⁶⁰ Dispozitat e neneve 70-77 të KPP trajtojnë veprimet hetimore të policisë që *inter alia* përfshinë por pa u kufizuar në : mbledhjen e provave nga vendi i ngjarjes, e drejta e policisë për të ndaluar për një kohë të shkurtë, marrja në pyetje nga policia, kontrolli i përkohshëm për siguri, masat për identifikimin e të dyshuarit, mbledhja e të dhënave nga të dëmtuarit.

rikonstrukcion minimal të vendit të ngjarjes për të vërtetuar gjetjet në raportin nga ky paragraf. Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron që ky raport të jetë i pranueshëm.

Gjyqtari i procedurës paraprake është autoriteti mbikëqyrës dhe do t'i kontrolloj veprimet të cilat i ka ndërmarrë policia gjatë kryerjes së autorizimeve të saja që burojnë nga nenet 70-77 të KPP dhe në funksion të verifikimit mund të urdhëroj këqyrje dhe rikonstrukcion minimal për t'i konfirmuar gjetjet në raport. Është me rëndësi të kuptohet se gjyqtari i procedurës paraprake është autoriteti që urdhëron që raporti të jetë i pranueshëm për qëllimet e mëvonshme procedurale.

Ndërsa, pas ngritjes së aktakuzës autoriteti për urdhërimin e rikonstrukcionit të vendit të ngjarjes është *kryetari i trupit gjykues*, nëse fajësia apo pafajësia e të pandehurit kërkon që trupi gjykues të ketë njohuri të drejtpërdrejta nga rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes apo nga vizita në vendin e kryerjes së veprës penale.

Ndërmarrja e veprimeve të këqyrjes së vendit të ngjarjes apo rikonstrukcionit pas ngritjes së aktakuzës është kompetencë funksionale e kryetarit të trupit gjykues. Ligdhënësi konfirmon se ndërmarrja e veprimeve të tilla duhet të ketë relevancë përkatësisht të jetë e atij kualiteti që do të siguronte informacione të rëndësishme për fajësinë respektivisht pafajësinë e të pandehurit.

2.6 Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

2.6.1 Shqyrtime të përgjithshme

Sistemi i drejtësisë penale nuk mund të funksionoj si duhet pa prezantimin e dëshmive relevante në procedimet penale dhe është e papranueshme të dështojë në sjelljen e të pandehurve për gjykim dhe të marrë vendimin, për shkak se dëshmitarët kanë qenë në mënyrë efektive të dekurajuar nga ofrimi i dëshmisë në mënyrë të lirë dhe të vërtetë.⁶¹ Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, jeta, liria, siguria e dëshmitarëve nuk mund të rrezikohet në mënyrë të pajustificuar dhe se autoritetet publike kanë për obligim të mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmitë e tyre të ngushtë nga ndërhyrjet, kërcënimet dhe rreziku, para gjatë dhe pas gjykimit.⁶²

Të bindur se ndërkohë të gjithë personat e kanë për obligim qytetarë për të dhënë dëshmi të sinqertë si dëshmitarë, nëse kërkohet nga sistemi i drejtësisë penale, duhet kushtuar vëmendje më të madhe të drejtave dhe nevojave të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën që

⁶¹ Rekomandimet No. R (97) Komiteti i Ministrave të 13 Shteteve Anëtare lidhur me frikësimin e dëshmitarëve dhe të drejtave të Mbrojtjes (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 10 shtator 1997 në takimin e 600 të zëvendës ministrave).

⁶² Siguria dhe Mbrojtja e Dëshmitarëve në Kosovë Vlerësim dhe Rekomandime- Raporti i OSBE-së në Kosovë , Nëntor 2007(Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut , Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës, 21363/93, 21364/93, 21427/93, 23 prill 1997, para. 53; Shih poashtu Doorson kundër Holandës, 20524/92, 26 mars 1996, para. 70; P . S. Kundër Gjermanis; 33900/96, 20 dhjetor 2001, para. 22

askush të mos jetë subjekt i asnjë ndërhyrje apo të jetë vënë në rrezik personal. Aftësia e një dëshmitari të dëshmojë në një mjedis gjyqësor ose të bashkëpunojë me autoritetet e zbatimit të ligjit pa frikën e kërcënimeve apo ndëshkimeve është thelbësore për garantimin e sundimit të ligjit në një shoqëri.

Shumë vende kanë aprovuar ligje dhe politika për të mbrojtur dëshmitarët, pasi që bashkëpunimi i tyre me autoritetet e zbatimit të ligjit ose dhënia e dëshmisë në një gjykatë do të rrezikonte jetën e tyre ose të familjeve të tyre.

Mbrojtja mund të jetë aq e thjeshtë si duke siguruar një shoqërim policor për sallën e gjykatës, duke ofruar qëndrim të përkohshëm në një shtëpi të sigurt ose përdorimin e teknologjisë moderne të komunikimit për dëshminë. Ka raste të tjera, ku edhe pse, bashkëpunimi me një dëshmitar është kritike për ndjekjen e suksesshme penale, por edhe niveli dhe forca kërcënuese nga grupet kriminale janë aq të fuqishme dhe se nevojiten masa të jashtëzakonshme për të siguruar dëshmitarin. Në raste të tilla, rivendosja e dëshmitarit nën një identitet të ri, në një vend të ri të pazbuluar sa i përket banimit, në të njëjtin vend apo edhe jashtë vendit, mund të jetë e vetmja alternativë e besueshme.⁶³

Neni 6. paragrafi 1 dhe 3 i KEDNJ përcakton “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...”, ndërsa paragrafi 3, d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.

Rrjedhimisht, dispozitat e KEDNJ-së dhe vendimet e GjEDNJ-së njohin të drejtën e mbrojtjes për të ekzaminuar dëshmitarët dhe të sfidojnë dëshminë, megjithatë kjo nuk nënkupton se duhet të ballafaqohen ballë për ballë ndërmjet tyre dëshmitarët dhe të pandehurit.

Sipas praktikës së GjEDNJ-së është provuar që përdorimi i dëshmisë anonime nga një hetim, për sa kohë që i pandehuri apo përfaqësuesi ligjori i tij/saj kanë mundësinë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, nuk shkel domosdo të kodetdrejtën e të pandehurit nga neni 6 i KEDNJ për një gjykim të drejtë. Megjithatë, dënimi nuk duhet të bazohet asnjëherë vetëm apo në masën në bazë të deklarimeve anonime.⁶⁴

⁶³ Praktikata e mira për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Procedurën Penale përfshirë krimin e organizuar - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, Vjenë, f. 1, New York, 2008.

⁶⁴ Shih vendimet e GjEDNJ-së Dorson kundër Holandës, para.68-71 (*Case of Doorson v. The Netherlands, Application no. 20524/92*) dhe Kostovski kundër Holandës 11454/85, 20 nëntor 1989, para.44.

KPP lejon fshehjen e identitetit të dëshmitarëve, dëgjime jo publike, largimin e përkohshëm të pandehurit nga salla e gjyqimit gjatë dëshmisë nga dëshmitari, përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme apo përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, dëshminë nga largësia ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrimin para seancës dëgjimore në praninë e mbrojtësit.⁶⁵ Rrjedhimisht për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarëve mund të aplikohen masat mbrojtëse dhe urdhëri për anonimitet të plotë.

GJEDNJ, në precedentët e saj ka një qasje të kujdesshme, ashtu që ndonëse nuk e ndalon shfrytëzimin e dëshmisë së dëshmitarit anonim, këshillon që shfrytëzimi i tillë të jetë i kufizuar (*Case of Doorson v. The Netherlands, Application no. 20524/92 Judgment Strasbourg 26 march 1996*). Mirëpo, GJEDNJ konsideron se është shkelur e drejta e të pandehurit në mbrojtje efikase, edhe pse mbrojtësi ka pasur të drejtë të pyes dëshmitarin përmes pyetjeve të shkruara, sepse mbrojtësi ka qenë i ballafaquar me pengesa të pakapërcyeshme - ka qenë i privuar nga informatat e domosdoshme, të cilat do ti mundësonin vërtetimin e kredibilitetit të dëshmitarit ose të shpreh dyshim në validitetin e dëshmisë së tij. Me këtë është shkelur edhe parimi i kontradiktoritetit, andaj i pandehuri ka qenë i privuar nga një gjykim i drejtë.⁶⁶

2.6.2 Subjektet e autorizuar për paraqitjen e kërkesës për masa mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet

Kërkesën për masa mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet mund ta paraqesin:

- Prokurori i shtetit;
- I pandehuri;
- Mbrojtësi;
- I dëmtuari;
- Dëshmitari bashkëpunues;
- Dëshmitari;

Në cilëndo fazë të procedurës mund t'i paraqesin gjyqtarit kompetent kërkesë me shkrim, për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet, kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjarëve të tyre.⁶⁷

⁶⁵ Neni 222 i KPP-së

⁶⁶ Shih rasti i GJEDN-së Kostovski kundër Holandës , kërkesa nr. 11454/85, aktgjykimi , Strasburg 20 Nëntor 1989 (*Case of Kostovski v. th Netherlands, Application no. 11454/85 Judgment, Strasbourg 20 November 1989*).

⁶⁷ Neni 221 paragrafi 1 i KPP.

Masat mbrojtëse përfshijnë, por nuk kufizohen:

- a) lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne apo informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
- b) mos-zbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
- c) përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme apo përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrim para seancës dëgjimore në praninë e mbrojtësit;
- d) caktimin e pseudonimit;
- e) seancën e mbyllur për publikun;
- f) urdhrat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose për të mos zbuluar ndonjë material apo informacion që mund të shpie në zbulimin e identitetit;
- g) largimin e përkohshëm të pandehurit nga gjykatëria nëse dëshmitari bashkëpunues dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të pandehurit apo nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do ta flasë të vërtetën në prani të pandehurit; ose
- h) cilido kombinim i metodave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.

Gjyqtari mund të zbatojë cilindo nga masat apo të kombinojë metodat e përmendura me qëllim të evitimit të *rrezikut serioz*⁶⁸ për të dëmtuarin, dëshmitarin, të pandehurit apo familjarëve të tyre, të cilat do të caktoj në varësi të rrethanave specifike të çështjes konkrete. Gjyqtari duhet të shqyrtoj në mënyrë të kujdesshme se cilat nga këto metoda do të ishin më të përshtatshme.

Urdhri për masë mbrojtëse bëhet me shkrim dhe nuk përfshin informata të cilat mund të çojnë në zbulimin e identitetit të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose të anëtarit të familjes së tij, ose të cilat mund ta zbulojnë ekzistimin ose seriozisht të rrezikojë sigurinë e veprimeve hetimore të policisë dhe fshehtësinë e tyre.

2.6.3 Kushtet që duhet të plotësohen për urdhrat mbrojtës

- Ekziston rreziku serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tyre;

⁶⁸ Neni 220 paragrafi 1 të KPP-së. “Rrezik serioz” do të thotë frikë e justifikueshme për rrezikim të jetës, shëndetit fizik apo mendor, pronës së të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose anëtarit të familjes së të dëmtuarit apo të dëshmitarit, si pasojë që pritet për faktin se i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari ka dhënë prova gjatë marrjes në pyetje apo dëshmimit në gjykatë.

- Masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin, dëshmitarin bashkëpunues ose anëtarin e familjes së tyre.

2.6.4 Urdhri për anonimitet nga publiku

Nëse masat mbrojtëse nga neni 222 paragrafi 1 i KPP janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit i cili është propozuar nga mbrojtja, në rrethana jashtëzakonshme gjyqtari kompetent mund të urdhërojë anonimitet,⁶⁹ ku dëshmitari të cilin e ka propozuar mbrojtja mbetet anonim për publikun, të dëmtuarin edhe përfaqësuesit e tij ligjor ose përfaqësuesit e autorizuar.

a) Gjyqtari mund të nxjerrë urdhër për anonimitet kur vlerëson se:

- Ekziston rrezik serioz për dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i dëshmitarit është i nevojshëm, për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
- dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa e bënë të padrejtë realizimin e mbrojtjes pa të;
- besueshmëria e dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur;
- nevoja për anonimitetin e dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë se sa interesi i publikut apo të dëmtuarit për ta ditur identitetin e dëshmitarit në zbatimin e procedurës

b) Procedura për urdhrin për anonimitet

Para marrjes së urdhrin për anonimitet, gjyqtari kompetent mban seancë dëgjimore me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje dëshmitari përkatës dhe personat tjerë të nevojshëm, siç janë personeli policor dhe personeli ushtarak që kujdesen për sigurinë. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm prokurori i shtetit, personeli i domosdoshëm i gjykatës e i prokurorisë dhe mbrojtësi.

c) Urdhri për anonimitet prej të pandehurit

Kur masat mbrojtëse të parapara në neni 222 paragrafi 1 të KPP janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit i cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari kompetent në rrethana të jashtëzakonshme

⁶⁹“Anonimitet” do të thotë mungesa e informatave të dhëna për identitetin ose vendndodhjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo të dëshmitarit, identitetin ose vendndodhjen e anëtarit të familjes së të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose identiteti i cilitdo personi që ka lidhje me të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues apo me dëshmitarin.

mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari mbetet anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin.

Prokurori i shtetit kërkon urdhër për anonimitet prej të pandehurit vetëm me propozim me shkrim të mbyllur ku paraqiten fakte të cilat tregojnë se:

- ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin për të cilin kërkohet urdhri për anonimitet; dhe
- anonimiteti do të parandalonte rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin.

Gjykata nuk lëshon urdhër nga ky nen bazuar në kërkesën nga paragrafi 2. i këtij neni që bazohet në përshkrim të përgjithshëm të rreziqeve që i kanosen dëshmitarëve në raste të ngjashme. Para se të merret urdhër për anonimitet, gjyqtari kompetent zbaton seancë dëgjimore me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari në fjalë dhe personat tjerë të nevojshëm siç është personeli policor ose ushtarak që kujdesen për rendin.

Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm prokurori i shtetit, personeli i domosdoshëm i gjykatës dhe i prokurorisë.

d) Gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër të tillë për anonimitet vetëm kur ai çmon se:

- ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin apo anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
- dëshmia e të dëmtuarit, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të;
- besueshmëria e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin kompetent në seancë të mbyllur; dhe
- nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë se sa interesi i të pandehurit për ta ditur identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit në zbatimin e mbrojtjes.

e) Forma e urdhrimit për anonimitet

Urdhri për anonimitet duhet bërë me shkrim dhe nuk përmban ndonjë informacion që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit

apo anëtarit të familjes së tij, ose që do të mund të zbulonte ekzistimin ose do të ekspozonte ndaj një rreziku serioz për sigurinë operationale të hetimit të fshehtë të policisë.

Të dhënat nga procesverbali i seancës së mbyllur hiqen nga procesverbali, mbyllen dhe ruhen si fshehtësi zyrtare menjëherë pas identifikimit dhe para marrjes në pyetje të dëmtuarit, dëshmitarit, bashkëpunues ose dëshmitarit

Të dhënat e kufizuara mund të inspektohen dhe të përdoren nga prokurori i shtetit dhe gjyqtari kompetent vetëm në procedurën e ankimit kundër urdhrit të shqiptuar nga neni 223 ose 224 të KPP. Ankesa kundër urdhrit për anonimitet dhe përdorimi i metodave për të parandaluar zbulimin e identitetit ndaj publikut, të dëmtuarit, dëshmitarëve, mbrojtësit dhe të pandehurit mund t'i paraqitet kolegjit shqyrtues kur urdhri është dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake. Në të kundërtën, mund të ushtrohet ankesë vetëm kundër aktgjykimit.

f) Ndalimi i pyetjeve që mund ta zbulojnë identitetin

Gjykata ndalon:

- parashtrimin e pyetjeve që mund të zbulojnë identitetin;
- të gjitha pyetjet, përgjigjja e të cilave mund të zbulojë identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit të mbrojtur me masa mbrojtëse apo të dhëna të kufizuara.

g) Mbrojtja e dëshmitarëve

Masat e veçanta dhe të jashtëzakonshme, mënyrat dhe procedurat për mbrojtje të dëshmitarëve dhe dëshmitarët bashkëpunues rregullohen me Ligjin për Mbrojtje të Dëshmitarëve, Ligji nr. 04/L- 015.

h) Masat tjera mbrojtëse në rastet e dhunës në familje

Masat mbrojtëse në rastet e dhunës në familje para gjykatës themelore rregullohen me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 03/L-182.

2.7 Heqja e lirisë dhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

2.7.1 Parimet e përgjithshme

Heqja e lirisë është njëra prej çështjeve më të ndjeshme në procedurën penale, pasi që bëhet fjalë për heqjen e lirisë ende pa u vërtetuar fajësia e të pandehurit. Prandaj, dispozitat të cilat kanë të bëjnë me heqjen e lirisë duhet të interpretohen nga policia, prokurori i shtetit dhe gjykatat duke u mbështetur në këto parime:

- e drejta e të pandehurit për liri dhe siguri përcakton prezumimin në favor të qëndrimit në liri;
- privimi nga liria urdhërohet nga gjykata vetëm nëse prokurori i shtetit paraqet prova nga ky kapitull që mbi peshojnë prezumimin nga nën-paragrafi 1.1. të këtij paragrafi;
- kur urdhërohet heqja e lirisë nga ky kapitull, policia, prokurori i shtetit ose gjykata përdor kufizimet më të vogla të mundshme ndaj lirisë.

Në KPP janë përcaktuar parimet të cilat duhet të aplikohen me rastin e heqjes së lirisë dhe në mënyrë të qartë e drejta e të pandehurit që gjatë procedurës penale, duke përfshirë periudhën në të cilën hetohet, ndiqet penalisht dhe gjatë gjykimit të jetë në gjendje të lirë, respektivisht ajo që njihet si prezumimi në favor të lirisë.

Neni 5 paragrafi 1 i KEDNJ-së, tregon që ka një prezumim që çdokush duhet të gëzojë lirinë e tij dhe si rrjedhojë një person mund të privohet nga kjo liri në rrethana përjashtuese.⁷⁰ Prezumimi në favor të lirisë sipas këtij standardi, siguron që liria ashtu si duhet të humbet jo më shumë se është e nevojshme, të jetë në gjendje që të rikuperohet menjëherë kur një humbje e tillë nuk justifikohet. Gjithashtu, bënë të qartë se masat për kufizimin e lirisë së të pandehurit janë përjashtim dhe gjithmonë duhet kuptuar në këtë aspekt dhe e drejta për t'u gjykuar në gjendje të lirë është një prej të drejtave thelbësore.

Në çdo rast, kur kontestohet një heqje lirie është thelbësore për një gjyqtar që të nis punën nga presupozimi se personi në fjalë duhet të lihet i lirë. Në bazë të këtij presupozimi, gjyqtari jo vetëm që duhet të presë dhe të kërkojë arsyet që duhen parashtruar për këtë heqje lirie, por edhe duhet t'i kalojë apo nëpërmjet një hetimi të hollësishëm për të shqyrtuar nëse ato aktualisht e justifikojnë veprimin që është ndërmarrë. Në të kundërtën do të rezultonte në devijim nga shteti ligjor dhe në dorëzim drejt trajtimit arbitrar. Papranueshmëria në këtë drejtim mund të shihet në konkluzionin e nxjerrë nga Gjykata Evropiane e Drejtave dhe Lirive të Njeriut se masa e ndalimit të vazhdueshëm të një personi nuk mund të justifikohet në çështjen “kur gjykata vendase

⁷⁰ Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Neni 5 paragrafi 1.

në mënyrë të përsëritur autorizoi vazhdimin e masës së paraburgimit, duke përdorur forma fjalësh identike dhe në fakt stereotipe, shpesh pa përpunim dhe analizë të mëtutjeshme. Në shqyrtimin e kësaj metode pune gjyqtari vendos thjesht po zbatonte vendimin e ligjvënësve dhe dështoj në ushtrimin e një gjykimi të pavarur e kritik, kjo nuk mund të jetë asnjëherë në pajtim me kushtin e justifikimit të heqjes së lirisë”.⁷¹

2.7.2 Barrën e provave (onus probandi) tek prokurori i shtetit, në shkallën që e mbi peshojnë prezumimin në favor të lirisë.

Në çdo rast konkret prokurori, ka për obligim që ta paraqes sasinë dhe cilësinë e provave, të cilat në mënyrë bindëse tregojnë se ekuilibri në mes të privimit të lirisë dhe prezumimit në favor të lirisë, është në anën e privimit të lirisë për arsyet ligjore që e justifikojnë domosdoshmërisht një gjë të tillë.

2.7.3 Parimi i proporcionalitetit

Nënkupton se gjithmonë duhen përdoren kufizimet sa më të vogla dhe të aplikohen masat më të lehta kur mund të arrihen qëllimet legjitime. Policia, prokurorët dhe gjyqtarët gjatë punës së tyre në përditshmëri, kur vendosin se cilën nga masat të kërkojnë, caktojnë, çdo herë duhet të kenë në mendjet e tyre këtë parim, që të mos aplikojnë masë të më të rëndë, kur efekti dhe qëllimi mund të arrihet edhe me një masë më të lehtë.

2.7.4 Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor

Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës. Personi të cilit i është hequr liria nga persona të tjerë përpos policisë, menjëherë i dorëzohet policisë, e kur kjo është e pamundur menjëherë njoftohet policia ose prokurori i shtetit. Policia vepron në pajtim me nenin 163 dhe 164 të KPP-së.

Në situatat flagrante respektivisht gjatë kryerjes dhe kur është në ndjekje për veprën e kryer përveç policisë në këto rrethana të autorizuar për arrestim, është edhe çdo person, të cilët kanë për obligim që t'i dorëzojnë policisë menjëherë, kur kjo është e pamundur njoftohet policia dhe prokuroria.

⁷¹ Shih vendimi i GJEDNJ-së *Mansur kundër Turqisë, aktgjykimi i GjEDNJ-së i datës 8. 06. 1995, Strasburg.*

Kufizimet në arrestimin e përkohshëm dhe ndalimin policor

Policia nuk mund të privojë personin nga liria, përveç nëse:

- arrestimi lejohet sipas nenit 162 të KPP-së;
- ka urdhër të gjykatës për të arrestuar personin;
- ka urdhërarrest që duket të jetë i vlefshëm, të pranuar përmes INTERPOL-it apo arrestimi është i autorizuar nga neni 164 i KPP;
- privimi nga liria është i shkurtë dhe në pajtim me nenin 72 të KPP.⁷²

Çdo person i privuar nga liria me arrest sipas bazave të lartcekura duhet që pa vonesë ta sillet te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin. Vonesa nuk tejkalon 48 (dyzet e tetë) orë.

2.7.5 Urdhri i gjykatës për të arrestuar personin

Një ndër kushtet nën të cilat një person mund të privohet nga liria, është ekzistimi i urdhrit të gjykatës. Në rastet e tilla duhet të konstatohet ekzistimi i urdhrit valid që përcakton heqjen e lirisë personit të caktuar për shkak të veprës penale të caktuar.

a) Ka urdhërarrest që duket të jetë i vlefshëm, të pranuar përmes INTERPOL-it apo rrugëve tjera diplomatike;

Bazë për privimin e lirisë është ekzistimi i urdhërarrestit të pranuar nga INTERPOLI (Organizata Ndërkombëtare e Policisë) apo përmes rrugëve të tjera diplomatike, trajton situatën kur urdhërarrestit është lëshuar nga autoritetet e shteteve të tjera dhe ju përcjellët autoriteteve vendore. Kjo bëhet në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftë kundër kriminalitetit. Privimi nga liria është i shkurtë dhe duhet të jetë në pajtim me nenin 72 të KPP.

Kjo është një situatë specifike e kufizimit të lirisë e cila i jep autorizime policisë që t'i ndalojë dhe të mbledhë informacione nga personat që gjenden në vendin e kryerjes së veprës penale, për të cilët besohet se mund të japin informacione të rëndësishme për procedurën penale, dhe nëse ka gjasa që mbledhja e informacionit nga këta persona më vonë do të ishte e pamundur ose do të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën apo do të shkaktonte vështirësi të tjera. Ndalimi i personave të tillë nuk mund të zgjasë

⁷² Në nenin 72 të KPP është parashikuar se “Policia ka të drejtë t’i ndalojë dhe të mbledhë informacione nga personat që gjenden në vendin e kryerjes së veprës penale, të cilët mund të japin informacione të rëndësishme për procedurën penale, nëse ka gjasa që mbledhja e informacionit nga këta persona më vonë do të ishte e pamundur ose do të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën apo do të shkaktonte vështirësi të tjera. Ndalimi i personave të tillë nuk mund të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme për të marrë emrat, adresat dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me këtë dhe në asnjë rast nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë orë. Ndalimi i tillë mund të bëhet vetëm nëse nuk ka mjete të tjera për të arritur deri tek informacioni...”.

më shumë se sa është e nevojshme për të marrë emrat, adresat dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me këtë dhe në asnjë rast nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë orë.

Ky kufizim është i natyrës subsidiare dhe mund të bëhet vetëm nëse nuk ka mjete të tjera për të arritur deri tek informacioni. Policia e trajton personin e ndaluar me dinjitet dhe nuk e ndalon personin në qendër të paraburgimit dhe nuk i vënë pranga.

b) Arrestimi gjatë fazës së hetimit:

Kur prokurori i shtetit autorizon hetimin, policia arreston dhe ndalon personin vetëm nëse:

- ka dyshim të bazuar se ai ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe
- ka baza të artikulueshme për të besuar se:
 - ka rrezik të arratisjes;
 - ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit;
 - ose kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.⁷³

Arrestimi dhe ndalimi autorizohet nga prokurori i shtetit që ka filluar hetimin, ose kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, nga policia e cila menjëherë pas arrestimit duhet të informojë prokurorin e shtetit.

Personi i arrestuar sipas këtij neni gëzon të drejtat e të pandehurit. Me rastin e arrestimit, personi i arrestuar informohet:

- gojarisht për të drejtat e parapara në nenin 167 të KPP dhe
- me shkrim për të drejtat tjera të cilat ai i gëzon sipas KPP.⁷⁴

⁷³Neni i 164 i KPP.

⁷⁴Neni 164 paragrafi 3 dhe 4 i KPP.

Ndalimi nuk mund të kalojë dyzet e tetë (48) orë nga koha e arrestimit. Pas kalimit të këtij afati, policia e liron të ndaluarin, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.

Sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, prokurori i shtetit i lëshon personit të arrestuar vendimin me shkrim mbi ndalimin, që përfshin emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet dhe bazën juridike për arrestim.

Brenda njëzetë e katër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit.

Kërkesa për caktimin e paraburgimit duhet të jetë në pajtim me nenin 165 të KPP. I pandehuri përfaqësohet nga mbrojtësi në seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës për caktim të paraburgimit dhe mbrojtësi ka qasje në shkresat e lëndës së të pandehurit për t'u përgatitur për seancën.⁷⁵

2.7.6 Sjellja e personave të arrestuar para gjyqtarit të procedurës paraprake

Çdo person i privuar nga liria me arrest duhet që pa vonesë të silltet te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin. Vonesa nuk tejkalon dyzet e tetë (48) orë.

Personat e arrestuar pa vonesa duhet të sillen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Ligjvënësi ka përdorur shprehjen “*pa vonesa*”, kjo duhet nënkuptuar që sa më parë në varësi të rrethanave të çështjes konkrete të procedohet sa më shpejt. Ndërsa kufizimi është 48 (dyzet e tetë) orë, i cili nuk guxon të tejkalohet, megjithatë në praktikë ka predispozita që ky afat kohor të shfrytëzohet deri në fund. Në të gjitha ato çështje ku mund të mblidhen dëshmitë e nevojshme për këtë fazë të procedurës, dhe në ato që janë më pak të komplikuar, do të duhet të krijohet një praktikë që afati maksimal prej 48 orëve të mos përdoret në tërësi. Por vetëm në rastet kur rrethanat e çështjes konkrete për shkak të komplikueshmërisë, angazhimit në mbledhjen informacioneve, dëshmimeve dhe analizimin e tyre e justifikojnë një gjë të tillë. Mund të supozohet se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që ta shkurtoj në afatin sa më të shkurtër kohën e privimit të lirisë para vendimit gjyqësor.

⁷⁵ Neni 164 paragrafët 5-9 të KPP.

KAPITULLI III
MASAT PËR SIGURIMIN E
PRANISË SË TË PANDEHURIT

KAPITULLI III

3. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT	68
3.1 Shqyrtime të përgjithshme	68
3.2 Thirrja	68
3.3 Urdhërarresti	69
a) Përmbajtja e urdhërarrestit.....	69
3.4 Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin	70
3.5 Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar	71
3.6 Paraqitja në stacionin policor.....	72
3.7 Dorëzania	73
a) Në çka konsiston dorëzania	73
b) Dështimi i dorëzanisë	74
c) Për cilat vepra penale nuk mund të caktohet masa e dorëzanisë	74
3.8 Arresti shtëpiak	75
a) Mbikëqyrja e zbatimit të masës dhe cenimi eventual i saj	75
b) Përshtatshmëria e aplikimit të dispozitave të paraburgimit.....	75
3.9 Diversioni.....	76
3.10 Paraburgimi.....	77
a) Njoftimi i organit kompetent për mirëqenie sociale për arrestin, kur kjo është e nevojshme	77
b) Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit	77
c) Me rastin e vlerësimit nëse do të urdhërohet paraburgimi gjykata duhet të ketë parasysht.....	81
d) Procedura për urdhrin për paraburgim.....	83
e) Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij.....	83
f) Dorëzimi i aktvendimit.....	84
i) Ankesa nuk ka karakter suspensiv	84
j) Diskrecioni i gjyqtarit.....	84
k) Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë	84
l) Afatet kohore të paraburgimit	85
m) Vazhdimi i paraburgimit	85
n) Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata.....	86
o) A do të duhet të mbahej seanca dëgjimore për të vlerësuar kërkesën për ligjshmërinë e paraburgimit?	88
p) Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës	89
.....	

3. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT

3.1 Shqyrtime të përgjithshme

Masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë:

- thirrja;
- urdhërarresti;
- premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
- ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar;
- paraqitja në stacionin policor;
- dorëzania;
- arresti shtëpiak
- diversioni dhe
- paraburgimi.

Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë.⁷⁶

Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.⁷⁷

Sipas nenit 173 paragrafi 4 të KPP, para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues, përveç nëse parashihet ndryshe me KPP.

3.2 Thirrja

Njëra prej masave të rregullta për sigurimin e prezencës së të pandehurit është thirrja, e cila njëkohësisht paraqet masën rutinore që përdoret në situata të zakonshme dhe në të cilën të pandehurit mbrohen në liri gjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj tyre.

Përmbajtja e thirrjes dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me thirrjen janë të rregulluara me nenin 174 të KPP.

⁷⁶ Sipas nenit 173 paragrafi 5 të KPP, shprehja “masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit” apo “masa më të buta” nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzanimin, arrestin shtëpiak dhe diversionin.

⁷⁷Neni 173 paragrafët 1-3 të KPP.

3.3 Urdhërarresti

Në nenin 175 paragrafi 1 të KPP, është përcaktuar se gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojë urdhërarrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1 i nenit 187 të KPP, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimin të thirrjes.

Gjykata, urdhërarrestin mund ta lëshojë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit. Gjithashtu, është paraparë edhe mundësia e lëshimit të urdhër arrestit edhe me kërkesë të policisë, mirëpo vetëm kur ekzistojnë rrethanat e ngutshme dhe kur plotësohen kushtet nga neni 187 paragrafi 1 i KPP ose mbi bazën e rrethanave kur i pandehuri është thirrur me rregull por nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën.

Duhet të plotësohen kushtet e caktuara, në mënyrë që të konsiderohet se i pandehuri është ftuar në mënyrë të rregullt. Në këtë aspekt vlen për t'u përmendur që ftesa duhet t'i jetë dërguar konform dispozitave ligjore, duke e përfshirë dorëzimin personal, për ftesat që kërkohen t'i dërgohen personalisht të pandehurit. Nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton, ose situatat kur thirrja nuk mund ti dërgohet dhe në bazë të rrethanave është e qartë që i shmanget pranimin të thirrjes. Në praktikë paraqiten situata kur të pandehurit i shmangen pranimin të thirrjeve në mënyrë që të evitojnë paraqitjen dhe pamundësojnë lëshimin e urdhërarrestit. Megjithatë është çështje faktike, kur në bazë të rrethanave të rastit konkret qartazi tregohet se i shmanget pranimin të thirrjeve, prandaj me rastin e konstatimit të këtyre rrethanave gjykata mund të lëshojë urdhërarrestin për sigurimin e prezencës së të pandehurit.

a) Përmbajtja e urdhërarrestit

Urdhërarresti lëshohet me shkrim dhe përfshin:

- emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat tjera personale të njohura për gjyqtarin;
- përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të KPRK apo ndonjë ligji të posaçëm me të cilën parashihen vepra penale;
- bazën mbi të cilën lëshohet urdhri, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që lëshon urdhërarrestin.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në urdhërarrest, urdhërarresti skadon në mesnatën e ditës së 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pestë) nga dita e lëshimit.⁷⁸ Pra, parimisht, urdhërarresti skadon me kalimin ditës së 365 (treqindegjashtëdhjetepesë), mirëpo është paraparë mundësia që të jetë paraparë ndryshe dhe në këtë mënyrë urdhërarresti vazhdon të jetë valid, por kjo duhet përcaktuar në mënyrë shprehimore në urdhërarrest.

Policia është autoriteti ligjor për ta ekzekutuar urdhërarrestin. Zyrtari i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrit ia dorëzon urdhrin të pandehurit dhe kërkon që i pandehuri ta shoqërojë. Kur i pandehuri këtë e refuzon, atëherë dërgohet forcërisht.⁷⁹ Konkludohet se fillimisht duhet t'ia dorëzojë të pandehurit urdhrin dhe kërkon nga i pandehuri që të shoqërohet, ndërsa nëse njëjti refuzon atëherë duhet të sjellët me dhunë.

Në nenin 175 paragrafi 5 të KPP, është parashikuar se urdhri për paraqitje të detyrueshme të zyrtarëve të policisë ose të rojtarëve të institucionit ku personat mbahen në ndalim ekzekutohet nëpërmjet ndërmjetësimit të komandës ose eprorit të tyre.

Në kohën e arrestimit, personi informohet në gjuhën që e kupton për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat nga neni 167 i KPP.

Menjëherë pas arrestimit, personi i arrestuar dërgohet para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhrin.⁸⁰

3.4 Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin

Në nenin 176 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer vepër penale dhe ka arsye për dyshim se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Premtimi i dhënë shënohet në procesverbal.

Njëra nga masat alternative të paraburgimit është premtimi se i pandehuri nuk do të fshihet ose nuk do ta braktisë vendbanimin pa lejen e gjykatës. Kjo masë përcaktohet në rastet kur ekziston dyshimi se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Pra i njëjti mund të fshihet brenda vendit pa e kaluar kufirin e shtetëror të vendit, por edhe mund të largohet jashtë vendit.⁸¹

Bazuar në rrethanat e rastit konkret që i referohen natyrës dhe seriozitetit të veprës penale, rrethanave personale të pandehurit veçanërisht lidhjet e tij eventuale me shtetet e jashtme, siç mund të jenë posedimi i shtetësisë së një shteti tjetër, ekzistimi i

⁷⁸Neni 175 paragrafi 2 i KPP- së.

⁷⁹ Neni 175 paragrafi 4 i KPP-së

⁸⁰Neni 175 paragrafët 6 dhe 7 i KPP.

⁸¹ Neni 176 paragrafi 1 i KPP-së

vendbanimit ose i vendqëndrimit, familja e të pandehurit jeton në shtet tjetër, ose lidhjet e tij biznesore me shtetet e tjera. Këto rrethana duhet të vlerësohen me kujdes, për të dhënë përgjigje në pyetjen nëse i njëjti më parë do të largohet nga vendi se sa do të ishte në gjendje të ballafaqohet me pasojat eventuale të veprës penale për të cilën dyshohet.

Konfiskimi i dokumentit është çështje fakultative që në varësi të rrethanave do të vendoset nëse do të ishte e nevojshme konfiskimi i dokumentit të udhëtimit në mënyrë që të minimizohet rreziku i largimit të pandehurit nga vendi. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk pezullon ekzekutimin e aktvendimit.⁸²

Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgimi nëse nuk i përmbahet këtij premtimi.⁸³

3.5 Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar

Gjykata mund t'ia ndalojë të pandehurit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar kur:

- ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
- ekzistojnë rrethanat nga neni 187, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2.2. ose 1.2.3 të KPP;
- ndalimi i tillë mund të zvogëlojë rrezikun që i pandehuri t'i asgjësojë provat e veprës penale, të ndikojë në dëshmitarë, në bashkëkryerës ose në bashkëpjesëmarrës pas kryerjes së veprës, në përsëritjen e veprës penale, në përfundimin e veprës penale të tentuar ose në kryerjen e veprës penale për të cilën është kanosur.

Me caktimin e kësaj mase gjykata përcakton largësinë përkatëse nga vendi i caktuar ose nga personi të cilën i pandehuri duhet ta respektojë dhe nuk duhet ta kalojë me qëllim. I pandehuri duhet të njoftohet përkitazi me pasojat e cenimit gjegjësisht do të vihet në dijeni se ndaj do të caktohet masa e paraburgimit në rastet e shkeljes së aktvendimit.

Ndërsa, nëse personi i mbrojtur me këtë masë qëllimisht cenon distancën të cilën i pandehuri detyrohet ta respektojë, gjykata mund ta dënojë personin e mbrojtur me gjobë siç parashihet në nenin të KPP.⁸⁴

⁸² Neni 176 paragrafi 2 i KPP-së

⁸³ Neni 176 paragrafi 3 të KPP

⁸⁴ Neni 177 paragrafi 6 të KPP.

Dispozitat ligjore lidhur me paraburgimin e përshtatshëmrisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës së ndalimit për t'iu ofruar vendit apo personit të caktuar.⁸⁵

Përmes caktimit të kësaj mase synohet eliminimi ose zvogëlimi i rrezikut për ndikim në të dëmtuar, dëshmitarë, por edhe atë të përsëritjes së veprës penale, në varësi të rrethanave specifike të rastit konkret vlerësohet si masë e mjaftueshme dhe më e përshtatshme për të garantuar integritetin e hetimeve dhe pengimin e ri-kryerjes së veprës penale.

3.6 Paraqitja në stacionin policor

Duke u bazuar në nenin 178 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të paraqitet herë pas here në kohë të caktuar në stacionin policor, në rajonin ku i pandehuri e ka vendbanimin apo vendqëndrimin ose në vendin ku i pandehuri është ndodhur në momentin e urdhrit, nëse:

- ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe
- ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të fshihet, do të shkojë në vend të panjohur ose do të largohet nga Kosova.

Gjykata mund të urdhërojë paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes. Përveç kur ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e KPP lidhur me paraburgimin përshtatshëmrisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen.

Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit.

Dokumenti i udhëtimit i personit i cili i nënshtrohet aktvendimit sipas këtij neni mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimi.⁸⁶

Kjo masë ka për qëllim të eliminoj ose të paktën të minimizoj rrezikun e arratisjes apo të fshehjes së të pandehurit, në atë mënyrë që gjykata përcakton që here pas here i pandehuri të paraqitet në stacionin policor. Shpeshtësia e paraqitjes vlerësohet në kontekst të rrethanave dhe shkallës së rrezikut që do ta vlerësoj gjykata dhe do të caktoj orarin e paraqitjeve i cili vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të garantuar prezencën e të pandehurit gjatë procedurës penale.

⁸⁵ Neni 177 paragrafi 7 të KPP

⁸⁶ Neni 178 paragrafët 2 – 7 të KPP -së.

3.7 Dorëzania

Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur:

- ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale;
- baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë dhe
- i pandehuri premtun se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij.⁸⁷

Ndërsa, sipas nenit 179 paragrafi 2 të KPP, gjykata me aktvendim gjithashtu mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur:

- ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale;
- i pandehuri nuk dyshohet për veprë penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim sipas kapitujve XIV, XV, XVI, XVII, XX, XXI, XXIX, XXX dhe XXXIII të KPRK;
- baza e vetme për paraburgim është rreziku se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, të përfundojë veprën e tentuar penale ose të kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë dhe
- i pandehuri ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprën penale, nuk do ta përfundojë veprën e tentuar penale ose nuk do ta kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë.

Dorëzania e urdhëruar nga gjykata jepet nga i pandehuri ose personi tjetër në emër të tij. Gjithashtu kjo masë është alternativë e paraburgimit në rastet e ekzistimit të rrethanave që tregojnë rrezikun e ikjes dhe dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzaninë.

a) Në çka konsiston dorëzania

Dorëzania mund të jepet:

- para të gatshme;
- me letra me vlerë;
- sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen;

⁸⁷Neni 179 paragrafi 1 i KPP -së.

- me vënien e hipotekës për shumën e dorëzarisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzani ose me detyrim personal të një apo më të shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzarisë.

b) Dështimi i dorëzarisë

Nëse i pandehuri ikë, me aktvendimi të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzania të derdhet në fondin për kompensimin e viktimave.⁸⁸ Gjithashtu dorëzania mund të caktohet edhe për bazën e paraburgimit në situatat kur ekziston rreziku i përsëritjes së veprës penale, të përfundojë veprën e tentuar penale ose të kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryejë. Njëkohësishtë ka premtuar se nuk do të përsërisë veprën penale, nuk do të përfundojë veprën e tentuar ose nuk do të kryej veprën penale të cilën është kanosur se do ta kryejë.⁸⁹

Mund të kuptohet se dorëzani mund të caktohet edhe për bazën e përsëritjes së veprës penale dhe jo vetëm rrezikun e arratisjes, siç jemi mësuar ta konceptojmë këtë masë tradicionalisht dhe kjo paraqet një zgjerim të mundësisë së alternativitetit ndaj masës së paraburgimit.

c) Për cilat vepra penale nuk mund të caktohet masa e dorëzarisë

Është e rëndësishme të kuptohet qartë se kur nuk mund të urdhërohet kjo masë. Ekzistojnë dy situata të cilat dallojnë sa i përket bazave për paraburgim. Deri sa kur kemi të bëjmë *me bazën e ekzistimit të rrezikut të ikjes si arsye për paraburgim*, nuk ka ndonjë kufizim sa i përket llojit të veprave penale për të cilat mund të caktohet kjo masë, andaj konkludimi është se mund të caktohet kur të plotësohet kushtet ligjore, siç janë dyshimi i bazuar dhe premtimi se nuk do të fshihet ose të largohet pa lejen e gjykatës.

Ndërsa, situata e dytë qëndron në ekzistimin e bazës së paraburgimit rrezikun se i pandehuri do të përsërisë veprën penale, ta kryej veprën e tentuar ose kryej veprën për të cilën është kanosur se do ta kryej. Për këtë duhet të plotësohet kushti i cili mund të konstatojmë se është pozitiv, që do të thotë se i pandehuri duhet të premtoj se nuk do përsërisë veprën penale, nuk do të kryej veprën për të cilën është kanosur se do ta kryejë.

⁸⁸ Neni 181 paragrafi. 3 të KPP-së

⁸⁹ Neni 179 par. 2. 2. 3 dhe 2.2.4 i KPP-së

Ndërsa, kushti është i natyrës negative, respektivisht ka të bëjë me atë që veprat penale për të cilat ekziston dyshimi i bazuar, nuk duhet të jenë në kapitujt e listuar gjegjësisht në Kapitullin XIV (Veprat kundër Rendit Kushtetues dhe Sigurisë së Republikës Kosovës); Kapitullin XV (Veprat Penale kundër Njerëzimit dhe Vlerave të Mbrojtura me të Drejtën Ndërkombëtare); Kapitullin XVI (Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit); Kapitullin XVII (Veprat Penale Kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut); Kapitullin XX (Veprat Penale Kundër Integritetit Seksual); Kapitullin XXI (Veprat Penale Kundër Martesës dhe Familjes); Kapitullin XXIX (Veprat Penale Kundër Sigurisë së Përgjithshme të Njerëzve dhe Pasurisë); Kapitullin XXX (Veprat Penale të Armëve) dhe Kapitullin XXXIII (Veprat Penale Kundër Rendit Publik).

3.8 Arresti shtëpiak

Sipas nenit 183 paragrafi 1 të KPP, gjykata mund të caktojë arrestin shtëpiak për të pandehurin nëse:

- ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe
- plotësohen kushtet nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i KPP.

Masa e arrestit shtëpiak paraqet masën alternative kundrejt masës së paraburgimit dhe mund të caktohet për të gjitha bazat për paraburgim dhe pa ndonjë kufizim formal. Me këtë masë përcaktohet se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku e ka vendbanimin dhe gjithashtu, gjykata mund të kufizoj kontaktin me personat me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri.⁹⁰

a) Mbikëqyrja e zbatimit të masës dhe cenimi eventual i saj

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj mase bëhet përmes policisë të cilës i dorëzohet një kopje e aktvendimit respektivisht stacionit policor në territorin që duhet të zbatohet masa. Është e rëndësishme që i pandehuri gjithmonë të lajmërohet qartësisht se nëse cenon detyrimet për të respektuar këtë masë ndaj tij do të mund të caktohet masa e paraburgimit. Policia me qëllim të verifikimit nëse i pandehuri është duke e respektuar masën në çdo kohë mund të kontrolloj vendbanimin dhe konstaton nëse gjendet në vendin e mbajtjes arrestit shtëpiak, ndërsa nëse i pandehuri ka cenuar masën në çfarëdo mënyre e njofton me shkrim gjykatën.

b) Përshtatshmëria e aplikimit të dispozitave të paraburgimit

Përveç nëse parashihet ndryshe me nenin 183 të KPP, dispozitat ligjore që i referohen paraburgimit përshtatshëmrisht zbatohen lidhur me caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës. Dispozitat e KPRK mbi përfshirjen e ndalimit në dënimin e shqiptuar, gjithashtu, zbatohen përshtatshëmrisht për masën e arrestit shtëpiak.

⁹⁰ Neni 183 paragrafi 3 i KPP.

Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos në të gjitha rastet mbi vazhdimin e arrestit shtëpiak në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kur i pandehuri ka mbrojtës, duhet njoftuar për propozimin brenda tre ditëve para kalimit të kohës së arrestit shtëpiak, sipas aktvendimit të mëparshëm.⁹¹

Pra, vazhdimi i masës së arrestit shtëpiak kushtëzohet me ekzistimin e propozimit të prokurorit të shtetit dhe më pas obligimi që të njoftohen mbrojtësi dhe i pandehuri në afatin kohor prej tre ditëve, para se t'i skadojë kjo masë në bazë të aktvendimit të mëparshëm.

3.9 Diversioni

Diversioni paraqitet si masë alternative kundrejt paraburgimit e cila ka për qëllim që të adresoj rastet kur kemi të bëjmë me veprat penale më pak serioze. Përkatësisht të dënueshme deri në 1 vjet burgim dhe për të pandehurit të cilët nuk kanë precedent të mëparshëm penal, nuk ka qenë i përfshirë më parë në masën e diversionit.⁹² Prandaj konsiderohet se kemi të bëjmë me delikuent primar dhe persona që vlerësohen me rrezikshmëri të ulët dhe nën kushtet e caktuara ndaj tyre mundë të pushohet procedura penale.

I pandehuri ose prokurori i shtetit, gjithashtu mund të propozojnë diversionin. Nëse prokurori i shtetit pajtohet ose i propozon gjykatës masën e diversionit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të pezullojë procedurën penale për 1 (një) vit dhe liron të pandehurin nën kushtet e mëposhtme:

- i pandehuri duhet të bëjë kompensimin e arsyeshëm ndaj viktimës së veprës penale, nëse ka ndonjë, siç përcakton gjyqtari i procedurës paraprake;
- i pandehuri lajmërohet rregullisht në stacionin policor që është më së afërmi prej vendbanimit të tij, në intervalet e caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake;
- i pandehuri merr pjesë dhe përfundon këshillimin, trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike, arsimimin, ose veprimet tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake.⁹³

Kur i pandehuri vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale kundër të pandehurit pushohet nga gjyqtari i procedurës paraprake gjatë muajit të dymbëdhjetë të diversitetit. Nëse i pandehuri shkel kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale rifillohet. Gjyqtari i

⁹¹Neni 183 paragrafi 4 i KPP.

⁹²Neni 184 par. 1 të KPP

⁹³ Id.

procedurës paraprake, nëse është e nevojshme, mund të lëshojë urdhërarrest sipas nenit 175 të KPP.⁹⁴

3.10 Paraburgimi

Paraburgimi mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara me KPP. Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme. Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij.

Me rastin e arrestimit, personi që i nënshtrohet paraburgimit informohet:

- gojarisht dhe me shkrim për të drejtat nga neni 167 i KPP dhe
- me shkrim për të drejtat tjera që i gëzon sipas KPP.⁹⁵

a) Njoftimi i organit kompetent për mirëqenie sociale për arrestin, kur kjo është e nevojshme

Kur është e nevojshme të ndërmerren masa për mbrojtjen e fëmijëve dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së personit të arrestuar të cilët janë nën kujdesin e tij, për arrestim njoftohet organi kompetent për mirëqenie sociale.

b) Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit

Në nenin 187 paragrafi 1 të KPP, është përcaktuar se gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:

- ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;
- përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
- kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
- kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
- kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

⁹⁴Neni 184 paragrafët 2 dhe 3 të KPP.

⁹⁵ Neni 185 i KPP.

Duhet bërë vlerësimin se masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.⁹⁶

Në rastin kur paraburgimi është caktuar për shkak të mos vërtetimit të identitetit të personit, paraburgimi i caktuar hiqet posa të vërtetohet identiteti i tij. Ndërsa, në rastin kur paraburgimi është caktuar për shkak se ka pasur arsye për të besuar se i pandehuri do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit, paraburgimi hiqet posa të merren ose sigurohen provat për të cilat është caktuar paraburgimi.⁹⁷

Paraburgimi është masa më e rëndë e cila mund të caktohet ndaj të pandehurit, për faktin se privohet nga liria ende pa ekzistuar aktgjykimi i formës së prerë për fajësinë e personit dhe për këtë arsye kërkon vëmendje dhe kujdes të veçantë. Paraburgimi ka karakter përjashtues që nënkupton se është një masë “*ultima rei*” apo mjet i fundit dhe vetëm pasi që masat e tjera alternative konsiderohet se janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme nën dritën e rrethanave konkrete të rastit konkret, respektivisht gjykata do të marrë parasysh përshtatshmërinë e masave alternative para marrjes së vendimit të tillë.

Të gjitha institucionet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në procedurën penale detyrohen të veprojnë me urgjencë⁹⁸ dhe kjo është në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të drejtësisë, duke zvogëluar periudhën e paraburgimit jo të domosdoshëm. Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme dhe kjo masë të hiqet posa të pushojnë arsyet për caktimin e tij.

Bazat për paraburgim mund të përmbliidhen në a) rreziku i ikjes, b) ndikimi në hetime apo dëshmitarë apo c) rreziku i kryerjes apo përsëritjes së veprës penale.

- a) Rreziku kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij. Duhet të ekzistojnë rrethana konkrete që tregojnë se i pandehuri fshihet që mund të jenë se është larguar nga vendbanimi, duke mos qëndruar në vendin ku jeton, duke mos frekuentuar vendet ku zakonisht frekuentonte dhe mund të ndërmarrë

⁹⁶ Neni 187 paragrafi.1.1.3 të KPP-së

⁹⁷ Neni 187 paragrafi 2 i KPP-së

⁹⁸ Neni 185 paragrafi 2 i KPP-së

edhe veprime të cilat konsistojnë në maskimin e identitetit të tij, gjithnjë në funksion të fshehjes së tij.

Në situatat kur nuk mund të vërtetohet identiteti mund të caktohet paraburgimi me ç ‘rast organet, marrin të gjitha masat që të vërtetohet identiteti sa më parë që është e mundur dhe posa të vërtetohet urdhërohet lirimi i menjëhershëm⁹⁹ .

Rreziku i ikjes në çdo rast duhet të konstatohet mbi bazën e rrethanave specifike që i referohen personalitetit të kryesit, veprës penale dhe rrethanave të tjera. Në kontekstin e këtyre tre aspekteve do të duhet të arrihet në përfundim nëse kemi të bëjmë me rrezikun real të ikjes. Çdo herë ky rrezik nuk mjafton të jetë vetëm abstrakt, ngase si tillë do ishte më tepër i supozuar dhe ky kualitet i një rrezikshmërie nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar se kemi të bëjmë me rrezik të ikjes, por gjithmonë kërkon që rreziku të jetë i një cilësie që tregon se kemi të bëjmë me rrezikun e vërtetë të ikjes. Rrethanat të cilat i referohen kryesit mund të jenë se kemi të bëjmë me person që udhëton mjaft shpesh në shtete të jashtme, për shkak të lidhjeve qoftë familjare, afariste apo lidhje që ndërlidhen me aktivitete kriminale. Ekzistimi i rrethanave të tilla mund të jetë i justifikueshëm për caktimin e masës së paraburgimit në funksion të parandalimit të ikjes.

I pandehuri ka provuar që të largohet nga vendi, menjëherë pas kryerjes apo është përgatitur të largohet, rrethanat e tilla objektivisht mund të tregojnë vullnetin dhe gatishmërinë e të pandehurit për t’u larguar nga vendi dhe rrjedhimisht edhe në këtë mënyrë ti shpëtojë përgjegjësisë para organeve të drejtësisë. Lidhshmëria me vendin respektivisht me Republikën e Kosovës, gjegjësisht lidhjet familjare, pronësore dhe biznesore mund të jenë tregues se i njëjti më parë do të qëndronte në vend se sa do të arratisët.

- b) Kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit. Ekzistimi i arsyeve të lart cituara paraqet bazë për paraburgim, megjithatë në çdo rast duhet konstatuar ekzistimi i mundësisë objektive për t’i asgjësuar, fshehë, ndryshoj falsifikojë provat e veprës penale. Në kontekstin e provave tani shumë ekspertime kryhen nga institucionet e specializuara për ekspertime të tilla, si p.sh. Agjencia e Forenzikës dhe ndikimi për të ndryshuar epilogun e ekspertizave në parim do të ishte i më tepër i supozuar. Besueshmëria se i pandehuri do të ndërmarrë një veprim të tillë duhet të jetë e lartë, kredibil dhe objektivisht e mundur.

⁹⁹ Neni 187 paragrafi 2 i KPP-së

Gjithashtu, për të ekzistuar rreziku i ndikimit në dëshmitarë duhet të ekzistojnë rrethana të posaçme, të cilat tregojnë se i pandehuri do të ndikojë në dëshmitarë, të dëmtuar apo bashkëkryes. Nuk mjafton fakti se ka dëshmitarë të cilët ende nuk janë dëgjuar dhe apriori të konkludohet se i pandehuri do të ndikojë, ngase kjo do të ishte një supozim i hamendësuar dhe nuk mund të ketë të bëjë asgjë me realitetin dhe thjeshtë një stereotip. Por rreziku duhet të jetë i vërtetë, për arsye të ekzistimit të rrethanave jo të zakonshme si mund të jetë i pandehuri ka raporte eprori me dëshmitarin apo bashkëkryesin. Rrjedhimisht ky relacion lehtësisht mund të jetë tregues se të njëjtit objektivisht mund të jenë objekt ndikimesh. I pandehuri ka provuar të ndikojë në dëshmitarë, duke i dërguar njerëz, apo duke komunikuar personalisht direkt apo përmes mjeteve të komunikimit, duke kërkuar që ta ndryshoj deklaratën dhe të jap dëshmi favorizuese për të.

- c) *Rreziku i përsëritjes së veprës penale* - Është rrezik i përsëritjes së veprës penale, e cila ekziston kur rrethanat e veçanta justifikojnë rrezikun se i pandehuri do të përsërisë veprën penale, të përfundoj veprën penale të filluar ose të kryej veprën penale për të cilën është kanosur.¹⁰⁰

Marrja e lirisë së lëvizjes si një nga të drejtat më themelore duhet të vlerësohet gjithmonë nga aspekti i proporcionalitetit, dhe marrja e kësaj të drejtë për veprat e lehta penale nuk do të ishte proporcionale me qëllimin që dëshirohet të arrihet.

Gjithashtu, duhet të jetë kufizuese se bëhet fjalë për rrezikun e përsëritjes së veprës penale të njëjtë apo të ngjashme, me atë për të cilën ngarkohet. Kjo nënkupton se gjykata është e obliguar të konstatoj ekzistimin e rrethanave të cilat e justifikojnë frikën nga recidivizmi i veprave penale të njëjta apo të ngjashme. Mundësia e përsëritjes së veprës penale, si njëra nga arsye për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, duhet të jetë konkrete dhe që në mënyrë të arsyeshme parashikohet dhe pritët, rrethanat të cilat gjykata duhet ti vërtetoj sa i përket ekzistimit të rrezikut të përsëritjes varet nga lloji i veprës penale, disa nga rrethanat të cilat i hasim në praktikën gjyqësore është se i takon rrethit të organizatës apo grupit kriminal, dënueshmërinë e mëparshme, labilitetit, i dhënë pas lojërave hazarde, keqpërdorimi i substancave narkotike.

Parimi se duhet të jetë njëllojshmëria ose ngjashmëria e veprës penale nuk është e shënuar në ligj, por është etabluar nga praktika gjyqësore dhe e pranuar edhe në teori. Arsyeja për këtë është se vërtetimi i rrezikut të përsëritjes së veprës penale është

¹⁰⁰ Neni 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2.3. të KPP kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

parashikim (prognozë) për sjelljen në të ardhmen. Gjykata mund të konstatoj vetëm se ekziston besueshmëria, por jo edhe se me siguri se i pandehuri do të kryej përsëri veprë penale. Gjykata në mënyrë primare do të vlerësoj rrezikun e të pandehurit në bazë veprës penale për të cilën zhvillohet procedura penale. Vlerësimi i rrezikut për kryerjen e veprave penale të tjera, do të ishte abstraktë, faktikisht e pabazuar dhe vetëm një masë parandaluese e cila nuk është e arsyeshme mbi bazën e të provuarit të rrezikshmërisë së kryesit dhe privimit nga liria mbi këtë bazë nuk do të ishte e ligjshme.

Nga dispozita e lartcekur nënkuptohet se merren parasysh një mori faktorësh duke filluar nga pesha apo serioziteti i veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale, etj. Dilema kyçe është nëse çdo njëra nga këto rrethana duhet të jenë të ndërlidhura me rrezikun e përsëritjes veprën penale. Në praktikë mjaft shpesh ndeshim interpretime të ndryshme, duke i marrë për bazë vetëm njërin nga këta faktorë e veçanërisht peshën apo seriozitetin e veprës penale, si faktor të vetëm dhe autonom për të caktuar masën e paraburgimit. Konsiderojmë se pesha e veprës vetvetiu nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të përcaktuar masën e paraburgimit. Ngase kjo do të ishte një koncept relativ dhe njëkohësisht paraburgimi mund të shndërrohet në një masë të obligueshme, aq më tepër kur nuk ekziston në legjislacionin tonë paraburgimi i obligueshëm (përjashtuar situatën e paraburgimit pas shqiptimit të dënimit me burgim me 5 ose më tepër vite)¹⁰¹

Lartësia abstrakte e ndëshkueshmërisë nuk mund të jetë përcaktues i vetëm për caktimin e kësaj mase. Pritshmëria e ashpërsisë se dënimit që pritet të shqiptohet është e pamjaftueshme që të konstatohet ekzistimi i rrezikut të ikjes.¹⁰² Në këtë kontekst, paraburgimi nuk mund të jetë obligativ dhe as i karakterit punitiv (ndëshkues). Rrjedhimisht, ekzistimi i dyshimit të bazuar se një person ka kryer veprë penale të caktuar, pa marrë parasysh se sa e rëndë që është, nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për caktimin e paraburgimit. Gjyqtari gjithmonë ka diskrecion të vendos nëse është e nevojshme t'i caktohet të pandehurit paraburgimi gjatë zhvillimit të procedurës penale.

c) Me rastin e vlerësimit nëse do të urdhërohet paraburgimi gjykata duhet të ketë parasysh:

- Rrethanat specifike të rastit konkret dhe në veçanti faktorët në vijim:
- Natyrën dhe seriozitetin e veprës penale të pretenduar;
- Fuqinë e provave përkitazi me veprën penale që është kryer;
- Dënimi që mund të shqiptohet në rast se i pandehuri shpallet fajtor;
- Karakteri, të dhënat e mëparshme personale dhe sociale lidhur me të pandehurin;

¹⁰¹ Neni 367 paragrafi 2 të KPP.

¹⁰² Rasti Matznetter kundër Austrisë (Kërkesa n. 2178/64) Aktgjykim, Strasburg 10 Nëntor, 1969.

- Sjellja e të pandehurit lidhur me faktin se si i ka përmbushur obligimet të cilat i janë përcaktuar atij lidhur procedurat e mëparshme penale.¹⁰³

Rrjedhimisht, çështja e paraburgimit si njëra ndër çështjet më të ndjeshme në procedurën penale ka qenë objekt i përpjekjeve për të caktuar standarde dhe kritere të qarta që duhet t'i përmbahen shtetet e caktuara, veçanërisht duhet potencuar aktivitetet e hershme të Këshillit të Evropës, respektivisht Komitetit të Ministrave e cila më 9 prill të vitit 1965, aprovoi rezolutën (65) 11, ku janë përcaktuar parime të qarta që kanë obliguar shtetet që t'i adoptojnë në legjislacionet e tyre të brendshme dhe të raportojnë për masat dhe progresin e arritur në implementimin e tyre. Parimet të përcaktuara në këtë rezolutë janë:

- a) Mbajtja në paraburgim asnjëherë nuk duhet të jetë e natyrës ndëshkuese, autoritetet gjyqësore vendimet e tyre duhet ti marrin nën dritën e fakteve dhe rrethanave të rastit konkret.
- b) Mbajtja në paraburgim duhet përcaktuar si një masë përjashtuese;
- c) Paraburgimi do të caktohet dhe vazhdohet vetëm kur është e domosdoshme dhe në asnjë mënyrë të aplikohet për qëllime ndëshkueshmërie;
- d) Çdo vendim paraburgimi duhet të jetë i përcaktuar qartë sa është e mundur duke analizuar objektin e akuzës dhe arsyet për paraburgim, dhe duhet që në mënyrë të menjëhershme t'i komunikohet personit të arrestuar.
- e) Duhet të sigurohen garanci efektive për të parandaluar vazhdimin e paraburgimit përtej asaj çka është e domosdoshme.

Të përcaktohen masa në veçanti që do të merren parasysh :

- Kufizimi i periudhës së paraburgimit me ligj;
- Shqyrtimi “ex officio” i paraburgimit në intervale të rregullta kohore;
- E drejta e apelit në autoritet gjyqësore;
- E drejta e në avokat mbrojtës;
- personi i paraburgosur duhet të informohet mbi të drejtat dhe kushtet në të cilat mund ti ushtroj;
- në disa raste masat e tjera mund të jenë në përparësi të aplikohen në raport me masën e paraburgimit, siç janë;
- përcjellja në shtëpi;
- detyrimi për të mos u ofruar vendit të caktuar;
- detyrimi për t'u paraqitur periodikisht para autoriteteve të caktuara;
- konfiskimi i pasaportës ose dokumenteve të tjera identifikuese;
- ofrimi i sigurisë;

¹⁰³ Rekomandimi Nr. R(80) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me paraburgimin në pritje të shqyrtimit gjyqësor, adoptuar nga Komiteti i Ministrave 27 korrik 1980 në takimin e 321 të zëvendësministrave .

- dërgimi i të miturve në institucionet speciale.¹⁰⁴

d) Procedura për urdhrin për paraburgim

Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore. Pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai menjëherë e informon personin e tillë për të drejtat e tij nga neni 167 i KPP. Në procesverbal shënohet koha e saktë e arrestimit dhe koha kur është sjellë personi te gjyqtari i procedurës paraprake. Pastaj, gjyqtari i procedurës paraprake zbaton seancën dëgjimore mbi paraburgimin, ku prokurori i shtetit dhe mbrojtësi janë të pranishëm gjatë seancës dëgjimore.

Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga koha e njoftimit për këtë të drejtë ose deklaron se nuk do të angazhojë mbrojtës, gjykata ia cakton mbrojtësin sipas detyrës zyrtare. Në seancën dëgjimore për paraburgim, prokurori i shtetit paraqet arsyet për kërkim të paraburgimit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të përgjigjen duke prezantuar argumentet e tyre.

Gjyqtari i procedurës paraprake vendos mbi propozimin e palëve pasi palët të jenë deklaruar për të gjitha çështjet të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e masave nga ky kapitull.¹⁰⁵

e) Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij

Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin:

- emrin dhe mbiemrin e personit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake;
- kohën e saktë të arrestimit;
- kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës paraprake;
- kohën e marrjes në pyetje për paraburgim;
- veprën penale për të cilën akuzohet;
- bazën ligjore për paraburgim;
- njoftimin për të drejtën në ankesë;
- arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i KPP.¹⁰⁶

¹⁰⁴Rezoluta nr. 65/11 e Komitetit të Ministrave (adoptuar nga zëvendës ministrat e Këshillit të Evropës, më 9 prill 1965)

¹⁰⁵Neni 188 i KPP.

¹⁰⁶Neni 189 paragrafi 1 i KPP.

f) Dorëzimi i aktvendimit

Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit, mbrojtësit dhe prokurorit. Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda 24 orëve, nga koha e pranimi dhe ankesa nuk ka karakter suspenziv. Nëse ankohet vetëm njëra palë, ankesa i dorëzohet palës tjetër e cila mund ti paraqesë argumentet e saj gjykatës brenda 24 orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda 48 orëve nga paraqitja e saj. Është me rëndësi të theksohet se procedura e paraburgimit është e natyrës urgjente, dhe ky afat duhet të llogaritet nga koha e paraqitjes pavarësisht se mundë të jenë ditë jo pune apo të festave.

i) Ankesa nuk ka karakter suspenziv

Parashtrimi i ankesës nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimin mbi paraburgimin, përkatësisht nuk ka karakter suspenziv.

j) Diskrecioni i gjyqtarit

Gjyqtari i procedurës paraprake mund të refuzoj kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit dhe të urdhërojë cilëndo masë tjetër për të cilën plotësohen kushtet ligjore dhe të cilën e vlerëson si të mjaftueshme dhe të përshtatshme nën dritën e rrethanave të rastit konkret duke pasur në konsideratë parimin e proporcionalitetit.

I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhrit nga neni 188 të KPP. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit.¹⁰⁷

k) Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se:

- katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim;
- tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.

Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar, siç përkufizohet në nenin 19 të KPP, e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, përveç afateve të lartcekura, para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti

¹⁰⁷Neni 190 paragrafi 1 i KPP.

deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj.

Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit mund të bëhet edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.

Nëse aktakuza nuk ngritët para kalimit të afateve të lartcekura, i paraburgosuri lirohet.¹⁰⁸

l) Afatet kohore të paraburgimit

Afatet përcaktojnë qartësisht periudhat kohore brenda të cilave mund të mbahet një person i privuar nga liria. Fillimisht mund të mbahet më së shumti deri në 1 (një) muaj nga dita e arrestimit.¹⁰⁹ Kjo përcakton afatin maksimal fillestar i cili nuk mund të jetë më i gjatë se periudha një mujore, ndërsa mund të jetë edhe më i shkurtër. Pas kësaj mund të vazhdohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues. Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë katër (4) muaj kur procedura zbatohet për veprë penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim; tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për veprë penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.¹¹⁰

m) Vazhdimi i paraburgimit

Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 187 i KPP, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë formalisht apo jo formalisht nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit.

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen me propozimin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.¹¹¹ Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë. Neni 189 paragrafët 3 dhe 4 të KPP, zbatohen përshtatshëm.¹¹²

¹⁰⁸ Neni 190 paragrafët 2 – 5 të KPP.

¹⁰⁹ Neni 190 paragrafi 1 i KPP

¹¹⁰ Neni 190. Par. 2 të KPP-së

¹¹¹ Neni 191 paragrafi 2 të KPP-së

¹¹² Neni 191 paragrafi 3 i KPP -së.

n) Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata

Në nenin 192 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se në çdo kohë, derisa hetimi është duke u zbatuar, gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndërpres paraburgimin sipas detyrës zyrtare, pasi të ketë paralajmëruar prokurorin e shtetit tri ditë më parë. Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë te kolegji shqyrtues kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për të ndërprerë paraburgimin. Kolegji shqyrtues nxjerr aktvendim brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimit e ankesës së prokurorit të shtetit.

I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose Kryetarit të Gjykatës Themelore që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose mbi ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit.¹¹³

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose Kryetari i Gjykatës Themelore mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 188, paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të KPP nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se:

- arsyet për paraburgim nga neni 187 i KPP që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja ose
- ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.¹¹⁴

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose Kryetari i Gjykatës Themelore në seancë dëgjimore urdhëron lirimin e menjëhershëm të paraburgosurit kur:

- pushojnë së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 i KPP;
- ka kaluar afati i paraburgimit i urdhëruar nga gjykata;
- afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 të KPP; ose
- ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.¹¹⁵

Sipas paragrafit 5 të nenit 192 të KPP, nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose Kryetari i Gjykatës Themelore mund të zbatojë një seancë dëgjimore ose vizitë në institucionin ku mbahet paraburgimi nëse ankesa në shikim të

¹¹³ Neni 192 paragrafi 2 i KPP-së

¹¹⁴ Neni 192 paragrafi 3 i KPP.

¹¹⁵ Neni 192 paragrafi 4 të KPP.

parë vërtetohet se kushtet e paraburgimit nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara me KPP ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me KEDNJ, siç interpretohet nga vendimet e GjEDNJ –së.

Seancat dëgjimore ose vizitat mbahen brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i ankesës.¹¹⁶ Ankesa e cila është substancialisht e ngjashme me ankesën e mëparshme menjëherë hedhet sipas detyrës zyrtare.¹¹⁷

Rrjedhimisht gjyqtari i procedurës paraprake, që në çdo kohë deri sa zbatohen hetimet mund ta ndërpret paraburgimin, duke respektuar obligimin që ta njoftoj prokurorin e shtetit tre (3) ditë më parë.¹¹⁸ Është interesant se autoriteti i cili do të vendos në ankesën e prokurorit të shtetit, në këtë situatë procedurale është kolegji shqyrtues, i cili është kuadër të Gjykatës Themelore, që ka për obligim që në afat prej 48 orëve të vendosë.

Në çdo kohë i pandehuri dhe mbrojtësi kanë të drejtë që të ankohen për ligjshmërinë e paraburgimit, zgjidhja në këtë dispozitë inkorporon mekanizimin e njohur si “*habeas corpus*”. E drejta për të pasur mundësinë e kundërshtimit të çfarëdo paraburgimi para trupit gjykues me autoritet për të urdhëruar lirin, është e drejtë thelbësore dhe parim i pa deroguar i së drejtës ndërkombëtarë, e zbatueshme madje edhe në kohë të emergjencës. Praktika gjyqësore e GjEDNJ sugjeron se drejta për të sfiduar paraburgimin është e drejtë ndaj së cilës nuk lejohet kurrfarë përjashtimi.¹¹⁹

Autoritetet për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit përveç gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm dhe kryetarit të trupit gjykues është edhe Kryetari i Gjykatës Themelore, që është plotësisht një risi në raport me kodin e mëparshëm .¹²⁰

Derisa duke i përmendur autoritet e tjera, ligjvënësi ka pasur për qëllim që të adresoj të gjitha momentet procedurale dhe kompetencën funksionale të cilat vijnë në shprehje varësisht nga faza e procedurës penale dhe kompetencës lëndore, ka paraparë edhe kryetarin e gjykatës.

Mirëpo shtrohet pyetja si do të përcaktohet “se kur do ta shqyrtoj ligjshmërinë e paraburgimit kryetari i gjykatës, dhe jo gjyqtari i çështjes, siç mund të jenë gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtar i vetëm, kryetari i trupit gjykues ?

¹¹⁶ Neni 192 par. 7 i KPP

¹¹⁷ Neni 192 par.8 i KPP

¹¹⁸ Neni 192 paragrafi 1 i KPP

¹¹⁹ Aksov Kundër Turqisë, 18. 12. 1996, Branigan dhe McBride Kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26. 05.1993, Lawless Kundër Irlandës, 01. 07. 1961 .

¹²⁰ Neni 192 paragrafi 2 i KPP-së

Një nga interpretimet logjike dhe praktike mund të jetë, se kjo do të përcaktohej duke i lejuar diskrecion të pandehurit respektivisht mbrojtësit, që ti drejtohet kryetarit të gjykatës, për një vlerësim të tillë. Mirëpo, mund të jetë një argument se kjo do të duhej të kishte karakter subsidiar, që nënkupton që fillimisht të ju drejtohej autoriteteve tjera të përmendura më lartë dhe pas këtyre përpjekjeve të pasuksesshme t'i drejtohet kryetarit të gjykatës.

o) A do të duhet të mbahej seanca dëgjimore për të vlerësuar kërkesën për ligjshmërinë e paraburgimit?

Seanca dëgjimore për të vlerësuar ligjshmërinë paraburgimit mund të mbahet vetëm nëse gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm, kryetar i trupit gjykues apo Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit paraprak *prima facie* vërtetohet se arsyet për paraburgim nga neni 187 të KPP-së, kanë pushuar nga vendimi i fundit gjyqësor për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja dhe ndalimi për ndonjë arsye tjetër do të ishte i paligjshëm.

Ndërsa, kërkesa për ligjshmërinë e paraburgimit nëse pas vlerësimit fillestar *prima facie* nuk vërteton ekzistimin e rrethanave nga neni 192 paragrafi 3.1 dhe 3.2 të KPP do të refuzohet pa mbajtjen e seancës dëgjimore.

Për më tepër kur është paraqitur kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit sipas nenit 192 paragrafit 3 të KPP, nuk është e nevojshme të merret vendimi formal, përpos nëse vendoset të mbahet seancë dëgjimore sipas kushteve të përcaktuara me këtë dispozitë. I pandehuri dhe mbrojtësi, në situata të tilla, vetëm do të njoftohen me shkrim se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për abrogimin e paraburgimit.¹²¹

Dispozitat e nenit 192 paragrafët 5-8 të KPP, rregullon çështjen e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së paraburgimit kushteve të paraburgimit.

Me këtë dispozitë është paraparë mundësia e paraqitjes së kërkesës për shqyrtimin e ligjshmërisë që i referohet jo arsyeve dhe bazës ligjore të paraburgimit, por kushteve të paraburgimit, pra është një lloj mjeti juridik që kanë dispozicion i pandehuri dhe mbrojtësi, për të kërkuar vlerësimin e kushteve në të cilat mbahet i pandehuri.

Kushtet e paraburgimit kërkohen që të jenë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të KPP ose ekzistojnë kushtet të cilat nuk janë në pajtueshmëri me KEDNJ, siç interpretohen nga GjEDNJ, vlen të ceket se kushtet e mbajtjes në paraburgim të paraburgosurve kanë qenë

¹²¹ Mendimi Juridik nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës GJA. Nr.565/13 të datës 19. 09.2013, përkitazi me vendosjen e kërkesave për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit.

mjaft shpesh objekt vlerësimi nga kjo gjykatë në shumë raste, shih më tepër: *Iëanczuk kundër Polonisë*, (kërkesa nr. 25196/94 15 nëntor 2001), *Douguz kundër Greqisë* (kërkesa nr. 40907/98, 6 mars 2001, *Khodorkovskiy kundër Rusisë*, (kërkesa nr. 5829/04) aktgjykimi - i datës 31. 05.2011 etj.

p) Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të KPP zbatohen përshtatshmërisht.¹²² Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4 të KPP.¹²³

Duke pasur parasysh zgjidhjet e tanishme ligjore për paraburgim pas ngritjes së aktakuzës ndryshojnë në raport me zgjidhjet në ish KPP, pasi me ish Kodin kjo çështje adresohet që pas ngritjes së aktakuzës brenda katërdhjetë e tetë (48) orëve vendoste kolegji prej tre gjyqtarëve ndërsa me Kodin e tanishëm për paraburgim vendos gjyqtari i çështjes respektivisht kryetari trupit gjykues apo trupi gjykues në seancë.

Kompetencë në aspektin funksional janë përcaktuar tre autoritete: gjyqtari i vetëm pra në të gjitha çështjet për të cilat është kompetentë departamenti i përgjithshëm. Kryetari trupit gjykues, këtu duhet nënkuptuar çështjet që kanë të bëjnë me krimet e rënda dhe trupi gjykues (krimet e rënda) vendos në situatat kur është në seancë.

Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit.

Dispozita e tillë e detyron gjyqtarin që detyrimisht ta dëgjoj mendimin e prokurorit të pandehurit ose mbrojtësit. Shtrohet pyetja a duhet të mbahet seanca dëgjimore apo mjafton që mendimet palët t'i shprehin edhe vetëm në formë të shkruar?

¹²² Neni 193 paragrafi 1 i KPP

¹²³ Neni 193 paragrafi 2 i KPP.

KPP përdor shprehje dëgjon konsideroj se seanca dëgjimore duhet të mbahet në mënyrë që i pandehuri me mbrojtësin e tij të kenë mundësinë që t'i shprehin argumentet e tyre në seancën dëgjimore për të kundërshtuar.

Dispozita e nenit 193 paragrafi 1 i KPP-së nuk përcakton ndonjë afat kohor për shqyrtimin e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, në rastet kur i pandehuri tani më ndodhet në paraburgim? Kjo është një çështje dilematike.

A do të duhet detyrimisht të shqyrtohet paraburgimi brenda një afati kohor pas ngritjes së aktakuzës?

Vlerësimi nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim në kuptimin gramatikor përdoret *shprehja pasi të kalon 2 (dy) muaj nga aktvendimi i fundit*. Rrjedhimisht një vlerësim i tillë duhet të bëhet pas kalimit të periudhës prej 2 (dy) muaj nga aktvendimi i fundit i paraburgimit. Gjithashtu mund të konkludohet se vazhdimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës në aspektin kohor është i lidhur vetëm me limitin respektivisht kohëzgjatjen e dënimit që parashihet për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, në rastin e vazhimit të paraburgimit formulimi i dispozitivit konsideroj se duhet të jetë se i vazhdohet paraburgimi nuk ceket afati kohor, por i cili do të rishikohet pas kalimit të periudhës prej 2 (dy) muaj nga dita e këtij aktvendimi.

Në praktikë zakonisht paraburgimi pas ngritjes së aktakuzës ju vazhdohet çdo 2 (dy) muaj, duke e përcaktuar saktësisht kohën, konsiderojmë se ky nuk është një interpretim që rrjedh nga kjo dispozitë. Edhe pse një praktikë e tillë nuk është e dëmshme, pasi që detyrimisht gjykatat e shqyrtojnë paraburgimin para kalimit të periudhës prej 2 muaj.

Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni sjellin deri diku konfuzitet sa i përket vazhimit të paraburgimit, pasi që si njëra dhe tjetra përmbajnë formulime që i referohen vazhimit të kësaj mase. Edhe pse dispozita e nenit 2 është më e qartë, ngase e rregullon vetëm çështjen e vazhimit, ndërsa dispozita e nenit 1, bënë fjalë edhe për vazhdimin e kësaj mase, dhe shtrohet pyetja se cila do të duhet të aplikohet kur të ju vazhdohet paraburgimi pas ngritjes së aktakuzës?

Dispozitat e këtij neni duhet interpretuar në atë mënyrë që në lidhshmërinë dhe tërësinë tyre duhet konsideruar si një unitet, në të cilët pjesët përbërëse të nenit janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra tjetrës dhe si të tilla të formojnë një përmbajtje koherente brenda tyre. Andaj nga sistemimi i këtyre mund të përfundojmë, se me rastin e vendosjes për herën e parë pas ngritjes së aktakuzës duhet të aplikohet dispozita e paragrafit 1.

Ndërsa në vazhdimet e më tutjeshme të paraburgimit (masës) do të duhet të aplikohen dispozita e paragrafit 2, një argument afortiori¹²⁴ për këtë e bënë fakti se pas ngritjes së aktakuzës siç e kemi elaboruar edhe më lartë paraburgimi nuk vazhdohet me limitet e caktuara kohore (përveç që nuk mund të jetë më i gjatë se lartësia e dënimit që parashihet për veprën që akuzohet) por rishikohet në periudhën kohore pas kalimit të 2 (dy) muajve, andaj në këtë kontekst dispozitën e paragrafit 2, duhet kuptuar si vazhdimësi e dinamikës dhe pasojës logjike që e sjell dispozita e paragrafit të parë në rastet kur është vazhduar kjo masë.

¹²⁴ A fortiori nga latinishtja - aq me tepër, aq më fuqishëm,

KAPITULLI IV
SHQYRTIMET DHE PROCEDURAT
PAS NGRITJES SË AKTAKUZËS

KAPITULLI IV

4. SHQYRTIMET DHE PROCEDURAT PAS NGRITJES SË AKTAKUZËS	95
4.1 Shqyrtimet dhe procedurat pas ngritjes së aktakuzës	95
4.1.1 Shqyrtimi fillestar	95
a) Shqyrtime të përgjithshme	95
b) Dorëzimi i aktakuzës në kopje të mjaftueshme	95
c) Caktimi i gjyqtarit për ta gjykuar çështjen.....	95
d) Kontrollimi i kompetencës dhe i aktakuzës.....	95
e) Shqyrtimi fillestar	96
f) Rastet kur nuk duhet të mbahet shqyrtimi fillestar	96
g) Aplikimi përshatshmërisht i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor.....	97
h) Kompetenca funksionale	98
i) Njoftimi për shqyrtimin fillestar.....	98
j) Vendi i mbajtjes dhe publiciteti i shqyrtimit fillestar	99
k) Prishja e rendit dhe mosbindja ndaj urdhrave të gjykatës	99
l) Procesverbali i shqyrtimit fillestar.....	99
m) Hapja e shqyrtimit fillestar	99
n) Dorëzimi i aktakuzës të pandehurit	100
o) Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit.....	100
p) Çështja e mbrojtjes dhe provave.....	100
q) Vërtetimi i identitetit të pandehurit dhe udhëzimet për të drejtat e tij.....	101
r) Leximi i aktakuzës dhe deklarimi i të pandehurit lidhur me aktakuzën.....	101
s) Caktimi i shqyrtimit të dytë nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë.....	102
t) Udhëzimet për të pandehurin dhe mbrojtësin	102
4.1.1.2 Marrëveshja për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqiptimi i dënimit	102
a) Marrëveshja për pranimin e fajësisë	103
b) Pranimi i fajësisë	103
c) Refuzimi i pranimit të fajësisë	103
d) Aktvendimi për pranimin e fajësisë dhe procedura e mëtejme	104
e) Marrja e aktgjykimit dhe shqiptimi i dënimit	105
f) Përbajtja e aktgjykimit	105
g) Shpallja e aktgjykimit.....	105
h) Vendosja lidhur me paraburgimin	105
i) Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit.....	105
4.2 Kundërshtimi i provave.....	106
4.2.1 Arsyet për kundërshtimin e provave	106
4.2.2 Paraqitja e kundërshtimit nga ana e mbrojtësit	106
4.2.3 Përgjigjet në kundërshtimin e paraqitur	106

4.2.4 Aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues lidhur me kundërshtimin	106
4.3 Kërkesa për hudhjen e aktakuzës	107
4.3.1 Arsyet për paraqitjen e kërkesës për hudhjen e aktakuzës.....	108
4.3.2 Paraqitja e kërkesës për hudhjen e aktakuzës nga ana e mbrojtësit.....	108
4.3.3 Përgjigjet ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës.....	108
4.3.4 Aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues lidhur me kërkesën për hudhjen e aktakuzës.....	108
4.3.5 Paraqitja e aktakuzës së ndryshuar	109
4.4 Hudhja e aktakuzës	109
4.4.1 Refuzimi i kërkesës për hudhjen e aktakuzës	110
4.4.2 Hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës penale	110
a) Nëse vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale	110
b) Nëse ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale	111
c) Nëse kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.....	112
d) Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.....	112
4.5 Shqyrtimi i dytë.....	112
4.5.1 Zbulimi i provave nga ana e mbrojtjes	113
4.5.2 Shqyrtimi i kundërshtimeve ndaj provave ose i kërkesave për hudhjen e aktakuzës	113
4.5.3 Caktimi i seancave dëgjimore	113
4.5.4 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor dhe marrja e aktvendimit lidhur me kundërshtimet ndaj provave ose kërkesave për hudhjen e aktakuzës	114
4.5.5 Gjatë shqyrtimit të dytë nuk duhet të administrohen prova.....	114
4.6 Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve.....	114

4. SHQYRTIMET DHE PROCEDURAT PAS NGRITJES SË AKTAKUZËS

4.1. Shqyrtimi fillestar

a) Shqyrtime të përgjithshme

Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat disponon për veprën penale dhe kryesin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit. Duke e interpretuar nenin 101 paragrafi 2 të KPP e cila është e ndërlidhur me këtë dispozitë ligjore, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka sqaruar se “për të gjitha veprat penale për të cilat ligji ka parashikuar dënim me burgim më tepër se tre vjet, nuk mund të ngritet aktakuzë e drejtpërdrejtë pa u zhvilluar hetimet”.¹²⁵

b) Dorëzimi i aktakuzës në kopje të mjaftueshme

Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.¹²⁶

c) Caktimi i gjyqtarit për ta gjykuar çështjen

Pasi prokurori i shtetit ta paraqesë aktakuzën, gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tij.¹²⁷ Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues apo si anëtar i trupit gjykues.¹²⁸

d) Kontrollimi i kompetencës dhe i aktakuzës

Pasi të jetë caktuar gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, ai duhet që paraprakisht të kujdeset për këto dy çështje :

¹²⁵ Letër qarkorja e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJ.A.-Su.A.321/13, e datës 26.04.2013.

¹²⁶ Neni 242 paragrafi 1 i KPP.

¹²⁷ Në vendimin për ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.40, i datës 22.02.2013, është parashikuar se caktimi i lëndëve të gjyqtarëve bëhet përmes tërheqjes së shortit. Të gjitha lëndët e pranuar brenda një muaji kalendarik nga personeli i administratës së gjykatës caktohen në grumbuj në bazë të numrit të gjyqtarëve të gjykatës dhe në bazë të llojit të tyre. Grumbujt do të tubohen duke i ndarë të gjitha lëndët e reja me rotacion në aq grumbuj sa ka edhe gjyqtarë në departamentin përkatës të gjykatës. Në secilin grumbull vendoset shënimi zyrtar, i cili përshkruan numrin dhe llojin e lëndëve të cilat merren nga gjyqtari të cilit i bie shorti dhe i cili është ose gjyqtar i vetëm gjykues, ose gjyqtar në pozitën e kryetarit të trupit gjykues, ose kryesues i kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë apo të tretë. Shorti tërhiqet nga gjyqtari apo në raste të jashtëzakonshme të pengimit të gjyqtarit nga zëvendësi përkatës, i cili duhet të jetë i autorizuar në mënyrë konkrete me shkrim nga ana e gjyqtarit.

¹²⁸ Neni 242 paragrafi 2 i KPP.

- a) Së pari, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë për çështjen që përmban aktakuza.¹²⁹ Nëse, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, konstaton gjykatës themelore pranë së cilës ai vepron i mungon kompetenca territoriale, atëherë ai e shpallë gjykatën jokompetente dhe pasi që aktvendimi të bëhet i formës së prerë, ia dorëzon rastin gjykatës e cila ka kompetencë territoriale.¹³⁰
- b) Së dyti, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet që ta kontrollojë aktakuzën se a është e kuptueshme dhe a përmban çdo gjë të nevojshme që të mund të veprohet sipas saj.¹³¹ Nëse me KPP nuk është parashikuar ndryshe, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret prokurorin e shtetit i cili e ka paraqitur aktakuzën e pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojnë aktakuzën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose nga kryetari i trupit gjykues e hudh poshtë aktakuzën. Në thirrjen për korrigjimin apo plotësimin e aktakuzës, prokurorit të shtetit i tërhiqet vërejtja për pasojat e mosveprimit.¹³²

e) Caktimi i shqyrtimit fillestar

Pas këtij kontrollimi paraprak të aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që menjëherë ta caktojë shqyrtimin fillestar. Periudha kohore brenda së cilës duhet të mbahet shqyrtimi fillestar dallon, varësisht nëse i pandehuri është në paraburgim apo jo dhe lidhur me këtë në KPP janë parashikuar dy situata.

- Nëse i pandehuri është në paraburgim, shqyrtimi fillestar duhet të mbahet në mundësinë e parë, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë, pas datës së ngritjes së aktakuzës.¹³³
- Nëse i pandehuri nuk është në paraburgim, atëherë shqyrtimi fillestar duhet të mbahet brenda tridhjetë ditëve pas ngritjes së aktakuzës.¹³⁴

f) Rastet kur nuk duhet të mbahet shqyrtimi fillestar

Duke e marrë për bazë faktin se gjykatat themelore në Republikën e Kosovës janë të ngarkuara edhe me lëndë të vjetra, të cilat presin për tu zgjidhur, si dhe duke e marrë për

¹²⁹ Neni 242 paragrafi 3 i KPP.

¹³⁰ Neni 37 paragrafi 1 i KPP.

¹³¹ Neni 242 paragrafi 3 i KPP. Përmbajtja e aktakuzës është parashikuar me nenin 241 të KPP.

¹³² Neni 442 paragrafi 4 dhe 5 i KPP.

¹³³ Neni 242 paragrafi 5 i KPP.

¹³⁴ Neni 242 paragrafi 4 i KPP.

bazë natyrën specifike të disa çështjeve penale, atëherë është me rëndësi të theksohet se shqyrtimi fillestar nuk duhet të mbahet në këto raste:

- Nëse procedura penale është iniciuar sipas propozim akuzës së paraqitur para hyrjes në fuqi të KPP;
- Nëse është konfirmuar aktakuza para hyrjes në fuqi të KPP;¹³⁵
- Në çështjet penale në të cilat procedura penale është iniciuar sipas propozim akuzës ose aktakuzës së paditësit subsidiar para datës së hyrjes në fuqi të KPP;¹³⁶
- Në çështjet penale në të cilat së bashku me aktakuzë është paraqitur edhe kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor;¹³⁷
- Në procedurën penale ndaj të miturve¹³⁸ dhe
- Në çështjet penale në të cilat procedura penale është iniciuar sipas propozimit të prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.¹³⁹

g) Aplikimi përshatshmërisht i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor

Paraprakisht duhet theksuar, se shumë çështje që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore me dispozitat e KPP, siç janë: zbatimi i shqyrtimit fillestar; vendi i mbajtjes së shqyrtimit fillestar; çështja e publicitetit; mbajtja e

¹³⁵ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me letër qarkoren GJ.A.-Su.A.321/13, të datës 26.04.2013, ka sqaruar se për të gjitha çështjet penale për të cilat aktakuza është ngritur dhe konfirmuar dhe në çështjet penale në të cilat është paraqitur propozim akuzë para hyrjes në fuqi të KPP, përfundohen sipas KPP, por nuk ka nevojë të procedohet sipas neneve 245 (Shqyrtimi fillestar) dhe 254 (Shqyrtimi i dytë).

¹³⁶ Në nenin 543 të KPP, është parashikuar se për veprat penale për të cilat kryerësi ndiqet me padi subsidiare, procedura e tillë vazhdon në kuadër në të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore dhe në këtë procedurë zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK, nr.2003/23, e datës 06.07.2003), i cili ka hyrë në fuqi më 06.04.2004.

¹³⁷ Çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e urdhrit ndëshkimor janë trajtuar në Kapitullin e IX të këtij Doracak, "Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimor". Në raste të tilla, nëse gjyqtari i vetëm gjykues nuk e aprovon kërkesën e prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, atëherë duke u bazuar në nenin 494 paragrafi 2 të KPP, caktohet drejtpërdrejt shqyrtimi gjyqësor. Në situatat kur gjyqtari i vetëm gjykues e aprovon kërkesën e prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, mirëpo i pandehuri ose mbrojtësi i tij paraqesin kundërshtim kundër aktgjykimit, atëherë edhe në këto raste, duke u bazuar në nenin 496 paragrafi 4 të KPP, caktohet drejtpërdrejt shqyrtimi gjyqësor. Mirëpo, në rastet kur gjyqtari i vetëm e hedh kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, sipas nenit 494 paragrafi 1 të KPP, atëherë në KPP, nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se si të veprohet, a të caktohet shqyrtimi gjyqësor, apo të caktohet shqyrtimi fillestar.

¹³⁸ Në nenin 69 paragrafi 1 dhe 2 të KDM, është parashikuar se kur gjyqtari për të mitur e merr propozimin nga prokurori, ai mund të merr aktvendim për hudhjen e propozimit apo transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, nëse ekzistojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hudhjen e propozimit ose transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, ai e cakton shqyrtimin gjyqësor brenda tetë ditëve nga pranimi i propozimit.

¹³⁹ Neni 512 paragrafi 1 të KPP.

rendit; mosparaqitja e palëve dhe mbrojtësit; vërtetimi i identitetit të të pandehurit; procesverballi i shqyrtimit fillestar; marrja, shpallja dhe përpilimi aktgjykimit, etj. Sa i përket këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar, mendojmë se duhet që përshtatshmërisht të aplikohen dispozitat e KPP që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor.

h) Kompetenca funksionale

Shqyrtimin fillestar në departamentin e përgjithshëm të gjykatës themelore e zbaton gjyqtari i vetëm gjykues, kurse në departamentin e krimeve të rënda, shqyrtimin fillestar e zbaton kryetari i trupit gjykues.

Në çështjet penale në të cilat është paraqitur aktakuzë ndaj të pandehurit për kryerjen e veprave penale ndaj fëmijëve nga neni 145 të KDM, shqyrtimin fillestar e zbaton kryetari i trupit gjykues për të mitur, i cili njeherit duhet të jetë gjyqtar për të mitur.¹⁴⁰

Përveç gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, në shqyrtimin fillestar duhet që vazhdimisht të prezantohet edhe procesmbajtësi.

i) Njoftimi për shqyrtimin fillestar

Në nenin 242 paragrafi 6 të KPP, është parashikuar se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

¹⁴⁰ Në nenin 145 të KDM, është parashikuar se trupi gjykues për të mitur dhe gjyqtari për të mitur i gjykojnë personat madhor për veprat penale në vijim të kryera kundër fëmijës, të parapara në Kodin Penal të Kosovës: dhunimi; kryerja e akteve seksuale me kërcënim të nderit ose të autoritetit; sulmi seksual; degradimi i integritetit seksual; keqpërdorimi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore ose emocionale ose me paaftësi mendore; keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet; nxitja e akteve seksuale ose prekja seksuale nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet; shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin ose profesionin; mundësimi i prostitucionit; keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi; tregimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet; marrëdhëniet seksuale brenda familjeve; bashkëjetesa me persona nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet në bashkësi jashtëmartesore; ndryshimi i statusit familjar të fëmijës; rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës; keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës; shkelja e detyrimeve familjare; shmangia nga ndihma për mjete jetese; pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve; rekrutimi ose regjistrimi i personave ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konflikt të armatosur; vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërisë dhe e punës së detyruar; trafikimi me njerëz dhe fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz. Ndërsa, në nenin 146 të KDM është parashikuar se procedura kundër personit që kryen vepra penale kundër fëmijës sipas nenit 145 të KDM, zbatohet në pajtim me dispozitat e Kodit Procedurës Penale të Kosovës, përveç dispozitave për dhënien e urdhrit ndëshkues. Meqë tani, pas datës 01.01.2013 janë shfuqizuar Kodi Penal i Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut, nr.2003/25, e datës 06.07.2003) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK, nr.2003/23, e datës 06.07.2003), atëherë sa i përket këtyre veprave penale që kryhen nga madhorët ndaj fëmijëve duhet që përshtatshmërisht të zbatohen Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013 (në tekstin e mëtejme KPRK). Gjithashtu, edhe sa i përket procedurës penale në këto çështje penale, duhet që përshtatshmërisht të aplikohet KPP.

Kurse, në nenin 245 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.

Edhe pse nuk është thënë në mënyrë shprehimore në KPP, duhet që për shqyrtim fillestar të ftohet edhe i dëmtuari.¹⁴¹

j) Vendi i mbajtjes dhe publiciteti i shqyrtimit fillestar

Shqyrtimi fillestar duhet të mbahet në selinë dhe ndërtesën e gjykatës.¹⁴²

Shqyrtimi fillestar është publik dhe në të mund të marrin pjesë vetëm personat e moshës madhore.¹⁴³

k) Prishja e rendit dhe mosbindja ndaj urdhrave të gjykatës

Në rastet kur palët dhe personat tjerë të pranishëm e prishin rendin dhe nuk i binden urdhrave të gjykatës, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që përshtatshmërisht të i aplikojnë nenet 302 dhe 303 të KPP.

l) Procesverbali i shqyrtimit fillestar

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të gjithë rrjedhën e shqyrtimit fillestar ta shënoj në procesverbal të shqyrtimit fillestar.¹⁴⁴ Procesverbali i shqyrtimit fillestar përfundohet me mbarimin e seancës dhe ai duhet të nënshkruhet nga kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm gjykues, procesmbajtësi dhe palët e pranishme.¹⁴⁵

m) Hapja e shqyrtimit fillestar

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pasi ta hapin seancën, atëherë duhet që ta shpallin çështjen që është objekt i aktakuzës.

¹⁴¹ Këtë konkludim e mbështesim në disa dispozita të KPP, të cilat flasin tërthorazi për këtë çështje. Kështu, siç do të shohim më poshtë, në nenin 248 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë edhe mendimin e të dëmtuarit. Po ashtu, duhet përmendur edhe nenin 9 paragrafi 2 të KPP, i cili flet për barazinë e palëve. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se i dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat.

¹⁴² Neni 286 paragrafi 1 i KPP. Në paragrafin 2 këtij neni, është parashikuar se kur në raste të caktuara, lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së hapësirës ose për shkaqe tjera të arsyeshme, kryetari i gjykatës mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në ndonjë ndërtesë tjetër. Kjo dispozitë ligjore duhet që përshtatshmërisht të zbatohet edhe në rastet e shqyrtimit fillestar.

¹⁴³ Sa i përket përjashtimit të publikut në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet që ti referohen neneve 294-296 të KPP.

¹⁴⁴ Një procesverbal i shqyrtimit fillestar është paraqitur përmes formularit nr.1.

¹⁴⁵ Neni 317 paragrafi 1 i KPP.

n) Dorëzimi i aktakuzës të pandehurit

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të pandehurit t'ia dorëzojë një kopje të aktakuzës.

Të pandehurit aktakuza mund ti dorëzohet në dy mënyra dhe atë:

- Mënyra e parë është kur së bashku me thirrjen për të marrë pjesë në shqyrtimin fillestar, të pandehurit i dorëzohet edhe kopja e aktakuzës. Kjo mënyrë e dorëzimit të aktakuzës të pandehurit, konsiderohet më adekuate, për shkak se të pandehurit i ipet kohë e mjaftueshme për ta lexuar aktakuzën dhe për ta përgatitur mbrojtjen e tij.
- Mënyra e dytë është kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit fillestar ia jep kopjen e aktakuzës të pandehurit, nëse ai nuk e ka pranuar kopjen e aktakuzës më parë.¹⁴⁶

o) Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit

Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues duhet që të vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit.¹⁴⁷

p) Çështja e mbrojtjes dhe provave

Krahas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar¹⁴⁸ dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP.¹⁴⁹

Në nenin 245 paragrafi 7 të KPP, është parashikuar se asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç nëse dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit.

¹⁴⁶ Neni 245 paragrafi 2 i KPP.

¹⁴⁷ Neni 245 paragrafi 3 i KPP.

¹⁴⁸ Sipas nenit 53 paragrafi 1 të KPP, i pandehuri ka të drejtë të ketë mbrojtës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. I pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës, kurse e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit. Në disa raste të parashikuara me KPP, mbrojtja me avokatë është e detyruar dhe nëse i pandehuri në këto raste nuk angazhon avokat, atëherë atij i caktohet një mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

¹⁴⁹ Në nenin 244 të KPP, është parashikuar se jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e cekura në këtë dispozitë ligjore ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit.

q) Vërtetimi i identitetit të pandehurit dhe udhëzimet për të drejtat e tij

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret të pandehurin dhe prej tij merr të dhënat personale.¹⁵⁰

Pasi të vërtetohet identiteti i të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta udhëzojë të pandehurin për këto të drejta:

- drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë;
- të drejtën të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij;
- të drejtën që ta kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.¹⁵¹

Gjithashtu, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta ftojë të pandehurin që ta përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit fillestar.

Përveç këtyre, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet ta njoftojë të pandehurin edhe për beneficionet dhe për pasojat e pranimit të fajësisë, përkatësisht duhet që ta njoftojë të pandehurin, se nëse i njëjti e pranon fajësinë, atëherë gjykata duke u bazuar në 75 të KPRK¹⁵² mund t'i shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë një lloj më të butë të dënimit.¹⁵³

r) Leximi i aktakuzës dhe deklarimi i të pandehurit lidhur me aktakuzën

Pastaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e fton prokurorin e shtetit që t'ia lexon aktakuzën të pandehurit.¹⁵⁴

¹⁵⁰ Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet ti vërtetojë këto të dhëna personale të të pandehurit: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit, si dhe nofkën nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; mbiemrin e vajzërisë së nënës; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin e tij dhe rrethanat familjare; a di shkrim e lexim; shkollimin e tij; a ka të ardhura personale dhe pozitën e tij materiale.

¹⁵¹ Neni 246 paragrafi 1 i KPP.

¹⁵² Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se në raste të tilla, gjykata e merr parasysh mendimin e prokurorit, mbrojtësit dhe palës së dëmtuar sa i përket zbutjes së dënimit dhe udhëzohet por nuk detyrohet nga kufizimet e parapara në nenin 76 të KPRK.

¹⁵³ Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.3/2014, të datës 16.01.2014, e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Apelit, me ç' rast çështja është kthyer në rigjykim, me arsyetimin se i pandehuri nuk është njoftuar për institucionin e pranimit të fajësisë, si dhe me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

¹⁵⁴ Neni 246 paragrafi 3 i KPP.

Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë.¹⁵⁵

Varësisht nga fakti, nëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë apo jo, shqyrtimi fillestar mund të marrë dy kahje të ndryshme.

s) Caktimi i shqyrtimit të dytë nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë

Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë apo nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim e refuzon pranimin e fajësisë, atëherë gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka këto dy mundësi:

- Që të caktojë shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar ose
- Të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar.¹⁵⁶

t) Udhëzimet për të pandehurin dhe mbrojtësin

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta njoftojë të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, ata duhet që:

- Të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë;
- Të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht dhe
- Të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshtimit të veprës penale sipas ligjit.¹⁵⁷

4.1.1 Marrëveshja për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqiptimi i dënimit

Ligdhënësi i ka kushtuar një rëndësi të veçantë marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar.

¹⁵⁵ Neni 246 paragrafi 4 i KPP.

¹⁵⁶ Neni 245 paragrafi 5 i KPP.

¹⁵⁷ Neni 245 paragrafi 6 i KPP.

a) Marrëveshja për pranimin e fajësisë

Nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i KPP paraqitet së bashku me aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shqyrton marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe më pastaj ka këto mundësi:

- Ta pranojë marrëveshjen pranimin e fajësisë;
- Ta refuzojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë ose
- Të cakton shqyrtim të veçantë në pajtim me procedurat nga neni 248 dhe neni 233 i KPP.¹⁵⁸

b) Pranimi i fajësisë

Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:

- I pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- Pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;
- Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri dhe
- Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.¹⁵⁹

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.¹⁶⁰

c) Refuzimi i pranimin të fajësisë

Në nenin 248 paragrafi 3 të KPP, është parashikuar se kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

¹⁵⁸Neni 247 paragrafi 1 i KPP.

¹⁵⁹Neni 248 paragrafi 1 i KPP.

¹⁶⁰Neni 248 paragrafi 2 i KPP.

d) Aktvendimi për pranimin e fajësisë dhe procedura e mëtejme

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe ka tri mundësi:

- Të vazhdon me shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurit;
 - Të caktojë seancë për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose
 - Të pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.
-
- Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, zgjedh mundësinë e parë, atëherë ai vazhdon me shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurit.¹⁶¹
 - Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, zgjedh mundësinë e dytë, atëherë ai duhet që ta caktojë një seancë në të cilën duhet të vërtetohen faktet që janë relevante për shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurit. Faktet relevante për shqiptimin e dënimit, janë parashikuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK. Pasi të vërtetohen faktet që janë relevante për shqiptimin e dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të vazhdojë me shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurit.

¹⁶¹ Pas hyrjes në fuqi të KPP, kjo dispozitë ligjore ka shkaktuar dilema dhe qëndrime të ndryshme në praktikën tonë gjyqësore. Në këtë aspekt, sa i përket kësaj dispozite ligjore kanë lindur qëndrime të ndryshme lidhur me dy çështje :

1. Në rastet kur kryetari i trupit gjykues pranë Departamentit për Krime të Rënda të gjykatës themelore e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vendos që të shqiptojë dënimin, atëherë a duhet që dënimin ta shqiptojë vetëm kryetari i trupit gjykues apo dënimin duhet ta shqiptojë trupi gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë profesional, njëri nga të cilët e kryeson trupin gjykues, siç parashihet në nenin 25 paragrafi 3 të KPP, si dhe

2. Në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i vetëm gjykues e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, atëherë a duhet të ketë fjalë përfundimtare të palëve apo jo.

Lidhur me çështjen e parë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, ka dhënë mendim juridik GJA.nr.207/13, i datës 19.03.2013, me të cilin ka sqaruar se “nëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin, d.m.th. janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohen me ligj, në një situatë të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund të vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit, pa shkuar fare në shqyrtim dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupin gjykues ta përbëjnë tre gjyqtarë profesionistë.” Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me shkresën GJ.A-Su.A.528/13, të datës 04.09.2013, ka sqaruar se në raste të tilla nuk ka nevojë të vazhdohet me fjalën përfundimtare të palëve, por shkohet drejtpërdrejt në shqiptimin e dënimit.

- Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e zgjedh mundësinë e tretë, atëherë shqiptimi i dënimit pezullohet deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.

e) Marrja e aktgjykimit dhe shqiptimi i dënimit

Pas këtyre veprimeve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të tërhiqet për ta marrë aktgjykimin dhe shqiptuar dënimin.

Aktgjykimi merret dhe shpallet në emër të popullit.¹⁶²

f) Përmbajtja e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në nenin 365 të KPP.

g) Shpallja e aktgjykimit

Pasi të merret aktgjykimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta shpall aktgjykimin, sipas nenit 366 të KPP.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i udhëzon palët për të drejtën në ankesë. Udhëzimi shënohet në procesverbal të shqyrtimit fillestar. Kur shqiptohet dënim alternativ nga neni 49 i KPRK, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues paralajmëron të pandehurin për rëndësinë e dënimit dhe kushtet të cilat duhet respektuar. Gjithashtu, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.¹⁶³

h) Vendosja lidhur me paraburgimin

Nëse i pandehuri është në paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet që të vendos lidhur me paraburgimin, duke u bazuar në nenin 367 të KPP.

i) Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit

Në fund, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet që aktgjykimin ta përpilojë dhe ta dorëzojë, sipas neneve 369 dhe 370 të KPP.

¹⁶² Neni 359 paragrafi 2 të KPP.

¹⁶³ Neni 368 i KPP.

4.2. Kundërshtimi i provave

Siç është cekur edhe më parë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit fillestar, duhet që të pandehurin ta udhëzojnë për të drejtën e tij në paraqitjen e kundërshtimit ndaj provave të cekura në aktakuzën e prokurorit të shtetit.

4.2.1. Arsyet për kundërshtimin e provave

Kundërshtimin ndaj provave të cekura në aktakuzë, i pandehuri mund ta paraqesë para shqyrtimit të dytë duke u bazuar në këto arsye:

- Provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;
- Provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i KPP ose
- Ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pamështetshme.¹⁶⁴

4.2.2 Paraqitja e kundërshtimit nga ana e mbrojtësit

Në nenin 245 paragrafi 6 i KPP, kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzën e prokurorit të shtetit, mund të paraqesë edhe mbrojtësi i të pandehurit, nëse i pandehuri ka mbrojtës.

4.2.3 Përgjigjet në kundërshtimin e paraqitur

Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij, paraqesin kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë, atëherë prokurorit të shtetit duhet ti jepet mundësia që të përgjigjet gojarisht ose me shkrim ndaj kundërshtimit të lartcekur.¹⁶⁵

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet ti jap prokurorit të shtetit kohë prej 1 (një) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit të paraqitur ndaj provave të cekura në aktakuzë.¹⁶⁶

4.2.4 Aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues lidhur me kundërshtimin

Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të merr aktvendim me shkrim, i cili duhet të jetë i

¹⁶⁴Neni 249 paragrafi 1 i KPP.

¹⁶⁵Neni 249 paragrafi 2 i KPP.

¹⁶⁶Neni 251 paragrafi 3 i KPP.

arsyetuar. Përmes këtij aktvendimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të vendos në dy mënyra:

- Lejimin e provës ose
- Përrjashtimin e provës.¹⁶⁷

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i vetëm gjykues lejon provën e caktuar, nëse vlerëson se prova është marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar; nëse prova nuk është në kundërshtim me rregullat e Kapitullit XVI të KPP dhe nëse nuk ka bazë të artikulueshme që prova e caktuar të çmohet si thelbësisht e pa mbështetshme.¹⁶⁸ Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta përjashtojnë provën e caktuar, përkatësisht duhet që provën e caktuar ta shpallin si të papranueshme.¹⁶⁹

Provat e papranueshme duhet që të ndahen nga shkresat e lëndës dhe të mbyllen. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.¹⁷⁰

Në nenin 249 paragrafi 5 të KPP, është parashikuar se të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Siç është cekur më lart, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që me aktvendim të vendos lidhur me kundërshtimin e paraqitur ndaj provave të cekura në aktakuzën e prokurorit të shtetit. Kundër këtij aktvendimi secila palë mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.¹⁷¹

4.3 Kërkesa për hudhjen e aktakuzës

Përveç paraqitjes së kundërshtimit ndaj provave të cekura në aktakuzë, i pandehuri ka të drejtë që të paraqesë edhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

I pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës para shqyrtimit të dytë.

¹⁶⁷ Neni 249 paragrafi 3 i KPP.

¹⁶⁸ Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.2.

¹⁶⁹ Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.3.

¹⁷⁰ Neni 249 paragrafi 4 i KPP.

¹⁷¹ Neni 249 paragrafi 6 i KPP. Me këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se lidhur me ankesën e paraqitur ndaj aktvendimit të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues vendos Gjykata e Apelit në Prishtinë, mirëpo, një gjë e tillë është e parashikuar me nenin 411 të KPP.

4.3.1. Arsyet për paraqitjen e kërkesës për hudhjen e aktakuzës

Kërkesa për hudhjen e aktakuzës mund të paraqitet duke u bazuar në këto arsye:

- Vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
- Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- Ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen ose
- Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.¹⁷²

4.3.2 Paraqitja e kërkesës për hudhjen e aktakuzës nga ana e mbrojtësit

Duke u bazuar në nenin 245 paragrafi 6 të KPP, kërkesë për hudhjen e aktakuzës mund të paraqesë edhe mbrojtësi i të pandehurit, nëse i pandehuri ka mbrojtës.

4.3.3 Përgjigjet ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës

Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij, paraqesin kërkesë për hudhjen e aktakuzës, atëherë prokurorit të shtetit duhet ti jepet mundësia që të përgjigjet gojarisht ose me shkrim ndaj kërkesës së lartcekur.¹⁷³

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet ti jap prokurorit të shtetit kohë prej 1 (një) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës.¹⁷⁴

4.3.4 Aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues lidhur me kërkesën për hudhjen e aktakuzës

Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij kanë paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që me aktvendim të arsyetuar të vendos lidhur me kërkesat e lartcekura. Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka dy mundësi:

- Ta refuzojë kërkesën për hudhjen e aktakuzës ose
- Ta hudh aktakuzën.

Siç është cekur më lart, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që me aktvendim të vendos lidhur me kërkesën për hudhjen e aktakuzës. Kundër këtij

¹⁷² Neni 250 paragrafi 1 i KPP.

¹⁷³ Neni 250 paragrafi 2 i KPP.

¹⁷⁴ Neni 251 paragrafi 3 i KPP.

aktvendimi secila palë mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.¹⁷⁵

4.3.5 Paraqitja e aktakuzës së ndryshuar

Duhet theksuar se në vend të përgjigjes ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës, prokurori i shtetit mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar.¹⁷⁶ Kështu, në nenin 252 paragrafi 1 i KPP, është parashikuar se nëse kërkesa e paraqitur nga i pandehuri për hudhjen e aktakuzës mund të rregullohet me ndryshim të aktakuzës, prokurori i shtetit paraqet aktakuzë të ndryshuar në pajtim me nenin 241 të KPP brenda 1 (një) jave nga shqyrtimit i dytë.

Nëse aktakuza e ndryshuar paraqitet kundër një të pandehuri apo disa të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtim fillestar nga neni 245 i KPP sikurse aktakuza të ishte e re.¹⁷⁷

I pandehuri mund të paraqesë kundërshtime të reja nga neni 249 i KPP ose kërkesa nga neni 250 i KPP, por vetëm për ato pjesë të aktakuzës të cilat janë ndryshuar.¹⁷⁸

Po ashtu, duhet theksuar se i pandehuri mund të paraqesë sërish kundërshtimet e mëparshme ndaj provave të cekura në aktakuzë ose kërkesat për hudhjen e aktakuzës. Nëse i pandehuri nuk i paraqet sërish kundërshtimet apo kërkesat e mëparshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë që ato kundërshtime apo kërkesa nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar, atëherë nuk i shqyrtojnë më tej.¹⁷⁹

4.4 Hudhja e aktakuzës

Nëse është paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës, siç është cekur edhe më parë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ose ta refuzojë këtë kërkesë ose ta hudhin aktakuzën e prokurorit të shtetit.

¹⁷⁵ Neni 250 paragrafi 4 i KPP. Me këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se lidhur me ankesën e paraqitur ndaj aktvendimit të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues vendos Gjykata e Apelit në Prishtinë, mirëpo, një gjë e tillë është e parashikuar me nenin 411 të KPP.

¹⁷⁶ Neni 251 paragrafi 4 i KPP.

¹⁷⁷ Neni 252 paragrafi 2 i KPP.

¹⁷⁸ Neni 252 paragrafi 3 i KPP.

¹⁷⁹ Neni 252 paragrafi 4 i KPP.

4.4.1 Refuzimi i kërkesës për hudhjen e aktakuzës

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e refuzon kërkesën për hudhjen e aktakuzës, nëse çmon se nuk ka arsye ligjore për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale.¹⁸⁰

4.4.2 Hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës penale

Kurse, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim e hudh aktakuzën dhe pushon procedurën penale kur çmon se:¹⁸¹

- Vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale;
- Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- Ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen ose
- Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.¹⁸²

a) Nëse vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale.

Nocioni dhe tiparet apo elementet e çdo vepre penale konkrete janë të përcaktuara me KPRK. Sipas nenit 7 të KPRK, vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm. Çdo veprim ose mosveprim, për tu konsideruar vepër penale, duhet që të posedojë në mënyrë kumulative të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale të cilat janë të përcaktuara me ligj.¹⁸³ Ndërsa, një veprim nuk përbën vepër penale, nëse nuk i përmban të gjitha elementet e parashikuar me ligj. Po ashtu, duke u bazuar në KPRK, vepra nuk përbën vepër penale, përveç tjerash edhe në këto raste:

- nëse vepra është vepër e rëndësisë së vogël;¹⁸⁴
- nëse vepra është kryer në mbrojtje të nevojshme;¹⁸⁵
- nëse vepra është kryer nën kushtet e nevojës ekstreme;¹⁸⁶
- nëse vepra është kryer nën ndikimin e dhunës ose të kanosjes së papërballueshme;¹⁸⁷

¹⁸⁰ Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.4.

¹⁸¹ Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.5.

¹⁸² Neni 253 paragrafi 1 i KPP.

¹⁸³ **Shala, Afrim** : Hyrje në të drejtën penale, Botimi i dytë, Gjilan, 2013, faqe 39.

¹⁸⁴ Neni 11 i KPRK.

¹⁸⁵ Neni 12 i KPRK.

¹⁸⁶ Neni 13 i KPRK.

¹⁸⁷ Neni 14 i KPRK.

- nëse vepra është kryer nën shtrëngim;¹⁸⁸
- nëse është akuzuar një person për tentativë të kryerjes së një vepre penale për të cilën nuk është parashikuar me ligj se ndëshkohet tentativa.¹⁸⁹

Po ashtu, mund të ndodh që në praktikën gjyqësore, një person të akuzohet për një vepër e cila nuk përbën vepër penale, por i përmban tiparet e ndonjë kundërvajtje, delikti ekonomik apo delikti disiplinor.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se ekziston ndonjëra nga rrethanat e lartcekura, përkatësisht nëse çmon se vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale, atëherë ai duhet me aktvendim ta hudh aktakuzën dhe ta pushojë procedurën penale.

b) Nëse ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale.

Rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas KPRK,¹⁹⁰ janë:

- Paaftësia mendore;¹⁹¹
- Kryerja e një vepre penale nga pakujdesia për të cilin sipas ligjit për të cilin sipas ligjit nuk parashikohet shprehimisht përgjegjësia penale;¹⁹²
- Moshë nën 14 (katërbëdhjetë) vjet;¹⁹³
- Lidhja shkakore;¹⁹⁴
- Lajthimi faktik¹⁹⁵ dhe
- Lajthimi juridik.¹⁹⁶

Po ashtu, duke ju përmbajtur parimit “*nullum crimen, nullum poena sine culpa*”, personi nuk ka përgjegjësi penale nëse nuk është fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe disa rrethana tjera të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, e të cilat janë trajtuar te Kapitulli i VI i këtij Doracaku-Aktgjykimi lirues.

¹⁸⁸ Neni 15 i KPRK.

¹⁸⁹ Në nenin 28 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet, ndërsa tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj.

¹⁹⁰ **Shala, Afrim:** Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010, faqe 113.

¹⁹¹ Neni 17 paragrafi 1 dhe neni 18 paragrafi 1 i KPRK.

¹⁹² Neni 17 paragrafi 2 i KPRK. P.sh. është me rëndësi të theksohet fakti, se për dallim nga legjislacioni i mëparshëm penal, tani KPRK nuk ka parashikuar përgjegjësi penale për kryerjen nga pakujdesia të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189 i KPRK.

¹⁹³ Neni 17 paragrafi 3 i KPRK.

¹⁹⁴ Neni 20 i KPRK.

¹⁹⁵ Neni 25 i KPRK.

¹⁹⁶ Neni 26 i KPRK.

c) Nëse ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen

Afatet e parashkrimit të ndjekjes penale janë parashikuar në nenin 106 të KPRK. Përveç parashkrimit, duke u bazuar në këtë nën paragraf, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet që ta hudh aktakuzën dhe ta pushojë procedurën penale, nëse vepra penale është përfshirë me amnisti,¹⁹⁷ falje ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.

d) Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë

Në fund, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta hudh aktakuzën dhe ta pushojë procedurën penale nëse vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme me anë të të cilave mbështet dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë.¹⁹⁸

4.5 Shqyrtimi i dytë

Në nenin 254 të KPP, janë parashikuar veprimet të cilat duhet ti ndërmarrë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit të dytë.

Në fillim duhet theksuar se parimisht në shqyrtimin e dytë marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë.¹⁹⁹

¹⁹⁷ Me Ligjin 04/L-209 për Amnistinë, i datës 11.07.2013, është parashikuar se lirohen plotësisht nga ndjekja penale ose nga ekzekutimi i dënimit kryesit e veprave penale të cilat janë të listuara në nenin 3 të këtij dhe të cilat janë kryer para datës 20.06.2013. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me qarkoren GJ.A.-Su.A.619/2013, e datës ka dhënë udhëzimet e nevojshme se si duhet të procedohen çështjet nga gjykatat me rastin e zbatimit të Ligjit për Amnisti.

¹⁹⁸ Neni 253 paragrafi 2 i KPP.

¹⁹⁹ Neni 254 paragrafi 1 i KPP.

4.5.1 Zbulimi i provave nga ana e mbrojtjes

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, gjatë shqyrtimit të dytë duhet të sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave.²⁰⁰ Në këtë aspekt, gjatë shqyrtimit të dytë, mbrojtja i paraqet prokurorit të shtetit:

- Njoftimin për qëllimin e prezantimit të alibit, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë;
- Njoftimin për qëllimin e prezantimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë dhe
- Njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.²⁰¹

Mirëpo, duhet theksuar se në nenin 256 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar edhe mundësia që në çdo kohë para shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi të ketë mundësi të plotësojë me shkrim informatat e lartcekura prokurorit të shtetit.

Nëse mbrojtësi nuk i përmbush detyrimet e lartcekura, ndërsa gjykata nuk gjen shkaqe të arsyeshme për një gjë të tillë, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në 250 (dyqindpesëdhjetë) Euro ndaj mbrojtësit dhe njofton Odën e Avokatëve për këtë.²⁰²

4.5.2 Shqyrtimi i kundërshtimeve ndaj provave ose i kërkesave për hudhjen e aktakuzës

Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrton kundërshtimet e paraqitura ndaj provave të cekura në aktakuzën e prokurorit të shtetit ose kërkesat për hudhjen e aktakuzës.²⁰³

Siç është cekur edhe më parë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit të dytë ose me shkrim, në pajtim me nenet 249-253 të KPP.

4.5.3 Caktimi i seancave dëgjimore

Mirëpo, për t'i vlerësuar kundërshtimet ndaj provave të cekura në aktakuzë ose kërkesat për hudhjen e aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton

²⁰⁰ Neni 254 paragrafi 2 i KPP.

²⁰¹ Neni 256 paragrafi 1 i KPP.

²⁰² Neni 256 paragrafi 3 i KPP.

²⁰³ Neni 254 paragrafi 3 i KPP.

seanca dëgjimore në pajtim me nenin 255 të KPP, nëse seancat e tilla janë të nevojshme.²⁰⁴

4.5.4 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor dhe marrja e aktvendimit lidhur me kundërshtimet ndaj provave ose kërkesave për hudhjen e aktakuzës

Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet ndaj provave të cekura në aktakuzë ose kërkesat për hudhjen e aktakuzës.²⁰⁵

Në nenin 254 paragrafi 6 të KPP, është parashikuar se nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet ndaj provave të cekura në aktakuzë ose për kërkesat për hudhjen e aktakuzës, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjdhura pas shqyrtimit të dytë. Po ashtu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.

4.5.5 Gjatë shqyrtimit të dytë nuk duhet të administrohen prova

Gjatë shqyrtimit të dytë, nuk mund të merret në pyetje asnjë dëshmitar apo ekspert dhe as nuk mund të paraqiten as prova tjera.²⁰⁶

4.6 Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve

Siç është cekur edhe më parë, nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit për të vlerësuar kundërshtimet ndaj provave të cekura në aktakuzë apo kërkesat për hudhjen e aktakuzës, ai cakton dhe zbaton shqyrtimin e tillë sa më parë që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 3 (tre) javë nga dita e shqyrtimit të dytë.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të nxjerr aktvendim me shkrim të arsyetuar sa më parë që të jetë e mundur pas këtyre shqyrtimeve të mbajtura dhe por jo më vonë se 3 (tre) javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit nga ky nen.²⁰⁷

²⁰⁴Neni 254 paragrafi 4 i KPP.

²⁰⁵Neni 254 paragrafi 5 i KPP.

²⁰⁶Neni 254 paragrafi 7 i KPP.

²⁰⁷Neni 255 paragrafi 2 i KPP.

KAPITULLI V

SHQYRTIMI GJYQËSOR

KAPITULLI V

5. SHQYRTIMI GJYQËSOR	119
5.1 Shqyrtimi gjyqësor.....	119
5.1.1 Shqyrtime të përgjithshme	119
5.1.2 Përgatitjet për shqyrtim gjyqësor	120
a) Caktimi i shqyrtimit gjyqësor	120
b) Vendi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor	121
c) Dërgimi i thirrjeve për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor	121
d) Propozimet për prova të reja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.....	122
e) Gjyqtarët zëvendësues	123
f) Marrja në pyetje e dëshmitarit ose ekspertit në vendin ku banojnë	123
g) Shtyrja e ditës së shqyrtimit gjyqësor.....	123
5.1.3 Karakteri publik i shqyrtimit gjyqësor.....	123
a) Rastet kur mund të përjashtohet publiku nga shqyrtimi gjyqësor	124
b) Fotografimi, filmimi, regjistrimit televiziv dhe regjistrime tjera të shqyrtimit gjyqësor	125
5.1.4 Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor.....	126
a) Prezenca e vazhdueshme e anëtarëve të trupit gjykues dhe procesmbajtësit, si dhe përbërja e trupit gjykues në përputhje me ligjin	126
b) Drejtimi i shqyrtimit gjyqësor	126
c) Mbajtja e rendit në gjykatore	127
5.1.5 Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.....	129
a) Shqyrtime të përgjithshme	129
b) Mosparaqitja e prokurorit të shtetit në shqyrtim gjyqësor	129
c) Mosparaqitja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor	129
d) Caktimi i paraburgimit ndaj të akuzuarit për shkak të mosparaqitjes në shqyrtim gjyqësor.....	130
e) Mosparaqitja e mbrojtësit në shqyrtim gjyqësor	130
f) Mosparaqitja e dëshmitarit ose ekspertit në shqyrtim gjyqësor	130
5.1.6 Shtyrja, ndërprerja dhe koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor	130
a) Shtyrja e shqyrtimit gjyqësor.....	131
b) Fillimi rishtas i shqyrtimit gjyqësor.....	131
c) Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor	132
d) Koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.....	132
5.1.7 Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor	133
5.2 Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor	136
5.2.1 Shqyrtime të përgjithshme për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor.....	136
5.2.2 Fillimi i shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit	137
a) Vërtetimi i identitetit të akuzuarit	137
b) Dërgimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve në vendin e caktuar	137

c) Udhëzimi i të akuzuarit për të drejtat e tij	137
d) Leximi i aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit.....	138
e) Deklarimi i të akuzuarit lidhur me aktakuzën.....	138
f) Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit	138
5.2.3 Paraqitja e provave.....	139
a) Fjala hyrëse	139
b) Paraqitja e provave	140
c) Marrja në pyetje e dëshmitarit	140
d) Fëmija si dëshmitar.....	141
e) Vërtetimi i identitetit të dëshmitarit.....	141
f) Dhënia e betimit nga ana e dëshmitarit	141
g) Radha e marrjes në pyetje të dëshmitarit.....	142
h) Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë.....	143
i) Deklarimi i ekspertit	143
j) Marrja në pyetje e dëshmitarit, këqyrja ose rikonstrukcioni jashtë shqyrtimit gjyqësor	144
k) Leximi i procesverbaleve ose riprodhimi i regjistrimeve	144
l) Marrja në pyetje e të akuzuarit	144
m) Marrja në pyetje e të bashkakuqzuarit.....	145
n) Të dhënat penale të akuzuarit	145
o) Fjala përfundimtare.....	146

5. SHQYRTIMI GJYQËSOR

5.1. Shqyrtime të përgjithshme

Shqyrtimi gjyqësor konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale dhe për këtë arsye shqyrtimit gjyqësor i kushtohet një rëndësi e veçantë edhe me dispozitat ligjore të KPP.

Shqyrtimi gjyqësor përbëhet prej disa fazave dhe e gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmbledhet në:

- fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimin e të akuzuarit;
- prezantimin (paraqitja) e provave dhe
- fjalën përfundimtare të palëve.

Mirëpo, duhet theksuar se nëse i akuzuari e pranon fajësinë, atëherë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimit të të akuzuarit, kalohet menjëherë në fjalën përfundimtare të palëve.²⁰⁸

Me qëllim që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me sukses dhe pa pengesa, atëherë nevojitet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues më parë të bëjë përgatitje të caktuara. Këto përgatitje kanë të bëjnë si me caktimin e shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe me çështje tjera përgatitore, siç janë dërgimi i ftesave të akuzuarit, mbrojtësit, të dëmtuarit, dëshmitarëve, ekspertëve, etj. Nëse i akuzuari është në paraburgim, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të kërkojë nga qendra e paraburgimit dhe Njësi për Transportimin e të Paraburgosurve sjelljen e të pandehurit në shqyrtim gjyqësor.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e drejtojnë shqyrtimin gjyqësor, kujdesën për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave, si dhe vendosin për propozimet e palëve.

Për gjithë veprimtarinë që zhvillohet në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të përpilojnë procesverbal me shkrim, ku shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor, parimisht është i hapur për publikun dhe në të mund të marrin pjesë vetëm personat madhor, të cilët kanë të drejtë që të përcjellin tërë rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor.

²⁰⁸Shala, Afrim : Shqyrtimi gjyqësor, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2013, faqe 1.

Pas përfundimit të procedurës së provave dhe fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupit gjykues duhet që të tërhiqen për ta marrë aktgjykimin.

5.1.2 Përgatitjet për shqyrtim gjyqësor

a) Caktimi i shqyrtimit gjyqësor

Siç është cekur edhe më parë, shqyrtimi gjyqësor konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale. Me qëllim që kjo fazë të zhvillohet me sukses dhe pa pengesa, atëherë nevojitet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues më parë të bëjë përgatitje të caktuara. Këto përgatitje kanë të bëjnë si me caktimin e shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe me çështje tjera përgatitore.

Në nenin 254 paragrafi 4 të KPP, është parashikuar se gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marrë aktvendim për kundërshtimet e paraqitura ndaj provave të cekura në aktakuzë, sipas nenit 249 të KPP apo kërkesat për hudhjen e aktakuzës, sipas nenit 250 të KPP.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet ndaj provave të cekura në aktakuzë, sipas nenit 249 të KPP apo kërkesat për hudhjen e aktakuzës, sipas nenit 250 të KPP, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë.

Siç është cekur edhe më lartë, se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.²⁰⁹

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me urdhër cakton ditën, orën dhe vendin e shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 254 të KPP.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që të caktojë fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda 1 (një) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254 paragrafi 5 të KPP.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se shqyrtimi gjyqësor nuk mund të mbahet brenda këtij afati kohor, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr aktvendim për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor deri në datën e parë të mundshme.²¹⁰

²⁰⁹Neni 254 paragrafi 6 i KPP.

²¹⁰Neni 285 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPP.

b) Vendi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor

Si rregull shqyrtimi gjyqësor mbahet në selinë e gjykatës dhe ndërtesën e gjykatës. Kur në raste të caktuara, lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së hapësirës ose për shkaqe tjera të arsyeshme, kryetari i gjykatës mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në ndonjë ndërtesë tjetër.²¹¹

c) Dërgimi i thirrjeve për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor

Në kuadër të përgatitjeve për shqyrtimin gjyqësor, bëjnë pjesë edhe dërgimi i thirrjeve personave të cilët duhet që të marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor.

Lidhur me këtë, në nenin 287 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se në shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe përfaqësuesit e tyre ligjor, përfaqësuesit e autorizuar, si dhe përkthyesi. Dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe nga mbrojtja sipas nenit 256 të KPP, thirren po ashtu në shqyrtimin gjyqësor.

Thirrja që i dërgohet të akuzuarit duhet të përmbajë: emrin dhe adresën e gjykatës e cila e dërgon thirrjen; emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit; përcaktimin e veprës penale për të cilën akuzohet; vendin, ditën dhe orën kur duhet të paraqitet i akuzuari; njoftimin se thirret në cilësi të të akuzuarit; paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes do të lëshohet urdhërarrest dhe do të silllet në gjykatë forcërisht; vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit i cili lëshon thirrjen.

Ndërsa, thirrja që i dërgohet dëshmitarit duhet që të përmbajë: emrin, mbiemrin dhe profesionin e dëshmitarit, koha dhe vendi ku duhet të paraqitet, lënda penale për të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat e mungesës pa arsye.

Kur mbrojtja me avokat nuk është e detyrueshme, i akuzuari në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij në mbrojtës, por shqyrtimi gjyqësor nuk mund të shtyhet nëse mbrojtësi nuk vjen në shqyrtimin gjyqësor ose për shkak se i akuzuari ka angazhuar mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor.

Sipas paragrafit 3 të nenit 287 të KPP, të akuzuarit i dërgohet thirrja jo më vonë se 8 (tetë) ditë para shqyrtimit gjyqësor që ai të ketë kohë të mjaftueshme ndërmjet dërgimit të thirrjes dhe ditës së shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Me kërkesën e të

²¹¹Neni 286 i KPP.

akuzuarit ose të prokurorit të shtetit dhe me pëlqimin e të akuzuarit, ky afat mund të shkurtohet.

Ndërsa, në thirrjen të cilën ja dërgon gjykata të dëmtuarit, i cili nuk thirret si dëshmitar, të njëjtin e njofton se shqyrtimi gjyqësor do të mbahet edhe pa praninë e tij dhe se deklarata e tij për kërkesën pasurore juridike do të lexohet.

I akuzuari, dëshmitari dhe eksperti, çdo herë njoftohen në thirrje për pasojat e mosparaqitjes në shqyrtimin gjyqësor.

Me kërkesë të Ombudspersonit të Kosovës, Ombudspersoni gjithashtu njoftohet për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në kufijtë e autorizimeve të tij.²¹²

Nëse i akuzuari është në paraburgim, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, përveç tjerash, duhet që të kërkojnë nga qendra e paraburgimit dhe Njësiti për Transportimin e të Paraburgosurve sjelljen e të pandehurit në shqyrtim gjyqësor.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e vlerësojnë të nevojshme, me qëllim të mbajtjes së rendit, mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të asistojnë edhe zyrtarët policor.

d) Propozimet për prova të reja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor

Në nenin 288 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara. Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e aprovon këtë kërkesë nëse dëshmitari i ri, eksperti i ri apo prova e re ka qenë e panjohur në kohën e shqyrtimit të dytë, ose nuk e përsërit në mënyrë të konsiderueshme dëshmitarin, ekspertin apo provën tjetër dhe e drejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e refuzon kërkesën për mbledhjen e provave të reja, refuzimi i tillë mund të ankimohet brenda 48 (dyzetetë) orëve nga pranimi i urdhrin për refuzimin e kërkesës.²¹³

Në rast se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, e aprovon kërkesën për mbledhjen e provave të reja, atëherë palët dhe mbrojtësi njoftohen për vendimin me të cilin urdhërohet mbledhja e provave të reja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

²¹²Neni 288 paragrafët 5, 6 dhe 7 të KPP.

²¹³ Neni 288 paragrafët 2 dhe 3 të KPP.

e) Gjyqtarët zëvendësues

Nëse parashihet se shqyrtimi gjyqësor do të zgjasë, kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës të caktojë një gjyqtar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor në mënyrë që të zëvendësojë anëtarët e trupit gjykues në rast se nuk mund të marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor. Nëse gjatë procedurës penale është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, një nga 2 (dy) gjyqtarët që kanë shërbyer në atë kolegji, por që nuk kanë qenë gjyqtar në procedurë paraprake, shërben si anëtar i trupit gjykues, ndërsa tjetri si gjyqtar zëvendësues.

f) Marrja në pyetje e dëshmitarit ose ekspertit në vendin ku banojnë

Sipas nenit 290 paragrafi 1 të KPP, kur dëshmitari ose eksperti i thirrur në shqyrtim gjyqësor nuk mund të paraqitet për shkak të sëmundjes kronike ose për shkak të pengesave të tjera, dëshmitari i tillë ose eksperti mund të merret në pyetje në vendin ku ai banon, përveç nëse dëshmitari apo eksperti i tillë është marrë në pyetje gjatë mundësisë hetuese të veçantë. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari njoftohen për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje nëse kjo është e mundshme duke pasur parasysh ngutën e procedurës. Nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos nëse prania e tij gjatë marrjes në pyetje është e nevojshme, duke siguruar që në mungesë të të akuzuarit, mbrojtësi i tij të jetë i pranishëm. Kur palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari janë të pranishëm, ata i gëzojnë të drejtat nga neni 149 paragrafi 6 i KPP.²¹⁴

g) Shtyrja e ditës së shqyrtimit gjyqësor

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për shkaqe të rëndësishme mund ta shtyjë ditën e shqyrtimit gjyqësor me propozim të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare. Në këtë drejtim, nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn ditën e shqyrtimit gjyqësor, ai mund të caktojë shqyrtime të herëpashershme për të diskutuar rreth statusit të lëndës, çështjeve të pazgjidhura dhe për të siguruar zgjedhjen në kohë të lëndës ose caktimin e shqyrtimit gjyqësor.²¹⁵

5.1.3 Karakteri publik i shqyrtimit gjyqësor

Parimi i publicitetit të shqyrtimit gjyqësor nënkupton të drejtën dhe mundësinë e qytetarëve të interesuar që të prezantojnë dhe ta përcjellin rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor.

²¹⁴Neni 290 paragrafi 2 i KPP.

²¹⁵Neni 291 i KPP.

Për shkak të rëndësisë së tij të madhe, ky parim është ngritur edhe në rang të parimeve kushtetuese. Kështu, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është parashikuar se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.²¹⁶ Gjithashtu, një parim i tillë është parashikuar edhe në nenin 7 paragrafi 4 të Ligjit për Gjykatat²¹⁷ dhe në KPP.

Në nenin 293 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se shqyrtimi gjyqësor është publik. Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor mundëson një lloj kontrolli të gjyqësorit me rastin e gjyqimit, i shërben interesit të përgjithshëm sepse nëpërmjet tij zgjerohen njohuritë për ligjet dhe forcohet besimi në jurisprudencë, i ofrohen garanci të pandehurit për gjykim të drejtë, pastaj ndikon në preventivën e kriminalitetit, afirmon moralin shoqëror dhe disiplinën shoqërore të qytetarëve dhe së bashku me parimet tjera mundëson në marrjen e vendimit të ligjshëm.²¹⁸

Sipas paragrafit 2 të nenit 293 të KPP, në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor. Kjo do të thotë se në shqyrtimin gjyqësor nuk lejohet pjesëmarrja e fëmijëve në cilësi të publikut, për faktin se ekziston mundësia e ndikimit negativ tek ata.

Mirëpo, edhe përkundër këtij parimi, me qëllim të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të shoqërisë apo interesat e palëve, në KPP është parashikuar edhe mundësia e përjashtimit të publikut gjatë shqyrtimit gjyqësor.

a) Rastet kur mund të përjashtohet publiku nga shqyrtimi gjyqësor

Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 294 të KPP, nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për:

- Ruajtjen e fshehtësisë zyrtare;
- Ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi i hapur;
- Ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit;

²¹⁶Neni 31 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²¹⁷ Ligji Nr.03/L-199 për Gjykatat, i datës 22.07.2010, është shpallur me dekretin Nr. DL-047-2010, të datës 09.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, ndërsa është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Viti V, Nr.79, të datës 24.08.2010 (në tekstin e mëtejme LGJ).

²¹⁸**Sahiti, Ejup** : E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, faqe 51; **Hajdari, Azem** : Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, faqe 575.

- Mbrojtjen e jetës personale ose familjare të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- Mbrojtjen e interesave të fëmijëve ose
- Mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të KPP.

Përfashtimi i publikut, nuk zbatohet për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësin, përveç nën kushtet e dispozitave për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose të dëshmitarëve, siç parashihet në kapitullin XIII të KPP.

Përveç kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të lejojë që në shqyrtimin gjyqësor në të cilën është përjashtuar publiku të marrin pjesë zyrtarë të caktuar, akademikë, figura publike dhe me kërkesën e të akuzuarit, mund të lejojë pjesëmarrjen e bashkëshortit ose bashkëshortit jashtëmartesor si dhe të afërmit e tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ti paralajmëron personat që marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të mbyllur se detyrohen të ruajnë fshehtësinë e informatave të cilat i kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor dhe se zbulimi i informatës së tillë përbën vepër penale.²¹⁹

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, vendos për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të mbyllur, atëherë ai duhet që të merr një aktvendim i cili duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht. Ky aktvendim mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.²²⁰

b) Fotografimi, filmimi, regjistrimit televiziv dhe regjistrime tjera të shqyrtimit gjyqësor

Përveç që lejohet pjesëmarrja e publikut gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 301 paragrafi 3 të KPP, lejohet edhe fotografimi, filmimi, regjistrimi televiziv dhe regjistrime të tjera përpos regjistrimit zyrtar të shqyrtimit gjyqësor, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kufizon fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera me aktvendim të arsyetuar me shkrim. Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, fotografimi, filmimi, regjistrimit televiziv dhe regjistrime tjera, si rregull lejohen, me përjashtim të rasteve kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i kufizon veprimet e lartcekura.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos që të kufizojë fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera, atëherë ai duhet që të marrë një aktvendim të arsyetuar.

²¹⁹Neni 295 i KPP.

²²⁰Neni 296 i KPP.

Lidhur me fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta aplikojnë edhe Udhëzimin për regjistrim gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilin e ka miratuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.²²¹

5.1.4. Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor

a) Prezenca e vazhdueshme e anëtarëve të trupit gjykues dhe procesmbajtësit, si dhe përbërja e trupit gjykues në përputhje me ligjin

Në shqyrtimin gjyqësor për shkak të peshës së madhe që ka, duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues.²²²

Për prezencën e tyre dhe për nevojën që trupi gjykues të jetë i përbërë në përputhje me ligjin, duhet që të kujdeset gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues.

Në këtë drejtim, sipas paragrafit 2 të nenit 297 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues detyrohet të vërtetojë nëse gjykata është përbërë në pajtim me ligjin dhe nëse ka arsye për përjashtimin e procesmbajtësit, kurse sipas paragrafit 2 të nenit 298 të KPP, kryetari i trupit gjykues detyrohet të vërtetojë nëse trupi gjykues është përbërë në pajtim me ligjin dhe nëse ka arsye për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues ose procesmbajtësit.

b) Drejtimi i shqyrtimit gjyqësor

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues drejton shqyrtimin gjyqësor dhe fton palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit ligjorë, përfaqësuesit e autorizuar, mbrojtësin dhe ekspertët për t'i prezantuar dëshmitë e tyre ose për të parashtruar pyetje. Po ashtu, anëtarët e trupit gjykues mund t'i parashtrojnë pyetje cilitdo dëshmitar apo ekspert.

Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave siç parashihet me KPP, siguron që provat të merren në pajtim me Kapitullin XVI të KPP, i dhe vendosin për propozimet e palëve. Në këto raste, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, vendosin me aktvendim i cili gjithmonë shpallet dhe shënohet në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor me sqarim të shkurtër.²²³

²²¹Ky Udhëzim është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.87/2013, të datës 09.09.2013 dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit.

²²² Paragrafët 1 të neneve 297 dhe 298 të KPP.

²²³ Neni 299 i KPP.

Shqyrtimi gjyqësor zbatohet sipas rregullave të parapara me KPP, por, për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndryshojë radhën e zakonshme të shqyrtimit të provave, sidomos për shkak të numrit të akuzuarve, numrit të veprave penale ose të vëllimit të materialit provues.²²⁴

c) Mbajtja e rendit në gjykatore

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës.

Paralajmërimi i personave të pranishëm - Kështu, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, menjëherë pas hapjes së seancës paralajmëron personat e pranishëm në shqyrtimin gjyqësor që të sillen si duhet dhe të mos e pengojnë punën e gjykatës. Për arsye të tilla, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë kontrollin personal të personave të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.

Largimi i publikut nga shqyrtimi gjyqësor - Kur me masat për mbajtjen e rendit të parapara me KPP nuk është e mundur të sigurohet mbajtja pa pengesë e shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë largimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor.²²⁵

Masat e lartcekura dhe jo vetëm ato, zbatohen ndaj disa pjesëmarrësve në procedurë.

Tërheqja e vërejtjes - Kështu, kur i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi ose personi tjetër që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u bindet urdhrave të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për mbajtjen e rendit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ia tërheq vërejtjen.

Nxjerrja jashtë gjykatores dhe shqiptimi i gjobës - Kur vërejtja e lartcekur është e pasuksesshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores, kurse personat tjerë jo vetëm që mund t'i nxjerrë jashtë, por mund t'i dënojë me gjobë deri në 1000 € (njëmijë Euro).²²⁶

Me urdhër të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari mund të nxirret përkohësisht nga gjykatorja, por nëse ai është marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, atëherë mund të nxirret gjatë tërë kohës së shqyrtimit të provave.²²⁷ ara

²²⁴ Neni 300 i KPP.

²²⁵ Neni 301 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

²²⁶ Neni 302 paragrafi 1 i KPP.

²²⁷ Neni 302 paragrafi 2 fjalia e parë e KPP. Kjo dispozitë ligjore e formuluar në këtë mënyrë, duhet që të ndryshohet, për faktin se sipas nenit 345 të KPP, i akuzuari merret në pyetje pas paraqitjes së provave, e jo

përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues thërret të akuzuarin dhe e njofton për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Kur i akuzuari vazhdon të prishë rendin dhe të ofendojë dinjitetin e gjykatës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përsëri mund ta nxjerrë nga seanca. Në këtë rast, seanca përfundon pa praninë e të akuzuarit, kurse aktgjykimin ia komunikon gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtar i trupit gjykues në praninë e procesmbajtësit.

Prishja e rendit nga ana e mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar - Mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'ia mohojë të drejtën për të mbrojtur ose përfaqësuar klientët e tyre në shqyrtim gjyqësor kur pas dënimit ata vazhdojnë të prishin rendin dhe në këtë rast kërkon nga pala që të angazhojë një mbrojtës tjetër apo përfaqësues të autorizuar. Kur i akuzuari nuk mund të angazhojë mbrojtës tjetër menjëherë, apo kur gjykata atë nuk mund ta caktojë më vonë pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor ndërpritet ose shtyhet. Aktvendimi për këtë çështje së bashku me arsyetimin shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.²²⁸ Kur gjykata e largon nga gjykatorja ose e gjobit anëtarin e Odës së Avokatëve apo avokatin praktikant për prishjen e rendit, për këtë e njofton Odën e Avokatëve të Kosovës.²²⁹

Prishja e rendit nga ana e prokurorit të shtetit - Kur prokurori i shtetit e prish rendin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për këtë e njofton mbikëqyrësin e prokurorit të shtetit dhe gjithashtu mund të pezullojë shqyrtimin gjyqësor dhe të kërkojë nga mbikëqyrësi i prokurorit të shtetit që për këtë çështje të caktojë një prokuror tjetër të shtetit.

Të gjitha aktvendimet lidhur me aplikimin e këtyre masave, dënimeve me të holla dhe dënimet tjera përkitazi me drejtimin e shqyrtimit gjyqësor shënohen në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor.²³⁰ Ankesa është e lejuar vetëm kundër vendimit mbi dënimin, ndonëse gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues i njihet e drejta që të mund të revokojë këtë aktvendim. Ndërsa, kundër aktvendimeve lidhur me mbajtjen e rendit dhe drejtimin e shqyrtimit gjyqësor nuk lejohet ankesë

para paraqitjes së provave, siç ka qenë me Ligjin e Procedurës Penale, që është aplikuar në Kosovës, deri më datën 06.04.2004. Për aq më tepër, marrja në pyetje e të akuzuarit i cili nuk e ka pranuar fajësinë, para paraqitjes së provave, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384 paragrafi 1 nën paragrafi 9 të KPP.

²²⁸ Neni 302 paragrafi 3 i KPP.

²²⁹ Neni 302 paragrafët 4 dhe 5 të KPP.

²³⁰ **Hajdari, Azem** : E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2013, faqe 57.

5.1.5 Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor

a) Shqyrtime të përgjithshme

Pas përfundimit të përgatitjeve të nevojshme, në ditën dhe kohën kur është caktuar shqyrtimi gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues hap seancën, shpall çështjen për gjykim në shqyrtim gjyqësor dhe përbërjen e trupit gjykues, nëse seanca mbahet nga trupi gjykues. Pastaj konstaton nëse kanë ardhur të gjithë personat e thirrur dhe kur nuk kanë ardhur, verifikon se a u janë dorëzuar thirrjet dhe a i kanë arsyetuar mungesat e tyre.²³¹

Si parakusht kryesor për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor është prania e subjekteve themelore të procedurës penale. Në këtë aspekt, me rëndësi të veçantë për zhvillimin me sukses të procedurës penale është se në radhë të parë trupi gjykues duhet të jetë në përbërje të rregullt.

Duke u mbështetur në rëndësinë që ka pjesëmarrja e subjekteve të caktuara të procedurës penale në shqyrtim gjyqësor, ligdhënësi kur është në pyetje mungesa e tyre ka parashikuar disa zgjidhje ligjore.

b) Mosparaqitja e prokurorit të shtetit në shqyrtim gjyqësor

Kështu, në nenin 306 të KPP, është rregulluar situata se si të vepohet në rastet kur në shqyrtimin gjyqësor nuk paraqitet prokurori i shtetit.

Sipas kësaj dispozite ligjore, kur prokurori i shtetit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor të caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit, shqyrtimi gjyqësor shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e prokurorit të shtetit.

c) Mosparaqitja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor

Nëse i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 175 të KPP. Kur i akuzuari nuk mund të silltet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të silltet me forcë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e revokon urdhërarrestin.²³²

²³¹ Neni 305 i KPP.

²³² Neni 307 paragrafi 1 i KPP.

d) Caktimi i paraburgimit ndaj të akuzuarit për shkak të mosparaqitjes në shqyrtim gjyqësor

Përveç këtyre që u cekën më lart, në paragrafin 2 të nenit 307 të KPP është parashikuar edhe mundësia e caktimit të paraburgimit ndaj të akuzuarit, i cili është ftuar në mënyrë të rregullt dhe qartazi i shmanget paraqitjes në shqyrtimin gjyqësor. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i KPP, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit, ndërsa për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të KPP. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se 1 (një) muaj.

e) Mosparaqitja e mbrojtësit në shqyrtim gjyqësor

Nëse në shqyrtim gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsyet e mosardhjes nuk e njofton gjykatën posa të ketë mësuar për ato, ose nëse mbrojtësi lëshon shqyrtimin gjyqësor pa lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, gjykata kërkon menjëherë nga i akuzuari që të angazhojë mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë, kurse caktimi i mbrojtësit nuk mund të bëhet pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor shtyhet.²³³

f) Mosparaqitja e dëshmitarit ose ekspertit në shqyrtim gjyqësor

Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor pa arsye, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë sjelljen e tij të menjëhershme me forcë. Mirëpo, shqyrtimi gjyqësor mund të fillojë edhe pa praninë e dëshmitarit ose ekspertit të thirrur. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor vendos nëse shqyrtimi gjyqësor duhet të vazhdojë ose të ndërpritet apo të shtyhet për shkak të mungesës së dëshmitarit ose të ekspertit.²³⁴

5.1.6 Shtyrja, ndërprerja dhe koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor

Pesha e madhe që ka shqyrtimi gjyqësor për procedurën penale në tërësi kërkon që ai të zhvillohet në mënyrë koherente dhe pa zvarritje në mënyrë që pas përfundimit të tij të shpallet aktgjykimi. Një mënyrë të tillë të zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor e kërkojnë

²³³Neni 308 i KPP.

²³⁴Neni 309 i KPP.

rregulla të shumta procedurale.²³⁵ Mirëpo, për shkaqe të caktuara shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet dhe të ndërpritet, ndërsa shkaqet të cilat e imponojnë shtyrjen ose ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme.

a) Shtyrja e shqyrtimit gjyqësor

Duke u bazuar në nenin 310 paragrafi 1 të KPP, përveç rasteve të përcaktuara me këtë KPP, shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, në këto raste:

- Kur duhet mbledhur prova të reja;
- Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se tek i akuzuari, pas kryerjes së veprës penale është paraqitur çrregullim ose paaftësi mendore e përkohshme ose
- Kur ekzistojnë pengesa të tjera për zbatim të suksesshëm të shqyrtimit gjyqësor.

Në paragrafin 2 të nenit 310 të KPP, është parashikuar se kur është e mundur, në aktvendim me të cilin shtyhet shqyrtimi gjyqësor caktohet dita dhe ora e vazhimit të shqyrtimit gjyqësor.

Gjithashtu, me këtë dispozitë ligjore është parashikuar se me të njëjtin aktvendim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë mbledhjen provave të cilat me kalimin e kohës mund të humbin. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

Çështja e vazhimit të shqyrtimit gjyqësor të shtyrë është e rregulluar varësisht nga përbërja e trupit gjykues që e vazhdon atë ose nga kohëzgjatja për të cilën është shtyrë shqyrtimi gjyqësor.

Rrjedhimisht, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë mund të vazhdojë aty ku ka mbetur ose të fillohet rishtazi.

b) Fillimi rishtas i shqyrtimit gjyqësor

Çdo herë që gjykata konsideron se i janë zbehur përshtypjet lidhur me provat të cilat kanë qenë të analizuara gjatë shqyrtimit të shtyrë, ajo cakton që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtas.²³⁶

Gjithashtu, në rastet kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, atëherë shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të

²³⁵ **Hajdari, Azem** : E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, faqe 72.

²³⁶ **Sahiti, Ejup** : E drejta e procedurës penale, faqe 213-214.

dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.

Kur shtyrja e shqyrtimit gjyqësor ka zgjatur më shumë se 3 (tre) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.²³⁷

Në rastet kur përbërja e trupit gjykues nuk ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë vazhdohet para të njëjtit trup gjykues dhe kryetari i trupit gjykues shkurtimisht paraqet rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm. Por, edhe në këtë rast, trupi gjykues mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtas.

Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor të drejtuar nga gjyqtari i vetëm gjykues, faktet në të cilat bazohet akuza tregojnë se për shqyrtimin e asaj vepre penale është kompetent trupi gjykues prej 3 (tre) gjyqtarëve, gjykimi i kalohet trupit përkatës në kuadër të gjykatës themelore dhe shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas.

c) Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor si rregull bëhet për një kohë të shkurtër. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 312 të KPP, përveç rasteve të përcaktuara me KPP, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor:

- Për pushim për shkak të kalimit të orarit të punës;
- Për të lejuar një kohë të shkurtër që të sigurohet provë konkrete ose
- Për përgatitjen e akuzës apo mbrojtjes.

Parimisht, shqyrtimi gjyqësor i ndërprerë gjithmonë vazhdon para të njëjtit gjyqtar të vetëm gjykues apo trup gjykues. Mirëpo, kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit trup gjykues, ose kur ndërprerja e tij zgjat më tepër se 8 (tetë) ditë, atëherë zbatohen dispozitat nga neni 311 i KPP.²³⁸

d) Koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor

Dispozitat e KPP, për shkak të rëndësisë që ka shqyrtimi gjyqësor, kanë paraparë edhe afate kohore kur duhet që të përfundojë shqyrtimi gjyqësor. Kështu, në paragrafin 1 të nenit 314 të KPP, është parashikuar se përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose

²³⁷ Neni 311 i KPP.

²³⁸ Neni 312 paragrafi 2 i KPP.

trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i KPP, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore:

- Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2 i këtij neni;
- Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda **120 (njëqindnjëzet) ditëve**, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Sipas paragrafit 2 të KPP, shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1 i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në:

- Numër të shumtë të dëshmitarëve;
- Dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë;
- Numri i provave është jashtëzakonisht i madh dhe
- Siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin.

Në këto raste, shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë për **30 (tridhjetë) ditë tjera**.

5.1.7 Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

Për gjithë veprimtarinë që zhvillohet në shqyrtimin gjyqësor përpilohet procesverbali. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor duhet të përpilohet me shkrim dhe në procesverbal duhet të shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor.

Përveç në procesverbal, shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike, përveç nëse ka shkaqe të arsyeshme për të mos bërë një gjë të tillë.²³⁹

Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor përfshin kopjen e transkriptit të regjistrimit audio të shqyrtimit gjyqësor dhe shënimin mbi rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, pjesët kryesore të tij dhe vendimet e marra.

Kur i akuzuari është dënuar me burgim ose pas paralajmërimit të paraqitjes së ankesës në një shkallë më të lartë, regjistrimet audio ose video të shqyrtimit gjyqësor përshkruhen

²³⁹ Neni 315 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

tërësisht brenda 3 (tri) ditëve të punës nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Ky afat mund të zgjatet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kur ekzistojnë rrethana të arsyeshme për një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues rishikon dhe konfirmon përshkrimin dhe atë e vendos në procesverbal si pjesë përbërëse të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor. Për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimi gjyqësor vendos gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.²⁴⁰

Në nenin 316 të KPP, është parashikuar i ashtuquajtur “procesverbali tekstual”. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, kur shqyrtimi gjyqësor regjistrohet vetëm me shkrim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palës ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që deklaratimet që i konsideron të një rëndësie të veçantë të përfshihen tekstualisht në procesverbal. Në raste të tilla dhe në çdo rast kur është e nevojshme dhe veçanërisht kur deklarimi është shënuar tekstualisht në procesverbal, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që pjesë të caktuara të procesverbalit të lexohen menjëherë. Deklarimet e regjistruara tekstualisht lexohen menjëherë kur kërkon pala, mbrojtësi ose personi deklarimi i të cilit është përfshirë në procesverbal.

Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ka rëndësi për gjykatën e shkallës së parë për të kontrolluar në kohën që e merr aktgjykimin, saktësinë e përshtypjeve lidhur me faktet e caktuara, veçanërisht në rastin kur shqyrtimi gjyqësor nuk ka përfunduar përgjatë një seance gjyqësore.

Mirëpo, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, ka rëndësi të veçantë edhe për gjykatën e shkallës së dytë e cila e vërteton saktësinë e përfundimeve të gjykatës së shkallës së parë nëpërmjet shqyrtimit të shkresave.²⁴¹

Përmbajtja e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor është rregulluar me nenin 318 të KPP. Sipas kësaj dispozite ligjore, pjesa hyrëse e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor duhet të përfshijë: gjykatën ku mbahet shqyrtimi gjyqësor, numrin e lëndës, vendin dhe kohën e seancës, emrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, të anëtarëve të trupit gjykues, të procesmbajtësit, prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit të tij ligjor ose përfaqësuesit të autorizuar, mbrojtësit të viktimës dhe emrin e përkthyesit, veprën penale që shqyrtohet dhe nëse dëgjimi zbatohet në shqyrtim gjyqësor të hapur apo të mbyllur.

²⁴⁰ Neni 315 paragrafët 3, 4 dhe 5 të KPP.

²⁴¹ **Hajdari, Azem:** vepra e cituar, faqe 59.

Përveç këtyre, procesverbali veçanërisht përfshin të dhënat vijuese: identifikimin e aktakuzës, nëse prokurori i shtetit e ka ndryshuar apo e zgjeruar aktakuzën, cilat propozime janë bërë nga palët dhe çka është vendosur për to nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues, cilat prova janë paraqitur, nëse provat ose shkrimet e tjera janë lexuar ose nëse regjistrimi audio dhe regjistrimet tjera janë riprodhuar, si dhe komentet e palëve për këtë. Nëse publiku përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor, në procesverbal shënohet se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka paralajmëruar të pranishmit për pasojat e zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë që e kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor.

Si rregull, në procesverbal përfshihet vetëm përmbajtja kryesore e deklaramit të prokurorit, akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Me kërkesë të palës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues urdhëron leximin e një deklarimi të mëparshëm ose ndonjë pjese të tij nga procesverbali. Me kërkesë të palës, në procesverbal shënohet edhe pyetja ose përgjigjja e refuzuar si e palejueshme nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues. Procesverbali shqyrtimit gjyqësor përfundohet me mbarimin e seancës dhe ai nënshkruhet nga procesmbajtësi, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe palët e pranishme.

Palët kanë të drejtë të kontrollojnë procesverbalin e përfunduar dhe pjesët shtojcë, të bëjnë komente mbi përmbajtjen dhe të kërkojnë korrigjimin e tij. Në këtë aspekt, korrigjimet e emrave të shënuar gabimisht, të numrave jo të saktë dhe të gabimeve të qarta në shkrim mund të bëhen me urdhrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues sipas detyrës zyrtare apo sipas propozimit të palës ose të personit që merret në pyetje.

Korrigjime ose shtesa të tjera në procesverbal mund të urdhërohen vetëm nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues. Komentet dhe propozimet e palëve lidhur me procesverbalin, si dhe korrigjimet dhe ndryshimet në procesverbal përfshihen si shtojcë në procesverbalin e përfunduar, ndërsa në shtojcë shënohen arsyet e mospranimit të sugjerimeve dhe komenteve të caktuara. Shtojcën e procesverbalit e nënshkruajnë procesmbajtësi dhe gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.²⁴²

Në nenin 319 të KPP, është parashikuar dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshihet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kështu, sipas paragrafit 1 të këtij neni, në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor në tërësi shënohet dispozitivi i aktgjykimit dhe fakti se aktgjykimi është shpallur publikisht, kurse ky formulim i dispozitivit të shkruar në procesverbal konsiderohet të jetë origjinal. Nëse, urdhërohet vendim për paraburgim, ky vendim gjithashtu shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

²⁴² Neni 317 i KPP.

Procesverbal i veçantë është parashikuar edhe për seancën për këshillim dhe votim që zbatohet para trupit gjykues. Procesverbali për këshillim dhe votimin e trupit gjykues përfshin rrjedhën e votimit dhe vendimin e marrë.

Këtë procesverbal e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Mendimet e ndara i bashkëngjiten procesverbalit për këshillim dhe votim, nëse nuk janë shënuar në procesverbal.

Procesverbali për këshillim dhe votim i trupit gjykues mbyllet në zarf të posaçëm dhe qasje në këtë procesverbal ka vetëm gjykata më e lartë kur vendos lidhur me mjetin juridik, ku me këtë rast detyrohet që procesverbalin ta mbyllë përsëri në zarf të posaçëm në të cilin shënon se e ka shqyrtuar procesverbalin.²⁴³

5.2 Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor

5.2.1 Shqyrtime të përgjithshme për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor

Siç është cekur edhe më parë, shqyrtimi gjyqësor përbëhet prej disa fazave dhe e gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmbledhet në:

- Fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimin e të akuzuarit;
- Prezantimin (paraqitja) e provave dhe
- Fjalën përfundimtare të palëve.

Duhet theksuar se nëse i akuzuari e pranon fajësinë, atëherë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimit të akuzuarit, kalohet menjëherë në fjalën përfundimtare.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, duhet të ndërmerren nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues një mori e veprimeve procedurale të përcaktuara me dispozitat e KPP. Të gjitha këto veprime procedurale duhet të ndërmerren sipas radhës e cila gjithashtu është e përcaktuar në mënyrë decitive me dispozitat e KPP. Mirëpo, në bazë të rrethanave të posaçme e veçmas për shkak të numrit të të akuzuarve, numrit të veprave penale dhe vëllimit të materialit provues, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të bëjë një renditje tjetër.

²⁴³ Neni 320 i KPP.

5.2.2. Fillimi i shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit

a) Vërtetimi i identitetit të akuzuarit

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtim gjyqësor janë të pranishëm të gjithë personat e thirrur, ose kur gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues vendos që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të ndonjë personi të thirrur apo vendimin për këto çështje e ka lënë për më vonë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret të akuzuarin dhe prej tij merr të dhënat personale, përveç të dhënave mbi dënimet e mëparshme, për të vërtetuar identitetin e tij.²⁴⁴

b) Dërgimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve në vendin e caktuar

Pasi të vërtetohet identiteti i të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i dërgon dëshmitarët dhe ekspertët në vendin e caktuar për ta dhe ata presin derisa të ftohen për të dëshmuar. Në rast nevojë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'i ndalë ekspertët në gjykatore që të përcjellin zbatimin e shqyrtimit gjyqësor. Nëse i dëmtuari është i pranishëm dhe ende nuk ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon se mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj kërkesë në procedurën penale. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndërmarrë masat e nevojshme për të penguar marrëveshjen e fshehtë midis dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve.²⁴⁵

c) Udhëzimi i të akuzuarit për të drejtat e tij

Pas këtyre, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e fton të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e udhëzon se mund të paraqesë fakte, t'u shtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të jep shpjegime rreth deklarimeve të tyre.²⁴⁶

Pastaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pastaj e udhëzon të akuzuarin se:

- Ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë pyetje;
- Nëse deklarohet lidhur me çështjen, ai nuk detyrohet të inkriminojë vetveten ose të afërmin e tij, e as të pranojë fajësinë dhe

²⁴⁴ Neni 321 i KPP.

²⁴⁵ Neni 322 i KPP.

²⁴⁶ Neni 323 paragrafi 1 i KPP.

- Ai mund të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij.²⁴⁷

d) Leximi i aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit

Pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve, shqyrtimi gjyqësor fillon me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit kundër të akuzuarit, megjithëse i akuzuari mund të heq dorë nga leximi i akuzave kundër tij.²⁴⁸

e) Deklarimi i të akuzuarit lidhur me aktakuzën

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe të akuzuarit i jep mundësinë të pranojë ose të mos e pranoj fajësinë. Nëse i akuzuari nuk e kupton akuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga prokurori që ta shpjegojë atë në mënyrë që i akuzuari të mund ta kuptojë pa vështirësi. Kur i akuzuari nuk dëshiron të bëjë deklaratë lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se nuk e pranon fajësinë.²⁴⁹

f) Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit

Nëse i akuzuari pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës në shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues vendos nëse janë përmbushur kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPP.

Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të konstatojë nëse:

- I pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- Pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;
- Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri dhe
- Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në shqyrtimin e pranimit të fajësisë së të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit, të mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Kur trupi gjykues vlerëson se kërkesat e lartcekura nuk janë përmbushur,

²⁴⁷ Neni 323 paragrafi 2 i KPP.

²⁴⁸ Neni 324 i KPP.

²⁴⁹ Neni 325 i KPP.

atëherë procedohet sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë. Nëse trupi gjykues vlerëson se kërkesat e lartcekura janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën përfundimtare të palëve. Nëse ka disa të akuzuar dhe një apo më shumë prej tyre pranojnë fajësinë, shqyrtimi gjyqësor vazhdon vetëm për të akuzuar të cilët janë deklaruar të pafajshëm. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn shqiptimin e dënimit për të akuzuarit të cilët pranojnë fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Nëse provat të cilat janë paraqitur në shqyrtimin gjyqësor e inkriminojnë të akuzuarin i cili ka pranuar fajësinë, por nuk janë prova relevante kundër të akuzuarve të tjerë të cilët nuk e kanë pranuar fajësinë, provat e tilla nuk mund të merren parasysh kundër të akuzuarve të tjerë.

Nëse i akuzuari pranon fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues zbaton përshtatshmërisht nenin 233 dhe nenin 247 të KPP.²⁵⁰

5.2.3 Paraqitja e provave

Prezantimi i provave përfshin të gjitha faktet që gjykata i konsideron të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.²⁵¹ Duke u bazuar në nenin 327 paragrafi 1 të KPP, provat në shqyrtim gjyqësor paraqiten sipas radhës së mëposhtme:

- Fjala hyrëse;
- Provat e paraqitura nga prokurori i shtetit;
- Provat e paraqitura nga i dëmtuari, nëse ka të dëmtuar;
- Provat e paraqitura nga mbrojtësi; dhe
- Fjala përfundimtare.

a) Fjala hyrëse

Fjala hyrëse është një institut juridik i ri në KPP. Fjala hyrëse ofron mundësinë për të ndërtuar një strukturë të organizuar për të gjitha provat, të cilat do të prezantohen lidhur me atë rast.²⁵² Një fjalë hyrëse e suksesshme është një hartë me të cilën është i mbështjellë një ditar i cili parashikon se nga do të jetë rruga e gjykatës dhe vë në pah dëshmitë dhe provat të cilat do të prezantohen nga ana e gjykatës. Tri qëllimet e përgjithshme të fjalës hyrëse janë: tërheqja e vëmendjes së gjykatës; të ndihmojë gjykatën të kuptojë ngjarjet që pritet të ndodhin në gjykatë dhe të përkrahë pozicionin e klientit tuaj.²⁵³ Fjala hyrëse prezantohet vetëm nëse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë në

²⁵⁰ Neni 326 i KPP.

²⁵¹ Neni 329 paragrafi 1 i KPP.

²⁵² **Krasniqi, Lavdim** : Fjala hyrëse si shkathtësi e përfaqësimit gjatë gjykimit, Revista “E drejta”, nr.2/2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, 2011, Prishtinë, faqe 119.

²⁵³ Po aty.

fillim të shqyrtimit gjyqësor. Kështu, sipas nenit 328 paragrafi 1 të KPP, nëse i akuzuari nuk e pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues thërret prokurorin e shtetit, të dëmtuarin dhe mbrojtësin për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tyre. Prokurori i shtetit flet i pari, pastaj i dëmtuari dhe mbrojtësi. Gjatë fjalës hyrëse personat mund t'u referohen provave të pranueshme, ligjit në fuqi dhe mund të përdorin tabela, diagrame, transkripte të kasetave të lejuara nga gjykata, përmbledhje dhe krahasime të provave nëse ato bazohen në prova të pranueshme, si dhe zmadhim të ekzemplarëve të tyre për t'i demonstruar ose për t'i paraqitur si ilustrim në gjykatë. Prezantimi i fjalëve hyrëse nga palët mund të kufizohet në kohë nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.²⁵⁴

b) Paraqitja e provave

Pas përfundimit të fjalëve hyrëse, vazhdohet me paraqitjen e provave. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohen rregullat e procedimit të provave që janë të parashikuara në Kapitullin XVI të KPP. Sipas këtyre dispozitave ligjore, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues është përgjegjës për marrjen e provave. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave nëse: marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme; fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar; prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme ose kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën.

Në nenin 329 paragrafi 3 të KPP, është parashikuar se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët dhe i dëmtuari mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe të përsërisin propozimet të cilat gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues më herët i ka refuzuar.

Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari, trupi gjykues ka të drejtë të shqyrtojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.²⁵⁵

c) Marrja në pyetje e dëshmitarit

Radha e marrjes në pyetje të dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor është e rregulluar me nenin 331 paragrafi 1 të KPP. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke filluar me dëshmitarët e propozuar nga prokurori i shtetit, dëshmitarët e propozuar nga i

²⁵⁴ Neni 328 paragrafët 2 dhe 3 të KPP.

²⁵⁵ Neni 329 paragrafi 4 i KPP.

dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave dhe në fund me dëshmitarët e propozuar nga i akuzuari apo mbrojtësi i tij. Në këtë aspekt, po qe se është e mundshme, dëshmitarët thirren duke respektuar radhën e propozuar nga prokurori i shtetit, i dëmtuari, mbrojtësi i viktimave, i akuzuari dhe mbrojtësi. Ndërsa, në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar se prokurori i shtetit, i akuzuari apo i dëmtuari mund të kërkojnë nga gjykata që të dëgjojë dëshmitarët për të kundërshtuar dëshmitë apo provat e paraqitura nga pala e kundërt sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Në parim, dëshmitari i cili ende nuk është marrë në pyetje, nuk mund të jetë i pranishëm në seancë derisa dëshmitari tjetër të jep deklarinimin e tij mbi çështjen e njëjtë.²⁵⁶

d) Fëmija si dëshmitar

Në shqyrtimin gjyqësor nuk lejohet marrja në pyetje e personit nën moshën 16 vjeçare që është viktimë e veprës penale nga Kapitulli XX i KPRK,²⁵⁷ nëse dëshmia e tij veç është marrë sipas nenit 132 ose nenit 149 të KPP dhe nëse trupi gjykues çmon se marrja e serishme në pyetje nuk është e nevojshme. Nëse dëshmitari i tillë merret në pyetje, trupi gjykues mund të vendosë të përjashtojë publikun. Nëse, fëmija është i pranishëm në seancë si dëshmitar ose si i dëmtuar, ai largohet nga gjykatorja posa prania e tij të mos jetë më e nevojshme.²⁵⁸

e) Vërtetimi i identitetit të dëshmitarit

Me rastin e verifikimit të të dhënave personale të dëshmitarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të shikojë nëse është fjala për dëshmitar të privilegjuar, i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet nga dëshmimi,²⁵⁹ apo i cili është i liruar nga detyra për të dëshmuar.²⁶⁰

f) Dhënia e betimit nga ana e dëshmitarit

Para marrjes në pyetje të dëshmitarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, nga dëshmitari mund të kërkojë dhënien e betimit.

Fëmija dhe personi për të cilin është vërtetuar të ketë kryer veprë penale ose me arsye dyshohet se ka kryer veprë penale ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale për të

²⁵⁶ Neni 330 i KPP.

²⁵⁷ Veprat penale kundër integritetit seksual, Kapitulli XX i KPRK.

²⁵⁸ Neni 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

²⁵⁹ Neni 126 i KPP.

²⁶⁰ Neni 127 i KPP.

cilën merret në pyetje, nuk i nënshtrohet betimit. Nëse dëshmitari është betuar në procedure paraprake, në shqyrtim gjyqësor i bëhet me dije se është nën betim.²⁶¹

g) Radha e marrjes në pyetje të dëshmitarit

Pala e cila paraqet provën merr në pyetje dëshmitarin ose paraqet provën e para. Palëve tjera pastaj u jepet mundësia për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit ose kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit. Ndërsa, pala e cila ka paraqitur provën i jepet mundësia në fund që të sqarojë përgjigjet me dëshmitarin ose të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarit. Nëse pala përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, vetëm mbrojtësi kryesor mund të merr në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrijë pyetje të tërthorta dhe të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarëve.²⁶²

Në nenin 333 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se dëshmitari merret në pyetje së pari nga pala e cila e ka propozuar, e cila mund t'i parashtrijë pyetje në pajtim me rregullat për procedimin e provave. Gjithashtu, pala mund t'i paraqesë dëshmitarit provën materiale në pajtim me nenin 336 të KPP. Nëse dëshmitari apo eksperti nuk mund të rikujtojë faktet të cilat i ka paraqitur në dëshmimet e mëparshme, pala e cila ka propozuar dëshmitarin mund t'i paraqesë provën e pranueshme për t'ia rifreskuar kujtesën.²⁶³

Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve, është rregulluar me nenin 334 të KPP. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit mund: t'i parashtrijë pyetje dëshmitarit në pajtim me rregullat për procedimin e provave; të pyesë dëshmitarin të konfirmoj ose të mohoj një fakt dhe t'i parashtrijë dëshmitarit pyetje të cilat shqyrtojnë besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo paragjykimet që dëshmitari mund të ketë. Nëse dëshmitari jep përgjigje që është në kundërshtim me provën e pranueshme, pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje pastaj mund t'ia paraqet ose t'ia lexojë dëshmitarit provën që është në kundërshtim. Pala e cila zbaton marrjen e tërthortë në pyetje ose gjykata mund të kërkojë nga dëshmitari që të shpjegojë mospërputhjet. Provat materiale të përdorura gjatë marrjes së tërthortë në pyetje duhet të identifikohen qartë për gjykatën dhe përdorimi i provës së tillë shënohet në procesverbal. Pas marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarit, pala e cila ka propozuar dëshmitarin ka mundësinë që t'i parashtrijë pyetje të cilat sqarojnë dëshminë e paqartë, shpjegojnë mospërputhjet në dëshmi, dyshimet lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo çfarëdo paragjykimi që dëshmitari mund të ketë.²⁶⁴

²⁶¹ Neni 340 paragrafi 1 i KPP.

²⁶² Neni 332 i KPP.

²⁶³ Neni 333 paragrafi 4 i KPP.

²⁶⁴ Neni 335 i KPP.

Nëse dëshmia e dëshmitarit është marrë gjatë mundësisë hetuese të veçantë, sipas nenit 149 të KPP, atëherë pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit.

Gjithashtu, pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit nëse dëshmia e tillë është marrë gjatë seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake nga neni 132 i KPP, dëshmitari nuk është në dispozicion për të dëshmuar dhe është paraqitur mbështetje e pohimit në pajtim me nenin 263 të KPP.²⁶⁵

h) Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë

Përveç rasteve të parapara me KPP, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:

- kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;
- kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor, ose
- kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.²⁶⁶

i) Deklarimi i ekspertit

Eksperti ia komunikon gjykatës konstatimin dhe mendimin e tij nëpërmjet raportit të përpiluar sipas nenit 138 të KPP, i cili raport futet në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor. Eksperti përshkruan konstatimet dhe shpjegon analizat e tij dhe i njëjti mund të përdorë provat materiale në mbështetje të dëshmisë së tij.

Pala e cila nuk ka kërkuar ekspertizën mund të bëjë marrjen e tërthortë në pyetje të ekspertit lidhur me raportin, analizat, arsimimin, përvojën, ose bazën e ekspertizës së tij.²⁶⁷

²⁶⁵ Neni 337 paragrafi 2 i KPP.

²⁶⁶ Neni 338 paragrafi 1 i KPP.

²⁶⁷ Neni 341 i KPP.

Ekspertët e marr në pyetje mbeten në gjykatore, përpos nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pas marrjes në pyetje të palëve, i lejon të shkojnë ose përkohësisht të largohen nga gjykatëria.

j) Marrja në pyetje e dëshmitarit, këqyrja ose rikonstruksioni jashtë shqyrtimit gjyqësor

Nëse është e nevojshme të zbatohet këqyrja ose rikonstruksioni jashtë shqyrtimit gjyqësor, këtë e bën gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtarë i trupit gjykues. Palët dhe i dëmtuari gjithmonë njoftohen kur dhe në cilin vend do të merret në pyetje dëshmitari apo do të zbatohet këqyrja ose rikonstruksioni dhe njoftohen se kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këto veprime.²⁶⁸

k) Leximi i procesverbaleve ose riprodhimi i regjistrimeve

Procesverbalet për këqyrjen e vendit jashtë shqyrtimit gjyqësor, për kontroll të lokaleve dhe të personit, marrjen e sendeve, dokumenteve, librave, dosjeve dhe shkresave të tjera si dhe incizime teknike me vlerë provuese lexohen ose riprodhohen në shqyrtim gjyqësor për vërtetimin e përmbajtjes së tyre. Trupi gjykues gëzon të drejtë diskrecioni të lejojë prezantim të përmbledhur gojor të këtyre të dhënave, si dhe riprodhim të regjistrimit audio ose video të rrjedhës së këtyre veprimeve hetimore. Dokumentet që kanë rëndësinë e provës, sipas mundësisë, dorëzohen në formë origjinale. Ndërsa, sendet që gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të shërbejnë për sqarimin e çështjes, mund t'i tregohen të akuzuarit, e në rast nevojë, edhe dëshmitarëve dhe ekspertëve.²⁶⁹

l) Marrja në pyetje e të akuzuarit

Sipas nenit 345 paragrafi 1 të KPP, pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve e ekspertëve dhe pas prezantimit të provave materiale vazhdohet me marrjen në pyetje të akuzuarit i cili nuk ka pranuar fajësinë. Dispozitat e zbatueshme gjatë marrjes në pyetje të pandehurit në procedurë paraprake zbatohen përshtatshëmrisht edhe gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor. Kurse, të bashkakuzuarit të cilët ende nuk janë marrë në pyetje nuk do të jenë të pranishëm gjatë pyetjes së të akuzuarit.

Siç është theksuar edhe më parë, i akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë, ndërsa nëse ai zgjedh që të deklarojë, marrja e tij në pyetje zbatohet duke u bazuar në rregullat e mëposhtme. Kështu, mbrojtësi kryesor merr në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejt të

²⁶⁸ Neni 343 paragrafi 1 i KPP.

²⁶⁹ Neni 344 i KPP.

pandehurin, në pajtim me nenin 333 të KPP, kurse, prokurori i shtetit, i bashkëpandehuri dhe i dëmtuari, e marrin në pyetje në mënyrë të tërthortë të pandehurin në pajtim me nenin 334 të KPP. Ndërsa, mbrojtësi mund që përsëri ta rimerr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 335 të KPP, në mënyrë që ti sqarojnë paqartësitë, shpjegojnë mospërputhjet në deklaratë, dyshimet lidhur me besueshmërinë e deklaratës së tij, etj.

Në fund, pasi gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet se palët nuk kanë pyetje të tjera, ai mund të vazhdojë t'i shtrojë pyetje të akuzuarit nëse në deklarinim ose në përgjigjet e tij ka zbrazësi, paqartësi apo kundërtënie. Pas kësaj, anëtarët e trupit gjykues mund t'i bëjnë pyetje të drejtpërdrejta të akuzuarit.

Pas përfundimit të marrjes në pyetje, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e pyet të akuzuarin nëse ka diçka për të shtuar për mbrojtjen e tij. Kur i akuzuari shtjellon më tej mbrojtjen e tij, mund të pyetet përsëri.²⁷⁰

m) Marrja në pyetje e të bashkakuzuarit

Në nenin 347 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se pas përfundimit të marrjes në pyetje të akuzuarit të parë, secili prej të akuzuarve të tjerë, nëse ka, merren në pyetje me radhë në pajtim me dispozitat e lartcekura, ndërsa në anën tjetër çdo i akuzuar ka të drejtë t'u bëjë pyetje të bashkakuzuarve të tjerë të pyetur më parë. Kur deklarinimet e të bashkakuzuarve për rrethana të njëjta ndryshojnë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të bëjë ballafaqimin e të bashkakuzuarve.

Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i pyet palët dhe të dëmtuarin nëse kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave. Nëse askush nuk ka propozim për plotësim të procedurës së provave, ose propozimi refuzohet dhe gjykata çmon se çështja është sqaruar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shpall të përfunduar procedurën e provave.²⁷¹

n) Të dhënat penale të akuzuarit

Të dhënat penale nga evidenca e të dënuarve, si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare.²⁷²

²⁷⁰ Neni 346 i KPP.

²⁷¹ Neni 348 i KPP.

²⁷² Neni 349 i KPP.

o) Fjala përfundimtare

Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues u jep fjalën palëve, të dëmtuarit dhe mbrojtësit për t'i përmbledhur argumentet e tyre. Së pari, fjalën e merr prokurori i shtetit, pastaj i dëmtuari, mbrojtësi dhe në fund i akuzuari.

Gjatë fjalës përfundimtare, personat mund t'u referohen provave të pranueshme, si dhe procedurës, ligjit në fuqi, karakterit dhe sjelljes së dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore; ata mund të përdorin tabela, diagrame, përshkrime incizimesh të lejuara nga gjykata, përmbledhje dhe krahasime të provave nëse ato bazohen në prova të pranueshme, si dhe zmadhim të ekzemplarëve të tyre për t'i demonstruar ose për t'i paraqitur si ilustrim në gjykatë.²⁷³

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare paraqet vlerësimin e tij për provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor, shpjegon konkluzionet e tij mbi faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit, paraqet dhe arsyeton propozimin e tij për përgjegjësinë penale të të akuzuarit, për dispozitat e KPRK të cilat duhet zbatuar si dhe për rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Prokurori i shtetit nuk mund të propozojë lartësinë e dënimit, por mund të propozojë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ose ndonjë dënim alternativ nga neni 49 i KPRK.²⁷⁴

Gjatë fjalës përfundimtare dëmtuari ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, mund të shpjegojë kërkesën e tij pasurore juridike dhe potencon provat që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të akuzuarit.²⁷⁵

Në fund siç është cekur edhe më lartë, fjalët përfundimtare, i paraqesin mbrojtësi, kurse më pas i akuzuari.

Mbrojtësi ose i akuzuari në fjalën përfundimtare paraqet personalisht argumente për mbrojtjen tij dhe mund të komentojë pretendimet e prokurorit dhe të dëmtuarit. Pasi mbrojtësi të ketë prezantuar argumentet për mbrojtjen, i akuzuari ka të drejtë të deklarohej personalisht nëse pajtohet me mbrojtjen e prezantuar nga mbrojtësi i tij dhe mbrojtjen e tillë ta plotësojë.

Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari kanë të drejtë të përgjigjen në mbrojtje, kurse mbrojtësi apo i akuzuari kanë të drejtë që këto përgjigje t'i komentojnë, mirëpo duhet theksuar se fjalën e fundit gjithmonë e merr i akuzuari.²⁷⁶

²⁷³ Neni 352 i KPP.

²⁷⁴ Neni 353 paragrafi 1 i KPP.

²⁷⁵ Neni 354 i KPP.

²⁷⁶ Neni 355 i KPP.

Nëse pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues nuk çmon se duhet marrë prova të tjera, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shpall shqyrtimin gjyqësor të përfunduar.

Kurse, pas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues tërhiqet për këshillim dhe votim për marrjen e aktgjykimit.²⁷⁷

²⁷⁷ Neni 356 i KPP.

KAPITULLI VI

AKTGJYKIMI

KAPITULLI VI

6.AKTGJYKIMI.....	151
6.1. Çka është aktgjykimi?.....	151
6.2. Cilat janë aktet akuzuese?.....	151
6.3. Marrja e aktgjykimit.....	152
a) Kush merr pjesë në seancën e këshillimit dhe votimit?.....	152
b) Si veprohet nëse njëri nga anëtarët e trupit gjykues nuk pajtohet me mendimin e shumicës?.....	153
c) Kush ka të drejtë ta hap procesverbalin e këshillimit dhe votimit?.....	153
d) Si veprohet në rastet kur vendos gjyqtari i vetëm gjykues?.....	153
e) Si bëhet këshillimi dhe votimit për marrjen e aktgjykimit?.....	154
f) A është votimi i detyrueshëm?.....	154
g) Në cilat raste një anëtar i trupit gjykues mund të lirohet nga votimi?.....	155
h) Si përcaktohet radha e çështjeve gjatë votimit?.....	155
i) Si përcaktohet radha e votimit për çështjen kryesore?.....	155
6.4. Identiteti subjektiv dhe objektiv në mes të aktgjykimit dhe aktakuzës.....	157
a) Çka është identiteti subjektiv?	157
b) Çka është identiteti objektiv?	157
6.5. Në cilat prova mund të bazohet aktgjykimi?	159
a) Cilat janë provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor në kuptim të nenit 361 paragrafi1 të KPP, në të cilat mund të bazohet aktgjykimi?	160
b) Si bëhet vlerësimi i provave?	162
6.6. Llojet e aktgjykimit.....	162
6.6.1. Aktgjykimi refuzues	163
6.6.1.1 Aktgjykimi refuzues për shkak të tërheqjes së prokurorit nga akuza	163
a) Kur konsiderohet së prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza?.....	163
b) Si të veprohet në rastet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga akuza vetëm për një pjesë të saj?.....	164
6.6.1.2 Aktgjykimi refuzues në rast se i akuzuari është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë (res judicata)	164
a) Kur mund të konsiderohet së aktgjykimi është i formës së prerë?	165
6.6.1.3 Refuzimi i aktakuzës për shkak së procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë gjykatës	165
6.6.1.4. Aktgjykimi refuzues në rastet kur ka kaluar afati i parashkrimit	166
6.6.1.5 Aktgjykimi refuzues për shkak të amnistisë ose faljes	167
6.6.1.6 Aktgjykimi refuzues kur ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale	168
a) Cilat janë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen dhe paraqesin bazë për marrjen e aktgjykimit refuzues?	168
6.6.1. Aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza	168
a) Aktgjykimi lirues për shkak së vepra me të cilën është akuzuar i akuzuari nuk paraqet vepër penale	168
b) Aktgjykimi lirues për shkak të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë penale	170
c) Aktgjykimi lirues për shkak të mungesës së provave	170
d) Çka është e përbashkët për të gjitha aktgjykimet liruese?	171

6.6.3 Aktgjykimi fajësues (dënues)	172
a) Çka duhet të përmbaj aktgjykimi fajësues (dënues)?	172
1. Përshkrimin faktik të veprës penale	172
2. Emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit	172
3. Dënimin i shqiptuar	173
6.6.3.1 Vendimi (urdhri) për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm ose për konfiskimin e dobisë pasurore (neni 365 paragrafi 1 pika 1.4 e KPP).	174
a) Vendimi (urdhri) për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm	174
b) Vendimi (urdhri) për konfiskimin e dobisë pasurore (neni 365 paragrafi 1 pika 1.5 e KPP)	175
c) Vendimi për llogaritjen e paraburgimit ose dënimin të mëparshëm në lartësinë e dënimin (neni 365 paragrafi 1 pika 1.5 e KPP)	176
6.6.3.2 Vendimin për shpenzimet e procedurës, kërkesën pasurore juridike dhe shpalljen e aktgjykimit të formës së prerë në mjetet e informimit	176
a) Vendimi për shpenzimet e procedurës	176
b) Vendimi për kërkesën pasurore juridike.	177
c) Vendimi për publikimin e aktgjykimit të formës së prerë në mjetet e informimit publik.	177
6.7 Shpallja e aktgjykimit (neni 366 i KPP)	178
a) Kur shpallet aktgjykimi?	178
b) Kush e shpallë aktgjykimin?	178
c) Si shpallet aktgjykim?	179
d) Çfarë njoftimesh jepen me rastin e shpalljes së aktgjykimit?	179
6.8 Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit (neni 367 i KPP)	180
6.9 Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit (neni 369 i KPP)	180
a) Koha e përpilimit të aktgjykimit	180
b) A mund të zgjatet afati për përpilimin e aktgjykimit të shkruar?	181
c) Kush e nënshkruan dhe e përpilon aktgjykimin?	181
d) Dorëzimi i aktgjykimi - kujt i dorëzohet aktgjykimi?	181
e) Si bëhet dorëzimi i aktgjykimit?	182
6.10 Forma dhe përmbajtja e aktgjykimit (neni 370 i KPP)	182
a) Hyrja	183
b) Dispozitivi i aktgjykimit	184
c) c) Arsyetimi i aktgjykimit	185
6.11 Përmirësimi i gabimeve të imëta dhe teknike të aktgjykimit (neni 371 i KPP)....	186
a) Cilat gabime mund të përmirësohen?	186
b) Kush e bën përmirësimin e gabimeve?	187
c) Si veprohet në raste kur aktgjykimi i shkruar ka mospërputhje me origjinalin ..	187
d) A është e lejuar ankesa kundër aktvendimit për përmirësimin e aktgjykimit	187
6.12 Ekzekutimi i sanksioneve penale pas shpalljes së aktgjykimit (neni 372 i KPP)....	187
6.13 Urdhërarrestin për ekzekutimin e sanksionit penal	188

6. AKTGJYKIMI

6.1. Çka është aktgjykimi?

Aktgjykimi është njëri nga tri format e mundshme të vendimeve që merren nga gjykata gjatë procedurës penale, krahas aktvendimit dhe urdhrit.²⁷⁸

Vetëm gjykata është e autorizuar për marrjen e aktgjykimit. Aktvendime gjatë procedurës penale mund të marrë edhe prokurori i shtetit, për çështje të caktuara (siç është aktvendimi për fillimin e hetimit, nga neni 104 paragrafi 1 i KPP, etj.),²⁷⁹ ndërsa urdhrin si formë e vendimit, përveç gjykatës dhe prokurorit mund ta marrin edhe organet tjera që marrin pjesë në procedurën penale.²⁸⁰

Me aktgjykim gjykata vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesën penalo-juridike të Prokurorit të shtetit të paraqitur në aktin akuzues-aktakuzë.

6.2. Cilat janë aktet akuzuese?

Pas hyrjes në fuqi të KPP, nga data 1 janar 2013, akt akuzues konsiderohet vetëm aktakuza e ngritur nga prokurori i shtetit, pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron së informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryesin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer atë vepër penale.²⁸¹

Përrjashtimisht nga neni 240 paragrafi 1 të KPP, sipas të cilit si akt akuzues konsiderohet vetëm aktakuza e ngritur nga prokurori i shtetit, sipas nenit 541 dhe 543 të KPP, si akte akuzuese do të konsiderohen edhe:

- Propozimakuza;
- Padia private dhe
- Padia supsiadiare.

Këto akte akuzuese të paraqitura nga prokurori i shtetit, nga i dëmtuari si paditës supsiadiar ose nga paditësi privat të cilat janë paraqitur në përputhje me dispozitat e KPP,

²⁷⁸ Me nenin 470 paragrafi 1 të KPP, janë përcaktuar llojet e vendimeve të cilat merren në procedurën penale dhe aktgjykimi është vendim i gjykatës me të cilin vendoset për çështjen kryesore të paraqitur me aktakuzë, por edhe lidhur me çështjen e paraburgimit, kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit, kërkesën për konfiskimin e dobisë pasurore dhe çështje të tjera që vendosen si çështje aksesore, siç janë çështja e shpenzimeve të procedurës etj.

²⁷⁹ Vetëm gjykata është e autorizuar për marrjen e aktgjykimit, ndërsa aktvendime gjatë procedurës penale, sipas nenit 470 paragrafi 2 të KPP, mund të marrë edhe Prokurori i shtetit, siç është rasti me aktvendimin për fillimin e fazës së hetimit, neni 104 i KPP, pezullimin e hetimit sipas nenit 157, pushimin e hetimit neni 140 dhe 160 i KPP, etj.

²⁸⁰ Ndërsa, gjatë procedurës penale, sipas autorizimeve që dalin nga neni 470 paragrafi 2 të KPP, përveç gjykatës dhe prokurorit të shtetit, urdhra mund të marrë edhe policia dhe organet tjera të shtetit që marrin pjesë në procedurë, siç është urdhri për ndalim të shkurtër nga policia sipas nenit 72 të KPP.

²⁸¹ Neni 240 paragrafi i KPP.

para datës 31 dhjetor 2012, do të konsiderohen se janë paraqitur nga paditësi i autorizuar deri sa gjykata do të vendosë me aktgjykim të formës së prerë lidhur me to.²⁸²

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata në parim vendos me aktgjykim. Në raste të veçanta gjykata, kur zbatohen procedura të veçanta penale ndaj personave me çrregullime mendore që kanë kryer vepra penale²⁸³ ose në raste të të miturve, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor vendos me aktvendim apo në rastet kur vendos për hudhjen e aktakuzës për shkak së:²⁸⁴

- Procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit;
- Ka munguar propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen;
- Ekzistojnë rrethana të cilat e pengojnë ndjekjen.

Aktvendimin për hudhjen e aktakuzës sipas këtyre bazave gjykata mund ta marrë edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata mund të vendos me aktgjykim edhe pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në rast të dhënies së urdhrin ndëshkimor.²⁸⁵

6.3. Marrja e aktgjykimit

Aktgjykimi merret pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve në shqyrtimin gjyqësor, nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson së nuk ka nevojë për marrjen e provave të tjera, atëherë ai e shpallë shqyrtimin gjyqësor të përfunduar dhe tërhiqet për këshillim dhe votim.

Me këtë rast gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton dhe i njofton palët dhe publikun për kohën e shpalljes së aktgjykimit.²⁸⁶ Aktgjykimi merret dhe shpallet në emër të popullit.

a) Kush merr pjesë në seancën e këshillimit dhe votimit?

Marrja e aktgjykimit bëhet në seancën e këshillimit dhe votimit. Seanca e këshillimit dhe votimit është mbyllur për palët dhe publikun. Në këtë seancë marrin pjesë vetëm anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi.²⁸⁷

²⁸² Me nenin 543 paragrafi 1 të KPP, është përcaktuar së padia private dhe padia supsidiare do të trajtohen si akte akuzuese, ndërsa sipas paragrafi 2 procedura penale sipas këtyre akteve akuzuese do të zbatohet në përputhje me KPPK.

²⁸³ Përjashtimisht, nga rastet kur gjykata vendos me aktgjykim pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, në procedura të veçanta të përcaktuara me ligj, gjykata për çështjen kryesore vendos me aktvendim, kur procedura penale zbatohet kundër personave me çrregullime mendore neni 514 paragrafi 3 i KPP, etj.

²⁸⁴ Me aktvendim vendoset edhe në rast të hudhjes se aktakuzës sipas nenit 358 i KPP.

²⁸⁵ Neni 495 paragrafi 1 i KPP.

²⁸⁶ Neni 366 paragrafi 1 i KPP.

²⁸⁷ Neni 473 paragrafi 2 i KPP.

Për seancën e këshillimit dhe votimit mbahet procesverbal i veçantë me shkrim. Në procesverbal shënohen emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të trupit gjykues dhe procesmbajtësit, koha e mbajtjes së seancës, rrjedha e procedurës së këshillimit dhe votimit dhe vendimet që ka marrë trupi gjykues.

b) Si vepohet nëse njëri nga anëtarët e trupit gjykues nuk pajtohet me mendimin e shumicës?

Në rastet kur ndonjë anëtar i trupit gjykues nuk është pajtuar me mendimin e shumicës për çështje të caktuara, atëherë mendimi i tij do të shkruhet në procesverbal, ose mund të paraqitet i ndarë dhe të jetë pjesë e procesverbalit.²⁸⁸

Procesverbali i këshillimit dhe votimit nënshkruhet nga anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi, mbyllet në zarfë të veçantë në të cilin mund të ketë çasje vetëm gjykata më e lartë.

c) Kush ka të drejtë ta hap procesverbalin e këshillimit dhe votimit?

Sipas dispozitës së nenit 320 paragrafi 1.4 të KPP, çasje në procesverbalin e këshillimit dhe votimit ka vetëm gjykata e shkallës së dytë kur vendos lidhur me mjetin juridik.

Pas hapjes së procesverbalit gjykata e shkallës së dytë atë e vendos përsëri në zarfë të mbyllur me shënimin së procesverbali është hapur.

d) Si vepohet në rastet kur vendos gjyqtari i vetëm gjykues?

Në rastet kur vendos gjyqtari individual nuk hartohet procesverbal i veçantë i këshillimit dhe votimit.

Pas marrjes së aktgjykimi nga ana e trupit gjykues apo nga gjyqtari i vetëm gjykues, dispozitivi i aktgjykimi, si dhe vendimi për heqjen ose caktimin e paraburgimit së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë, shënohet i plotë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor paraqet origjinalin e aktgjykimit dhe konstatohet së është shpallur publikisht.²⁸⁹

Aktgjykimi i shkruar që u dorëzohet palëve duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin origjinal.²⁹⁰ Në rast të mospërputhjes së dispozitivit të aktgjykimit të shpallur publikisht që është regjistruar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe dispozitivit të aktgjykimit të shkruar që u dorëzohet palëve, aktgjykimi i regjistruar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor që është shpallë publikisht konsiderohet së është aktgjykimi burimor.

²⁸⁸ Neni 320 paragrafi 1 pika 1.3 e KPP.

²⁸⁹ Neni 319 paragrafi 1 i KPP.

²⁹⁰ Neni 370 paragrafi 1 i KPP.

e) Si bëhet këshillimi dhe votimi për marrjen e aktgjykimit?

Aktgjykimi merret pas këshillimit gojor dhe votimit. Konsiderohet së aktgjykimi është marrë kur për të kanë votuar shumica e anëtarëve të trupit gjykues.²⁹¹

Këshillim do të thotë marrëveshje e anëtarëve të trupit gjykues për mënyrën së si do të vendoset rasti i caktuar. Kjo nënkupton shqyrtimin e çështjeve faktike dhe juridike nga ana e anëtarëve të trupit gjykues.

Votim do të thotë deklarimi i anëtarëve të trupit gjykues për vendimet që merr trupi gjykues lidhur me çështjet faktike dhe juridike.

Votimi është i detyrueshëm. Asnjë anëtar i trupit gjykues nuk mund të abstenoj gjatë votimit.

Për marrjen e vendimit është e nevojshme që shumica e anëtarëve të trupit gjykues të kenë qëndrime identike për çështjen që votohet. Për shembull: dy anëtarë të trupit gjykues mendojnë se i akuzuari është fajtor, ndërsa i treti mendon së nuk është fajtor, atëherë vendimi i gjykatës do të jetë së i akuzuari është fajtor.

Në rastet kur gjatë votimit për ndonjë çështje të caktuar, anëtarët e trupit gjykues kanë mendime të ndryshme dhe nuk mund të sigurohet shumica e votave për vendosje, atëherë çështja ndahet me qëllim të arritjes së shumicës së votova dhe votohet ndaras, deri sa të arrihet shumica e nevojshme.

Nëse edhe në këtë mënyrë nuk arrihet shumica e votave të nevojshme për marrjen e vendimit, atëherë vota e cila është me e pafavorshme për të akuzuarin i bashkohet votës e cila është më pak e pafavorshme për te dhe kështu veprohet deri sa të arrihet të shumica e nevojshme për marrjen e vendimit.²⁹²

Ndarja e çështje me të favorshme dhe më pak të favorshme për të pandehurin bëhet, jo vetëm të marrja e vendimit për dënimin, por edhe me rastin e vendosjes për ekzistimin e veprës penale, për përgjegjësinë penale etj.

Këshillimi dhe votimi bëhen gojarisht dhe haptas brenda seancës.

Kryetari i trupit gjykues e drejton këshillimin dhe votimin dhe kujdeset që çështja të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme, që do të thotë se shqyrtohen të gjitha çështjet faktike dhe juridike nga të cilat varet vendosja e çështjes konkrete.²⁹³

f) A është votimi i detyrueshëm?

Anëtarët e trupit gjykues janë të detyruar të votojnë për secilën çështje që kryetari i trupit gjykues e hedh në votim.²⁹⁴

Ata mund të votojnë sipas bindjes së tyre, por nuk mund të abstenojnë.

²⁹¹ Neni 471 paragrafi 1 i KPP.

²⁹² Neni 471 paragrafi 3 i KPP.

²⁹³ Neni 471 paragrafi 2 i KPP.

²⁹⁴ Neni 471 paragrafi 4 i KPP.

g) Në cilat raste një anëtar i trupit gjykues mund të lirohet nga votimi?

Është i liruar nga votimi për dënimin, vetëm anëtari i trupit gjykues i cili ka votuar për lirimin e të akuzuarit nga akuza dhe ka mbete në pakicë. Në këtë rast konsiderohet së ai është pajtuar me votën më të favorshme për të akuzuarin. P.sh. nëse nga tre anëtar të trupit gjykues njëri ka votuar për lirimin e të akuzuarit, kurse dy të tjerë për shpalljen e tij fajtor, atëherë me rastin e vendimit për dënimin njëri anëtarë voton që dënimi të jetë tri vjet burgim, kurse anëtari tjetër voton që dënimi duhet të jetë dy vjet, konsiderohet së vota e anëtarit të tretë të trupit gjykues, që ka votuar për lirimin e të akuzuarit, është dy vjet burgim edhe pse ky nuk është i detyruar të votoj për dënimin.²⁹⁵

h) Si përcaktohet radha e çështjeve gjatë votimit?

Sipas nenit 472 të KPP është përcaktuar se cila është radha e çështjeve të këshillimit dhe votimit.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore rezulton së gjykata:

- Së pari, duhet të vendos për kompetencën lëndore të saj për vendosjen e çështjes konkrete penale.
- Së dyti, gjykata vlerëson nëse çështja që duhet të gjykohe është zbardhur në masë të mjaftueshme dhe nuk ka nevojë për plotësimin e procedurës provuese, ose se duhet hapur sërish shqyrtimi gjyqësor për plotësimin e procedurës së provave (marrja e ndonjë prove, a vërtetimi i ndonjë fakti). Në rast së trupi gjykues vlerëson së duhet “*plotësuar procedura*” nuk merr aktgjykim, por me aktvendim vendos për hapjen e serishme të shqyrtimit gjyqësor, duke theksuar provat që duhet administruar për vërtetimin e ndonjë fakti konkret.
- Së treti, vendos nëse ka ndonjë çështje paraprake që duhet zgjidhë para marrjes së aktgjykimit.

Pyetja është cilat mund të jenë çështjet paraprake të cilat gjykata duhet t’i vendos para së të vendos për çështjen kryesore.

i) Si përcaktohet radha e votimit për çështjen kryesore?

Me rastin e votimit për marrjen e aktgjykimit apo për çështjen kryesore (*in media res*), sipas paragrafit 2 të nenit 472 të KPP, radha e votimit është përcaktuar në këtë mënyrë:

- Së pari, votohet për faktin së a është kryer vepra penale dhe a është i akuzuari kryes i saj (a janë realizuar të gjitha elementet ligjore të veprës penale).²⁹⁶

²⁹⁵ Po aty.

²⁹⁶ Me nenin 7 të KPRK, janë përcaktuar elementet e veprës penale të cilat domosdoshmërisht duhet të jenë konsumuar në veprimin e të akuzuarit.

- Së dyti, votohet se a është i akuzuari penalisht përgjegjës apo ka ndonjë rrethanë që e përjashton përgjegjësinë e tij penale, siç mund të jetë paaftësia mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, etj.²⁹⁷
- Së treti, votohet për:
 - Dënimin (llojin dhe lartësinë e dënimit);
 - Shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, etj.

Pastaj votohet edhe për çështje të tjera për të cilat duhet të merret vendim nga trupi gjyqësor, siç mund të jenë:

- Vendimi për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me veprë penale ose të sendeve që domosdoshmërisht konfiskohen (armët, narkotikët, paratë e falsifikuara, sendet e kontrabanduara),
- Vendimi për çështjen e paraburgimit,
- Vendimi për shpalljen e aktgjykimi në media, etj.

Në rastet kur i akuzuari ka kryer më shumë së një veprë penale votohet në mënyrë të veçantë për secilën veprë penale dhe përcaktohet dënimi për secilën veprë për të cilën i akuzuari është shpallë fajtor, pastaj shqiptohet një dënim unik për të gjitha veprat, sipas rregullave të përcaktuara me nenin 80 të KPRK.

Për shembull: Nëse një i akuzuar është shpallë fajtor për tri vepra penale të mashtrimit nga neni 261 paragrafi 1 të KPRK, atëherë gjykata për veprën e parë penale do t'ia caktoj dënimin me gjobë në shumë prej 500 euro dhe dënimin me burgim prej 1 (një) viti; për veprën e dytë penale dënimin me gjobë në shumë prej 300 euro dhe dënimin me burgim prej 10 (dhjetë) muajsh, kurse për veprën e tretë penale dënimin me gjobë në shumë prej 700 euro dhe dënimin me burgim prej 1 vit e gjysmë. Pastaj gjykata duke u bazuar në nenin 80 të KPRK do t'ia shqiptoj një dënim unik në atë mënyrë që shumat e dënimit me gjobë do të mbledhen ($500+300+700=1.500$) që do të thotë së dënimi me gjobë do të jetë 1.500 euro, kurse dënimi me burg do të llogaritet në atë mënyrë që dënimi nuk mund të jetë më i vogël së cilido nga dënimet e përcaktuar e as nuk mund ta arrijë shumën e dënimeve të përcaktuara veç e veç. Në rastin konkret kemi tri dënime të përcaktuara për tri vepra penale:

Vepra e parë penale= 1 vit burgim

Vepra e dytë penale= 10 muaj dhe

Vepra e tretë penale= 1 vit e 6 muaj.

Shuma e tri dënimeve=3 vjet e 4 muaj.

Atëherë, pas unifikimit të këtyre tri dënimeve, dënimi i unifikuar nuk do të jetë më i ulët së 1 (një) vit e 6 (gjashtë)muaj, por as nuk mund ta arrijë shumën e këtyre tri dënimeve

²⁹⁷ Me dispozitën e nenit 17 të KPRK është përcaktuar së kur një person mund të jetë penalisht përgjegjës për veprën e kryer penale.

që është 3 (tri) vjet e 4 (katër) muaj, por do të jetë në mes të këtyre dy dënimeve (p.sh. mund të jetë 2 vjet, 2 vjet e 6 muaj, 3 vjet e kështu më radhë), varësisht nga rrethanat për matjen e dënimit.

Për secilën nga këto çështje votohet veç e veç.

Nëse ka më shumë kryes të së njëjtës veprë penale, ose që kanë kryer më shumë vepra penale, veprohet në të njëjtën mënyrë, votohet për secilin në mënyrë të veçantë.

6.4. Identiteti subjektiv dhe objektiv në mes të aktgjykimit dhe aktakuzës

Gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit ka autoritet për të vendosur vetëm lidhur me personin e akuzuar dhe veprën penale që është objekt i aktakuzës së paraqitur në gjykatë e cila më vonë mund të jetë ndryshuar ose plotësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.²⁹⁸

a) Çka është identiteti subjektiv?

Identiteti subjektiv në mes të aktgjykimit dhe aktakuzës nënkupton së aktgjykimi mund të merret vetëm ndaj personit që është akuzuar me aktakuzën e prokurorit të paraqitur para gjykatës.

Prokurori i shtetit nuk ka mundësi që ta ndryshoj aktakuzën e paraqitur kundër personit të caktuar, si rezultat i ndryshimit të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të ngrisë aktakuzë kundër personit tjetër ose ta zgjeroj aktakuzën duke përfshirë persona të tjerë me këtë aktakuzë.

Në një rast të tillë prokurori i shtetit mund ta tërheq aktakuzën kundër personit të akuzuar dhe të paraqes aktakuzë të re kundër personit tjetër.

Aktgjykimi i gjykatës gjithashtu mund t'i referohet vetëm personit të përfshirë me aktakuzën e paraqitur nga prokurori i shtetit, por jo edhe personit që nuk është përfshirë me aktakuzë.

b) Çka është identiteti objektiv?

Identiteti objektiv i aktgjykimit me aktakuzën nënkupton se aktgjykimi mund t'i referohet vetëm veprës penale të përfshirë me aktakuzën e paraqitur fillimisht në gjykatë, aktakuzën e plotësuar ose të ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Është e ditur se, kur prokurori i shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton së provat e administruara tregojnë së gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai

²⁹⁸ Neni 360 i KPP ka përcaktuar së aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës penale të përfshirë me aktakuzën. Ruajtja e identitetit subjektiv dhe objektiv është e domosdoshme edhe për faktin e shmangies së gjykimit të dyfishtë, në rast së personi i njëjtë akuzohet përsëri për të njëjtën ngjarje. Me këtë rast nuk është me rëndësi cilësimi juridik i veprës i dhënë në aktakuzë, pasi gjykata nuk është e lidhur me të, por ajo duhet t'i përmbahet përshkrimit faktik të veprës penale të dhënë në aktakuzë, në të kundërtën mund të kemi tejkallim të aktakuzës ose moszgjdhje të objektit të akuzës që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara amë nenin 384 paragrafi 1 pika 1.7 dhe 1.10 të KPP.

mund ta ndryshoj aktakuzën e paraqitur ose mund të paraqes aktakuzë të re, por kundër të njëjtit të akuzuar.²⁹⁹

Ndryshimi i aktakuzës mund të bëhet gojarisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor ose në formë të shkruar.

Aktakuza mund të ndryshohet edhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjatë procedurës së vlerësimit të ligjshmërisë së aktakuzës konform nenit 252 të KPP.

Pavarësisht nga fakti së prokurori ka mundësi ta ndryshoj aktakuzën si rezultat i ndryshimit të gjendjes faktike, gjykata është e lidhur me veprën penale të paraqitur në aktakuzë fillimisht ose në aktakuzën e plotësuar apo ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor për veprën penale që nuk është përfshirë me aktakuzë, pavarësisht së gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë ka ndryshuar si rezultat i administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, nëse prokurori i shtetit nuk e ka ndryshuar aktakuzën.

Megjithatë identiteti objektiv i aktgjykimit me aktakuzën nuk do të sjellët në pikëpyetje, nëse në aktgjykim ndryshohen rrethanat që e bëjnë më të qartë të elementeve të veprës penale nga aktakuza, apo nëse në aktgjykim ndryshohen rrethanat që nuk janë qenësore për veprën penale e as në rastet kur në aktgjykim bëhet përkrahimi më i plotë dhe më i saktë i veprës penale, ose në rastet kur i akuzuari është akuzuar për vepër penale në vazhdim dhe gjykata vlerëson së është fjala për bashkim të veprave penale, sepse gjykata nuk është e lidhur me cilësimin juridik të veprës penale siç është dhënë në aktakuzë nga ana e prokurorit të shtetit.³⁰⁰

Gjykata nuk është e detyruar t'i përmbahet as marrëveshjes ndërmjet prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes lidhur me ndryshimin e aktakuzës e as me pranimin e fajësisë, përveç kur është fjala për marrëveshje për pranimin e fajësisë të pranuar nga gjykata konform nenit 233 të KPP.³⁰¹

Me qëllim të ruajtjes së identitetit objektiv të aktgjykimit me aktakuzën, gjykata është e obliguar që me aktgjykim ta vendos **në tërësi objektin e aktakuzës, por nuk mund ta tejkaloj atë.**

Në të dy rastet, nëse veprohet ndryshe, do të ketë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 1.7 dhe 1.10 të KPP.

Rasti 1 - Mos vendosja e objektit të akuzës në tërësi

I akuzuari duke e drejtuar veturën e tij me shpejtësi prej 72 km/h në vend të banuar ku shpejtësia e lëvizjes ka qenë e kufizuar në 40 km/h dhe në pamundësi që ta frenoj automjetin e tij, në vendkalimin e këmbësorëve e godit një këmbësor duke i shkaktuar

²⁹⁹ Neni 350 i KPP, ka përcaktuar së në këtë fazë të procedurës, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendimin për ndryshimin e aktakuzës së paraqitur me shkrim, mund ta marrë vetëm prokurori i shtetit në bazë të autorizimeve që ka sipas ligjit. Ai edhe mund të heq dorë nga akuzat, ndërsa gjykata është e obliguar të vendos për aktakuzën e paraqitur me shkrim ose të ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

³⁰⁰ Ndërsa me nenin 360 është përcaktuar detyrimi i gjykatës që ajo të vendos lidhur me atë që përmban aktakuza, pa pasur mundësi që ta ndryshoj atë, pa pasur mundësi që ta ndryshoj atë në varësi të gjendjes së fakteve të vërtetuara. Në rast me provat e administruara gjykata vërteton gjendje tjetër faktike, ajo mund ta liroj të akuzuarin nga akuzat për veprën penale për të cilën është akuzuar.

³⁰¹ Neni 360 paragrafi 3 të KPP.

lëndime të rënda trupore dhe menjëherë largohet nga vendi i ngjarjes, duke mos ia dhënë ndihmën personit të lënduar.

Prokurori ka ngritë aktakuzë kundër tij për dy vepra penale: një vepër penale të rrezikimit të trafikut publik, nga neni 297 paragrafi⁴ lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të KPRK dhe një vepër penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi të trafikut publik, nga neni 301 paragrafi² lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Gjykata me rastin e vendosjes së kësaj çështje të akuzuarin e ka shpallë fajtor vetëm për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 paragrafi⁴ lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të KPK, ndërsa nuk ka vendosur fare për veprën penale të mosdhënies së ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi të trafikut publik, nga neni 301 paragrafi² lidhur me paragrafin 1 të KPK.

Rasti 2 - Tejkalmi i objektit të akuzës

Prokurori i shtetit ka ngritë aktakuzë kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 252 paragrafi¹ të KPK, pasi i akuzuari ka hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit dhe ka marrë stoli ari në vlerë prej 14.000 Euro. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave, gjykata ka vërtetuar së vlera e stolive të arit ka qenë 15.800 Euro, e jo 14.000 Euro, siç është thënë në aktakuzë, por prokurori i shtetit nuk e ka ndryshuar aktakuzën e tij dhe nuk e ka bërë ricilësimin e veprës penale në vjedhje të rendë. Gjykata duke u bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka shpallë të akuzuarin fajtor për vepër penale të vjedhjes së rendë nga neni 253 paragrafi¹ pika 1 të KPK.

Në të dy rastet kemi shkelje të identitetit objektiv të aktgjykimit me akuzë, sepse:

Në rastin e parë gjykata nuk e ka gjykuar në tërësi objektin e aktakuzës, pasi nuk ka vendosur për një vepër penale nga aktakuza, ndërsa në rastin e dytë e ka tejkaluar akuzën, pasi të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale që nuk ka qenë i akuzuar.

6.5. Në cilat prova mund të bazohet aktgjykimi?

Aktgjykimi mund të bazohet vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor.³⁰²

³⁰² Neni 361 paragrafi 1 i KPP. Përjashtim nga ky rregull mund të bëhet vetëm në raste të veçanta të parashikuara me ligj, siç mund të shihet në vijim.

1. Dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët para shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 149 të KPP (mundësia hetuese e veçantë);
2. Dëshmia e dëshmitarëve dhe të ekspertëve të marrë në procedurë paraprake sipas nenit 132 dhe 263 të KPP;
3. Provat e siguruara me masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit në përputhje me nenin 88 dhe 92 të KPP.
4. Deklaratat e dëshmitarëve, mendimet e eksperteve, të bashkëkuzuarve dhe personave të dënuar të cilat, sipas vendimit të trupit gjykues ose të gjyqtarit të vetëm gjykues, mund të lexohen në shqyrtimin gjyqësor, për shkak së ata kanë vdekur, kanë çrregullime mendore, nuk mund të paraqitën në gjykatë, apo kur palët pajtohen për leximin e tyre në shqyrtimin gjyqësor.
5. Deklarimet e dëshmitarëve nën mbrojtje të veçantë që nuk mund të dëgjohen në shqyrtimin gjyqësor siç janë: fëmijët viktime të veprës penale nën moshën 16 vjeçare, dëshmitarët e marrë në pyetje nën masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve.

Duke vepruar në këtë mënyrë gjykata realizon parimin e drejtpërdrejtshmërisë së gjykimit. Provat të cilat nuk janë proceduar drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor, nuk mund të shërbejnë si prova në të cilat bazohet aktgjykimi.

Me ligj janë përcaktuar rastet kur provat e siguruar në faza të më hershme të procedurës nuk do të procedohen drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor, por ato do të prezantohen përmes leximit apo shikimit të tyre në seancën e shqyrtimit gjyqësor në prani të palëve, siç është rasti të mundësia hetuese e veçantë nga neni 149 të KPP, kur dëshmitari apo eksperti i dëgjuar në përputhje me këtë dispozitë ligjore, për shkaqe objektive, nuk ka mundësi që të paraqitet në gjykatë, për tu marrë në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor; këqyrja e vendit të ngjarjes nga neni 150 të KPP dhe raste të tjera të parashikuara me ligj, me kusht që këto prova të jenë siguruar në përputhje me ligjin.

a) Cilat janë provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor në kuptim të nenit 361 paragrafi1 të KPP, në të cilat mund të bazohet aktgjykimi?

Si prova të administruara në shqyrtimin gjyqësor në të cilat mund të bazohet aktgjykimi i shkallës së parë konsiderohen:

- A) Provat të cilat administrohen drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor dhe
- Dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor;
 - Deklarimet e ekspertëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor;
 - Deklarimi i të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor.
- B) Provat të cilat nuk administrohen drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor, por lexohen, shikohen, dëgjohen ose në ndonjë mënyrë tjetër procedohen në shqyrtimin gjyqësor, që gjithashtu konsiderohen si prova, e në të cilat mund të bazohet aktgjykimi janë:
- Neni 149 i KPP ka parashikuar mundësinë e veçantë të marrjes së provave kur prova është e rëndësishme dhe procedura penale zhvillohet për vepra penale nga neni 90 i KPP nëse gjykata vlerëson së ka rrezik të konsiderueshëm së kjo provë nuk mund të merret gjatë shqyrtimit gjyqësor. Këto dëshmi dëgjohen në prani të tre gjyqtarëve (gjyqtari i procedurës paraprake dhe dy anëtarë tjerë të panelit), njëri nga të cilët do të jetë kryetar i trupit gjykues. Me rastin e marrjes së kësaj prove janë të pranishëm prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Provat e siguruar në këtë mënyrë do të konsiderohen së janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata mund ta bazoj aktgjykimin në to.
 - Edhe provat e siguruar në përputhje me nenin 132 dhe 263 të KPP, mund të shërbejnë si bazë për mbështetjen e aktgjykimit, edhe pse ato nuk do të mund të procedohen drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor, nëse janë marrë në përputhje me këto dispozita ligjore.

- Konsiderohen si prova të pranueshme dhe gjykata mund ta bazoj aktgjykimin në to edhe provat e siguruara me masa të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit të siguruara në pajtim me nenin 88 dhe 92 të KPP.
- Edhe ky është një përjashtim kur dëshmitari, eksperti ose i bashkakuzuari për shkaqe objektive nuk mund të merren në pyetje drejtpërsëdrejti në shqyrtimin gjyqësor dhe gjykata me pëlqimin e palëve merr vendim për leximin e deklaratave të tyre të dhëna në faza të mëhershme të procedurës, pavarësisht së nuk janë proceduar drejtpërsëdrejti në shqyrtim gjyqësor mund të shërbejnë si bazë për mbështetjen e aktgjykimit të gjykatës sipas nenit 361 paragrafi 1 i KPP.
- Nuk do të procedohen si dëshmitarë as fëmijët nën moshën 16 vjeç, nëse janë viktimë e veprës penale dhe dëshmitë e tyre do të dhëna në faza të mëhershme të procedurës do të shërbejnë si prova për ta mbështetur aktgjykimin nëse janë marrë në përputhje me nenin 132 dhe 149 të KPP. E njëjta gjë vlen edhe për dëshmitarët e mbrojtur nga Kapitulli i XIII i KPP.
- Deklarimi i dëshmitari apo ekspertit kur ai nuk mund të vijë në gjykatë për shkaqe të arsyeshme dhe merren në pyetje nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit ose gjyqtari-anëtar i trupit gjykues ose kur marrja në pyetje bëhet nga gjyqtari i procedurës paraprake, sipas urdhrit të gjykatës;
- Kur është e nevojshme që prova të merret nga këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes dhe
- Leximi i procesverbaleve ose riprodhimi i regjistrimeve.
- Edhe dëshmitari dhe eksperti që për shkak të sëmundjes ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të vijë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, me urdhër të gjykatës do të merren në pyetje jashtë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose gjyqtarit të procedurës paraprake. Dëshmia e tillë do të shërbejnë si bazë për marrjen e aktgjykimit nëse është marrë në pajtim me nenin 343 të KPP.
- Në rastet kur është e nevojshme që prova të merret me këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes, atëherë provat e siguruar në këtë mënyrë, nëse janë marrë në pajtim me dispozitat e procedurës për këqyrjen dhe rikonstruksionin nga neni 150 i KPP. Provat e siguruar në këtë mënyrë mund të shërbejnë si bazë për mbështetjen e aktgjykimit.
- Mund të shërbejnë si provë për ta mbështetur aktgjykimin e gjykatës edhe procesverbalet si dhe incizimet tjera të siguruara gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes jashtë shqyrtimit gjyqësor, kontrollit të objekteve, marrjes së sendit, dokumenteve, librave, etj, të cilat kanë vlerë provuese dhe të njëjtat mund të shërbejnë si prove në kuptim të nenit 361 paragrafi 1 të KPP.

Të gjitha këto prova konsiderohet së janë proceduar në shqyrtimin gjyqësor, nëse janë marrë në përputhje me ligjin, në të kundërtën aktgjykimi nuk mund të bazohet në to.

Këto prova zakonisht merren në faza më të hershme të procedurës, por, nëse gjykata duke vepruar ex officio ose sipas propozimit të palëve, konsideron së ato mund të shërbejnë

për vërtetimin e fakteve të rëndësishme për vendosjen e çështjes konkrete penale, atëherë të njëjtat do t'i procedoj në shqyrtimin gjyqësor në prani të palëve, në mënyrë që palët të kenë mundësi të deklarohen lidhur me to.

b) Si bëhet vlerësimi i provave?

Se si do të vlerësohen provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, nuk ka ndonjë rregull të shkruar. Gjykata është plotësisht e lirë që t'i vlerësoj ato sipas bindjes së saj të lirë duke vepruar me ndërgjegje dhe profesionalizëm.

6.6. Llojet e aktgjykimit

Aktgjykimi është vendim i gjykatës me të cilin vendoset lidhur me çështjen që ka qenë objekt i akuzës dhe merret pasi që të përfundoj shqyrtimi gjyqësor. Kodi i procedurës penale ka paraparë tri lloje të aktgjykimeve:

LLOJET E AKTGJYKIMEVE (neni 362 i KPP)				
	Aktgjykimi refuzues	Aktgjykimi lirues	Aktgjykimi fajësues	
Ne cilat raste merren këto Aktgjykime	1	Prokurori është tërhequr nga akuzat nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.	Vepra me të cilën është akuzuar nuk është veprë penale	Nëse vërtetohet se është kryer vepra penale dhe i akuzuari është fajtor për kryerjen e saj
	2	I akuzuari është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë për atë veprë penale.	Ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale.	
	3	Procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë.	Nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale.	
	4	Ka kaluar afati i parashkrimit.		
	5	Vepra penale është përfshirë me amnisti ose falje.		
	6	Ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale.		

- Aktgjykimi me të cilin refuzohet aktakuza (aktgjykimi refuzues)
- Aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuzat (aktgjykimi lirues) dhe
- Aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor (aktgjykimi fajësues ose dënues)

6.6.1. Aktgjykimi refuzues

Me aktgjykim refuzues gjykata nuk vendos në mënyrë meritore.

Aktgjykimi refuzues është aktgjykim formal-procedural, me të cilin nuk vendoset lidhur me çështjen kryesore. Çështja kryesore mbetet e pazgjidhur, ndërsa gjykata vetëm konstaton së ka pengesa procedurale për vendosjen e çështjes kryesore.

Për ekzistimin e këtyre pengesave gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, por edhe me iniciativën e palëve.

Me nenin 363 të KPP janë përcaktuar në mënyrë taksative rastet kur gjykata nuk mund të vendosë meritorisht, por është e detyruar që të marrë aktgjykim refuzues.

Aktgjykimi refuzues merret gjithmonë në rast se:

- Prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.
- I akuzuari për të njëjtën vepër penale është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Procedura kundër të akuzuarit është pushuar me aktvendim të formës së prerë;
- Ka kaluar afati i parashkrimit,
- Vepra është përfshirë me amnisti ose falje ose
- Kur ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale.

6.6.1.1 Aktgjykimi refuzues për shkak të tërheqjes së prokurorit nga akuza

a) Kur konsiderohet së prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza?

Konsiderohet së prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza, nëse ai nga momenti i leximit të aktakuzës e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor e deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor³⁰³ deklaron së heq dorë nga akuza ose nga ndonjë pjesë e saj.

Prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga akuza edhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Tërheqja nga akuza mund të bëhet në formë të shkruar, kur prokurori i shtetit me shkrim e njofton gjykatën së është tërhequr nga aktakuza ose gojarisht, kur gjatë seancës e deklaron tërheqjen dhe ky deklaram i tij shënohet në procesverbal.

Në raste të tilla, gjykata vendos me aktgjykim refuzues, me kusht që tërheqja të jetë bërë nga momenti i fillimit të shqyrtimit deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Është e nevojshme që të mbahet kujdes së nëse prokurori tërhiqet nga akuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor ose gjatë përgatitjeve për shqyrtimin gjyqësor edhe pas caktimit të

³⁰³ Leximi i aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në shqyrtimin gjyqësor ose deklarimi i të akuzuarit nuk ka nevojë për leximin e aktakuzës, siç është parashikuar me nenin 324 paragrafi 1 të KPP, paraqet momentin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Ndërkaq, deklarimi i kryetarit të trupit gjykues për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 357 paragrafi 1 të KPP, paraqet përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Tërheqja e prokurorit të shtetit nga akuza gjatë kësaj faze të procedurës vendoset me aktgjykim refuzues.

datës së shqyrtimit atëherë gjykata nuk merr aktgjykim për refuzimin e aktakuzës sipas nenit 363 të KPP, por merr aktvendim për hüdhen e saj.

Është me rëndësi që të bëhet identifikimi i momentit të tërheqjes së aktakuzës, sepse nëse aktakuza është tërhequr para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, siç është parashikuar me nenin 292 të KPP, atëherë gjykata me aktvendim e hedhë aktakuzën, sikurse në rast të hedhjes së aktakuzës sipas nenit 358 të KPP.

b) Si të vepohet në rastet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga akuza vetëm për një pjesë të saj?

Duke u bazuar në parimin e legalitetit së prokurori i shtetit është i autorizuar që ta ndër marrë ndjekjen penale, në raste të caktuara me ligj, ai ka autorizim që edhe të tërhiqet nga ndjekja penale, për ndonjë vepër penale, apo për ndonjë të akuzuar, nëse më një aktakuzë janë përfshirë më shumë të akuzuar ose më shumë vepra penale. Atëherë shtrohet pyetja: si do të veprohet gjykata në raste të tilla?

Në rastet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga akuza për një të akuzuar, atëherë gjykata merr aktgjykim për refuzimin e akuzës për atë të akuzuar për veprën penale të caktuar, ndërsa për të akuzuarit e tjerë vendos në mënyrë meritor duke marrë aktgjykim liruës ose aktgjykim me të cilin të akuzuarin apo të akuzuarit tjerë i shpallë fajtor.

Në të njëjtën mënyrë vepohet edhe në rastet kur kemi një të akuzuar për më shumë vepra penale. Në raste të tilla gjykata merr aktgjykim të kombinuar me të cilin e refuzon aktakuzën për veprën penale për të cilën prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza, ndërsa për veprat tjera merr aktgjykim meritor duke e shpallë të akuzuarin fajtor, ose duke e liruës nga akuza, për veprat tjera, varësisht nga situata.

6.6.1.2 Aktgjykimi refuzues në rast se i akuzuari është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë (res judicata)

Gjykata do të marr aktgjykim refuzues në çdo rast kur konstatohet së personi i akuzuar më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë për të njëjtën vepër penale.

Në këtë rast, arsye për refuzimin e aktakuzës është parimi i çështjes së gjykuar (res judicata), përkatësisht parimi së askush nuk mund të gjykohej dy herë për të njëjtën çështje, nëse është liruës ose është dënuar me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.³⁰⁴

Për marrjen e aktgjykimit refuzues për shkak se i akuzuari është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë është e nevojshme që të plotësohen dy kushte kumulative:

- që më parë të jetë zhvilluar procedurë penale kundër personit të njëjtë për veprën e njëjtë penale dhe
- që të jetë marrë aktgjykim i formës së prerë lidhur me atë vepër penale.

³⁰⁴ Sipas dispozitës së nenit 4 të KPP është përcaktuar së askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruës ose është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës ose aktakuza është refuzuar me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

Gjykata, para se ta marr aktgjykimin refuzues, për shkak së i akuzuari është gjykuar me aktgjykimi të formës së prerë, duhet të vërtetohet së kundër të akuzuarit të njëjtë, për veprën e njëjtë penale, aktgjykimi është bërë i formës së prerë.

Për ekzistimin e çështjes së gjykuar (res judicata) është e domosdoshme që të vërtetohet identiteti subjektiv i kryesit të veprës penale dhe ai objektiv në mes të veprës penale të përfshirë me aktgjykimin e formës së prerë dhe veprës penale të përfshirë me aktakuzë e cila refuzohet.

a) Kur mund të konsiderohet së aktgjykimi është i formës së prerë?

Aktgjykimi merr formën e prerë kur nuk mund të kundërshtohet me ankesë, ose kur nuk lejohet ankesa kundër tij.³⁰⁵

Ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme nuk është pengesë që aktgjykimi të konsiderohet i formës së prerë.

Pavarësisht nga ekzistimi i aktgjykimit të formës së prerë, gjykata nuk do ta refuzoj aktakuzën nëse është lejuar rishikimi të procedurës së përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, sipas dispozitave të nenit 419-428 të KPP. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për “res judicata”.

6.6.1.3 Refuzimi i aktakuzës për shkak së procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë gjykatës

Mundësia e refuzimit të aktakuzës për shkak të pushimit të procedurës penale apo hudhjes së aktakuzës në bazë të aktvendimit të formës së prerë të gjykatës është rregulluar me të njëjtën dispozitë ligjore (neni 363 paragrafi 1 pika 1.2 të KPP), sikurse edhe në rast të ekzistimit të aktgjykimit të formës së prerë, mirëpo këtu është paraqitur në mënyrë të veçantë për shkak të specifikave që ka pushimi i procedurës.

Së pari, duhet pasur kujdes që vetëm aktvendimi i formës së prerë i gjykatës, pra, jo edhe i prokurorit, mund të shërbej si bazë ligjore për refuzimin e aktakuzës.

Së dyti, aktvendimi për pushimin e procedurës, respektivisht hudhjen e aktakuzës duhet të jetë marrë për arsye të cilat nuk janë procedurale ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë përkohësisht ndjekjen,³⁰⁶ sepse në raste të tilla prokurori i shtetit ka mundësi ta ndër marrë ndjekjen posa të evitohen këto pengesa.

Se treti, aktvendimi për pushimin e procedurës penale ose për hudhjen e aktakuzës do të shërben si bazë ligjore për refuzimin e aktakuzës, nëse arsyet për një vendim të tillë janë

³⁰⁵Me nenin 485 paragrafi 1 të KPP, është përcaktuar së kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë. Ky fakt është më rëndësor kur gjykata vendosë për refuzimin e aktakuzës për shkak së çështja është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, sepse, nëse aktgjykimi nuk ka marrë formë të prerë nuk mund të bëhet fjalë për “res judicata”.

³⁰⁶ Arsye procedurale për pushimin e procedurës siç mund të jetë mungesa e kërkesës së prokurorit të autorizuar, mungesa e propozimit të dëmtuarit, ose mungesa e lejes së organit kompetent apo tërheqja e lejes për ndjekje nga organi kompetent, nuk paraqesin bazë për refuzimin e aktakuzës për shkak të res judicata, sepse në këto raste prokurori i shtetit mund ta fillojë ndjekjen kundër personit të njëjtë për veprën e njëjtë penale sapo të evitohen këto pengesa procedurale.

të natyrës materiale dhe të karakterit të përhershëm, si p.sh. mungesa e provave të mjaftueshme që vërtetojnë se vepra përbën veprë penale, se i akuzuari nuk është kryes i veprës penale apo nuk është përgjegjës për kryerjen e veprës penale, pra duhet të ekzistojnë arsyet nga neni 253 të KPP.

6.6.1.4 Aktgjykimi refuzues në rastet kur ka kaluar afati i parashkrimit

Gjykata çdo herë do të marr aktgjykim refuzues edhe në rastet kur ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Afatet e parashkrimit, fillimi dhe ndërprerja e tij, si dhe llogaritja e afateve të parashkrimit janë përcaktuar me dispozitat e nenit 106 dhe 107 të KPRK. Gjykatat në punën e tyre shpeshherë kanë vështirësi ta përcaktojnë datën e fillimit të parashkrimit.

Parimisht, afati i parashkrimit fillon të ecë nga dita e kryerjes së veprës penale. Ndërsa si ditë e kryerjes së veprës penale konsiderohet dita kur kryesi i veprës penale e ka ndërmarrë veprimin e fundit inkriminues të veprës konkrete penale.

Përgjashtimisht nga kjo, të veprat penale të kryera kundër personit nën moshën 18 vjet, afati i parashkrimit nuk fillon të ecë nga dita e kryerjes së veprës penale, e as nga dita e shkaktimit të pasojës, nëse pasoja ka ardhur më vonë, por nga dita kur ky person ta mbush moshën 18 vjet.³⁰⁷

Nëse ndonjë pasojë, që përbën element të veprës penale, shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga koha e shfaqjes së pasojës. P.sh. të vepra penale e rrezikimit të trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafi 1 të KPRK, nëse vdekja e personit të aksidentuar ka pasuar pas gjashtë muajsh, si pasojë e aksidentit të shkaktuar, atëherë afati i parashkrimit do të filloj nga dita e vdekjes së tij e jo nga dita e kryerjes së veprës penale, që është dita e shkaktimit të aksidentit.

Të veprat penale në vazhdim afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita e kryerjes së veprimit të fundit i cili hyn në përbërje të veprës penale të vazhduar.³⁰⁸

Nëse për ndonjë veprë penale që përbën veprën e vazhduar penale ka ardhur deri të parashkrimit, atëherë gjykata me aktgjykim do të vendos për refuzimin e akuzës për veprën penale për të cilën ka arritur parashkrimit, ndërsa për pjesën tjetër do të vendos në mënyrë meritore.

Të veprat penale të përhershme, afati i parashkrimit llogaritet nga dita e pushimit të veprimit të kundërligjshëm. Në praktikë janë të shpeshta veprat penale të uzurpimit të

³⁰⁷ Për dallim nga rregullat e përcaktuara me nenin 106 dhe 107 paragrafi 1 të KPRK, për fillimin e afatit të parashkrimit, me nenin 107 paragrafi 2 të KPRK është përcaktuar se në rast se vepra penale është kryer ndaj personit nën moshën 18 vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur i mituri e mbush moshën 18 vjet.

³⁰⁸ Qëndrim i shprehur në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Jugosllavisë KZ.nr.19/64 i pranuar edhe në praktikën e gjykatave të tjera.

paligjshëm të pronës së paluajjtshme, të parashikuar me nenin 332 të KPRK dhe në këto raste afati i parashkrimit nuk fillon nga dita e ndërmarrjes së veprimit të uzurpimit të pronës, por nga dita e pushimit të veprimit të kundërligjshëm, pra, nga dita e lirimit të pronës.

Gjykatat shpesh kanë vështirësi për llogaritjen e afatit të parashkrimit në rastet kur ka pas pushim ose ndërprerje të afatit të parashkrimit, prandaj duhet pasur kujdes në identifikimin e veprimeve të cilat konsiderohen si veprime të cilat e ndërpresin afatin e parashkrimit.

Parashkrimin e ndërpresin të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga organi i autorizuar i shtetit në drejtim të ndjekjes penale të kryesit të caktuar për veprën e caktuar penale.

Si veprime procedural konsiderohen:

- thirrja për të pandehurin;
- marrja në pyetje e të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit;
- shikimi i vendit të ngjarjes;
- marrja e vendimit për paraburgimin;
- ngritja e aktakuzës, si dhe
- të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë shqyrtimit gjyqësor (ftesat, urdhëresat, njoftimet, aktvendimet etj.)

Gjykata gjithmonë kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse ka ardhur deri të parashkrimi i ndjekjes penale, pavarësisht se a ka iniciativë të palëve apo jo.

6.6.1.5 Aktgjykimi refuzues për shkak të amnistisë ose faljes

Gjykata me aktgjykim do ta refuzoj aktakuzën në rast së me aktakuzë është përfshirë ndonjë nga veprat penale për të cilën sipas nenit 2 paragrafi 2 të Ligjit për Amnistinë është parashikuar së kryesit e tyre lirohen nga ndjekja penale. Veprat penale të cilat janë përfshirë me Ligjin për Amnistinë janë të listuar në nenin 3 të këtij Ligji.

Gjykata është e detyruar që të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse ndonjë vepër penale është përfshirë me Ligjin për Amnistinë edhe nëse nuk ka kërkesë të palëve në këtë drejtim.

Me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin refuzohet aktakuza për shkak së vepra penale është përfshirë me amnisti, gjykata vërteton vetëm:

- nëse vepra penale në trajtën si është paraqitur në përshkrimin faktik në dispozitivin e aktakuzës është përfshirë me Ligjin për Amnistinë dhe
- nëse vepra penale është që është përfshirë me Ligjin për Amnistinë është kryer deri me datën 20 qershor të vitit 2013.

Kur me aktakuzë janë përfshirë më shumë vepra penale disa prej të cilave nuk janë përfshirë me Ligjin për amnistinë, atëherë gjykata merr aktgjykim refuzues vetëm përkitazi me veprën penale të përfshirë me amnezi, ndërsa për të tjerat vendos në mënyrë meritore.

6.6.1.6 Aktgjykimi refuzues kur ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale

Me nenin 363 paragrafi 1.3 të KPP është parashikuar mundësia e refuzimit të aktakuzës me aktgjykim kur ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen.

a) Cilat janë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen dhe paraqesin bazë për marrjen e aktgjykimit refuzues?

- Vdekja e të pandehurit;³⁰⁹
- Gjykimi i personave të ekstraduar për veprat penale që nuk janë përfshirë me aktin e ekstradimit, nëse nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 39 të Ligjit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.³¹⁰
- Imuniteti materialo-juridik.

6.6.1 Aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza

Me aktgjykim lirues gjykata vendos për lirimin e të akzuarit nga akuza për të gjitha ose për disa nga veprat penale të përfshira me aktakuzë.

Sipas nenit 364 të KPP gjykata do të marrë aktgjykim lirues në rast se:

- Vepra penale me të cilën i akuzuari është akuzuar nuk përbën vepër penale;
- Ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të kryesit ose
- Nuk është provuar së i akuzuari ka kryer vepër penale për të cilën akuzohet.

Gjykata nuk mund të marr aktgjykim lirues për ndonjë arsye tjetër, nëse nuk është plotësuar ndonjëri nga kushtet e parashikuara me këtë dispozitë ligjore.

a) Aktgjykimi lirues për shkak së vepra me të cilën është akuzuar i akuzuari nuk paraqet vepër penale

Gjykata do të marr aktgjykim lirues, nëse vepra e përshkruar në aktakuzë nuk përmban të gjitha elementet e përgjithshme të veprës penale³¹¹ ose tiparet e veçanta të përcaktuara me përshkrimin ligjor të veprës konkrete penale.

³⁰⁹ Me nenin 160 të KPP është parashikuar detyrimi për pushimin e procedurës penale në rast të vdekjes së të pandehurit. Në rast së i pandehuri vdes gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata merr aktgjykim refuzues.

³¹⁰ Me nenin 39 të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, nr.04/L-213, datë 31.07.2013 është ndaluar gjykimi i personave të ekstraduar, nëse me aktakuzë është përfshirë ndonjë vepër penale që nuk është përfshirë me aktin e ekstradimit.

Elementet që duhet të përmbaj përshkrimi i veprës penale janë:

- Kundërligjshmëria;
- Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale;
- Vepra penale duhet të jetë e parashikuar me ligj;
- Ndëshkueshmeria;
- Veprimi i kryerjes së veprës penale;
- Pasoja,
- Lidhja kauzale në mes të veprimit të të akuzuarit dhe pasojës së shkaktuar.

Gjithashtu gjykata do të marrë aktgjykim lirues edhe në rastet kur përshkrimi i veprës penale të dhënë në aktakuzë i përmban të gjitha elementet e veprës penale të përcaktuara me ligj, mirëpo ekziston baza ligjore për përjashtimin e kundërligjshmërisë siç mund të jenë:

- Mbrojtja e nevojshme;³¹²
- Nevoja ekstreme;³¹³
- Nëse vepra është kryer nën ndikimin e dhunës ose kanosjes;³¹⁴
- Nëse vepra penale është kryer nën shtrëngim;³¹⁵
- Nëse vepra penale është kryer në zbatim të një urdhri nga lartë;³¹⁶
- Nëse vepra penale është e rëndësisë së vogël,³¹⁷ etj.

Si bazë ligjore për përjashtimin e kundërligjshmërisë së veprës dhe për marrjen e aktgjykimit lirues mbi këtë bazë ligjore, konsiderohet edhe ndërmarrja e veprimeve të caktuara në bazë të autorizimeve ligjore, siç është:

- Privimi nga liria, me rastin e arrestimit të përkohshëm dhe ndalimit policor, sipas nenit 162 të KPP;
- Cenimi i paprekshmërisë së banesës gjatë kontrollit të ushtruar, sipas nenit 105 të KPRK, etj.

Aktgjykim lirues gjykata do të marrë edhe kur vepra e caktuar për të cilën është ngritur aktakuza, përmban në vete elemente të kundërligjshmërisë nëse ajo paraqet:

- Kundërvajtje;
- Shkelje disiplinore ose
- Raport juridiko-civil.

³¹¹ Me nenin 7 të KPRK, janë përcaktuar elementet e përgjithshme të veprës penale, në mungesë të të cilëve vepra penale e përfshirë me aktakuzë nuk paraqet vepër penale.

³¹² Neni 12 i KPRK.

³¹³ Neni 13 i KPRK.

³¹⁴ Neni 14 i KPRK.

³¹⁵ Neni 15 i KPRK.

³¹⁶ Neni 16 i KPRK.

³¹⁷ Neni 11 i KPRK.

b) Aktgjykimi lirues për shkak të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë penale

Ekzistimi i rrethanave të veçanta të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të kryesit të veprës penale paraqesin bazë ligjore për marrjen e aktgjykimit lirues, sipas nenit 364 paragrafi 1 pika 1.2 të KPP, nëse gjykata e vërteton ekzistimin e tyre.

Rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale janë:

- Kryerja e veprës penale në gjendje të paaftësisë mendore, siç është parashikuar me neni 18 të KPRK;³¹⁸
Nëse personi i akuzuar e ka kryer veprën penale duke qenë në lajthim faktik;³¹⁹
- Nëse vepra penale është kryer në lajthim juridik;³²⁰
- Nëse personi i akuzuar për kryerjen e ndonjërës nga këto vepra penale siç është: moslajmërimi të përgatitjes së veprës penale;³²¹ moslajmërimi i veprës penale;³²² moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal;³²³ dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale³²⁴ dhe dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga Tribunali ndërkombëtar penal³²⁵ është në lidhje familjare me kryesin e ndonjë vepre tjetër penale.

Në të gjitha këto raste gjykata merr aktgjykim lirues pasi që të vërtetoj se:

- ekziston vepra penale;
- se i akuzuari është kryes i saj dhe
- se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

c) Aktgjykimi lirues për shkak të mungesës së provave

Gjykata duke u bazuar ne nenin 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP do të marr aktgjykim lirues edhe kur nuk është provuar së personi i akuzuar e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Përmes kësaj dispozite ligjore bëhet i mundur zbatimi i parimit *in dubio pro reo* që është përcaktuar me nenin 3 të KPP në pjesën e parimeve të përgjithshme të procedurës penale.

³¹⁸ Neni 18 paragrafi 1 i KPRK.

³¹⁹ Neni 25 paragrafi 1 i KPRK.

³²⁰ Neni 26 paragrafi 1 i KPRK.

³²¹ Neni 385 paragrafi 3 i KPRK;

³²² Neni 386 paragrafi 3 i KPRK.

³²³ Neni 387 paragrafi 2 i KPRK.

³²⁴ Neni 388 paragrafi 5 i KPRK.

³²⁵ Neni 389 paragrafi 2 i KPRK.

Aktgjykimi liruës për mungesë të provave do të merret gjithmonë nëse me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor:

- është provuar pafajësia e të akuzuarit;
- nuk është provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm;

Dyshimet e gjykatës lidhur me ekzistimin e fakteve që shkojnë në dëm (*in peius*) të të akuzuarit duhet të interpretohen në favor të të akuzuarit.³²⁶

Këto fakte duhet të vërtetohen në mënyrë të sigurt, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ekzistojnë.

Ndërkaq, faktet që shkojnë në favorin e të akuzuarit (*in favorem*), edhe atëherë kur nuk janë vërtetuar në mënyrë të sigurt, por janë bërë të besueshme, konsiderohet se ekzistojnë.

Para marrjes së aktgjykimit liruës, sipas kësaj bazë ligjore, gjykata është e detyruar që t'i administroj të gjitha provat e rëndësishme për marrjen e një vendimi të tillë, në të kundërtën do të krijohet baza për ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve.³²⁷

Është me rëndësi që të bëhet dallimi në mes të lirimit nga akuza dhe lirimit nga dënimi sipas dispozitave të nenit 77 dhe 78 të KPRK, sepse kur një i akuzuar lirohet nga akuza ai shpallet i pafajshëm, ndërsa kur lirohet nga dënimi ai shpallet fajtor, por nuk i shqiptohet ndonjë sanksion penal.

d) Çka është e përbashkët për të gjitha aktgjykimet liruëse?

Në të gjitha aktgjykimet liruëse duhet të shënohet në mënyrë të qartë se:

- I akuzuari lirohet nga akuza;
- Baza ligjore për lirim nga akuza;
- Përshkrimi i qartë i veprës penale për të cilën i akuzuari lirohet nga akuza;
- Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga paraburgimi, nëse ai gjendet në paraburgim;
- Vendimin se shpenzimet e procedurës bien në barrë të shpenzimeve buxhetore;
- Vendimin për kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, nëse ato mund të kthehen;
- Udhëzimin për palën e dëmtuar lidhur me kërkesën pasurore juridike.

³²⁶ Neni 3 paragrafi 2 i KPP ka përcaktuar parimin *in dubio pro reo*, sipas të cilit, faktet për të cilat ka dyshime se ekzistojnë, duhet të interpretohen në favorin e të akuzuarit.

³²⁷ Vasiljevic, Tihomir; Grubac Momčilo : Komentar Zakon o Krivicnom postupku, Beograd, 2003, faqe 630.

6.6.3 Aktgjykimi fajësues (dënues)

Me aktgjykimin fajësues gjykata e shpallë të akuzuarin fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, nëse pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, si rezultat i administrimit të provave ka vërtetuar së i akuzuari është fajtor për veprën penale për të cilën i akuzuari është akuzuar me aktakuzë.

a) Çka duhet të përmbaj aktgjykimi fajësues (dënues)?

Aktgjykimi fajësues (dënues) duhet të përmbajë:

1. Përshkrimin faktik të veprës penale

Në dispozitivin e aktgjykimit me rastin e përshkrimit faktik të veprës penale, përfshihen të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale dhe të cilat vërtetojnë së i akuzuari e ka kryer veprën konkrete penale, si dhe rrethanat tjera nga të cilat varet zbatimi i drejtë i ligjit, por edhe individualizimi i veprës penale në rast të paraqitjes së kundërshtimit *ne bis in idem*.³²⁸

Në përshkrimin faktik duhet të paraqitën në mënyrë të plotë e të qartë:

- veprimi i kryerjes;
- mënyra e kryerjes;
- vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale,
- pasoja që ka rrjedhë si rezultat i veprës penale, etj.

Në raste të caktuara në dispozitivin e aktgjykimit përshkruhen edhe veprimet e të dëmtuarit edhe pse ato nuk përbëjnë tipare të veprës penale, por ndihmojnë në vendosjen e çështjes, siç është rasti të tejkalimi i mbrojtjes së nevojshme.

2. Emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit

Në dispozitivin e aktgjykimit dënues duhet të shënohet emërtimi ligjor i veprës penale, siç është dhënë në KPRK, ose në ndonjë Ligj tjetër me të cilin janë parashikuar veprat penale. Nëse një ligj i tillë nuk përmban emërtim të veprës penale, atëherë gjykata do ta emërtoj veprën në përputhje me atë dispozitë ligjore për të cilën i akuzuari shpallet fajtor.

Në rastet kur dispozita ligjore lidhur me veprën penale konkrete ka më shumë së një paragraf, atëherë emërtimi bëhet në atë mënyrë që përveç nenit shënohet edhe paragrafi, pika e kështu me radhë, në mënyrë që aktgjykimi të jetë i qartë.³²⁹

³²⁸ Përcaktimi i saktë i veprës penale, përshkrimit të saj faktik, me të gjitha elementet e veprës penale, veprimin e kryerjes dhe përgjegjësisë penale të kryesit janë më rëndësi jo vetëm për qartësinë e dispozitivit të aktgjykimit, por edhe për përcaktimin e saktë të veprës penale në rast të ngritjes së aktakuzës për të njëjtën veprë penale kundër kryesit të njëjtë.

³²⁹ Kjo do të ilustruhet me shembullin në vijim: Në rast së i akuzuari është shpallë fajtor për veprën penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 327 të KPRK dhe vlera e sendeve të vjedhura e tejkalon shumën prej 7.000

Përveç emërimit të veprës penale në dispozitivin e aktgjykimit shënohen edhe të gjitha dispozitat tjera ligjore, qofshin ato materiale apo procedurale, të cilat zbatohen me rastin e marrjes së aktgjykimit fajësues, siç janë: dispozita e nenit 12 të KPRK, nëse vepra penale është kryer në mbrojtje të nevojshme; neni 28 i KPRK, nëse vepra ka ngelë në tentativë dhe dispozita të tjera që kanë të bëjnë llojin e dënimit, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit, dënimet alternative, për çështjen e paraburgimit, shpenzimet e procedurës, konfiskimin, etj.

- **Si veprohet në rastet kur me aktgjykim janë përfshirë me shumë vepra penale ose më shumë kryes?**

Në rast së i akuzuari akuzohet për më shumë vepra penale në bashkim real, përshkrimi faktik bëhet veç e veç për secilën vepër penale të përfshirë me aktgjykim.

Në rast të bashkimit ideal të veprave penale ato përshkruhen së bashku.

Në rast së me një aktgjykim janë përfshirë më shumë të akuzuar, si bashkëkryes ose për ndonjë formë tjetër të bashkëpunimit, atëherë në përshkrimin faktik të veprës penale paraqiten veprimet konkrete të secilit të akuzuar.

3. Dënimin i shqiptuar

Me aktgjykimin fajësues (dënues) duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë lloji dhe lartësia e dënimit.

Përveç dënimit kryesor, gjykata përcakton qartë edhe dënimet tjera plotësuese, ose në rast të shqiptimit të dënimit kumulativ caktohen qartë të dy dënimet: P.sh. dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë.

Për veprat penale të kryera në bashkim real, gjykata përcakton dënimet për secilën vepër penale veç e veç e pastaj sipas rregullave të përcaktuara me nenin 80 të KPRK, shqiptohet një dënim unik për të gjitha veprat penale. Në rast të unifikimit të dënimeve, unifikimi bëhet veçantë për dënimin me burg dhe veçantë për dënimin me gjobë.

Në aktgjykim do të përfshihen edhe dënimet tjera të shqiptuara ndaj të akuzuarit me aktgjykim tjetër, nëse dënimi ende nuk është ekzekutuar ose është duke u ekzekutuar. Edhe në këtë rast caktohet dënimi unik, sikurse në rast të bashkimit real të veprave penale.

euro, atëherë në emërtimin ligjor nuk mjafton të shkruhet vetëm nenin 327, por duhet të shkruhet neni 327 paragrafi 2 pika 2.1 të KPRK, sepse po të shkruhet vetëm neni 327, atëherë nuk është e qartë së cilën trajtë e të veprës penale e ka konsumuar i akuzuari me veprimin e tij.

Në rast të shqiptimit të dënimit me gjobë, caktohet edhe afati për pagesën e gjobës, si dhe mënyra e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burg sipas kushteve të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 2 të KPRK.³³⁰

Në aktgjykim fajësues caktohet edhe mënyra e zëvendësimit të dënimit me burg në dënim me gjobë ose me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme sipas neneve 47 dhe 48 të KPRK.³³¹

Me aktgjykim fajësues caktohen qartë edhe dënimet alternative (dënimi me kusht, gjysëmliria apo urdhri për punë në dobi të përgjithshme), duke caktuar qartë kohëzgjatjen e dënimit, afatin e verifikimit, kushtet e caktuara për të akuzuarin në rast të dënimit me kusht dhe mënyrën e ekzekutimit.³³²

Në dispozitiv të aktgjykimit duhet të shënohen qartë edhe dënimet plotësuese, kohëzgjatja dhe mënyra e ekzekutimit.³³³

Nëse me aktgjykim fajësues i akuzuari është shpallë fajtor, por është liruar nga dënimi, gjykata duhet të shënoj bazën ligjore për lirim nga dënimi, sipas neneve 77 dhe 78 të KPRK, apo sipas ndonjë dispozite tjetër të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat parashohin mundësinë e lirimit nga dënimi, siç është tejkalimi i mbrojtjes së nevojshme neni 12 i KPRK, apo vepra penale rebelimi i personave të privuar nga liria neni 404 paragrafi 4 të KPRK, etj.

6.6.3.1 Vendimi (urdhri) për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm ose për konfiskimin e dobisë pasurore (neni 365 paragrafi 1 pika 1.4 e KPP).

a) Vendimi (urdhri) për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm

³³⁰ Me dispozitën e nenit 46 paragrafi 2 të KPRK, është përcaktuar së afati i pagesës nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se tre muaj. Në raste të arsyeshme (nëse shumica e gjobës është e lartë, ose mundësitë e të akuzuarit janë të tilla) gjykata me aktgjykim përcakton së gjoba do të paguhet në këste për një periudhë jo më të gjatë se dy vjet, duke përcaktuar edhe afatin e pagesës së kësteve. Me aktgjykim përcaktohet gjithashtu së do të revokohet mundësia e pagesës me këste, nëse ato nuk paguhet me kohë.

³³¹ Me dispozitat e neneve 47 dhe 48 të KPRK, është parashikuar mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim deri në 6 muaj në dënim me gjobë ose me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, mirëpo ky zëvendësim mund të bëhet vetëm me rastin e shqiptimit të aktgjykimit në shkallë të parë, nëse i akuzuari e ka dhënë pëlqimin për një gjë të tillë ose me rastin e vendosjes lidhur me ankesën kundër aktgjykimit, nëse ekziston pëlqimi i të akuzuarit dhe gjykata e gjen të arsyeshme ta bëjë një zëvendësim të tillë. Ky zëvendësim nuk mund të bëhet në faza të mëvonshme të procedurës, siç është procedura e ekzekutimit, gjë që ka pas një tendencë të tillë në praktikën e gjykatave.

³³² Në rast të shqiptimit të dënimeve alternative gjykata në aktgjykim duhet të përcaktoj qartë kushtet për revokimin e dënimit të shqiptuar, qoftë për shkak të arsyeve ligjore për revokimin e dënimeve alternative, siç është përcaktuar me dispozitat ligjore (nenet 53, 54, 55, 56 paragrafi 2, 57 paragrafi 4, 58 paragrafi 4, 60 paragrafi 5 dhe 61 paragrafi 3 të KPRK) apo nuk i përmbush detyrimet e caktuara konform nenit 59 të KPRK.

³³³ Në rastet kur gjykata vendos që krahas dënimit kryesor ose dënimit alternativ, të shqiptoj edhe ndonjë dënim plotësues të përcaktuar me nenin 62 të KPRK, atëherë dispozitivi i aktgjykimit duhet të përmbajë qartë të dhënat për llojin e dënimit apo dënimeve (nëse janë shqiptuar më shumë dënime të tilla), kohën e zgjatjes, mënyrën e ekzekutimit, etj.

Dispozitivi i aktgjykimit fajësues duhet të përmbajë edhe vendimin (urdhri) për masat e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të kryerësve të varur nga droga dhe alkooli, në rast së gjykata ka caktuar një masë të tillë.³³⁴

Vendimi për shqiptimin e masës duhet të përmbaj:

- Llojin e masës së shqiptuar;
- Kohëzgjatjen e masës;
- Mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së masës;
- Procedurën për ndryshimin dhe pushimin të masës së shqiptuar, etj.

b) Vendimi (urdhri) për konfiskimin e dobisë pasurore (neni 365 paragrafi 1 pika 1.5 e KPP)

Aktgjykimi fajësues duhet të përmbajë edhe vendimin (urdhri) për konfiskimin e dobisë pasurore ose për lirimin e saj, qoftë duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, qoftë sipas detyrës zyrtare kur konfiskimi është i obligueshëm.³³⁵

Në dispozitivin e aktgjykimit fajësues përcaktohet qartë pasuria e paluajtshme, e luajtshme, mjete monetare ose asetet tjera të cilat janë objekt i konfiskimit.

Në vendimin për konfiskim të pasurisë së paluajtshme duhet të përshkruhet qartë lloji i pasurisë, vendi ku gjendet pasuria, mundësisht vlera e saj dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e saj.

Pasuritë e paluajtshme duhet të përshkruhen gjithashtu sipas llojit, sasisë dhe vlerës. P.sh. nëse me vendimin e gjykatës është vendosur që të konfiskohet një veturë, atëherë duhet të shënohen të dhënat e sakta për automjetin duke përfshirë llojin, tipin, vitin e prodhimit, numrin e karrocërisë, vendin e regjistrimit, emrin e personit në të cilin është regjistruar etj.

Kështu veprohet edhe me sendet dhe asetet tjera të luajtshme.

Vlerat monetare shënohen në shuma të sakta, në valutën përkatëse, me numër të kontos, nëse janë të depozituara në ndonjë bankë, etj.

Në dispozitivin e aktgjykimit fajësues (dënues) gjykata do të jep udhëzime për administrimin e kësaj pasurie nga ana e Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar.

³³⁴ Në rastet kur gjykata krahas dënimit të shqiptuar, ka vendosur edhe për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim të kryesve të varur nga alkooli dhe droga, atëherë ajo me aktgjykim duhet të përcaktojë llojin e masës, kohëzgjatjen, mënyrën e ekzekutimit, mënyrën e ndryshimit të kësaj mase siç është përcaktuar me nenin 91 të KPRK.

³³⁵ Me aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallë fajtor, gjykata mund të vendosë edhe lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore. Sipas nenit 284 paragrafi 1 të KPP është përcaktuar se gjykata mund të vendosë për konfiskim ose jo të ndërtesave, pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme, mjeteve financiare apo asetëve të tjera. Gjikata me aktgjykim vendos gjithmonë për konfiskimin e sendeve nëse konfiskimi i tyre është i detyrueshëm sipas ligjit. P.sh. nëse i akuzuari është shpallë fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 të KPRK, atëherë arma detyrimisht konfiskohet.

c) Vendimi për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit (neni 365 paragrafi 1 pika 1.5 e KPP)

Gjykata e shkallës së parë me rastin e hartimit të aktgjykimit fajësues (dënues) në pjesën e vendimit për dënimin duhet të theksojë së në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet:

- Koha e kaluar në paraburgim dhe/ose në arrest shtëpiak, nëse ndaj të akuzuarit është caktuar një masë e tillë, duke përfshirë gjithë periudhën e zgjatjes së kësaj mase, nga dita e arrestimit deri në ditën e heqjes e tyre.³³⁶
- Dënimi i mëparshëm, sipas aktgjykimeve të tjera, nëse dënimi nuk është ekzekutuar.³³⁷
- Koha e kaluar në paraburgimit dhe dënimit të mbajtur në juridiksione të tjera.³³⁸
- Kohën e kaluar në institucione të kujdesit shëndetësor.³³⁹
- Koha e kaluar në mbajtje të dënimit me burg, ose gjoba e paguar për kundërvajtje, nëse tiparet e kundërvajtjes përmbajnë edhe tipare të veprës penale për të cilën është gjykuar i akuzuari.

6.6.3.2 Vendimin për shpenzimet e procedurës, kërkesën pasurore juridike dhe shpalljen e aktgjykimit të formës së prerë në mjetet e informimit.

a) Vendimi për shpenzimet e procedurës

Me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata vendos edhe lidhur me shpenzimet e krijuara gjatë procedurës penale dhe ato të shkaktuara lidhur me të cilat ngarkohet i akuzuari, sipas nenit 453 paragrafi 1 të KPP.

Përkitazi me shpenzimet gjykata mund të vendos edhe me aktvendim të veçantë, nëse në momentin e marrjes së aktgjykimit mungojnë të dhënat lidhur me lartësinë e shpenzimeve.³⁴⁰

³³⁶ Sipas nenit 83 paragrafi 2 të KPRK, përveç paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar i llogaritet çdo privim nga liria lidhur me atë vepër penale, duke llogaritur dënimin me burgim apo me gjobë që i akuzuari e ka mbajtur ose paguar për kundërvajtje apo delikt ekonomik, nëse elementet e veprës penale përfshijnë kundërvajtjen apo deliktin ekonomik.

³³⁷ Nëse gjykata ka vendosur për shqiptimin e një dënimi unik duke përfshirë edhe dënimin e shqiptuar me aktgjykim tjetër i cili nuk është ekzekutuar në tërësi ose nuk është ekzekutuar fare, atëherë në dënimin e shqiptuar llogaritet gjithë koha e kaluar në paraburgim ose në mbajtje të dënimit sipas aktgjykimit të parë.

³³⁸ Në dënimin e shqiptuar me aktgjykim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim në juridiksionet tjera në pritje të vendimit për ekstradim apo dënimi i mbajtur për atë vepër penale sipas aktgjykimit të huaj, ashtu siç është përcaktuar me nenin 84 të KPRK.

³³⁹ Në dënimin e shqiptuar llogaritet edhe koha e kaluar në institucionin shëndetësor konform nenit 508, 509 dhe 515. Për më tepër shiko: Sahiti, Ejup; Murati Rexhep: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, faqe 375.

³⁴⁰ Sipas nenit 451 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar mundësia që gjykata me aktgjykim mos të vendosë lidhur me shpenzimet e procedurës penale. Në këtë rast çështja e shpenzimeve vendoset me aktvendim të veçantë të cilin e merr procesmbajtësi, me miratimin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit

Nëse gjykata nuk ka vendosur me aktgjykim lidhur me shpenzimet e procedurës, ajo do të theksoj së çështja e shpenzimeve do të vendoset me aktvendim të veçantë.

Kur ka më shumë të akuzuar të cilët janë shpallë fajtor me një aktgjykim, gjykata cakton pjesën e shpenzimeve që duhet paguar secili i akuzuar veç e veç, e nëse ato nuk mund të ndahen, atëherë ajo i obligon ata që shpenzimet t'i paguajnë solidarisht.

b) Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Me aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallë fajtor, gjykata mund të vendosë lidhur me kërkesën pasurore-juridike në tërësi ose pjesërisht, nëse provat e siguruara gjatë procedurës penale paraqesin bazë të sigurte për një vendim të tillë.³⁴¹

Nëse dëmi i shkaktuar me veprën penale është element konstitutiv i veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallë fajtor dhe me aktgjykim vërtetohet saktë lartësia e dëmit, atëherë gjykata **duhet të vendosë lidhur me kërkesën pasurore-juridike deri në lartësinë e dëmit të vërtetuar**, në të kundërtën aktgjykimi do të ishte kontradiktor me vetveten dhe kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 12 e KPP.³⁴²

Në rastet kur gjykata me aktgjykim nuk vendosë fare lidhur me kërkesën pasurore juridike ose nuk vendos në tërësi, në aktgjykimin fajësues, i dëmtuari duhet të udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

c) Vendimi për publikimin e aktgjykimit të formës së prerë në mjetet e informimit publik.

Dhe së fundi, nëse gjykata me aktgjykimin fajësues ka vendosur që aktgjykimi të shpallët në mjetet e informimit në shtyp, radio ose televizion, atëherë është e nevojshme që ky vendim të shkruhet në dispozitivin e aktgjykimit, ku do të përcaktohen kushtet, mënyra,

gjykues pas sigurimit të të dhënave. Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë dhe për ankesën vendos Kolegji i së njëjtës gjykatë.

³⁴¹ Me nenin 463 paragrafi 2 të KPP është parashikuar mundësia që gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin e shpallë fajtor të akuzuarin të vendos në tërësi ose pjesërisht lidhur me kërkesën pasurore-juridike, nëse provat e grumbulluara gjatë procedurës penale e mundësojnë një gjë të tillë, në të kundërtën të dëmtuarin e udhëzon në kontest civil.

³⁴² Ndryshe qëndron situata nëse dëmi i shkaktuar me veprën penale paraqet element qenësor të veprës penale dhe gjykata e vërteton saktë lartësinë e dëmit të shkaktuar, atëherë gjykata me aktgjykim do të vendos edhe lidhur me kërkesën pasurore juridike, siç është treguar në rastin në vijim: Nëse i akuzuari është shpallë fajtor për veprën penale të mashtrimit nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK dhe gjykata gjatë procedurës penale me administrimin e provave përkatëse ka vërtetuar së i akuzuari përmes kësaj vepre penale nga i dëmtuari ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme shumën prej 10.000 Euro (që është trajtë e kualifikuar e kësaj vepre penale), atëherë gjykata duhet të vendosë lidhur me kërkesën pasurore-juridike nëse i dëmtuari ka paraqitur një kërkesë të tillë, sepse shuma prej 10.000 Eurosh, paraqet element qenësor të veprës penale dhe nuk ka arsye që i dëmtuari të udhëzohet në kontest civil. Në praktikë ndodhë shpesh që gjykata mos të vendos lidhur me kërkesën pasurore juridike edhe pse në dispozitiv të aktgjykimit theksohet saktë shuma e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit me kryerjen e veprës penale.

koha e shpalljes dhe mediat në të cilat do të publikohet aktgjykimi pasi që ai të marrë formën e prerë, siç është përcaktuar me nenin 70 të KPRK.

6.7 Shpallja e aktgjykimit

a) Kur shpallet aktgjykimi?

Në parim, gjykata e shpallë aktgjykimin, menjëherë pas marrjes së tij nga gjyqtari i vetëm gjykues, ose nga trupi gjykues.

Në rastet komplekse (kur ka më shumë të akuzuar, më shumë vepra penale ose ka shumë material provues) gjykata mund ta shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së shumti për tri ditë nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Vendimi për shtyrjen e shpalljes së aktgjykimit konstatohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Nëse aktgjykimi nuk shpallët të njëjtën ditë, gjykata është e detyruar që të caktoj datën, kohën dhe vendin e shpalljes dhe për këtë t'i njoftoj palët, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe përfaqësuesit e autorizuar të palëve që janë të pranishme dhe publikun. Ky njoftim bëhet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.³⁴³

b) Kush e shpall aktgjykimin?

Aktgjykimin e shpall gjyqtari i vetëm gjykues, ose kryetari i trupit gjykues nëse aktgjykimi është marrë nga trupi gjykues.³⁴⁴

Në shpalljen e aktgjykimit marrin pjesë të gjithë anëtarët e trupit gjykues, palët, mbrojtësit e të akuzuarit, përfaqësuesit ligjor dhe të autorizuar të palëve.

Nëse me rastin e shpalljes së aktgjykimit mungojnë ndonjëra nga palët, mbrojtësit përfaqësuesit ligjor apo të autorizuar të palëve, kjo nuk paraqet pengesë për shpalljen e aktgjykimit, madje edhe nëse mungon ndonjëri nga anëtarët e trupit gjykues, për shkak të sëmundjes apo arsyeve tjera objektive.³⁴⁵

Në rast së i akuzuari ose ndonjë i akuzuar nuk është i pranishëm me rastin e shpalljes së aktgjykimit, gjykata mund të vendos që të akuzuarit i cili nuk është i pranishëm t'ia komunikoj gojarisht aktgjykimin ose t'i dërgohet me shkrim.³⁴⁶

³⁴³ Neni 366 paragrafi 1 i KPP.

³⁴⁴ Neni 366 paragrafi 2 i KPP.

³⁴⁵ Neni 366 paragrafi 3 i KPP.

³⁴⁶ Po aty.

c) Si shpallet aktgjykimi?

Aktgjykimin e shpallë gjyqtari i vetëm gjykues, apo kryetari i trupit gjykues duke e lexuar tekstin e dispozitivit të aktgjykimit që është marrë nga gjykata dhe është regjistruar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor (aktgjykimi burimor).

Dispozitivi i aktgjykimit të shpallur duhet të përmbaj të dhënat personale për të akuzuarin, veprën penale për të cilën është shpallë fajtor (përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale dhe sanksionin penal që i është shqiptuar të akuzuarit.

Aktgjykimi merret në emër të popullit dhe lexohet më zë, deri sa të gjithë të pranishmit qëndrojnë në këmbë.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i paraqet në pika të shkurta arsyet e aktgjykimit.

Aktgjykimi shpallet në mënyrë publike, pavarësisht nëse publiku ka qenë i përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor.

Në rastet kur shqyrtimi gjyqësor ka qenë i mbyllur për publikun, **publikisht do të shpallët vetëm dispozitivi i aktgjykimit**, ndërsa për pjesëmarrjen e publikut gjatë prezantimit të arsytimit të aktgjykimit, trupi gjykues do të vendos me aktvendim të veçantë.

Arsyet për përjashtimin e publikut nga kjo fazë e shpalljes së aktgjykimit jenë të njëjta me arsyet për përjashtim të publikut nga shqyrtimi gjyqësor.

Aktgjykimi i shpallur nga gjykata nuk mund të pësoj më asnjë ndryshim, me përjashtim të korigjimit të gabimeve të imta teknike në numra, emra, etj. që mund të bëhen në përputhje nenin 371 të KPP, por pa e ndryshuar përmbajtjen e tij.

d) Çfarë njoftimesh jepen me rastin e shpalljes së aktgjykimit?

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit gjykata i udhëzon palët për të drejtën në ankesë dhe për detyrimin e njoftimit të gjykatës për çdo ndryshim të adresës, derisa të përfundoj procedura.

Në rastet kur me aktgjykim është shqiptuar ndonjë dënim alternativ, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm gjykues e paralajmëron të pandehurin për rëndësinë e dënimit dhe për kushtet dhe obligimet që duhet plotësuar.³⁴⁷

Këto paralajmërimet shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

³⁴⁷ P.sh. në qoftë së të akuzuarit i është shqiptuar dënim me kusht dhe është obliguar për përmbushjen e ndonjë detyrimi (siç mund të jetë kompensimi i dëmit për të dëmtuarin, mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor apo ndonjë detyrim tjetër nga neni 59 i KPRK), me rastin e shpalljes së aktgjykimit i akuzuari duhet të njoftohet për mundësinë e revokimit të dënimit me kusht, nëse nuk i përmbush detyrimet e caktuara nga gjykata brenda afateve që i janë caktuar nga gjykata.

6.8 Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit (neni 367 i KPP)

Çështje që duhet vendosur me aktgjykim kur i akuzuari shpallet fajtor dhe dënohet me dënim me burg.

Në këtë rast gjykata do të marrë njërin nga këto vendime:

- Për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit nëse i akuzuari gjendet në paraburgim;
- Për caktimin e paraburgimit, nëse i akuzuari gjendet në liri dhe është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej pesë ose më shumë vite burgim;³⁴⁸
- Për caktimin e paraburgimit, kur i akuzuari gjendet në liri dhe është dënuar me më pak së pesë vjet burg, nëse janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e paraburgimit.³⁴⁹

Me rastin e vendosjes lidhur me paraburgimin, gjykata paraprakisht e merr mendimin e prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit, nëse paraburgimi nuk caktohet ose hiqet sipas fuqisë së ligjit, siç është përcaktuar me nenin 367 paragrafi 2 të KPP.

- Gjykata çdoherë merr vendim për heqjen e paraburgimit nëse është plotësuar ndonjëri nga këto kushte:
- Nëse i akuzuari është liruar nga akuza;
- Nëse aktakuza është refuzuar, por jo për shkak të inkompetencës së gjykatës;
- Nëse është shpallë fajtor, po nuk i është shqiptuar dënim me burgim;
- I akuzuari është dënuar me burg, por për shkak të llogaritjes së paraburgimit në dënimin e shqiptuar, ai veç e ka mbajtur dënimin.

6.9 Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit

a) Koha e përpilimit të aktgjykimit

Nëse i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, afati i përpilimit të aktgjykimit me shkrim është 15 ditë nga dita e shpalljes së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk gjendet në paraburgim afati është 30 ditë nga dita e shpalljes së aktgjykimit.³⁵⁰

³⁴⁸ Për dallim nga Kodi i mëparshëm i procedurës penale, me nenin 367 paragrafi 2 të KPP, paraburgimi është i obligueshëm nëse gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me pesë ose më shumë vjet burgim. Kështu veprohet edhe në procedurë me ankesë para Gjykatës së Apelit, nëse gjykata me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit, kur ai ka të drejtë ankesë, ka vendosur për rritjen e dënimit të shqiptuar dhe të akuzuarit i shqipton një dënim prej 5 ose më shumë vjet burgim.

³⁴⁹ Në rastet kur gjykata e shkallës së parë shqipton dënim më të ulët së pesë vjet, atëherë ajo duke vepruar konform nenit 367 paragrafi 3 të KPP, mund të vendos për caktimin ose vazhdimin e paraburgimit nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 187 paragrafi 1 të KPP.

³⁵⁰ Neni 369 i KPP.

b) A mund të zgjatet afati për përpilimin e aktgjykimit të shkruar?

Afati për përpilimin e aktgjykimit të shkruar mund të zgjatet deri në 60 ditë, nga dita e shpalljes publike të aktgjykimit. Në këtë afat llogaritet edhe koha e rregullt për hartimin e aktgjykimit, prej 15, respektivisht 30 ditësh.

Për zgjatjen e afatit vendosë kryetari i gjykatës në bazë të kërkesës së kryetarit të trupit gjykues ose gjyqtarit të vetëm gjykues, nëse rasti është i ndërlikuar (ka shumë të akuzuar, shumë vepra penale ose për shkak të vëllimit të madhe të materialit provues).

Afati për përpilimin e aktgjykimit ndaj të miturve dhe vendimit për shqiptimin e masës edukuese është 8 ditë. Ky afat mund të zgjatet më së shumti deri në 15 ditë.³⁵¹

c) Kush e nënshkruan dhe e përpilon aktgjykimin?

Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi, të cilët njëherit edhe e përpilojnë aktgjykimin.

Në rast të pengimit të përhershëm ose për shkak të rrethanave tjera të jashtëzakonshme, për shkak të të cilave ekziston mundësia që kryetari i trupit gjykues nuk mund ta përpilojë vendimin gjyqësor, atëherë vendimi do të përpilohet nga anëtari i parë i radhës i trupit gjykues.³⁵²

Në rast gjyqtari i vetëm gjykues nuk mund ta nënshkruaj aktgjykimin për shkak të pengesave objektive (sëmundja, vdekja, ose pushimi i funksionit të gjyqtarit), atëherë kryetari i gjykatës e cakton një gjyqtar i cili do ta nënshkruaj aktgjykimin.

Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe në rast së procesmbajtësi nuk mund ta nënshkruaj aktgjykimin.

d) Dorëzimi i aktgjykimi - kujt i dorëzohet aktgjykimi?

Nga një kopje e vërtetuar e aktgjykimit i cili përmban edhe udhëzimin për ankesë u dorëzohet:

- Prokurorit të shtetit;
- Të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij;³⁵³
- Të dëmtuarit ose përfaqësuesit të autorizuar;
- Personit të cilit i është konfiskuar sendi me aktgjykim, si dhe
- Personit juridik të cilit i është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale.

³⁵¹ Neni 74 i KDM.

³⁵² Neni 4 paragrafi 13 i Rregullores për Organizmin e Brendshëm të Gjykatave.

³⁵³ Sipas nenit 478 të KPP aktgjykimi i dorëzohet të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Ndërkaq, nëse i akuzuari ka më shumë mbrojtës, mjafton që aktgjykimi t'i dorëzohet njërit prej tyre.

e) Si bëhet dorëzimi i aktgjykimit?

Dorëzimi i aktgjykimit bëhet në përputhje me dispozitat e kapitullit XXVII të KPP.³⁵⁴

- **Dorëzimi i aktgjykimit prokurorit të shtetit**

Prokurorit të shtetit i dorëzohet kopja e vërtetuar e aktgjykimit përmes zyrës së regjistrimit të shkresave të Prokurorisë së shtetit. Si datë e dorëzimit konsiderohet data e dorëzimit të aktgjykimit në këtë zyrë.

Afati për ankesë fillon nga dita e dorëzimit të aktgjykimit në zyrën e regjistrimit. Në kërkesë të Prokurorit të shtetit, atij do t'i dërgohen edhe shkresat e lëndës për shqyrtim, me qëllim të përpilimit të ankesës ose për qëllime të tjera, siç mund të jetë përgjigja në ankesë, etj.

- **Të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij**

Të akuzuarit aktgjykimi i dorëzohet personalisht. Vetëm përjashtimisht, me kërkesën e të akuzuarit, aktgjykimi mund t'i dorëzohet personit të caktuar nga ai.³⁵⁵

Të akuzuarit të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim dhe të cilit nuk mund t'i dorëzohet aktgjykimi për shkak të ndryshimit të adresës, atëherë gjykata menjëherë ia cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare për dorëzimin e aktgjykimit. Mbrojtësi i caktuar në këtë rast ka të drejtë të kërkoj një afat për shikimin e shkresave.

6.10 Forma dhe përmbajtja e aktgjykimit (neni 370 i KPP)

Sa i përket formës aktgjykimi gjithmonë duhet të përpilohet në formë të shkruar. Dispozitivi i aktgjykimit të përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur publikisht dhe i cili është regjistruar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Aktgjykim i përpiluar me shkrim duhet të përmbajë:³⁵⁶

³⁵⁴ Me këtë kapitull është rregulluar mënyra e dorëzimit të shkresave pjesëmarrësve në procedurë, duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës. Me këto dispozita janë përcaktuar rregulla të veçanta për dorëzimin e aktgjykimeve duke e rregulluar në mënyrë shumë të hollësishme procedura e dorëzimit të aktgjykimit të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Për më shumë shiko dispozitën e nenit 378 të KPP.

³⁵⁵ Me dispozitën e nenit 478 paragrafi 2 të KPP është parashikuar mundësia që në vend të akuzuarit, aktgjykimi t'i dorëzohet personit të caktuar nga ai. Në rast të tillë do të hartohet një shënim zyrtar, ose do të kërkohet një autorizim i veçantë nga i akuzuari për personin e autorizuar, sepse mënyra e këtillë e dorëzimit të aktgjykimit bën përjashtim nga dorëzimi personal dhe afati për ankesë rrjedhë nga momenti i dorëzimit të aktgjykimit këtij personi e jo të akuzuarit.

- a) Hyrjen
- b) Dispozitivin dhe
- c) Arsyetimin

a) Hyrja

Hyrja e aktgjykimit përmban:

- Shënimin së aktgjykimi merret në emër të popullit;³⁵⁷
- Emrin e gjykatës;³⁵⁸
- Emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe anëtarëve të trupit gjykues;
- Emrin dhe mbiemrin e procesmbajtësit;
- Emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit;
- Veprën penale për të cilën është akuzuar;³⁵⁹
- Shënimin nëse i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë;³⁶⁰
- Emrin dhe mbiemrin e Prokurorit të shtetit;
- Emrin dhe mbiemrin e mbrojtësit;
- Emrin dhe mbiemrin e të dëmtuarit, përfaqësuesit ligjor dhe përfaqësuesit të autorizuar nëse kanë marrë pjesë në seancën e shqyrtimit gjyqësor;
- Datën e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor;³⁶¹
- Shënimin nëse seanca ka qenë e hapur për publikun;³⁶²

³⁵⁶ Me nenin 370 paragrafi 1 KPP është përcaktuar së aktgjykimi duhet të përpilohet me shkrim, pra forma e shkruar e aktgjykimit është e obligueshme, duhet të jetë identik me aktgjykimin e shpallur dhe duhet të përmbajë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin.

³⁵⁷ Në paragrafin 2 të nenit 370 të KPP është përcaktuar së aktgjykimi merret në emër të popullit. Ky konstatim bëhet në fillim të aktgjykimit, pavarësisht së a është fjala për aktgjykim refuzues, lirues apo dënues.

³⁵⁸ Emërtimi i gjykatës shkruhet i plotë duke përfshirë departamentin përkatës, ose degën e gjykatës: P.sh. “Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i krimeve të rënda”, ose nëse çështja është vendosur në ndonjë degë të kësaj gjykate shkruhet: “Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan”. Në këtë rast nuk ka nevojë të shkruhet Departamenti i përgjithshëm, sepse Degët e gjykatave e kanë vetëm këtë departament.

³⁵⁹ Edhe pse në paragrafin 2 të nenit 370 të KPP shkruan së në hyrje të aktgjykimit duhet të shkruhet vepra penale për të cilën i akuzuari është dënuar, sepse vepra për të cilën është dënuar shkruhet në dispozitiv të aktgjykimit, sepse gjykata mund ta ndryshojë cilësimin juridik dhe ky ndryshim shënohet në dispozitiv.

³⁶⁰ Ku bëhet fjalë për konstatimin nëse i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancën e shqyrtimit gjyqësor, është me rëndësi të theksohet se ai duhet të jetë gjithmonë i pranishëm, me përjashtim të aktgjykimit për dhënien e urdhërit ndëshkimor sipas nenit 495 paragrafi 1 të KPP. Në këtë pjesë shkruhet edhe numri dhe data e aktit akuzues.

³⁶¹ Në hyrje të aktgjykimit shkruhet edhe data e shqyrtimit gjyqësor, por në qoftë së shqyrtimi gjyqësor ka zgjatë më shumë së një ditë, atëherë në hyrje të aktgjykimit shënohen të gjitha ditët sa ka zgjatur shqyrtimi gjyqësor.

³⁶² Shënimin nëse shqyrtimi ka qenë publik, ose ka qenë i mbyllur për publikun është pjesë e hyrjes së aktgjykimit, sepse nëse shqyrtimi është mbajtur pa prezencën e publikut, pa u plotësuar kushtet ligjore,

- Datën e shpalljes së aktgjykimit dhe
- Datën e përpilimit të aktgjykimit.

b) Dispozitivi i aktgjykimit

Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përmbaj:

- Të dhënat personale për të akuzuarin;³⁶³
- Vendimin e gjykatës lidhur me veprën penale të paraqitur në aktakuzë (për shpalljen e të akuzuarit fajtor, lirimin nga akuza ose refuzimin e aktakuzës);³⁶⁴
- Përshkrimin faktik të veprës penale;
- Cilësimin juridik të veprës penale;
- Vendimet tjera lidhur me:
 - sanksionin penal,
 - çështjen e paraburgimit,
 - shpenzimet e procedurës,
 - kërkesën pasurore juridike;
 - konfiskimin e dobisë pasurore ose kthimin e pasurisë apo sendeve të sekuestruara;³⁶⁵

Në rast të gjykimit për vepra penale në bashkim, gjykata është e obliguar që në dispozitiv të aktgjykimit t'i paraqes dënimet e përcaktuara për secilën vepër penale për të cilat i akuzuari është shpallë fajtor si dhe dënimin unik të shqiptuar për të gjitha veprat penale në bashkim.

Nëse me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë dënim i shqiptuar më parë me aktgjykim të formës së prerë, atëherë në dispozitiv shënohet emri i gjykatës, numri dhe data e

atëherë kjo përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 1.4 të KPP, prandaj kjo duhet të vihet në dukje që në hyrje të aktgjykimit, në mënyrë që Gjykata e Apelit, në rast të ankesës kundër një aktgjykimi të tillë, të këtë mundësi që ta vlerësoj nëse ka pas bazë ligjore për përjashtimin e publikut.

³⁶³ Në dispozitivin e aktgjykimit gjykata i shënon të gjitha të dhënat personale për të akuzuarin, duke filluar nga emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, emri dhe mbiemri i prindërve, vendbanimi, profesioni, të dhënat për punësimin gjendjen ekonomike, faktin nëse ka qenë i dënuar më parë ose nëse është duke u zhvilluar ndonjë procedurë kundër tij. Këto të dhëna janë të rëndësishme jo vetëm për përcaktimin e identitetit subjektiv të të akuzuarit, por janë me rëndësi edhe për marrjen e vendimit për dënimin, shpenzimet e procedurës penale, etj.

³⁶⁴ Në dispozitivin e aktgjykimit shënohet edhe baza ligjore për refuzimin e aktakuzës, ose për lirimin e të akuzuarit nga akuza, në mënyrë që të bëhet e njohur që në fillim së cila është arsyeja që gjykata ka marrë një vendim të tillë.

³⁶⁵ Në rast të aktgjykimit refuzues ose lirues gjykata gjithmonë vendos për lirimin dhe kthimin e sendeve të sekuestruara, me përjashtim të rasteve kur konfiskimi i tyre është i domosdoshëm sipas ligjit (armët, narkotikët, parat e falsifikuara, etj.) që në nuk mund të jenë në disponim të qytetarëve.

aktgjykimit dhe dënimit që merret si dënim i përcaktuar me rastin e shqiptimit të dënimit të unifikuar.³⁶⁶

Dispozitivi i aktgjykimit të shkruar duhet të jetë identik me dispozitivin e aktgjykimit të shkruar në Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor (aktgjykimi burimor).

c) Arsyetimi i aktgjykimit

Çdo aktgjykim, pavarësisht nga lloji duhet të përmbaj arsyetimin.

Kodi i procedurës penale nuk lejon mundësinë e aktgjykimit pa arsyetim, siç ka qenë rasti me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.³⁶⁷

Arsyetimi i aktgjykimit duhet të përmbaj arsye për çdo pikë të aktakuzës.

Në arsyetim gjykata duhet të paraqes në mënyrë të plotë dhe të qartë arsyet, duke dhënë në këtë rast së cilat fakte i konsideron si të vërtetuara ose të pavërtetuara, duke dhënë më këtë rast vlerësimin e saktësisë së provave kontradiktore, arsyet konkrete për mosmiratimin e propozimeve të palëve, si dhe arsyet në të cilat është udhëhequr me rastin e zgjedhjes së çështjeve juridike, sidomos atyre që kanë të bëjnë me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe atyre nga të cilat varet zbatimit i drejtë i dispozitave të Kodit penal, kundrejt të akuzuarit dhe veprës penale.

Arsyetimi duhet të jap sqarime për gjithë atë që është vendosur në dispozitivin e aktgjykimit.

Nëse i akuzuari është shpallë fajtor dhe është dënuar, në arsyetim duhet të përfshihen rethanat të cilat kanë ndikuar në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Arsye të veçanta duhet të jepen me rastin e shqiptimit të dënimit më të rëndë ose kur gjykata vendos për zbutjen e dënimit, lirimimin nga dënimi apo në rast të shqiptimit të ndonjë dënimi alternativ ose masën e trajtimit të detyrueshëm të rehabilitimit.

Në rast të aktgjykimit meritore (aktgjykim lirues ose dënues), gjykata në arsyetimin e aktgjykimit duhet të respektoj radhën e paraqitjes së arsyeve si në vijim:

- a) Paraqitja e përmbajtjes së aktakuzës së paraqitur me shkrim ose të ndryshuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit, nëse ka pasur një kërkesë të tillë;
- b) Paraqitja e qëndrimit të të akuzuarit lidhur me akuzën dhe kërkesën pasurore juridike;
- c) Qëndrimin e gjykatës lidhur me aktakuzën;
- d) Prezantimi i provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- e) Analiza e provave;

³⁶⁶ Në rastet kur gjykata e bën bashkimin e dënimeve të shqiptuara me aktgjykime të gjykatave të tjera, përpos që shënohet emri i gjykatës, shënohen edhe numri dhe data e aktgjykimit, ndërsa bashkimi i dënimeve bëhet konform nenit 80 të KPRK.

³⁶⁷ Në bazë të dispozitës së nenit 400 të KPPK, që ka qenë në fuqi deri më datën 31.12.2012, ka qenë e mundur që gjykata në rastet e caktuara me ligj, me rastin e përpilimit të aktgjykimit mos të jep arsyetim të aktgjykimit, ndërsa pas hyrjes në fuqi të KPP, çdo aktgjykim duhet të përmbaj edhe arsyetimin e shkruar.

- f) Vlerësimet e gjykatës lidhur me provat;
- g) Përfundimet e gjykatës lidhur gjendjen e fakteve të vërtetuara;
- h) Arsyet për refuzimin e propozimeve konkrete të palëve;³⁶⁸
- i) Arsyet për vendosjen e fakteve të caktuara nën normën konkrete ligjore;
- j) Përfundimet e gjykatës për ekzistimin ose mosekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale;
- k) Arsyetimet e gjykatës lidhur me rrethanat e rëndësishme për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe sanksioneve të tjera penale;
- l) Arsyet lidhur me vendimet tjera të gjykatës, siç janë : kërkesa pasurore juridike, konfiskimin e dobisë pasurore, shpenzimet e procedurës penale dhe vendimet tjera të përfshira me aktgjykim.

Në aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallë fajtor për veprën penale blankete, në dispozitiv të aktgjykimit, përveç paraqitjes së fakteve dhe rrethanave që paraqesin konstruktin e veprës penale, duhet theksuar edhe dispozitën materialo-juridike nga e cila varet ekzistimi i veprës penale.³⁶⁹

Në aktgjykimin lirues duhet theksuar bazën ligjore për lirimin e të akuzuarit nga akuza dhe në këtë drejtim, në arsyetim, paraqiten të gjitha faktet e vërtetuara që paraqesin bazën për lirimin e të akuzuarit nga aktakuza.

Në aktgjykimin refuzues gjykata nuk paraqet arsye lidhur me çështjen kryesore, por ajo kufizohet vetëm në arsyet për refuzimin e aktakuzës.³⁷⁰

6.6 Përmirësimi i gabimeve të imëta dhe teknike të aktgjykimit

a) Cilat gabime mund të përmirësohen?

Gjykata mund të përmirësoj gabimet e imta dhe ato teknike që qartë kanë të bëjnë emrat, numrat, llogaritjet e gabuara gjatë përpilimit të aktgjykimit.³⁷¹

Gjykata mund të përmirësoj edhe parregullsitë tjera që kanë të bëjnë me mospërputhjen e aktgjykimit të shkruar me origjinalin (aktgjykimin burimor).

Përmirësimet bëhen në kërkesë të palëve, mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare.

³⁶⁸ Me nenin 370 paragrafi 7 të KPP, është përcaktuar detyrimi i gjykatës për paraqitjen e arsyeve për refuzimin e propozimeve konkrete të palëve të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor.

³⁶⁹ Qëndrim i miratuar në Seancën e përbashkët të Gjykatës Federative dhe Gjykatave Supreme të Republikave dhe Krahinave, i datës 26.03.1984.

³⁷⁰ Arsyetimi i aktgjykimit refuzues nuk përmban asnjë arsye tjetër lidhur me faktet, me përjashtim të arsyeve që kanë të bëjnë me refuzimin e aktakuzës, e që janë arsye procedural. P.sh. nëse akuza refuzohet për shkak të parashkrimit, atëherë vetëm paraqiten arsyet lidhur faktet që e vërtetojnë parashkrimin.

³⁷¹ Neni 371 paragrafi 1 i KPP.

b) Kush e bën përmirësimin e gabimeve?

Përmirësimet bëhen ma aktvendim të veçantë dhe aktvendimin për përmirësimin e aktgjykimit e merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

Nëse aktgjykimi përmban gabime të imta apo të padëmshme, dhe këto gabime janë theksuar në ankesë kundër aktgjykimit, atëherë këto gabime i eviton Gjykata e Apelit duke vepruar konform nenit 403 të KPP.³⁷²

c) Si vepron në raste kur aktgjykimi i shkruar ka mospërputhje me origjinalin?

Nëse ka mospërputhje në mes të aktgjykimit të shkruar me origjinalin lidhur me të dhënat e përcaktuara me nenin 365 paragrafi pika 1.1 deri në 1.4 dhe pika 1.6 e KPP, atëherë aktvendimi për korrigjim u dorëzohet të gjithë personave me të drejtë ankesë kundër aktgjykimit sipas neni 369 të KPP.

Në këtë rast afati për ankesë kundër aktgjykimit rrjedhë nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi, e jo nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

d) A është e lejuar ankesa kundër aktvendimit për përmirësimin e aktgjykimit?

Kundër aktvendimit për përmirësimin e aktgjykimit nuk është e lejuar ankesë e veçantë.

6.12 Ekzekutimi i sanksioneve penale pas shpalljes së aktgjykimit

A mund të filloj ekzekutimi i sanksionit penal pas shpalljes së aktgjykimit, para së ai të bëhet i plotfuqishëm?

Ekzekutimi i sanksionit penal të shqiptuar me aktgjykim i cili ende nuk është bërë i formës së prerë mund të filloj në këto raste:

- Kur gjykata ka vendosë për caktimin ose vazhdimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit dhe i akuzuari pajtohet me këtë;
- Kur gjykata me rastin e caktimit të dënimi ka përfshirë edhe dënimin që të akuzuarit i është shqiptuar më parë me aktgjykim të formës së prerë duke vepruar konform dispozitës së nenit 369 paragrafi 5 të KPP.

Në këto raste konsiderohet se i akuzuari është në mbajtje të dënimit dhe tretmani i tij është i njëjtë me personat që janë në mbajtje të dënimit, sipas dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, e jo i personave që janë në paraburgim.³⁷³

³⁷² Neni 371 paragrafi 2 i KPP.

³⁷³ Neni 372 i KPP.

6.13 Urdhërarresti për ekzekutimin e sanksionit penal

Gjykata do të urdhëroj dhënien e urdhërarrestit për të akuzuarin pas shpalljes së aktgjykimit edhe pse aktgjykimi nuk është bërë i formës së prerë nëse:

- Të akuzuarit i është caktuar paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimi për shkak të dënimit me pesë ose më shumë vite burgim, ose së ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e paraburgimit,
- Me rastin e caktimit të dënimit është përfshirë edhe dënimi i shqiptuar me aktgjykim të formës dhe i akuzuari është arratisur jashtë vendit apo i shmanget mbajtjes së dënimit të shqiptuar.

KAPITULLI VII

PROCEDURAT E VEÇANTA

KAPITULLI VII

7.PROCEDURAT E VEÇANTA	192
7.1 Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimor	192
7.1.1 Shqyrtime të përgjithshme	192
7.1.2 Hudhja e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor	192
a) Caktimi i shqyrtimit gjyqësor	193
b) Pranimi i kërkesës së prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrit ndëshkimor.	193
c) Kundërshtimi ndaj aktgjykimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor	194
d) Kthimi në gjendje të mëparshme	194
e) Gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet nga kërkesa për urdhër ndëshkimor dhe as me ndalesën “Reformatio in Peius”	195
7.2 Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore	195
7.2.1 Shqyrtime të përgjithshme	195
7.2.2 Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik të pandehurit.....	195
7.2.3 Caktimi i mbrojtësit	196
7.2.4. Paraburgimi për personat me çrregullime mendor.....	196
7.2.5 Kohëzgjatja dhe vendi i mbajtjes së paraburgimit	196
7.2.6 Seanca e dëgjimit dhe dërgimi i aktvendimit për caktimin e paraburgimit	197
7.2.7 Aplikimi i përshtatshmërisht i dispozitave të KPP lidhur me paraburgimin	197
7.2.8 Aktvendimi mbi aftësinë për t’iu nënshtruar gjykimit.....	197
7.2.9 Pushimi apo ndërprerja e procedurës për shkak të aktvendimit mbi paaftësinë për t’iu nënshtruar gjykimit.....	197
7.2.10. Propozimi i prokurorit për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik	198
7.2.11. Shqiptimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik	198
7.2.12 Vendimet gjyqësore	199
7.2.13 E drejta në ankesë	200
7.2.14 Shqiptimi dhe llogaritja e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik	200
7.3 Procedura për revokimin e dënimeve alternative.....	200
7.3.1 Shqyrtime të përgjithshme	200
7.3.2. Revokimi i dënimit me kusht.....	201
a) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të kryerjes së veprës së re penale	201
b) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës tjetër penale të kryer më parë	202
c) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me dënimin me kusht	202
7.3.3. Revokimi i dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues..	203
7.3.4. Revokimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.	203
7.3.5. Revokimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.....	204

7. PROCEDURAT E VEÇANTA

7.1 Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor

7.1.1 Shqyrtime të përgjithshme

Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor konsiderohet një nga procedurat e veçanta që parashihen në KPP.

Esenca e kësaj procedure qëndron në atë se ofrohet mundësia e përfundimit të çështjes penale dhe shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor.

Në paragrafin 1 të nenit 493 të KPP, është parashikuar se për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në 3 (tri) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të pandehurit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Prokurori i shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënim me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjykimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.³⁷⁴

Kur kërkesa e prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të jetë paraqitur në gjykatë, atëherë gjyqtari i vetëm ka këto tri mundësi:

- Ta hudh kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor;
- Ta caktojë shqyrtimin gjyqësor ose
- Ta pranojë kërkesën e prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

7.1.2 Hudhja e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor

Gjyqtari i vetëm e hudh kërkesën e prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor në dy raste:

- Nëse kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor është paraqitur për vepra penale për të cilat nuk mund të paraqitet kërkesë e tillë. Në këtë aspekt, siç është cekur edhe më lart, kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor mund të paraqitet për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- Nëse prokurori i shtetit kërkon shqiptimin e dënimit i cili sipas ligjit nuk është i lejueshëm. Siç është cekur edhe më lart, duke u bazuar në nenin 493

³⁷⁴ Neni 493 paragrafi 2 i KPP.

paragrafi 2 të KPP, prokurori i shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënim me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjykimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Gjyqtari i vetëm e hedh kërkesën e prokurorit shtetit me aktvendim, i cili duhet të jetë i arsyetuar.

Kolegji shqyrtues në afat prej 48 (dyzet e tetë) orëve vendos për ankesën e prokurorit të shtetit kundër aktvendimit mbi hudhjen e kërkesës.

a) Caktimi i shqyrtimit gjyqësor

Kur kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor të jetë paraqitur në gjykatë, gjyqtari i vetëm pasi që ta pranojë aktakuzën e cakton shqyrtimin gjyqësor në këto 2 raste:

- Kur gjyqtari i vetëm çmon se të dhënat në aktakuzë nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor ose
- Nga të dhënat në aktakuzë mund të pritët shqiptim i ndonjë dënimi tjetër nga ai që e ka propozuar prokurori i shtetit.³⁷⁵

Me rastin e caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, duhet që përshtatshmërisht të aplikohen dispozitat ligjore që i referohen shqyrtimit gjyqësor në procedurën e rregullt penale.

b) Pranimi i kërkesës së prokurorit të shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Nëse gjyqtari i vetëm pajtohet me kërkesën, ai jep urdhër ndëshkimor me aktgjykim. Gjyqtari i vetëm duhet që në aktgjykimin me të cilin jep urdhrin ndëshkimor, të shënojë se pranohet kërkesa e prokurorit të shtetit dhe se shqiptohet dënimi nga kërkesa ndaj të pandehurit, të dhënat personale të cilit duhet shënuar qartë. Dispozitivi i aktgjykimit mbi urdhrin ndëshkimor përfshin të dhënat e nevojshme nga neni 365 paragrafi 1 i KPP,³⁷⁶

³⁷⁵ Neni 494 paragrafi 2 i KPP.

³⁷⁶ Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se aktgjykimi me të cilin i pandehuri shpallet fajtor përmban: veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK; emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit; dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga KPRK ose lirimim nga dënimi; urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryerësve të varur nga droga dhe alkooli, ose për konfiskimin e dobisë pasurore që i nënshtrohet konfiskimit; vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimin të mëparshëm në lartësinë e dënimin dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, si dhe përcaktimin se a duhet shpallur aktgjykimin e formës së prerë në shtyp, në radio apo në televizion. Kur i pandehuri dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës.

përfshirë vendimin për kërkesën pasurore juridike nëse është paraqitur propozimi për realizimin e saj. Ndërsa, në arsyetimin e aktgjykimit, gjyqtari i vetëm duhet që t'i shënojë provat që arsyetojnë dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Aktgjykimi për dhënien e urdhrin ndëshkimor duhet që gjithashtu, të përmban edhe udhëzimin për të drejtën e paraqitjes së kundërshtimit, si dhe njoftimin se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtim nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar kundër të pandehurit.³⁷⁷

Aktgjykimi për dhënien e urdhrin ndëshkimor i dërgohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, nëse ka mbrojtës, si dhe prokurorit të shtetit.

c) Kundërshtimi ndaj aktgjykimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor

Në nenin 496 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se i pandehuri ose mbrojtësi i tij në afat prej tetë (8) ditëve pas pranimit mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë kundër urdhrin ndëshkimor në procesverbal të gjykatës. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Në të mund të propozohen prova në dobi të mbrojtjes. I pandehuri mund të heqë dorë nga e drejta në kundërshtim, por nga kundërshtimi i paraqitur nuk mund të tërhiqet pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor. Pagimi i gjobës para kalimit të afatit për kundërshtim nuk konsiderohet heqje dorë nga e drejta në kundërshtim.

Gjyqtari i vetëm duhet që ta hudh kundërshtimin, nëse i njëjti është i pa afatshëm ose është paraqitur nga personi i paautorizuar. Kur një gjyqtar i vetëm nuk e hudh kundërshtimin si të pa afatshëm ose të paraqitur nga personi i paautorizuar, cakton shqyrtim gjyqësor lidhur me aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Kolegji prej 3 (tre) gjyqtarësh vendos për ankesë kundër aktvendimit mbi hudhjen e kundërshtimit kundër urdhrin ndëshkimor në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 494 të KPP.³⁷⁸

d) Kthimi në gjendje të mëparshme

Të pandehurit i cili për shkaqe të arsyeshme lëshon afatin për paraqitjen e kundërshtimit, gjyqtari i lejon kthim në gjendje të mëparshme.

Me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, gjyqtari duhet që t'i zbaton dispozitat e neneve 447 dhe 448 të KPP.

³⁷⁷ Neni 495 i KPP.

³⁷⁸ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në mendimin juridik GJ.A-SU.A.771/2013, të datës 18.12.2013, ka sqaruar se “kolegji prej 3 (tre) gjyqtarëve i Gjykatës Themelore është kompetentë për të vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është hedhur kundërshtimi i paraqitur kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor”.

e) Gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet nga kërkesa për urdhër ndëshkimor dhe as me ndalesën “Reformatio in Peius”

Në nenin 497 të KPP, është parashikuar se me rastin e marrjes së aktgjykimit lidhur me kundërshtimin, gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet me kërkesën e prokurorit të shtetit nga neni 493, paragrafi 2 i KPP dhe as me ndalesën “Reformatio in Peius” nga neni 395 i KPP.

7.2 Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore

7.2.1 Shqyrtime të përgjithshme

Një procedurë tjetër e veçantë e parashikuar në KPP është edhe procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore.

Kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm gjykues, duhet që gjatë kësaj procedure parimisht t’i aplikojnë nenet 506³⁷⁹ deri në 518 të KPP. Dispozitat tjera ligjore të KPP duhet t’i aplikohen përshtatshmërisht vetëm nëse me nenet 506 deri 518 të KPP, nuk është parashikuar ndryshe.

7.2.2 Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik të pandehurit

Në paragrafin 1 të nenit 508 të KPP, është parashikuar se në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit të shtetit apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert sipas nenit 146 të KPP për të kryer ekzaminimin psikiatrik të pandehurit për të konstatuar nëse:

- Në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore ose

³⁷⁹ Në nenin 506 të KPP, janë paraqitur domethëniet e disa shprehjeve që kanë të bëjnë me procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se për qëllime të këtij Kapitulli:

1. “Çrregullim mendor” do të thotë çdo paaftësi apo çrregullim i mendjes apo trurit qoftë i përhershëm apo i përkohshëm që rezulton me dëmtim apo çrregullim të funksionimit mendor;
2. “Paaftësi mendore” ka kuptimin e paraparë në paragrafin 1 të nenit 18 të KPRK;
3. “Aftësi e zvogëluar mendore” ka kuptimin e paraparë në paragrafin 2 të nenit 18 të KPRK dhe
4. “Masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik” do të thotë masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor ose masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

- I pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.

Në urdhrin e gjykatës për caktimin e ekspertit shënohet koha kur duhet kryer ekzaminimin psikiatrik i cili duhet kryer brenda dy (2) javësh nga lëshimi i urdhrit.³⁸⁰

Çështjet tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e ekzaminimit psikiatrik të pandehurit janë të rregulluara me paragrafët 2 deri në 8 të nenit 508 të KPP.

7.2.3 Caktimi i mbrojtësit

Me KPP është parashikuar se i pandehuri duhet të ketë mbrojtës nëse shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses. Në raste të tilla, nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, atëherë angazhimin e mbrojtësit mund ta bëjnë përfaqësuesi ligjor i të pandehurit, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe prindi birësues. Nëse as i pandehuri e as personat e lartcekur nuk angazhojnë mbrojtës, atëherë duhet që gjykata të pandehurit t'ia caktojë një mbrojtës me shpenzime publike.³⁸¹

7.2.4. Paraburgimi për personat me çrregullime mendore

Me nenin 509 të KPP është parashikuar edhe mundësia e caktimit të paraburgimit ndaj personave me çrregullime mendore. Kështu, në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar se përveç rasteve nga neni 187 i KPP, ku mund të urdhërohet paraburgimi, gjykata mund të urdhërojë paraburgim ndaj personit nëse:

- Ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;
- Në bazë të ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 508 të KPP, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale dhe
- Personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor dhe si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

7.2.5 Kohëzgjatja dhe vendi i mbajtjes së paraburgimit

Personat me çrregullime mendore paraburgimin e mbajnë në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe paraburgimi mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim në nenin 190 të KPP.³⁸²

³⁸⁰ Neni 508 paragrafi 2 i KPP.

³⁸¹ Neni 57 paragrafi 2 dhe neni 508 paragrafi 2 të KPP.

³⁸² Neni 509 paragrafi 2 i KPP.

Në paragrafin 3 të nenit 509 të KPP, është parashikuar se nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe më pas konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor.

7.2.6 Seanca e dëgjimit dhe dërgimi i aktvendimit për caktimin e paraburgimit

Gjykata merr aktvendim në pajtim me paragrafin 1 ose 3 të nenit 509 të KPP, vetëm pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit, nëse gjendja e tij këtë e lejon dhe pasi të ketë shqyrtuar mendimin e ekspertit. Aktvendimi i tillë i dërgohet prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, institucionit mjekësor dhe qendrës së paraburgimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.³⁸³

7.2.7 Aplikimi i përshtatshmërisht i dispozitave të KPP lidhur me paraburgimin

Dispozitat e KPP mbi paraburgimin zbatohen përshtatshmërisht për paraburgimin e mbajtur në institucionin e kujdesit shëndetësor.³⁸⁴

7.2.8 Aktvendimi mbi aftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit

Pas shqyrtimit të raportit të ekspertit të marrë në pajtim me nenin 508 të KPP dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit, gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të mbrojtësit apo prokurorit të shtetit, duhet të merr aktvendim mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit. Gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit nëse ai aktualisht ka çrregullim mendor dhe për shkak të çrregullimit të tillë mendor ai nuk është i aftë që të mbrohet, të konsultohet me mbrojtësin apo të kuptojë procedurën. Kundër aktvendimit mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit mund të ushtrohet ankesë.³⁸⁵

7.2.9 Pushimi apo ndërprerja e procedurës për shkak të aktvendimit mbi paaftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit

Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit gjatë procedurës për shkak të sëmundjes së përhershme mendore, ajo merr vendim për pushimin e procedurës. Në këto raste procedura rifillohet me kërkesën e prokurorit të shtetit, posa të pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e aktvendimit të tillë.³⁸⁶

³⁸³ Neni 509 paragrafi 4 i KPP.

³⁸⁴ Neni 509 paragrafi 6 i KPP.

³⁸⁵ Neni 510 i KPP.

³⁸⁶ Neni 511 paragrafët 1 dhe 3 të KPP.

Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit gjatë procedurës për shkak se ai ka pësuar ndonjë çrregullim të përkohshëm mendor pas kryerjes së veprës penale, ndërpriten hetimet ose ndërpritet shqyrtimi gjyqësor në pajtim me dispozitat ligjore të KPP.³⁸⁷

Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit në pajtim me nenin 511 të KPP, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurave për pranimin e tij në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor në pajtim me Ligjin për procedurën jokontestimore. Në këtë rast, gjykata mund të merr aktvendim që i pandehuri të ndalet në institucionin e kujdesit shëndetësor për një periudhë maksimale prej dyzet e tetë (48) orëve në pritje të fillimit të procedurave për pranim në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor në pajtim me Ligjin për procedurën jokontestimore,³⁸⁸ nëse si rezultat i çrregullimit mendor të këtij personi ekzistojnë arsyet për të dyshuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.³⁸⁹

7.2.10. Propozimi i prokurorit për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Para hapjes së shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë, siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të KPRK. Nëse provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor e ndryshon aktakuzën dhe paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë bazat për shqiptimin e masës së tillë siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të KPRK.³⁹⁰

7.2.11. Shqiptimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohet pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e cila është kompetente për gjykimin e çështjes në shkallë të parë.³⁹¹ Përveç personave të cilët duhet të thirren në shqyrtimin gjyqësor duhet të thirren edhe ekspertët dhe psikiatrit nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilëve iu është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të akuzuarit. Bashkëshorti/ja e të pandehurit dhe prindërit e tij ose prindërit adoptues njoftohen për shqyrtimin gjyqësor.³⁹²

³⁸⁷ Neni 511 paragrafi 2 të KPP.

³⁸⁸ Ligji nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, i datës 20.11.2008.

³⁸⁹ Neni 511 paragrafi 4 i KPP.

³⁹⁰ Neni 512 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

³⁹¹ Neni 513 paragrafi 1 i KPP.

³⁹² Neni 513 paragrafi 2 i KPP.

Vendimi mbi shqiptimin e masës së tillë bazohet në dëgjimin e personave të thirrur dhe në rezultatet dhe mendimet e ekspertëve. Gjatë marrjes së vendimit mbi shqiptimin e masës, gjykata nuk detyrohet nga propozimi i prokurorit të shtetit.³⁹³

7.2.12 Vendimet gjyqësore

Nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të parapara në nenet 88 dhe 89 të KPRK, ajo e pushon procedurën e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.³⁹⁴

Në rastin kur gjykata vendos të pushojë procedurën në pajtim me paragrafin 1 të nenit 514 të KPP, pas konstatimit se në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori i shtetit mund të heqë dorë nga e drejta e parashtrimit të ankesës kundër këtij vendimi, dhe menjëherë mund të paraqesë aktakuzë.

Aktakuza paraqitet brenda tetë (8) ditësh nga heqja dorë e të drejtës për ankesë. Në këto raste, shqyrtimi gjyqësor rihapet pranë trupit të njëjtë gjykues dhe procedura vazhdon në bazë të aktakuzës së re duke iu nënshtruar këtyre kushteve:

- Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes dhe
- Provat e paraqitura më herët nuk prezantohen përsëri, përveç se në rastet e parapara në nenin 311 të KPP, ose nëse trupi gjykues e çmon të nevojshme që ndonjë pjesë e provës të prezantohet sërish.³⁹⁵

Gjykata merr aktgjykim lirues për të pandehurin nëse i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore kur e ka kryer veprën penale dhe nëse prokurori i shtetit nuk ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me nenin 512 të KPP.³⁹⁶

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohet me aktvendimin e gjykatës, nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe nëse prokurori i shtetit ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me nenin 512 të KPP.

Në aktvendimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, duhet të theksohen:

³⁹³Neni 513 paragrafi 3 i KPP.

³⁹⁴Neni 514 paragrafi 1 i KPP.

³⁹⁵Neni 514 paragrafët 5 dhe 6 të KPP.

³⁹⁶Neni 514 paragrafi 2 i KPP.

- Vepra të cilën është vërtetuar se e ka kryer i pandehuri, kualifikimi juridik i veprës dhe dispozitat e zbatuara të ligjit penal;
- Vendimin që i pandehuri e ka kryer veprën në gjendje të paaftësisë mendore dhe
- Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik që i është shqiptuar të pandehurit.³⁹⁷

7.2.13 E drejta në ankesë

Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit, përveç të dëmtuarit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktvendimit të gjykatës brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së aktvendimit.

7.2.14 Shqiptimi dhe llogaritja e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 88 dhe 89 të KPRK. Kjo masë mund të shqiptohet pavarësisht nëse i pandehuri ndodhet në liri apo ndaj tij është shqiptuar dënimi me burgim. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor në pajtim me nenin 508, me urdhrin për paraburgim në pajtim me nenin 509 të KPP ose me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, llogaritet në dënimin e shqiptuar.³⁹⁸

7.3. Procedura për revokimin e dënimeve alternative

7.3.1 Shqyrtime të përgjithshme

Në nenin 49 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se dënimet alternative janë:

- Dënimi me kusht;
- Gjysmëliria dhe
- Urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit 49 të KPRK, është parashikuar se kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

- Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe
- Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

³⁹⁷ Neni 514 paragrafi 3 i KPP.

³⁹⁸ Neni 515 i KPP.

Dënimi me kusht është pezullim i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar për një kohë të caktuar dhe me kushte të caktuara. Nëse personi i dënuar me kusht nuk kryen veprë penale të re, brenda afatit të caktuar dhe nëse i përmbush kushtet të cilat ia ka caktuar gjykata, dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet. Në të kundërtën, nëse personi i dënuar me kusht gjatë afatit të pezullimit të këtij dënimi, kryen veprë të re penale apo nuk i përmbush kushtet e tjera, të cilat ia ka caktuar gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, ky lloj i sanksionit penal mund të revokohet, përkatësisht do të revokohet, kështu që personi i dënuar me kusht do të detyrohet ta mbajë dënimin.

7.3.2. Revokimi i dënimit me kusht

Revokimi i dënimit me kusht, mund të bëhet për këto tri shkaqe:

- Nëse i dënuari gjatë periudhës së verifikimit kryen veprë të re penale,
- Nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht vërtetohet se i dënuari ka kryer veprë penale, para se të jetë dënuar me kusht dhe
- Nëse i dënuari nuk i ka përmbushur detyrimet, të cilat i janë caktuar me dënim me kusht.

a) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të kryerjes së veprës së re penale –

Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës penale të re mund të jetë obligativ dhe fakultativ.

Në mënyrë obligative, gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim prej së paku dy apo më tepër vjet.³⁹⁹

Sipas paragrafit 2 të nenit 53 të KPRK, gjykata mund (mënyra fakultative) ta revokojë dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim me më pak se dy vjet ose dënim me gjobë pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.

Nëse e revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 80 të KPRK dhe trajton dënimin e revokuar me kusht si të përcaktuar.

³⁹⁹ Neni 53 paragrafi 1 i KPRK.

Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, mund ta shqiptojë dënimin me kusht apo dënimin me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, gjykata zbaton dispozitat e nenit 80 të KPRK për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se një (1) vit e as më shumë se pesë (5) vjet, duke filluar prej ditës kur vendimi për dënimin bëhet i formës së prerë. Nëse gjykata shqipton dënim me burgim për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë.⁴⁰⁰

b) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës tjetër penale të kryer më parë

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me vendim të formës së prerë konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër.

c) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me dënimin me kusht –

Në nenin 519 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se kur dënimi me kusht kushtëzohet me njërin nga detyrimet nga neni 51 i KPRK dhe i akuzuari nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata themelore fillon procedurën për revokimin e dënimit me kusht sipas propozimit të prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit ose sipas detyrës zyrtare.

Gjyqtari të cilit i caktohet çështja gjyqësore, merr në pyetje të dënuarin kur është i arritshëm dhe shtron pyetjet e nevojshme për vërtetimin e fakteve dhe mbledhjen e provave që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjes, e pastaj shkresat ia dërgon kolegjit.

Kryetari i kolegjit cakton seancën e kolegjit për të cilën e lajmëron prokurorin e shtetit, të dënuarin dhe të dëmtuarin. Mos prania e palëve dhe e të dëmtuarit nëse janë thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit.

Kur gjykata vërteton se i dënuari nuk e ka përmbushur detyrimin e caktuar me aktgjykim, atëherë merr aktgjykimin në pajtim me nenin 55 të KPRK.⁴⁰¹

Në nenin 55 të KPRK është parashikuar se nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një apo më shumë kushteve të paraparë me paragrafin 3 të nenit 51 të

⁴⁰⁰ Neni 53 paragrafët 3 dhe 4 të KPRK.

⁴⁰¹ Neni 519 paragrafët 2, 3 dhe 4 të KPP.

KPRK⁴⁰² dhe nenin 59 të KPRK⁴⁰³ dhe personi i dënuar nuk përmbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mund ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj.

7.3.3. Revokimi i dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

Në nenin 57 paragrafi 4 të KPRK, është parashikuar se nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

7.3.4. Revokimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Edhe në nenin 58 paragrafi 4 të KPRK, është parashikuar mundësia e revokimit të dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. Kështu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së

⁴⁰² Në nenin 51 paragrafi 3 të KPRK është parashikuar se në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e këtij Kodi. Gjukata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit.

⁴⁰³ Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme:

1. mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
2. nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
3. vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
4. aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
5. kryerja e aktiviteteve punuese;
6. shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;
7. mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
8. heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
9. heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;
10. heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
11. heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
12. të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
13. të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
14. të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose
15. të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht, nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 59 të KPRK, siç është urdhëruar nga gjykata.

7.3.5. Revokimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata ka dy mundësi:

- Ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose
- Ta revokojë dënimin.⁴⁰⁴

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.⁴⁰⁵

⁴⁰⁴ Neni 60 paragrafi 5 i KPRK.

⁴⁰⁵ Neni 60 paragrafi 6 i KPRK.

KAPITULLI VIII
PËRMBLEDHJE E DISA
VENDIMEVE GJYQËSORE,
PROCESVERBALEVE DHE
SHKRESAVE TJERA

KAPITULLI VIII

Formulari numër 1. Procesverbali seancës dëgjimore mbi paraburgimin	208
Formulari numër 2. Aktvendim për caktimin e paraburgimit.....	212
Formulari numër 3. Aktvendim për lirin nga paraburgimi	215
Formulari numër 4. Aktvendim për heqjen e masës së paraburgimit	218
Formulari numër 5. Aktvendim për vazhdimin e masës së paraqitjes në stacionin policor	221
Formulari numër 6. Procesverbal i shqyrtimit fillestar	223
Formulari numër 7. Aktvendim për hudhjen e aktakuzës	226
Biografia e Autorëve.....	229
LITERATURA:	231

Formulari numër 1. Procesverbali seancës dëgjimore mbi paraburgimin

PPrKR. Nr.../..

PROCESVERBAL

I SEANCËS DËGJIMORE MBI PARABURGIMIN

I përpiluar me datën _____, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, para gjyqtarit të procedurës paraprake _____

Duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit PPI.nr./2013 të datës 01.10.201..., për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit _____ nga fshati _____ Komuna _____ për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale: Kontrabandimi me Migrant nga neni 170 par. 1 të KPRK-ës.

TË PRANISHËM JANË:

Gjyqtari i procedurës paraprake,

I pandehuri,

Sekretarja juridike,

Gjatë marrjes në pyetje të pandehurin marrin pjesë:

1 Prokurori i Shtetit _____

2. Mbrojtësi, avokati _____

3. I dëmtuari,

4. Përkthyesi

Filloj në ora 11:40

I pandehuri _____ me shënime personale si në kërkesën për caktimin e paraburgimit PPI.nr.../2013 të datës 31 tetor 2013, me ndryshime, me vendbanim përkohësisht me punë në Gjermani.

I pandehuri është ndaluar me datën 30.09.2013, në ora 21:00 kurse është sjellë të gjyqtari i procedurës paraprake me datën 01.10.2013, në ora 11:00.

I pandehuri është njoftuar mbi të drejtat e tij në kuptim të nenit 167 të KPP.

Se në cilësinë e personit të arrestuar gëzon këto të drejta:

1. të informohet në gjuhën që ai kupton për arsye të arrestimit;
2. të hesht dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij;
3. të sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet seanca dëgjimore për caktimin e paraburgimit;
4. të shfrytëzoj ndihmën e mbrojtësit dhe ti caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguaj për ndihmë juridike;
5. për arrestimin e tij të lajmëroj ose të kërkoj nga policia ta lajmëroj anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij;
6. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Më tutje i pandehuri theksoj: unë kam kuptuar të drejtat e mia që më takojnë sipas ligjit, përndryshe unë do të deklarohej lidhur me kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së paraburgimit, avokat mbrojtës kam të angazhuar avokatin _____, me rastin e arrestimit nga ana e policisë kam lajmëruar anëtarët e familjes, po ashtu më është ofruar kontrollim dhe trajtim mjekësor, për të cilin nuk kam pasur nevojë.

Prokurori i Shtetit _____, përkritazi me kërkesën për caktimin e paraburgimit deklaroj: *mbetem në tërësi pranë kërkesës së paraburgimit kundër kërkesës për _____ dhe _____ është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve për shkak të dyshimit se të njëjtit kanë kryer veprën penale Kontrabandimi me Migrantë nga neni 170 par. 1 lidhur me neni 31 të KPK-së. Aktvendimi është marrë për shkak të dyshimit se i njëjti ka trafikuar migrantë nga Republika e Kosovës nëpër vende të ndryshme të Evropës dhe atë me qëllim të përfitimit pasuror duke marrë shuma të ndryshme të parave nga 3000€ deri në 3500 dhe të njëjti i ka bartur me automjetin e tij "Audi ..." me targa Gjermane _____ dyshimi i bazuar rezulton nga provat të cilat janë siguruar në procedurën paraprake duke u nisur nga masat e fshehta teknike të vëzhgimit siç janë: përgjimi i telekomunikimeve regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe nxjerrja e sms-ve, fotografimi apo vëzhgimi i fshehtë me video në vende publike nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës.*

Në rastin konkret ekzistojnë baza ligjore të artikulueshme për caktimin e paraburgimit janë përmbushur nga neni 187 par. 1 nënpar. 1.1, 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2, dhe 1.2.3 të KPP-së.

Pika 1.2.1 përmbushet se po të gjendet në liri i pandehuri ekziston rreziku i ikjes për faktin se i njëjti është edhe me qëndrim të përhershëm në Gjermani në qytetin Dureln afër Keln-it, dhe duke pasur parasysh

faktin se për këtë veprë është paraparë dënimi 2-10 vite burgim, ekziston rreziku i ikjes me çka do të pengonte zhvillimin e procedurës penale.

Pika 1.2.2, në këtë çështje penale akoma para prokurorit nuk janë dëgjuar dëshmitarët – viktimat _____ dhe _____, i dhe dëshmitarët e tjerë _____ etj., i cilët mund të jenë viktima andaj po të gjenet në liri i njëjti mund të ndikoj tek dëshmitarët me çka do të ndikonte në rrjedhën e procedurës penale.

Pika 1.2.3, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri dyshohet të ketë ushtruar këtë veprimtari që një kohë të gjatë dhe atë prej datën7.2013 deri në ditën kur është ndaluar, karakteristikat e tij personale vendi ku dyshohet se është kryer vepra penale peshë e kësaj veprë si dhe duke pasur parasysh moshën e viktimave ekziston rreziku i përsëritjes së kësaj veprë penale.

Andaj masat tjera të parapara nga neni 173 të KPP nuk do të jenë të mjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit si dhe zbatimin e suksesshëm të procedurës penale andaj i propozoj Gjyqtarit të Procedurës paraprake për Krimet e Rënda, që konform nenit 187 par. 1, nënpar. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së të pandehurit ti caktoj masën e paraburgimit.

I pandehuri _____ në mundësinë e tij për tu deklaruar në lidhje me çështjen e paraburgimit deklaron: konsideroj se nuk ekziston dyshimi i bazuar për tu caktuar paraburgimi unë nuk kam kryer veprat penale për të cilat po pretendon Prokurori i Shtetit.

Për më tepër arsyeja e qëndrimit rreth 5 muaj në Kosovë ka qenë e natyrës personale nga fakti se bashkëshortja ime ka pasur probleme rreth shtatzënisë ashtu që për këtë arsye kamë qëndruar në Kosovë derisa ka pasur sukses shtatzënia e saj. Përndryshe e njëjta tani vazhdon kurimin në Prishtinë e sipas mjekëve duhet që ky kurim të zgjatë diku deri në 6 muaj, por sa i përket pretendimeve të prokurori i shtetit lidhur me veprimet që kam kryer ato asnjë nuk qëndrojnë. Po shtoj po ashtu faktin se unë që 19 vite punoj në Gjermani kurse në Kosovë në _____ jeton vetëm bashkëshortja ime dhe një fëmijë i moshës 12 vjeçare dhe askush tjetër. Ashtu që kërkoj nga Gjykata që të mos më caktoj paraburgimin ngase është afati i fundit që të lajmërohem në Gjermani

Mbrojtës i të akuzuarit me autorizim avokati _____ deklaron: unë nuk jam në gjendje që ta pohoj apo ta mohoj ekzistimin e dyshimit të bazuar për shkak të faktit se unë si avokat i _____ ende nuk jam pajisur me dokumentacion përkatës që do ta vërtetonin apo mohonin këtë edhe në rast se Gjykata bindet se ekziston dyshimi i bazuar në besojmë se arsyet ligjore nuk janë përmbushur që klientit tim ti caktohet masa e paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës dhe për zhvillimin e papenguar të procedurës penale me faktin se ligji na obligon që fillimisht të tentojmë të arrihen efektet e njëjta me masa më të buta. Unë Gjykatën do ta lus që të ketë parasysh fillimisht Aktvendimin për fillim të hetimeve në të cilin Prokuroria ka vendosur që të filloj dhe të zhvilloj hetimet kundër klientit tim _____ për veprë të njëjtë penale i cili është shqiptar, por, me vendbanim në Republikën e Serbisë dhe është paksa e çuditshme se si Prokuroria i zhvillon hetimet për veprën e njëjtë ndërsa paraqet kërkesë për paraburgim vetëm për _____ kjo nuk duhet të kuptohet nga mbrojtja e _____ se ne jemi duke kërkuar që të bëhet kërkesa edhe për _____ pastaj Prokuroria pretendon se ekziston rreziku i ikjes së klientit tim gjë që nuk është e vërtet ai me rastin e arrestimit të tij ka qenë duke udhëtuar në mënyrë krejtësisht legale për në Gjermani ku ai është me punë të përkohshme që 19 vite dhe vetëm ky fakt arrestimi i tij në afërsi të kufirit nuk do të thotë se ai ka qenë apo se mund të iki gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale Gjykata edhe dyshimin e këtitillë të ikjes mund ta parandaloj me një mori masash të tjera siç janë kaucioni , marrja e përkohshme e pasaportës se e cila veprë është marrë dhe gjendet tek Prokurorja e çështjes dhe masa të tjera ligjore.

Sa i përket rrezikut të kinse ndikimin në dëshmitar kjo prapë mund të parandalohet me masa alternative të parapara me dispozitën e nenit 173 të KPP-së, e që mund të jetë ndalimi i ofrimit kontaktimit të tyre dhe

dëshmitarëve të tjerë potencial, por, kjo arsye nuk mund të qëndroj edhe për faktin se me atë. Për fillimin e hetimeve të prokurorisë është shënuar se dyshimi i bazuar rrjedh nga kallëzimi penal etj. Si dhe dëshmia e dëshmitarëve _____, këta dëshmitarë përmenden nga prokuroria edhe si të dëmtuar por Prokuroria dhe Gjykata i ka deklarata e tyre të cilat sido që të jenë janë deklarata të vlefshme në bazë të ligjit. Sa i përket rrezikut të përsëritjes së kësaj veprë penale për këtë mund të themi se kemi të bëjmë me person të padënuar gjë që e vërtetoj edhe Prokuroria dhe mbrojtja nuk sheh arsye për eleboorim të mëtejme të kësaj rrethane.

Kur kemi të bëjmë me rrezikun e ndikimit në prova ne duam vetëm të potencojmë se Prokuroria është thirrur në masa të fshehta teknike të përgjimit, thirrjen, fotografimi, etj. Gjë që është e çartë se _____ por edhe askush tjetër nuk ka mundësi që ato ti ndryshoj ngase ato janë prova që janë siguruar nga hetuesit policor dhe gjenden të Prokuroria.

Duke pasur parasysh gjendjen tepër specifike familjare të klientit tim unë ju lus që eventualisht të caktoni një apo më tepër masa alternative të paraparë me ligj që mos të vij në situatë që klienti im të humbi punën në Gjermani që gjendet që 19 vite dhe të krijojme raste sociale pa nevojë ndërsa unë personalisht besoj se kaucioni në shumën që do ta përcaktoj Gjykata në lidhje me masa tjera do të ishte e mjaftueshme që pa pengesa të zhvillohet procedurën penale. është e qartë se karakteristikat personale të klientin tim mundën vetëm eventualisht të ndikojnë për mos caktimin e paraburgimit por jo të kundërtën.

Procesverbali është diktuar me zë, palët deklarojnë se nuk kanë vërejtje në përmbajtje të procesverbalit dhe të njëjtin e nënshkruajnë pa vërejtje.

Mbaroi në ora 12:30.

I pandehuri:

Prokurori i Shtetit

Mbrojtësi:

Vërtetojnë:

Sekretarja juridike,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

Formulari numër 2. Aktvendim për caktimin e paraburgimit

PPRKR../13

GJYKATA THEMELORE NË _____ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA me gjyqtarin e procedurës paraprake – Gjyqtarin _____ dhe me sekretaren juridike _____, në lëndën penale kundër të pandehurit _____, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale Kontrabandimi me Migrantë nga neni 170 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PPI.nr. 177/2013 të dt. 01.10.2013, e në kuptim të nenit 187 par.1 të KPP-së në prezencë të Prokurorit të Shtetit _____, të pandehurit _____ dhe mbrojtësit të tij me autorizim avokati _____, me datën 2 shtator 2013, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit _____ nga i ati _____ dhe e ëma _____, e gjinisë _____, i lindur me _____ në fshatin _____, Komuna _____ me vendbanim në njëtin vend, me punë të përkohshme në _____ shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i një fëmije, i ndaluar nga dt. 30.09.2013, ora 21:00, **CAKTOHET MASA E PARABURGIMIT** në kohëzgjatje për 1 (një) muaj, duke filluar nga data 30 shtator 2013, i cili sipas këtij aktvendimi do të zgjas deri me datën 29 tetor 2013.

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krimet e Rënda, ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit të PPI.nr. 177/2013 të dt. 01.10.2013 kundër të pandehurit _____ për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Kontrabandimi me Migrantë nga neni 170 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj kërkesë, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë paraqitur argumentet e tyre Prokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi kërkesën nëse ekzistojnë arsyet për caktim të paraburgimit dhe gjeti se qëndrojnë bazat për caktimin e masës së paraburgimit në këtë stad të procedurës penale dhe atë:

Baza ligjore të përcaktuara nga nen. 187 par. 1 nënpar 1.1 meqë ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale të përcaktuar sipas kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit, i cili dyshim vërtetohet në bazë të provave të cilat janë prezantuar në seancën dëgjimore dhe atë nga masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit – përgjimi i telekomunikimeve (ku vërtetohet se i pandehuri ka komunikuar përmes telefonit të tij mobil me nr. 045_____ ka komunikuar vazhdimisht me persona të ndryshëm, e që përmbajtja e këtyre bisedave ndërlidhet me kontrabandimin me migrantë)⁴⁰⁶, regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe sms-ve si dhe vëzhgimi i fshehtë me video në vende publike (ku shihen personat duke kaluar kufirin Kosovë – Serbi si dhe automjeti i të pandehurit), e po ashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve_____

Po ashtu janë përmbushur kushtet për caktimin e paraburgimit të përcaktuara nga neni 187 par. 1 nënpar 1.2 pika (1.2.1), dhe atë ekzistojnë rrethana të posaçme, të cilat tregojnë rrezikun e ikjes meqë në rastin konkret i pandehuri posedon leje qëndrimi në Shtetin e Gjermanisë dhe mund të largohet nga Kosova, për më tepër edhe vetë vendi i arrestimit të tij është bërë në pikën kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë duke udhëtuar për në Gjermani, e që potencialisht paraqet një rrezik konkret dhe real se mund t'i shmanget procedurës së mëtutjeshme penale.

Megjithatë Gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë sa i përket pikave 1.2.2 dhe 1.2.3 nuk është e bazuar nga fakti se në këtë çështje penale siç edhe rezulton nga aktvendimi për fillimin e hetimeve tanimë janë dëgjuar dëshmitarët _____ dhe pikërisht dyshimi i bazuar vërtetohet përmes dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve.

Të dyshuarit dyshohet se kanë kryer veprë të rëndë penale e për më tepër ekziston rrezik konkret dhe real se mund të largohen nga Kosova, kurse sa i përket pikës (1.2.2) ka arsye për të besuar se të pandehurit do të pengojnë rrjedhën e procedurës penale përkatësisht do të mund të ndikojnë në dëshmitarët që do të dëgjohen gjatë kësaj procedure, dhe atë këtë rrezik e bënë edhe më të besueshëm fakti se disa nga dëshmitarët jetojnë në të njëjtën qytet me të _____ e po ashtu ekziston rrezik konkret dhe real se nga rrethanat nga të cilat është kryer vepra penale (e planifikuar deri në detalet më të imta) japin për të kuptuar se të pandehurit do të mund të përsërisin vepra të kësaj natyre përkatësisht ekziston rrezik konkret dhe real se do të përfundojnë veprën e tentuar penale.

Gjykata me kujdes të veçantë ka shqyrtuar pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve që ndaj tyre të aplikohen masa tjera përkatësisht masa e arrestit shtëpiak me anë të secilës do të arrihej i njëjti objektiv që do të arrihej edhe me masën e paraburgimit por aplikimi i masave tjera nga neni 173 par. 1 të KPP-ës, është i pa mjaftueshëm dhe nuk do të ishin te

⁴⁰⁶ Shih transkriptet e bisedave telefonike të urdhëruara sipas urdhëresës UGJK ../13

mjaftueshme për sigurimin e pranisë së të pandehurve, për pengimin e ri kryerjes si dhe zbatim të suksesshëm të procedurës penale

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

PPRKR ../13 e dt. 02.08.2013

Sekretarja juridike

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Formulari numër 3. Aktvendim për lirim nga paraburgimi

PKR.../.

GJYKATA THEMELORE NË _____ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA me gjyqtarin e procedurës paraprake, gjyqtarin _____ dhe me sekretaren juridike _____, në lëndën penale kundër të pandehurit _____ për shkak të të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale kontrabandimi me migrantë nga neni 170 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas propozimit të mbrojtëses së të akuzuarit avokati _____ dhe pëlqimit të Prokurorisë Themelore në F PP.I.nr. .../2013 të dt. 2...12. 2013, me datën 27 dhjetor 2013, konform nenit 179 par. 1 të KPP-së mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i mbrojtëses së të pandehurit _____ avokati _____ i dt. 26.12.2013 dhe zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e dorëzarisë.

II. URDHËROHET, LIRIMI NGA PARABURGIMI me dt. 27.12.2013 dhe caktohet **MASA E DORËZANISË** në shumë prej 15000 /pesëmbëdhjetë mijë/ €.

III. Nëse i akuzuari nuk i përgjigjet ftesave të Gjykatës mjetet e caktuara në dorëzani do të derdhen në fondin për kompensimin e viktimave dhe të njëjtit mund ti caktohet paraburgimi.

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krimet e Rënda, ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit të PPI.nr. 177/2013 të dt. 01.10.2013 kundër të pandehurit _____, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Kontrabandimi me Migrantë nga neni 170 par. 1 të KPRK-së, e cila masë është caktuar dhe është vazhduar deri më dt. 28.12.2013.

Mbrojtësja e të pandehurit avokati. _____ ka paraqitur propozimin e dt. _____12.2013 që ndaj të pandehurit _____ të zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e dorëzarisë dhe atë në shumë prej 15000/pesëmbëdhjetëmijë/€.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me shkresën PP.I./2013 të dt.2013 ka dhënë pëlqimin që të pandehurit _____ t'i zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e dorëzansë.

Gjykata duke vepruar sipas këtij propozimi, e konform nenit 179 shqyrtoi mundësinë që i pandehuri të lirohet nga paraburgimi me dorëzani dhe gjeti se:

Ekzistojnë bazat ligjore të përcaktuara nga nen. 179 par. 1 nënpar 1.1 meqë ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, i cili dyshim vërtetohet në bazë të provave të cilat janë prezantuar në seancën dëgjimore dhe atë nga masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit – përgjimi i telekomunikimeve (ku vërtetohet se i pandehuri ka komunikuar përmes telefonit të tij mobil me nr. 045....., ka komunikuar vazhdimisht me persona të ndryshëm, e që përmbajtja e këtyre bisedave ndërlihet me kontrabandimin me migrantë),⁴⁰⁷ regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe sms-ve si dhe vëzhgimi i fshehtë me video në vende publike (ku shihen personat duke kaluar kufirin Kosovë – Serbi si dhe automjeti i të pandehurit), e po ashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, NN, NN dhe NN

Po ashtu janë përmbushur kushtet të përcaktuara nga neni 179 par. 1 nënpar 1.2 dhe atë ekzistojnë rrethana të posaçme, të cilat tregojnë rrezikun e ikjes meqë në rastin konkret i pandehuri posedon leje qëndrimi në Shtetin e Gjermanisë dhe mund të largohet nga Kosova, për më tepër edhe vetë vendi i arrestimit të tij është bërë në pikën kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë duke udhëtuar për në Gjermani, e që potencialisht paraqet një rrezik konkret dhe real se mund t'i shmanget procedurës së mëtutjeshme penale.

Duke u mbështetur në propozimin e dt. 27.12.2013 mbrojtësit i të pandehurit konsideron se i pandehuri çdo herë do t'i përgjigjet ftesave të gjykatës, si dhe duke pasur parasysh që të pandehurit, i është konfiskuar pasaporta e Kosovës, Gjykata konsideron se i njëjti nuk do të iki nga Kosova dhe do ti përgjigjet ftesave të Gjykatës.

Gjykata me rastin e vlerësimit të propozimit veçanërisht pati parasysh faktin se paraburgimi duhet te hiqet në çdo fazë të procedurës penale.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË- DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

PPR.KR ../13 e dt.2013.

⁴⁰⁷ Shih transkriptet e bisedave telefonike të urdhëruara sipas urdhërësës UGJK .../..

Sekretarja juridike

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në _____.

Formulari numër 4. Aktvendim për heqjen e masës së paraburgimit

PKR nr.../13

GJYKATA THEMELORE NË -DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, me Gjyqtarin e procedurës paraprake NN dhe Sekretaren juridike NN në çështjen penale kundër të pandehurit _____, nga fsh. _____ Komuna _____ për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga nen. 327 par 2 nënpar. 2.1 dhe 2.2 lidhur par. 1 dhe nen. 31 të KPK-së duke vendosur sipas detyrës zyrtare lidhur me masën e paraburgimit, e në kuptim të nenit 191 par.1 të KPP-së, me datën 20 shkurt _____ mori këtë:

A K T V E N D I M

Kundër të pandehurit _____, nga i ati _____ dhe e ëma _____ e gjinisë _____ i lindur me _____ në _____, me vendbanim në fsh _____ Komuna _____, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën fillore, pa profesion, i pa punë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, gjendet në paraburgim prej datës _____ në ora 16:00.

HIQET MASA E PARABURGIMIT, ashtu që i akuzuari do të lirohet nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan, menjëherë me datë 20 shkurt 2013.

Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në _____ ka paraqitur aktakuzën PP.nr. II-.....13 të dt. 11.02.2013 kundër të pandehurit _____, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par 2 nënpar. 2.1 dhe 2.2 lidhur par. 1 dhe nen. 31 të KPK-së, si dhe propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, ndaj të pandehuri _____, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë në vazhdim nga neni 327 par 2 nënpar. 2.1 dhe 2.2 lidhur par. 1 dhe nenit 31 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar konform dispozitës së nenit 193 par.1 të KPP-së, para se të vendosë në lidhje me masën e paraburgimit, me parashtresë ka kërkuar mendimin nga ana e

Prokurorisë Themelore në Ferizaj, nga ana e avokatit të të pandehurit, avokati _____ si dhe të pandehurit _____

Prokurori i Shtetit pas marrjes së parashtrësës për dhënien e mendimit për masën e paraburgimit, përmes kërkesës ka kërkuar vazhdim të masës së paraburgimit, e që Gjykata këtë kërkesë e ka trajtuar sikurse dhënia e mendimit, për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Kryetari i Trupit Gjykues sipas detyrës zyrtare pasi që paraprakisht shqyrtoi kërkesën (mendimin) e Prokurorit të Shtetit, vërtetoi se ekziston dyshimi i bazuar në bazë të nenit 187 par. 1 nënpar 1.1 të KPP-së, se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë.

Megjithatë Gjykata vlerësoi nëse në këtë fazë të procedurës (pas paraqitjes së akuzës) ende ekzistojnë arsyet për vazhdim të paraburgimit të parapara me nenin 187 par. 1 nënpar.1.2 pikat (1.2.1) dhe (1.2.3) dhe në kontest të saj vlerëson se:

- nuk është i nevojshëm vazhdimi i mëtutjeshëm i masës së paraburgimit, sa i përket pikës (1.2.1), meqë me asnjë rrethanë konkrete nuk është arsyetuar se i akuzuari mund të fshihet apo ekziston rreziku i ikjes së tij, kjo rrethanë është e natyrës abstrakte dhe e paqëndrueshme, e pa mbështetur me asnjë provë konkrete, për më tepër nga pretendimi nuk vërtetohet me asnjë të dhënë fakti se “ ... i akuzuari ka qenë në arrati dhe gjatë dy jave nuk ka mundur të kapet nga organet e ndjekjes...”⁴⁰⁸

- po ashtu edhe përkitazi me pikën (1.2.3), nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e posaçme që do të bënin të besueshëm faktin se i akuzuari do të përsërisë vepra të kësaj natyre, meqë përveç frazës së paraqitur në kërkesë “... është kryes i shumë veprave penale...”⁴⁰⁹, nuk është paraqitur asnjë fakt i specifikuar dhe i konkretizuar se është kryes as edhe një veprë penale, po ashtu nuk është paraqitur se çfarë është natyra e veprave penale që dyshohet se ka kryer i akuzuari dhe në cilën fazë të procedurës janë këto vepra të dyshuara penale.

Nga të gjitha shkresat që posedon Gjykata dhe nga kërkesa (mendimi) i Prokurorit të Shtetit, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka qenë në arrati dhe gjatë dy jave dhe nuk ka mundur të kapet nga organet e ndjekjes, e po ashtu me asnjë provë konkrete nuk është mbuluar dyshimi i bazuar se po të gjendej në liri i pandehuri do të përsëriste vepra të kësaj natyre, meqë nuk është ofruar asnjë mbështetje faktike se i njëjti është kryes i shumë veprave penale.

Gjykata me rastin e vendosjes për vazhdimin e paraburgimit nuk mund te mjaftohet në arsyetimin e saj duke u kufizuar thjesht e vetëm në perifrazime standarde, më tepër

⁴⁰⁸ Shih kërkesën (mendimin) e Prokurorit të Shtetit

⁴⁰⁹ Po aty

referuese mbi dispozitat e KPP-së, që parashikojnë kushtet e kriteret pa arsyetuar në mënyrë ezauruese se si e përse gjejnë ato zbatim në çështjen konkrete.

Në kuptim të kësaj që u tha më lartë referohet edhe vendimi i GJEDNJ, se “ ... në arsyetimin e vendimit të gjykatës duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimi ose jo të kërkesës/ankesës për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit dhe jo të bëhet një përshkrim ritual e formal i shkaqeve e kriterëve të parashikuara nga ligji (Mansur kundër Turqisë, 1995), (Smirnova kundër Rusisë, 2003)”.

Po ashtu, Gjykata me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 185 par. 3 të KPP-së, “Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij”, që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit *ultima ratio* dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara. Për më tepër këto të drejta në favor të akuzuarit janë të garantuara edhe përmes nenit 5.3 të KEDNJ, “pra, jo vetëm në caktimin e masës arrest në burg, por edhe në shqyrtimin gjyqësor të kërkesës për revokim ose zëvendësimin e kësaj mase në të ardhmen”, gjykata duhet të mbajë parasysh se: “prezumimi është në favor të lirit të të arrestuarit. Neni 5/3 i Konventës nuk i jep autoritetit gjyqësor të drejtën të zgjedhë në mënyre alternative midis dërgimit të të akuzuarit në gjyq brenda një kohe të arsyeshme, ose dhënies atij të lirisë së përkohshme deri në kohën e gjykimit (Neumeister kundër Austrisë, 1968).

Nga arsyet e sipër cekura është vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

PKR nr.../13 të datës 20.02.2013

Sekretarja juridike,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në _____

Formulari numër 5. Aktvendim për vazhdimin e masës së paraqitjes në stacionin policor

PKR.nr..../13.../12PR1

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËR KRIMET E RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues _____, me Sekretaren juridike _____, në çështjen penale kundër të akuzuarit _____ nga fsh. _____ Komuna e _____ për shkak të veprës penale trafikim me qenie njerëzore nga neni 139 par. 1 të KPK-së, duke vendosur, pas ngritjes së aktakuzës të ish Prokurorisë Qarkut në Prishtinë, PP.16...-../2012 të dt. XX...2012, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 193 parag. 2 të KPP-së, me dt _____2013 mori këtë:

A K T V E N D I M

Kundër të pandehurit,

_____ i biri i _____ dhe e ëmës _____ e gjinisë _____, i lindur me _____, në fsh. _____ Komuna _____, ku edhe jeton, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

VAZHDOHET MASA E PARAQITJES NË STACIONIN POLICOR në afat prej 1 (një) muaj dhe atë nga dt.26.04.2013 deri me 25.05.2013,

Detyrohet i akuzuari që gjatë kësaj periudhe kohore të paraqitet në Stacionin Policor në _____ një herë në javë dhe atë çdo të hënë në orën 10:00, në rast të moszbatimit të saj nga i pandehuri.

Në rast të shkeljes së këtij detyrimi, ndaj të akuzuarit, mund të shqiptohet masa e paraburgimit.

Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ushtruar aktakuzën PP. 168-2/2012 të dt.06.07.2012, kundër të akuzuarve _____ dhe _____ për shkak të veprës

penale trafikim me qenie njerëzore nga neni 139 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, NN për shkak te veprës penale në mundësim i prostitucionit nga neni 201 të KPK-së.

Gjykata Themelore në _____ duke vepruar në kuptim te nenit 193 parag.2 te KPP-se, shqyrtoi arsyet për vazhdimin e masës së sipër shënuar dhe gjeti se edhe me tutje ekzistojnë arsyet për vazhdimin e kësaj mase.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi, se ekzistojnë edhe me tutje arsyet për vazhdimin e masës së paraqitjes në stacion policor konform nen.178 par.1pika 1.1 dhe 1.2 të KPP-së.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se ekziston dyshimi i bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale trafikim me qenie njerëzore nga neni 139 par.1 të KPK-së.....E po ashtu ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të mund të largohet nga Kosova dhe atë duke u mbështetur në faktin se i akuzuari posedon leje qëndrimi Zvicerane, e për më tepër edhe familjarët e tij jetojnë në këtë vend, andaj mbi këto rrethana ekziston rrezik konkret dhe real se i akuzuari mund të ikën me ç’rast do të vështirësonte zbatimin e suksesshëm të procedurës penale të iniciuar ndaj tij.

Nga sa u tha ma lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË....., DEPARTAMENDI PËR KRIMET E RËNDA,
PKR.nr.2...../12PR1, dt. 2XX.04.2013**

Sekretare Juridike,

Kryetari i trupit gjykues,

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankese, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, ne afat prej 3 ditë pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në . _____

PROCESVERBALI I SHQYRTIMIT FILLESTAR

I përpiluar më datën 18.10.2013, në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjilan, në çështjen penale ndaj të pandehurit _____, nga Gjilani, për shkak të veprës penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike, nga neni 274 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prezantojnë:

Kryetari i trupit gjykues,

Prokurori i shtetit

I pandehuri

Sekretarja juridike,

Mbrojtësi

Filloi në ora 9:15 minuta

Shqyrtimi fillestar është publik.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtimin e sotëm fillestar prezantojnë Prokurori i shtetit _____, i pandehuri _____ dhe mbrojtësi i tij, avokati _____, nga Gjilani.

Kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e këtij shqyrtimi fillestar.

Kryetari i trupit gjykues e fton të pandehurin dhe nga i njëjti merr shënimet personale.

I pandehuri _____, me nofkën “_____”, nga babai _____, nëna _____, e lindur _____, i lindur me date 08.08.1988 në Gjilan, tani me vendbanim në fshatin _____, Komuna e Gjilanit, me numër personal _____, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, punon si instalues i rrymës dhe ujësjellësit, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme.

Kryetari i trupit gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar për çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen e tij nuk e ka për detyrë ta inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as ta pranojë fajësinë, të mbrohet vet ose përmes mbrojtësit dhe ta kundërshtojë aktakuzën ose pranueshmërinë e provave të cekura në aktakuzë.

Nga shkresat e lëndës shihet se një kopje e aktakuzës i është dorëzuar mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa duke u bazuar në nenin 245 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kryetari i trupit gjykues ia jep nga një kopje të aktakuzës të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se e drejta në mbrojtës e të pandehurit është respektuar dhe se prokurori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP.

Të pandehurin _____, në këtë çështje penale sipas autorizimit do ta mbrojë avokati _____, nga Gjilani.

Ftohet Prokurori i shtetit që të pandehurit t’ia lexojë aktakuzën PP.nr.11/2013, e datës 01.11.2013.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri deklarojë se e kuptova në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohem, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale që më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Prokurori shtetit _____ dhe mbrojtësi i të pandehurit, avokati _____, konsiderojnë se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë.

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve mori këtë:

AKTVENDIM

Pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit _____, për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur, ngase kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë; pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin _____; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çartë ligjore ose gabime faktike.

Gjithashtu, kryetari i trupit gjykues konstaton se i pandehuri edhe më parë e ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Pa vërejtje.

Nuk ka propozime tjera.

Meqenëse nuk ka propozime tjera, kryetari i trupit gjykues tërhiqet për ta marr aktgjykimin dhe shqiptuar dënimin, ndërsa publikimi i aktgjykimit do të bëhet në sot në ora 11:15 minuta.

Përfundoi në 9:50 minuta.

I pandehuri,

Prokurori i shtetit,

Mbrojtësi i të pandehurit,

Vërtetojnë:

Sekretarja juridike,

Kryetari i trupit gjykues,

Formuari numër 7. Aktvendim për hudhjen e aktakuzës

P.nr.111/2011

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes Gjyqtarit _____, me Sekretaren juridike _____, në lëndën penale kundër të pandehurit _____, nga Gjilani, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilin sipas autorizimit e mbron avokati MM, nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.111/2011, e datës 03.03.2013, më datën 12.08.2013, mori këtë:

AKTVENDIM

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.111/2011, e datës 03.03.2013 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit Limon Limoni, nga Gjilani, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 i KPRK, **ngase vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale.**

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit _____, nga Gjilani, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 i KPRK.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje juridike penale është mbajtur më datën 15.07.2013 dhe meqë i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, atëherë gjyqtari i vetëm gjyqtari, duke u bazuar në nenin 245 paragrafi 5 fjalja e fundit e Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka kërkuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, që deri në datën e shqyrtimit të dytë gjyqësor ti paraqesin vetëm kundërshtimet dhe kërkesat për hudhjen e aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit _____, avokati _____, nga Gjilani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Prokurori i shtetit _____, gjatë shqyrtimit të dytë, i ka propozuar gjyqtarit të vetëm gjykues që ta refuzoj kërkesën e mbrojtësit të pandehurit për hudhjen e aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës, si dhe të shkresave të lëndës, konstatoi se duhet të hudhet aktakuza e lartcekur dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit _____, ngase vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale.

Në këtë aspekt, i pandehuri _____, nga Gjilani, sipas aktakuzës së lartcekur është akuzuar për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 i KPRK. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se këtë vepër penale e kryen “Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare...”. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, për të ekzistuar kjo formë e kësaj vepre penale duhet që “personi me dhunë ose me kanosje për përdorimin e qasshëm të dhunës, ta ketë penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”. Pra, **përdorimi i “forcës ose kanosjes serioze” është element esencial i figurës së kësaj vepre penale**, pa të cilin kjo vepër penale nuk mund të ekzistojë. Nga procesverbali nr.0111, i datës 08.02.2013 dhe nga kallëzimi penal, nr.11/11, i datës 10.02.2013, shihet se në rastin konkret nuk është përdorur forca ose kanosja serioze. Një gjë e tillë nuk është theksuar as dispozitivin e aktakuzës së lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm. Përveç këtyre, as dëshmitari _____, gjatë deklaratës së dhënë në polici, nuk ka deklaruar se i pandehuri LL të ketë përdorur forcën apo kanosjen serioze ditën kritike. Andaj, meqë në rastin konkret nuk është përdorur “forca ose kanosja serioze”, atëherë nuk mund të bëhet fjalë as për veprën penale të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 i KPRK. Andaj, duke u bazuar në këtë, veprimet e të pandehurit nuk i përbëjnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 253 paragrafi 1 nënparagrafi 1, nenit 463 paragrafi 3 dhe nenit 454 paragrafi 1 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm
Më 12.08.2013

Sekretarja juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

BIOGRAFIA E AUTORËVE



Afrim Shala, fakultetin juridik e ka përfunduar me sukses të dalluar më datën 30.06.2003, ndërsa, studimet postdiplomike të magjistraturës, në drejtimin juridiko-penal, i ka përfunduar më datën 06.07.2009, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin 2009, ka përfunduar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë.

Në vitet 2004 - 2009, ka punuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Gjilan, pastaj në ProCredit Bank në Gjilan.

Në vitin 2010 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe që nga momenti i emërimit ka punuar si gjyqtar i çështjeve penale. Aktualisht është gjyqtar në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Përveç këtyre, që nga viti 2009 ka punuar edhe si ligjërues i lëndës “E drejta penale”, në Fakultetin Juridik të Kolegjit “Gjilani” në Gjilan.

Është autor i disa artikujve shkencor dhe publikimeve në fushën e shkencave juridike penale.



Bashkim Hyseni, në vitin 2006 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Komunale në Ferizaj. Në procesin e emërimit dhe riemërimit në tetor të viti 2010 emërohet Kryetar i kësaj Gjykate.

Si rezultat i reformave dhe riorganizimit të sistemit gjyqësor në Kosovë me 1 janar 2013 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës emërohet kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj.

LITERATURA:

1. **Çollaku, Hashim:** Prokurori publik në procedurën penale (Aspekti teorik dhe praktik), Prishtinë, 2010.
2. **Dhrami, Jorgo:** I pandehuri, "Marrja e një personi në cilësinë e të pandehurit", Tiranë, 2001.
3. **Funk, T. Markus:** Doracak mbi shkathtësitë gjyqësore në Kosovë, Prishtinë, 2006.
4. **Gashi, Ramadan:** E drejta për gjykim publik dhe publiciteti i gjykimit, Prishtinë, 2014.
5. **Hajdari, Azem:** Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010.
6. **Hajdari, Azem:** E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2013.
7. **Hajdari, Azem:** E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013.
8. **Hajdari, Azem:** Shkathësitë e praktikës gjyqësore, Prishtinë, 2013.
9. **Hall, E. Daniell:** Criminal Law and Procedure, Fifth Edition, Delmar, 2009.
10. **Ilić, Mihajlo:** Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997.
11. **Islami, Halim; Hoxha, Artan; Panda, Ilir:** Procedura penale, Komentar, Tiranë, 2003.
12. **Krasniqi, Lavdim :** Fjala hyrëse si shkathtësi e përfaqësimit gjatë gjykimit, Revista "E drejta", nr.2/2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, 2011, Prishtinë.
13. **Krapac, Davor:** Kazneno Procesno Pravo, Zagreb, 2003.
14. **Luarasi, Aleks:** Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2002.
15. **Meksi, Sokrat; Blakaj, Flamur:** Mjekësia ligjore, Prishtinë, 2010.
16. **Murati, Rexhep:** Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe të provave të reja, Prishtinë, 2006.
17. **Pradel, Jean; Corstens, Geert; Vermeulen, Gert:** E drejta penale Evropiane, Dalloz, 2009.
18. **Roxin, Claus:** Strafprozessordnung mit Einführungsgesetz zum Gerichtsverfassungsgesetz, "DTV", München, 2006.
19. **Rrapi, Marenglen:** Komentari i kodit të procedurës penale, Tiranë, 2000.
20. **Sadiku, Isuf:** Ekzekutimi i sanksioneve penale në dritën e akteve më të reja ndërkombëtare, Prishtinë, 2010.
21. **Sahiti, Ejup:** Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë, 1999.
22. **Sahiti, Ejup:** E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.
23. **Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep:** E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013.

24. **Salihu, Ismet; Zhitija, Hilmi; Hasani, Fejzullah:** Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014.
25. **Sijerčić-Ćolić, Hajrija:** Krivično procesno pravo, Sarajevo, 2005.
26. **Smibert, Jon:** Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013.
27. **Smibert, Jon:** Parimet e provave, Prishtinë, 2014.
28. **Shala, Afrim :** Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.
29. **Shala, Afrim:** Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.
30. **Shala, Afrim:** Organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës sipas Ligjit për Gjykatat, Revista Shkencore “Norma”, Kolegji “Gjilani”, Gjilan, 2013.
31. **Shala, Afrim:** Hyrje në të drejtën penale, Botimi i dytë, Gjilan, 2013.
32. **Shefani, Altin:** E drejtë penale e krahasuar, Tiranë, 2012.
33. **Vasiljevic, Tihomir; Grubac Momčilo:** Komentar Zakon o Krivicnom postupku, Beograd, 2003.

PUBLIKIME TJERA

1. Benchbook for U.S. District Court Judges, Fifth Edition, Federal Judicial Center, September 2007.
2. Buletini i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, Vëllimi I, Prishtinë, 2014.
3. Crown Court Bench Book, Directing the Jury, March, 2010.
4. Commentary on The Bangalore Principles of Judicial Conduct, United Nations Office on Drugs and Crime, September, 2007.
5. Deskbook for Chief Judges of U.S. District Courts, Third Edition, Federal Judicial Center, 2003.
6. E drejta penale, Ligjet e aplikueshme në Kosovë, Publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2014, Prishtinë.
7. Magna Carta of Judges, (Fundamental Principles), Consultative Council of European Judges, Strasbourg, November 17, 2010.

AKTET JURIDIKE:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Kodi i Procedurës Penale.
3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
4. Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut.
5. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

6. Ligji për Gjykatat.
7. Kodi i Drejtësisë për të Mitur.
8. Ligjin për Amnistinë.
9. Ligji për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.
10. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje.
11. Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe parandalimin e financimit të terrorizimit.
12. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.
13. Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.
14. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve.
15. Ligji për mbrojtjen e informatorëve.
16. Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.
17. Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.
18. Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
19. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.
20. Vendimi KGJK.nr.40, i datës 22.02.2012, për Ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.